



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve
Shoqërore”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE NË “INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE”

Tiranë, më 28/06/2018



PËRMBAJTJA	Faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4 - 7
II. HYRJA	17-20
a. Objektivat dhe qëllimi	
b. Identifikimi i çështjes	
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
d. Përgjegjësitë e audituesve	
e. Kriteret e vlerësimit	
f. Standardet e auditimit	
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	19-20
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	
A. Auditim i Përgjithshëm për administrimin në tërësi të sigurimeve shoqërore për vitin 2016	
1. Plani i buxhetit i Sigurimeve Shoqërore dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit ¹	20-33
2. Auditimi i fondit të Sigurimeve Shoqërore (të ardhurat) të mbledhura nga kontributet e detyrueshme, vullnetare dhe suplementare ²	34-55
3. Auditimi i shpenzimeve për Sigurimet Shoqërore ³	55-60
4. Mbi deficitin e sigurimeve shoqërore ⁴	61-81
B. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e ISSH	
1. Organizimi dhe funksionimi i ISSH në përputhje me rregulloret e miratuara ⁵	81-85
2. Vlerësimi i organizimit dhe funksionimit të Këshillit Administrativ	86-95
3. Funksionimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm	95-107
4. Funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit ⁶	107-113
C. Auditimi i Pasqyrave Financiare në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.	
1. Auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të ISSH ⁷	113-123
2. Auditimi i Aparatit të ISSH ⁸ :	

¹ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018; Pika B/ 1.1; 1.2;

² Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, Pika B/ 1.4

³ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, Pika B/ 1.3

⁴ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, Pika B / 1.3

⁵ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, ojesë përbërëse e pikës A / 1.1

⁶ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, Pika C/1.1

⁷ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, Pika A / 2

⁸ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, Pika A / 2



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

a. Mbi planin e buxhetit të ISSH	123-126
b. Mbi pasqyrat financiare të Aparatit të ISSH	126-145
c. Inventarizimi i pasurisë	145-147
d. Rregullshmëria e dokumentave të ditareve të arkës dhe bankës	147-151
e. Ligjshmëria e prokurimeve dhe fondeve publike	151-160
IV. ZBATIMIT TË DETYRAVE TË LËNA NË KONTROLLIN E MËPARSHËM⁹	160-169
V. TË NDRYSHME	169-178
VI. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	179-195
VII. ANEKSE	196-204

⁹ Drejtimi sipas programit të auditimit nr. 1345/1, datë 19.01.2018, Pika C / 1.2

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE****I/1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me:

1. Zbatueshmërinë e rekomandimeve të mëparshme,
2. Njohjen me aktivitetin ekonomik-financiar të ISSH dhe organizimin e funksionimit sipas rregulloreve të miratuara,
3. Vlerësimin e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Administrativ në ISSH
4. Vlerësimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm dhe sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe
5. Auditimin e pasqyrave financiare të ISSH

Gjithashtu nga pikëpamja e përputhshmërisë me aktet ligjore, nënligjore e rregullative në fuqi, gjithashtu iu kushtua vëmendje e vecantë çështjeve që lidhen me:

6. Plani i buxhetit i Sigurimeve Shoqërore dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit
7. Auditimit të të ardhurave të mbledhura nga kontributet e detyrueshme, vullnetare dhe suplementare
8. Shpenzimeve për sigurime shoqërore
9. Deficitit i skemës së sigurimeve shoqërore

Ky auditim është realizuar edhe me kontributin e ekspertëve polakë, në kuadër të projektit të Binjakëzimit AL 13 IB FI 01 "Fuqizimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm".

I/b. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	Pasaktësi dhe formalitet në programimin e buxhetit për vitin 2017	Faqe 20-32	E mesme	a. Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Makro Ekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, të riorganizojnë dhe mundësojnë programimin e të ardhurave në të gjitha fazat e programimit edhe nga strukturat e ISSH, duke shtuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese; b. Strukturat drejtuese të ISSH/Strukturat që merren me kontributet në ISSH (bujkut) të kërkojnë nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				MBZHR ripërcaktimin e qartë të termit “fermer”, duke i shoqëruar këto ripërcaktime me ndryshimet ligjore për këtë proces; c. Strukturat drejtuese të ISSH, të mundësojnë programimin e shpenzimeve në të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit; d. Të programohen në mënyrë të detajuar <u>shpenzimet administrative</u> në të gjitha strukturat, si për shpenzimet operative, ashtu edhe për shpenzimet e investimeve
2.	Problematika dhe mangësi në hedhjen analitike të kontributeve të mbledhura nga DPT për ISSH.	Faqe 33-55	E mesme	a. Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithëshme të Tatimeve, të riorganizojnë dhe mundësojnë <u>evidentimin</u> e subjekteve të biznesit të madh të cilat nuk paguajnë në rregull, apo nuk derdhen fare kontribute të sigurimeve shoqërore për të punësuarit e tyre; b. Të zgjidhet nga strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/ Drejtoria e Përgjithëshme të Tatimeve çështjen e mungesës së listëpagesave vjetore; c. Të ndiqen me prioritet mungesa e informacionit për ato raste kur subjektet gjenden me detyrime të papaguara, ose të paguara pjesërisht, për të eliminuar mungesën së periudhave të sigurimit; d. Të ndiqet me prioritet çështja e listë pagesave të munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012
3.	Mbi kontabilizimin jo analitik të të ardhurave të kontributeve, mbledhur nga DPT dhe mos	Faqe 33-55	E mesme	Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/DPT: a. të riorganizojnë dhe mundësojnë regjistrimin e kontributeve të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore të derdhura në DPT dhe të transferuara në ISSH me nënlogari



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	kontabilizimin e subjekteve debitore			përkatëse analitike; b. Listat dhe shumat e debitorëve, të krijuar për kontributet e pa derdhura të sigurimeve shoqërore, të kontabilizuara në DPT, të jenë pjesë e rakordimit vjetor midis dy institucioneve.
4.	Mospërputhje të llogarive dhe vlerave respektive të MFE dhe ISSH për transfertat nga buxheti i shtetit.	Faqe 33- 55	E mesme	Strukturat drejtuese të ISSH/Drejtoria e Financës, dhe Ministria e Financës dhe Ekonomisë të riorganizojnë dhe krijojnë një <u>nomenklaturë të përbashkët llogarish e nënllogarish</u> , mes ISSH dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për transfertat nga buxheti i shtetit, si për mbulimin e deficit, ashtu edhe për mbulimin e skemave të pensioneve.
5.	Mbi analizën e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e deficitit ¹⁰	Faqe 70 -81	E mesme	E arsyeshme nga pikpamja metodologjike është që, rritja e pensioneve si pasojë e indeksimit, të bëhet në të njëjtën kohë me indeksimin e pages minimale. Nën këtë këndvështrim gjithashtu merr rëndësi, qëndrueshmëria në implementimin e politikave, sa i takon indeksimit të pensioneve, në mënyrë që të shmangen diferencat në kohë nga viti në vit.
6.	Mbi rishikimin e numrit të anëtarëve të KA-së pas ndryshimit të fushave të përgjegjësive të ministrive.	Faqe 85- 95	E mesme	Të gjykohet mundësia për të shmangur praninë e dy përfaqësuesve nga e njëjta ministri duke marrë në konsideratë edhe ministrinë e bujqësisë duke qenë se Instituti i Sigurimeve Shoqërore operon me skemat e fermerëve
7.	Eliminimi i llogarive të pagueshme dhe atyre të arketueshme mes Aparatit dhe njërive rajonale, në pasqyrat e konsoliduara të	Faqe 127-146	E mesme	Drejtoria e Financës të marrë masa që përgjatë konsolidimit të pasqyrave financiare të eliminojë llogaritë që mbartim të drejta dhe detyrime brenda grupit.

¹⁰ Konstatim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	ISSH			
8.	Mbi respektimin e parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara	Faqe 127-146	E lartë	Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa për përgatitjen e një urdhri për të gjitha njësitë e varësisë, ku të kërkohet menjëherë njohja në kontabilitet e shpenzimeve në momentin e konstatimit dhe jo vetëm në momentin e lëvrimin të parasë.
9.	Mungesa e gjurmëve të auditit për ndryshimet në strukturën organizative	Faqe 81-85	E lartë	Strukturat drejtuese në ISSH, të marrin masat e nevojshme për miratimin e strukturës aktuale, si dhe ruajtjen e gjurmëve të sakta në rastet e ndryshimeve sipas urdhrave të titullarit për të evidentuar kështu vakancat në drejtoritë përkatëse.
10.	Mbi trupëzimin e shpenzimeve të përmirësimit në Aktivin përkatës në Bilancin Kontabël (për pajisjet IT)	Faqe 127-146	E lartë	Spektori i Financës të marr masa të formatojë dhe plotësojë me informacion, regjistrin e Aktiveve të Patrupëzuara në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu nevojitet të bëhen sistemimet e nevojshme në zërat respektiv të Bilancit kontabël (llogaria 203 dhe 213) dhe në Pasqyrën e Të ardhurave dhe Shpenzimeve (llogaria 6025).
11.	Pasaktësi në llogaritjen e zbritjeve të pagës për shkak të mungesave të justifikuara me raport mjekësor dhe në përgatitjen e borderove	Faqe 127-146	E lartë	ISSH duke marrë shkas nga interpretime të ndryshme që subjekte buxhetore i bëjnë të njëjtin akt ligjor (konkretisht neni 130, pika 1 e Kodit të Punës; neni 22, 23 dhe 25 të pikës 1 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”), të ndërmarë masat e nevojshme për të nxjerrë një interpretim unifikues të bazës ligjore të trajtuar gjatë këtij materiali, duke e bërë atë më lehtësisht të kuptueshëm prej nëpunësve duke mos lënë vend për interpretime të ndryshme..



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
12.	Mbi forcimin e gjurmës së auditimit për kontablizimin e shpenzimeve për pensione, në nivel të konsoliduar	Faqe 127-146	E lartë	Struktura drejtuese në ISSH të marrin masa për kalimin e cdo pike postare dhe banke online (konstatohet se jo të gjitha rajonet janë online); si dhe informacioni I përpunuar nga rajonet dhe gjeneruar nga IT te perfshije ndër të tjera edhe: (a) Shpenzimet e varrimit, (b) Leje lindjet, (c) karburantin, etj.
13.	Mbi kryerjen e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit	Faqe 128-148	E mesme	Strukturat drejtuese të ISSH, të ndjekin procedurat ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimi të mallrave të evidentuara nga komisioni i inventarizimit si të papërdorshme nga institucioni, që prej vitit 2015.
14.	Mbi prokurimet me vlera të vogla	Faqe 152 -159	E mesme	-NA dhe Titullari i institucionit, të hartojnë dhe miratojnë rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve; AK të marrë masa që të mos kalohet asnjë blerje apo shërbim me procedurë të vogël, pa u kaluar nëpërmjet platformës elektronike, në respektim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi. -Njësia e Prokurimit, të marrë masat, që specififikimet teknike, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kriteret e sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik, me qëllim arritjen e mallrave dhe shërbimeve me cilësinë e kërkuar. - AK të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, me qëllim përmirësimin e punës së Njesisë së Prokurimit
15.	Mbi certifikimin e pensioneve	Faqe 170-179	E lartë	a -Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontrolleve dhe çertifikimi i pensioneve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhet jo më vonë se viti i lidhjes së tyre me qëllim identifikimin e në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara nga mos zbatimi me korektësi i akteve ligjore të ligjit nr.7,703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ” në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				<p>mënyrë që fondet për pensione të përdoren me efektivitet në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10 296, datë08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin ”, i ndryshuar neni 2 ;</p> <p>b- Institucioni të marrë masa që të përfundojë kontrollin për 3,613 dosje të identifikuar, në 5 DRSSH (DRSSH Vlorë, Tiranë, Kukës, Durrës), në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar dhe për 596 dosje të identifikuar të pensioneve për suplimentin nga viti 2014 deri më fund të vitit 2016 në DRSSH Berat, Gjirokastrë, Korçë, Tiranë dhe Shkodër.</p> <p>c- Institucioni të marrë masa që të përfundojë kontrollin dhe çertifikimin e dosjeve të pensionit për 96,321 dosje nga viti 2014 e në vazhdim për 12 DRSSH sipas listës nr.2.</p> <p>d- Institucioni të përfundojë kontrollin nga viti 2014, 2015, 2016, 2017 për 5,661 dosje, në 12 DRSSH, që rezultojnë të lidhura për pension suplementar, por që vijojnë të jenë të pakontrolluara nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve.</p>
16.	Mbi certifikimin e pensioneve	Faqe 170-179	E lartë	<p>Në institucion të merren masa që sistemi i hedhjes së të dhënave të pensioneve “Oracle”, të hartojë module ku të reflektohen gjatë hedhjes së të dhënave nga Njësia e Inspektimit të Pensioneve shënimet për çdo dosje të kontrolluar dhe të çertifikuar, me qëllim lënien e gjurmëve të kontrollit të dosjeve të pensioneve.</p> <p>Njësia e Inspektimit të Pensioneve duhet të krijojë një “Fjalor të unifikuar”, në mënyrë që komentet në sistemin “Oracle”, në përfundim të kontrollit të përfitimeve të pensioneve të jenë të unifikuar dhe sipas një formati gjithpërfshirës informacioni.</p>
17.	Mbi respektimin e afateve të lidhjes dhe dokumentimi të pensioneve për vitin 2017	Faqe 170-179	E lartë	<p>Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa që: të rriten trajnimet e punonjësve që merren me përlogaritjen dhe caktimin e pensioneve; si dhe të publikojë institucionet që nuk kanë dërguar në ISSH, regjistrat e vjetërsisë në punë dhe listëpagesat të institucioneve</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
				qendrore dhe ministrive, në zbatim të kërkesave të VKM nr.464, datë 22.07.1998 “Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë ISSH”, me qëllim përfundimin e dixhitalizimit dhe të skanimit të regjistrave të vjetërsisë në punë dhe të listëpagesave

I/c. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Opinion mbi pasqyrat financiare

Ne nuk shprehim opinion mbi pasqyrat financiare të ISSH. Për shkak të rëndësisë së çështjes së përshkruar në seksionin mbi bazën e refuzimit të opinionit të raportit tonë, ne nuk siguroam evidenca auditimi përkatëse, të mjaftueshme për të marrë një bazë për dhënien e opinionit të auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Baza për Opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Ne vume re se, në ISSH sistemi financiar që integron informacionin në kohë reale nga të gjitha njësitë e varësisë (Oracle) ende nuk është i qenderzuar.

Drejtoria e Financës në ISSH kryen rakordimet për vlerat totale të zërave, duke qenë së kontabilizimet në llogaritë respective kryhen nëpër rajone, ku edhe mbahen dokumentat justifikues. Të dhënat mbi shpenzimet për përfitime që gjenerohen nga sistemet specifike IT (PCAMS dhe CIMS), në fakt nuk shërbejnë si evidencë e mjaftueshme për informacionin kontabël, për shumatat e xhiruara “offline”. Ne testuam 1 agjenci edhe për diferencat offline, nga ku **nuk** na rezultuan diferenca me kontabilitetin. Por ne e kishim të pamundur të verifikonim ose konfirmonim me mjete alternative vlerat “offline” për të gjitha njësitë shpenzuese.

Opinion mbi përputhshmërinë me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi



Ne gjithashtu audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së ISSH me rregullat financiare dhe rregulloret për implementimin e rregullave financiare të ISSH, përfshirë rregullat mbi prokurimet, mbi limitet buxhetore, si dhe rregulla, rregullore, marrëveshje që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të ISSH.

Në opinionin tonë, veprimet në procesin e raportimit financiar, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor kontabël, të aplikueshëm dhe përkatës, si dhe me parimet dhe rregullat, **përveç** kontabilizimit dhe raportimit mbështetur mbi parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (ose kontabilitetit rritës).

Transaksionet e kryera gjatë ekzekutimit të buxhetit të ISSH kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi, përfshirë rregullat e prokurimeve dhe ato buxhetore.

Baza për Opinionin mbi Përputhshmërinë

Në pasqyrat financiare (Bilanci dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) transaksionet e ISSH, duhet të reflektohen mbështetur mbi parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Nga auditimi u konstatua se, kontabilizimi i tyre, nuk mbështetet mbi parimin e kontabilitetit rritës, por mbi atë të lëvrimit të parasë, duke rezultuar në transaksione të paregjistruara në periudhën e duhur kontabël. Edhe pse efekti sasior i këtij konstatimi është vlerësuar vetëm pjesërisht nga ana jonë¹¹, mos aplikimi i parimit të kontabilitetit rritës përbën një cënim të bazës ligjore në fuqi sa i takon aplikimit të parimit kontabël të zbatueshëm.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen e drejtimit për nevojën e rishikimit të ligjit nr. ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, me qëllim sigurimin e parimit kontributiv të skemës, rritjen e përgjegjësiave individuale për pensionet, si edhe drejtësi të sistemit në trajtimin e barabartë kontributiv të kontribuesve/qytetarëve. Në lidhje me sa më sipër, kemi konstatuar se, deficiti i financiar i degës së pensioneve të fshatit, ka rezultuar 11,371.11 milion lekë, nga 11,593.2 milion lekë një vit më parë, pra 222 milion lekë më pak, ose 1.92% më pak se një vit më parë. Edhe pse në vlerë nominale, skema e pensioneve në fshat dhe rezultati financiar i kësaj dege, duket disi i përmirësuar¹², vëmë re që skema e fshatit vijon të subvencionohet nga shteti në masën 41% (tregues ky i cili nuk është përmirësuar në krahasim me vitin 2016) ose në

¹¹ Si pasojë e kufizimit të objektit të auditimit

¹² Përmirësimi ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve nga 53,168 që ishin në vitin 2016, në 58,528 në vitin 2017, duke dhënë një impakt të vlerësuar prej 203,6 milion lekë në kontributet e vitit korent.



masën rreth 1,443 milion lekë, vlerë kjo e cila duke iu shtuar deficitit direkt, e con vlerën e financimit nga buxheti i shtetit në masën 12,814 milion lekë.

Ndërsa skema e qytetit kontribuon në totalin e të ardhurave të skemës së pensioneve në masën 95%, ndërsa në shpenzime vetëm 85% (pra me një diferencë prej 10% të ardhura mbi shpenzimet), ky raport paraqitet në kah të kundërt për skemën e fshatit, ku kjo e fundit rezulton të kontribuojë në të ardhurat e mbledhura vetëm 5%, ndërkohë që përthith shpenzime rreth 15% të total shpenzimeve të skemës së pensioneve. Skema e fshatit, edhe pse me një kontribut relativisht të ulët në të ardhura (prej 5%), vërehet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme të total deficitit prej 41%.

Gjithashtu, bazuar në VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar me VKM nr. 551, datë 27.07.2016, të vetpunësuarit në bujqësi paguajnë kontribute sipas një tarife kontributeve vjetore, e cila për zonat fushore është 38,400 lekë në vit dhe për zonat kodrinore malore është 29,400 lekë në vit.

Gjithashtu tërheqim vëmendjen e drejtimit për nevojën që në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Makro Ekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit, (a) të mundësojnë programimin e të ardhurave në të gjitha fazat e programimit edhe në strukturat e ISSH, duke shtuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese që mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhura të mos vijnë të gatshme në ISSH, e të programohen drejt e pa rezerva; si dhe (b) të mundësojnë programimin e shpenzimeve në të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit

Theksojmë nevojën e aplikimit të indeksimit të pensioneve dhe politikave që lidhen me këtë proces, në periudha të njëjta cdo vit, për të shmangur cdo lloj risku që lidhet me politizimin e procesit, dhe impaktin e procesit në rritjen e deficitit si pasojë e shtimit të muajve pordheluhatjeve të vetë koeficientit të indeksit në muaj të ndryshëm të vitit. Në vitin 2017, rritja e pensioneve sipas indeksit të cmimeve është implementuar që në muajin mars 2017. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 2013-2017, Këshilli I Ministrave ka miratuar datën e indeksimit të pensioneve, në mbështetje të kërkesave të nenit 61 të ligjit për sigurimet shoqërore, të cilat për cdo vit, duke filluar nga vitit 2013, kanë hyrë në fuqi më datë 01.08, ndërsa me VKM nr. 130, datë 22.02.2017 “Për indeksimin e pensioneve”, indeksimi për vitin 2017 është bërë në muajin Mars 2017¹³. Në vitin 2017, si pasojë e indeksimit 4 muaj më herët, impakti në rritjen e shpenzimeve ka qenë 1,120 milion lekë më shumë se në vitin 2016.

Në rritjen e shpenzimeve për pensione përveç shtesës së periudhës 4 mujore, ndikoi edhe vetë niveli i rritur i koeficientit të indeksimit të cmimeve. Në vitin 2016 indeksi rezultoi 1.6 %, ndërsa në vitin 2017, ky indeks ishte 3%, duke sjellë një impakt prej rreth 780 miliona lekë shpenzime më

¹³

Viti	VKM	Hyn ne fuqi
2013	583, date 17.07.2013	01.08.2013
2014	456, datë 09.07.2014	01.08.2014
2015	651, datë 22.07.2015	01.08.2015
2016	549, datë 27.07.2016	01.08.2016
2017	130, datë 22.02.2017	01.03.2017



shumë. Pra në total, efektet shtese nga indeksimi i pensioneve, rrezultojnë rreth 1,900 milione lekë më shumë. Por ndërsa pensionet u rriten me efekte nga 01.03.2017, pagat u rriten me efekt nga muaji maj kontributet e të cilit derdhen në muajin qershor. Pra kemi edhe një diferencë prej 3 muaj me një efekt në të ardhura, të vlerësuar në rënie nga ISSH, me rreth 300 milione leke në muaj, ose në total 900 milionë leke. Këta janë tre faktorë që nëse do të zhvilloheshin në të dy vitet në kushte të njëjta, do të kishin impakt pozitiv në uljen e deficitit nominal,

Çështjet kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat në gjykimin tonë, kanë rezultuar më të rëndësishme gjatë auditimit. Këto çështje u trajtuan gjatë auditimit të pasqyrave financiare në tërësi, të pajtueshmërisë ligjore, si dhe mbi të cilat u mbështetëm për formulimin e opinionit tonë lidhur me auditimin. Çështjet kryesore në auditimin në ISSH për vitin 2017, paraqiten si më poshtë:

1. Përgatitja dhe mbajtja e kontabilitetit analitik sipas llogarive të klasës 9 është e domosdoshme, për të ndjekur përputhjet e shpenzimeve me burimet që përdoren për mbulimin e tyre.
2. Shpenzimet për pensione paraqesin një zë të rëndësishëm në pasqyrat financiare të ISSH. Procesi i shpenzimeve për pensione në ISSH suportohet nga sistemi i IT-së, CIMS, që përfshin një sërë të dhënash kyçe të cilat aktualisht i përdorin degët e përfitimeve. Ky informacion duhet të finalizohet në një informacion financiar të konsoliduar për tu përfshirë në pasqyrat financiare (deri tani ky informacion përdoret vetëm për qëllime statistikore). Çështja u trajtua në auditim nëpërmjet krahasimit të të dhënave të gjeneruara nga sistemi CIMS, të dhënave kontabël nga sistemi Oracle i agjencisë Fier (me ndihmën e excel-it) dhe evidencës fiskale që dorëzohet në Drejtorinë e Financës, ISSH për 1 agjenci të vecantë, për të cilën nuk pati diferencë.
3. Të ardhurat nga Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve paraqesin një zë material në pasqyrat financiare të ISSH. Kontributet e mbledhura nga DPT, për llogari të ISSH për subjektet fizikë, publikë dhe privatë dhe sistemimet e mëvonshme të këtyre kontributeve, nuk regjistrohen në kontabilitetin e ISSH me numra llogarish të specifikuar për çdo lloj kontributi, por regjistrohen në një llogaritë vetme - 512100 “Të ardhura të hyra nga llogaria e unifikuar e thesari-TSA”, llogari e cila nuk jep sigurinë analitike të krijimit të të ardhurave. Si pasojë, në pasqyrat financiare të konsoliduara të ISSH, kjo shumë reflektohet në mënyrë joanalitike, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.7661, datë 10.04.1998 “Për kontabilitetin”.
4. Aktivitetet e qëndrueshme: Çështja u trajtua nëpërmjet verifikimit të aseteve për Aparatin e ISSH, duke kryer procedurë analitike (rikalkulime nga Regjistri I Aseteve të vëna në dispozicion) dhe krahasimi me vlerat e kontabilizuara, kontrolle fizike mbi ekzistencën e aseteve të përzgjedhura, si dhe verifikimi i dokumentacionit ligjor. Sa i takon llogarisë 203 “Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme”, nga auditimi u konstatua se, është mbajtur Regjistri i Aktiveve¹⁴ edhe për këto kategori aktive, por ndërsa identifikohen total shtesat ndër vite ndaj vlerës totale të Aktivit, nuk janë të identifikueshme vec e vec aktivet e patrupëzuara (pra nga se përbëhet vlera). Paraqitja e Regjistrimit të Aktiveve në këtë lloj

¹⁴Referoju Ankesit 2



formati, ku mungon identifikimi i tyre sipas llojit, vecanërisht në kushtet kur ISSH ka një sërë sistemesh IT të cilat duhet të mirëmbahen, nuk na shërben si evdencë e mjaftueshme¹⁵ për të dhënë siguri të arsyeshme rreth regjistrimit të saktë të vlerës së këtij Aktivi. Kjo sjell një impakt (të vështirë për tu vlerësuar nga pikëpamja sasiore), edhe mbi vlerën e amortizimit të këtyre pajisjeve, si edhe mbi kostot e mirëmbajtjes që duhet të trupëzohen në aktivet respektive. Kemi konstatuar se, shpenzimet e mirëmbajtjes së sistemeve IT, të kryera për vitin 2017, në shumën 92,280,000 lekë janë njohur me pa të drejtë, si shpenzim periudhe (në llogarinë 602), në një kohë që në fakt duhen konsideruar si kosto të përmirësimit, që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve, duke qenë se dhe vlera e tyre është më e madhe së 15% e vlerës kontabel të mbetur të aktiveve, kjo në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 1, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi te ardhurat”.

5. Eliminimi I llogarive të pagueshme dhe arkëtueshme: Shuma prej 29,262,163.57 leke, e reflektuar në llogarinë 468 “Të Drejta të Arkëtueshme” konsiston në vlerën e librezave të kontributeve që Aparati ka shpërndarë në Rajonet e Sigurimeve Shoqërore e që këta të fundit ua shesin klientëve. Në kuptimin e të drejtave që ISSH ka për këtë aset, vlerësojmë se në pasqyrat e konsoliduara ky zë nuk ka kuptim të reflektohet me kundërparti shumën respektive në llogarinë 401-408 “Klientë e llogari të lidhura me to”, sikundër kemi konstatuar. Në pasqyrat financiare të konsoliduara Llogaritë e Pagueshme dhe ato të Arkëtueshme mes njësisve shpenzuese dhe Aparatit duhet të eliminohen.
6. Ndërsa për shpenzimet e pensioneve Drejtorja e Financës në ISSH e merr shumën për pjesën e shpenzimeve off-line¹⁶ nga Rajonet, pasi dokumentat mbështetëse ndodhen nëpër Rajone, dhe nga sistemi IT këto të dhëna nuk vijnë në kohë reale. Për të rritur nivelin e sigurisë për llogaritë që lidhen me shpenzimet e pensioneve në nivel të konsoliduar, përzgjedhëm në mënyrë rastësore agjencinë e Fierit¹⁷ konkretisht muajin nëntor ku në përfundim nuk na rezultuan diferenca. (Procesi për këtë kategori shpenzimi paraqitet në Aneksin 5 të projekt raportit të auditimit).
7. Në përfundim konkluduar se, për të rritur nivelin e sigurisë në nivel pohimi, për zërat respektivë të shpenzimeve në të gjitha rajonet e ISSH do të nevojitej që:
 - Çdo pike postare dhe banke duhet te jete online (konstatohet se jo të gjitha rajonet janë);
 - Informacioni nga IT duhet te perfshije: (a) Shpenzimet e varrimit, (b) Leje lindjet, (c) karburantin, etj.

Duke konsideruar se, pikërisht në këtë hallkë të procesit kemi “thyerje të kontrollit” nga ana e Drejtorisë së Financës në ISSH, përzgjedhëm 266 çështje¹⁸, nëpërmjet kryerjes së testeve të detajeve, për shifrën e plotë të shpenzimeve për pensione, kontabilizuar në muajin Nëntor, në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, Fier. Nga kryerja e testeve të detajeve mbi popullatën e përzgjedhur na rezultoi se vlera prej 500,679,072 lekë e njohur si shpenzim në kontabilitet rakordon me të dhënat e gjeneruara nga sistemi PCAMS (për pjesën on-line të shpenzimeve), plus pjesa off-line 52,919,856 lekë, e verifikuar me

¹⁵Mbështetur në ISSAI 1500

¹⁶ Shpenzimet që kryhen nga posta, ose bankat, për rajonet ku këto të fundit janë “off”line”

¹⁷ Zgjedhëm agjencinë Fier pasi aty vetëm posta është off/line.

¹⁸Referoju Aneksit 4 për materialitetin; dhe linkut: [Teste Agjencia Fier.xlsx](#)



dokumentat justifikues (raportet e postës¹⁹) dhe stornuar një nga një nga specialisti i pagesave në Rajon.

Përgjegjësitë e Drejtimit të ISSH

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*Nëpunësi autorizues*), Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*Nëpunës aututorizues i dytë zëvendësues*), Drejtori i Drejtorisë së Financës (*Nëpunësi zbatues*), si dhe Drejtori i Sektorit të Financës (*Nëpunësi zbatues i dytë, zëvendësuese*), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Drejtimi i ISSH^{së} është përgjegjës për përputhshmërinë e vepimtarisë së ISSH me rregullat financiare dhe rregulloret për implementimin e tyre, përfshirë rregullat mbi prokurimet, mbi limette buxhetore, si dhe rregulloret, marrëveshje që dhe dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve /burimeve të ISSH^{së}.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali material, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu dhënia e një opinioni mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.
- Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke patur si qëllim kryesor dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të ISSH.
- Vlerësojmë nëse politikat kontable të zgjedhura nga stafi drejtues janë të duhurat dhe të arsyeshme.
- Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të kontabilitetit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi

¹⁹[praktika e nje qender paguese poste-sigurime.pdf](#)



aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

- Vlerësojmë informacionin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe shënimet, për të evidentuar nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksione rutinë dhe ngjarje të prezantuara drejt.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë ne lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Auditimi gjithashtu është kryer në përputhje me ISSAI 4200 (Auditim Pëpruthshmërie lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare), i cil ka për qëllim të vlerësojë nëse:

- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; dhe
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1345/1, datë 19/01/2018, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore për periudhën nga 18.01.2018 deri në 15.04.2018, sipas miratimit të shtesës në program nr.282 prot datë 01.03.2018 nga Kryetari i KLSH u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore” për periudhën 01.01 – 31.12.2017, nga grupi i auditimit më përbërje:

1. A.J, Përgjegjëse Grupi
2. N.LI, Auditues
3. M.B, Auditues
4. V.S, Auditues
5. A.K, Auditues
6. J.T, Auditues

Ky auditim i kushtoi një vëmendje të vecantë çështjeve që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, plotësimin e pasqyrave financiare në afat, dhënien e opinionit për saktësinë e



paraqitjes së zërave të aktivitetit dhe pasqyrave të tjera shoqëruese të bilancit, përputhshmërinë e aktivitetit dhe transaksioneve financiare me kuadrin ligjor përkatës.

Auditimi u krye me zgjedhje, për vlerësimin e saktësisë së raportimit financiar të aktivitetit ekonomik të mbyllur më datë 31.12.2017, përputhshmërinë me kuadrin rregullativ e ligjor përkatës, dhe transaksioneve financiare, nga datat 18.01.2018 deri më 15.04.2018.

Titulli:

Raporti i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore

Marrësi:

Ky Projektraport i adresohet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorit Ekzekutiv dhe Zv/Drejtorit.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

-Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.

-Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.

-Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si; transaksione, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare. Gjithashtu, lidhur ky qëllim me aspektin e përputhshmërisë ligjore dhe rregullative të këtyre transaksioneve, mundësohet një qasje më e gjerë e analizimit të aktivitetit të këtij institucioni në tërësi. Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Gjithashtu ky auditim ka për qëllim edhe kryerjen e auditimit të përputhshmërisë (pajtuueshmërisë) me qëllim përcaktimin nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si psh me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; si dhe nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

b) Identifikimi i çështjes:

Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, është realizuar në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të



sipërcituarasi edhe shoqërohen me relacion shpjegues (si lista e kreditorëve, e debitorëve, akt-rakordimet me sistemin e Thesarit, si edhe shpjegime të tjera sa i takon evidentimit të transaksioneve në llogaritë respektive).

Për ushtrimin e aktivitetit, ISSH mbështetet në Ligjin nr 7703, datë 11.05.1993 "Per sigurimet shoqërore ne RSH" dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore të dala në funksion të tij si dhe rregullore e udhëzime përkatëse. Për vitin 2017, subjekti gjithashtu është mbështetur në Ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017", si dhe aktet normative për ndryshime në ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017, etj.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar (trajtuar te opinioni).

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH për auditimin e pasqyrave financiare (trajtuar te opinioni).

e) Kriteret e vlerësimit:

-Ligji nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017",

- Aktet Normative "Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017",

-Ligji nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në RSH", i ndryshuar;

-Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar;

-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar

-Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar;

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar,

-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik".

-UMF nr. 14, datë 28.12.2006, "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre" i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

-Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar

-Rregullorja e Personelit, VKA nr. 3, datë 26.02.2008

-Rregullore Financiare nr. 5, datë 25.05.2009 e Institucionit të Sigurimeve Shoqërore

- Ligji nr 7703, datë 11.05.1993 "Per sigurimet shoqërore ne RSH", etj

f) Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar të KLSH, Manualin e Auditimit të Përputshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

II.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi, dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij Institucioni, mbulimi i



popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

Objektivat e përgjithshme të ISSH-së

- a. Vazhdimi të punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve.
- b. Zbatimit të politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve nëpërmjet rritjes së masës së pensioneve, nëpërmjet indeksimit të tyre.
- c. Përmirësimi të administrimit të buxhetit të ISSH-së dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- d. Vazhdimi të punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i plotë i një sistemi të informatizuar të autorizimit dhe pagesave të pensioneve në mënyrë online, si për pagesat në zonat urbane ashtu dhe ato rurale;
- e. Përmirësimi rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, fokusimin e tij në luftën kundër informalitetit, duke zbatuar standartet e përcaktuara.

2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit

- a. Objekti i këtij auditimi është dhënia e një opinioni mbi pasqyrat financiare të institucionit, si dhe dhënia e një konkluzioni mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimeve dhe shpenzimet vjetore të buxhetit.
- b. Qëllimi i auditimit është përcaktimi nëse pasqyrat financiare të subjektit që auditohet janë paraqitur saktë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara, janë në cdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë ISSH.
- c. Fushëveprimi i këtij auditimi lidhet me pasqyrat financiare të konsoliduara dhe në vecanti pasqyrat financiare të aparatit të ISSH. Evidencat janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e ISSH, duke qenë se nuk kanë qenë objekt auditimi, njësitë e tjera shpenzuese të ISSH.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET

I. AUDITIM I PËRGJITHSHËM PËR ADMINISTRIMIN NË TËRËSI TË SIGURIMEVE SHOQËRORE PËR VITIN 2017.

I/1. Plani i buxhetit i Sigurimeve Shoqërore dhe ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit.

a. Baza ligjore në auditimin e objektivave afatmesme në programimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në funksion të misionit të ISSH-së.

Auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të ISSH, u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:



-Ligjet: nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nr.130/2015, datë 57.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017” dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit; nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në aktet e tjera ligjore dhe nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Sigurimeve Shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

-VKM: nr.8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtesave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300/kv në muaj”; nr. 80, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017-2019”.

-Udhëzimet e Ministrisë së Financave:nr.4, datë 29.02.2016“Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019; nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit” dhe “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”; nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, me ndryshime.

-Akt marrëveshja e Bashkëpunimit datë 19.05.2017, midis Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

-Statuti i të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

-Rregullorja Financiare e ISSH nr. 5, datë 25.05.2009.

Programimi i buxhetit të këtij institucioni realizohet në 15 njësitë e sistemit për: 12 Drejtoritë Rajonale; Drejtoria Qendrore e Arkivit; Llogaria e shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH (Sektori i Buxhetit të Brendshëm); Sektori i Buxhetit të Përgjithshëm, ku realizohen transfertat nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH dhe nga këtu në Drejtoritë Rajonale për pagesat e pensioneve, marrëdhëniet financiare me Ministrinë e Financave dhe me Bankën e Shqipërisë.

Programi “Sigurime Shoqërore” mbulon me fonde të drejta e fituara dhe ato që lindin gjatë vitit planifikues nga skemat e sigurimit shoqëror të detyrueshëm, programeve të veçanta sociale të Qeverisë, sigurimeve suplementare dhe trajtimeve financiare të veçanta. Programi parashikon fonde për kryerjen e funksioneve të ISSH për administrimin e për modernizimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, të infrastrukturës së tij, transmetimit të të dhënave, funksionimit të Regjistrave Qendrore, si dhe komisione shërbimi që u paguhen të tretëve për realizimin e transfertave nga buxheti i ISSH në buxhetet familjare.

Politika e Programit është përmbushja cilësore e misionit të ISSH në mbulimin e popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore dhe në atë kohë kur e drejta lind.

Qëllimi i Politikës së Programit është: Përmirësimi i efikasitetit të ISSH në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, suplementare dhe programore. Vazhdimi i punës për konsolidimin administrativ të ISSH, i aftë e bashkëkohor për t'u integruar dhe zbatuar standartet e BE. Vendosja e personave të siguruar dhe e përmirësimit të shërbimit ndaj tyre, në qendër të veprimtarisë së tij. Plotësimi i kërkesave të aplikantëve jo më vonë 30-35 ditë nga data e aplikimit. Grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe sigurimet vullnetare, administrimi eficient i fondeve përkohësisht të lira dhe i fondit rezervë. Përmirësimi i infrastrukturës, vazhdimi i punës për arkivimin e përqëndruar të dokumentacionit për periudhat e sigurimit dhe dixhitalizimin e tyre.

Objektivat e Politikës së Programit janë: Administrimi i fondit të sigurimeve shoqërore dhe rritja cilësore e shërbimit ndaj të gjithë përfituesve, duke u fokusuar në dhënien e të drejtave në afatet e përcaktuara me ligj nëpërmjet:

a. Përditësimi i bazës së të dhënave të pensioneve dhe kontributeve;



b. Vazhdimin të procesit të modernizimit të të gjithë sistemit të arkivave të vjetërsisë në punë dhe listëpagesave dhe intensifikimit të punës për digitalizimin e periudhave të sigurimit dhe kalimit në historikun kontributiv si llogari individuale.

c. Administrimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit për programe të veçanta të qeverisë, nëpërmjet përditësimit të informacionit dhe koordinimin të punës me Shërbimin Social Shtetëror dhe organet e pushtetit vendor.

d. Administrimi i fondeve të alokuara nga Buxheti i Shtetit për përfitime suplementare për punonjësit e shtetit, për ushtarakët, për policinë e shtetit, për minatorët, për statusin "Dëshmor i Atdheut", punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake, për pilotët fluturues në pension dhe ushtarakëve e nëndetëseve në pension.

e. Administrimi me efikasitet i fondeve për shpenzime administrative për kryerjen e transfertave nga fondet shtetërore në buxhetet familjare të FSSH.

Në përgjigjet e dhëna për pyetSORIN, drejtuar strukturave planifikuese e drejtuese për mënyrën dhe fazat e programimit, rezultoi:

Në përgjigje të pyetjes se sa ndikon dhe kontribon ky institucion në përcaktimin e treguesve kryesorë të kuadrit makroekonomik dhe fiskal të periudhës 2017-2019, ky institucion është përgjigjur: "Programi "Sigurime Shoqërore" mbulon me fonde të drejtat e fituara dhe ato që lindin gjatë vitit planifikues nga skemat e sigurimit shoqëror të detyrueshëm, programeve të veçanta sociale të Qeverisë, sigurimeve suplementare dhe trajtimeve financiare të veçanta. Gjithashtu, programi parashikon fonde kryerjen e funksioneve të ISSH për administrimin e për modernizimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, të infrastrukturës së tij, transmetimit të të dhënave, funksionimit të Regjistrave Qendrore, si dhe komisione shërbimi që u paguhen të tretëve për realizimin e transfertave nga buxheti i ISSH në buxhetet familjare. Duke qenë unik për gjithë vendin, puna përgatitore, përllogaritjet, parashikimet dhe supozimet që bën ISSH drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet programeve aktuale janë një mbështetje bazë për përcaktimin dhe miratimin e tavaneve të shpenzimeve, të cilat miratohen nga qeveria sipas fazave të programimit. Buxheti i

Konkluzion: ISSH, ende nuk ka një bazë të plotë të të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë dhe për pasojë edhe baza e vlerësuar për efekt të përllogaritjes së pensionit kalkulohet rast pas rasti. Mbi bazë parashikimesh përllogaritet edhe numri i invalidëve, pensioneve familjare etj, si dhe e pensioneve të parakohshme e suplementare, numri i të cilëve varet nga reformat që parashikojnë institucione të tjera si ushtria, policia, administrata publike etj. Për numrin e pensioneve të reja pleqërisë, për të cilët ka informacion të plotë nga regjistri i shtetasve, përsëri ka problematika planifikimi, që lidhen me paraqitjen e kërkesave për përfitimet sepse rreth 40% e popullsisë shqiptare të regjistruar gjendet jashtë shtetit. Për këto arsye dhe të tjera, programi buxhetor i sistemit të sigurimeve shoqërore, mbetet të shqyrtohet e rishqyrtohet e ndryshohet deri në ditën e miratimit në kuvend. Veç kësaj ky program, për shkak të madhësisë së shifrave edhe pasaktësitë në përqindje të vogla, riskon të sjell efekte financiare shumë të larta.

ISSH ka veçori edhe në disa tregues, megjithëse me efekte të konsiderueshme financiare, bazohet në parashikime specifike, që bartin edhe risqe e pasaktësi në programim. Këtu evidentojmë parashikimin e numrit të pensioneve të reja dhe sidomos parashikimin e përfitimit mesatar vjetor të këtyre pensioneve". Grupi i auditimit u drejtoi disa pyetje strukturave që planifikojnë



kontributet dhe shpenzimet: Në përgjigje të pyetjes se a janë programuar të dy fazat e PBA 2017-2019 nga të gjitha strukturat e varësisë, dhe a janë dorëzuar në kohë fazat e programimit nga institucioni, drejtoria përkatëse na konfirmoi se: “Faza e parë e programimit të buxhetit vjetor si dhe atij afatmesëm kryhet vetëm në ISSH, nën përgjegjesinë e grupit të menaxhimit strategjik, si dhe të angazhimit të plotë të sektorit të parashikimeve aktuariale. Faza e dytë e programimit bëhet në të gjitha njësitë e vartësisë, puna e të cilave mbështetet në tavanet dhe politikat e përfitimeve dhe shpenzimeve, si dhe në kërkesat e legjislacionit dhe metodikat e programimit dhe udhëzimin përkatës. GMS dhe grupi qendror i planifikimit, ballafaqon përlllogaritjet e shpenzimeve, kërkesat etj dhe mbi bazën e tyre harton edhe programin analitik të vitit të parë të tre vjeçarit 2017-2019. Treguesit e fazës së dytë të programimit janë dërguar në MMSR me shkresën nr.6055/1, datë 10.08.2016. Për arsyt që përmendëm më lart, treguesit e buxhetit vjetor të ISSH mbeten në vëmendje të grupit të programimit në Ministrinë e Financave, në bashkërkendim dhe koordinim të përditshëm me profesionistët e ISSH, deri në miratimin draftit përfundimtar. Treguesit e projekt buxhetit dhe buxhetit të ISSH, paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Administrativ të ISSH, i cili i miraton ato me vendim, si në total dhe të detajuar sipas njësive shpenzuese. Politikat e pensioneve dhe politikat e mbështetjes financiare të pensionisteve, pavarësisht nga programimi dhe buxheti, janë objekt i miratimit me VKM të veçantë”.

Konkluzion: Pra faza e parë e programimit afat mesëm në këtë institucion, **nuk ka obliguar dhe angazhuar asnjëherë strukturat e varësisë së këtij institucioni**, por vetëm strukturën qendrore të saj, e cila meret me parashikimet e shpenzimeve. E njëjta gjë ka ndodhur dhe për fazën e parë të PBA 2017-2019.

Në përgjigje të pyetjes se si programohen të ardhurat, të cilat mblihen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe a ka vështirësi në këtë proces, drejtoria përkatëse na konfirmoi se: “Deri në vitin 2017, programi i përgjithshëm i të ardhurave si dhe ngarkesa për kontribute të sigurimeve shoqërore të subjekteve, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave, dhe për rjedhoje ISSH ka marrë tregues të gatshëm. Bazuar edhe në detyrat e përcaktuara nga KLSH, në rekomendimet e raportit të auditit për vitin 2016, në analizën që ka bërë KA, për buxhetin 2018, është shqyrtuar dhe dhënë edhe mendimi i ISSH, lidhur me programimin e të ardhurave. Mbi këtë bazë, si dhe të detyrave të lëna nga Ministri i Financave, ISSH i ka komunikuar Drejtorisë së Përgjithshme Makro në Ministrinë e Financave mendimin për përfshirjen në programimin e të ardhurave të vitit 2018 të strukturave të ISSH, të cilat lejojnë një program më real të të ardhurave, duke hartuar një program për vitin 2018, sipas mundësive, duke pasur parasysh evazionin, rritjen ekonomike, mbledhjen e borxheve etj.

Konkluzion: Deri në vitin 2017, programi i përgjithshëm i të ardhurave si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve të mbledhura nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave, dhe për rjedhoje ISSH ka marrë tregues të gatshëm për të ardhurat. Si rezultat në programimin e vitit 2017 në programimin e të ardhurave kishte rezerva e kjo rezultoi që megjithëse programimi i tyre u shtua me akte normative, përsëri të ardhurat nga kontributet që mblihen nga DPT, është tejkuluar me mbi 2.8 miliardë lekë.

Mendojmë se në programimin e vitit 2017 të të ardhurave ende ka rezerva, pavarësisht nga planifikimi, ky plan është tejkuluar me mbi 2.8 miliardë lekë. Kështu duke rujtur të njëjtat argumenta të shtesës së planit për vitin 2018 ndaj planit të 2017, atëherë programimi i të



ardhurave për vitin 2018, nga subjektet nën administrim të tatimeve, duhet të shtohet me mbi 2.8-3 miliardë lekë. Në mënyrë analitike, konsiderojmë se janë këto rezerva të mundëshme për t'u konsideruar të realizueshme: -Paga minimale është rritur në maj 2017 me rreth 9% dhe për vitin 2018 efektin për 5 muaj me një shtesë në të ardhura minimalisht 250 milionë deri 300 milionë lekë në muaj, ose rreth 1.2 deri në 1.5 miliard lekë. -Rreth 45,000 punonjës në çdo muaj derdhen kontribute në nivelin minimal të pagës. Natyrisht këtu ka lëvizje të punonjësve, sepse dikush hyn në punë dhe dikush largohet, por konstatohet se arsyet kryesore nuk janë bindese dhe sjellin evasion, sidomos në subjektet fason, për shkak të kurseve të kualifikimit ndërmjet punës, ku derdhet vetëm sigurim për aksidente (VKM 77). Efekti financiar përlllogaritet nga 110 milion lekë deri në 140 milionë lekë në muaj, ose rreth 1.1-1.3 miliard lekë në vit. -Rritja ekonomike dhe ulja e evazionit të personave të pa regjistruar, duhet të sjellë një shtesë mesatare vjetore të numrit të kontribuesve me rreth 15 mijë persona me një efekt vjetor për rreth 1 miliard lekë. -Borxhet kontributive janë bërë problematike, si në volumin e tyre mjaft të madh, ashtu edhe se përfaqësojnë persona të pa siguruar, prandaj nga përlllogaritja, është e mundur mbledhja e 10% e tyre, me një efekt prej 1 miliard lekë. Në këto kushte është e mundur që planifikimi mund të jetë rreth **4-4.5 miliard lekë** më shumë se realizimi i vitit 2017, duke arritur në një planifikim të kontributeve prej 77 miliardë lekë, duke përmirësuar performancën e sistemit të sigurimeve shoqërore dhe një ulje të transfertës nga buxheti i shtetit për këtë skemë, si nëpërqindje ndaj PBB, ashtu edhe në kuptimin e madhësisë së saj, ndaj vitit 2017.

Konkluzion: Rritja e të ardhurave nga sigurimi i fermerit dhe sigurimi vullnetar do të vijë nga rritja përgjegjshmërisë së inspektorëve në këtë sektor, nga nevoja për një ripërcaktim të termit fermer nga Ministria e Bujqësisë dhe nga rishikimi i skemës së pensioneve për fermerët, shoqëruar me ndryshimet ligjore për këtë proces.

Në përgjigje të pyetjes se si programohen të ardhurat, të cilat mbledhen nga ky institucion, pra të ardhurat nga kontribuesit në bujqësi dhe të ardhurat nga kontribuesit vullnetarë, nga kjo drejtori citohet: “Programi i të ardhurave nga sigurimi vullnetar mban parasysh ecurinë e këtij procesi në një vit më parë, si dhe disa objektiva për rritjen e tij.

Programi i të ardhurave nga sigurimi i personave të **vetpunësuar në bujqësi**, përgjithësisht mbështet në dy faktore: Bilanci i popullsisë aktive në fshat; Zhvillimet dhe rezultatet e viteve të mëparshme dhe rezultatet e pritëshme të vitit në vazhdim. Këto të ardhura do të rriten, kur të rritet numri i popullsisë fshatare të mbuluar me elemente të sigurimeve shoqërore për vitin aktual dhe sidomos për vitet e ardhshme. Aktualisht është aritur të futen në skemë rreth **60%** e personave të mundshëm për t'u siguruar. Në analizat që janë bërë në Drejtoritë Rajonale dhe në qendër është përcaktuar përgjegjësia e inspektorëve në këtë sektor, nevojat për një ripërcaktim të termit fermer nga Ministria e Bujqësisë, rishikimi i skemës së pensioneve për fermerët, shoqërimi i ndryshimeve ligjore me një punë të fokusuar në marrëdhënie me publikun, nëpërmjet një strategjie të detajuar komunikimi individual”.

Në përgjigje të pyetjes se si programohen shpenzimet për përfitimet në përgjithësi dhe shpenzimet për pensionet në vecanti, citohet se: “Përlllogaritjet bazë të shpenzimeve sipas programeve dhe aktiviteteve realizohen nga programet aktuale afatmesme, bazuar në treguesit, supozimet dhe politikat e pensioneve të viteve të ardhshme. Në mënyrë të veçantë në hartimin e programit vjetor, shpenzimet sipas programeve, aktiviteteve, zërave dhe nënzërave, realizohen në mënyrë analitike, duke mbajtur parasysh çdo tregues dhe çdo faktor”.



-Në përgjigje të pyetjes se si programohen shpenzimet administrative në përgjithësi dhe shpenzimet e administrative të aparatit të ISSH në veçanti citohet se: "Këto shpenzime përlllogariten në mënyrë analitike nga DRSSH dhe Drejtoria e Financës dhe Administrimit të Përgjithshëm në ISSH, duke plotësuar nevojat në mënyrë të pranueshme, deri në limitet e shpenzimeve të përcaktuara nga Ministria e Financës dhe të miratuara në Kuvend. Edhe ky program miratohet në KA i detajuar për çdo rajon. Pra, pavarësisht limiteve të shpenzimeve, politikat e qeverisë në fushën e sigurimeve, si dhe indeksimet, shpërblimet etj, si dhe ndyshimet, miratohen me VKM".

b. Programimi i PBA 2017-2019 (faza e I & II) dhe i buxhetit të vitit 2017.

Programimi i buxhetit të ISSH-së është i ndarë në 3 produkte kyesore, dhe secili nga produktet është i ndarë në aktivitetet e veta. Llogaritjet për përgatitjen e buxhetit të ISSH-së bëhen duke përdorur modelin aktuarial afatshkurtër. Modeli aktuarial afatshkurtër bën parashikime tremujore dhe vjetore për një periudhë trevjeçare, duke u nisur nga një bazë të dhënash, pra te dhëna statistikore të ISSH, marrë nga sektori i statistikës, sektori IT dhe Drejtoria e Financës. Ky proces kalon nëpër të gjitha hapat e kryerjes së një parashikimi, që konstaton në: mbledhjen dhe analizën e të dhënave; hartimin e bashkësisë së supozimeve për periudhën që parashikohet; plotësimin e të dhënave në periudhën bazë dhe supozimet në periudhën e parashikimit; ekzekutimin e modelit dhe kryerjen e parashikimeve; marrjen e rezultateve dhe analizën e tyre.

Treguesit e projektbuxhetit të vitit 2017, por edhe për vitet 2017-2019, janë hartuar bazuar në të dhënat mbi: Numrin e pensionistëve dhe përfituesve të tjerë; Nivelin mesatar të pensionit apo trajtimit; Raportin pagë/pension etj; dhe Rritjen e shpenzimeve në vitin 2016 ndaj vitit 2015, për shkak të efekteve mbetëse të indeksimit të pensioneve në vitin 2015.

Mbështetur në treguesit e programuar, transfertat në buxhetet familjare nga programet që administrojnë ISSH, në variantin pasiv, parashikohen të arrijnë 7.3% të PBB, kundrejt 7.1% të PBB që ishin një vit më parë. Për këtë periudhë ISSH ka administruar mesatarisht:

-Mbi 603,000 pensione të të gjitha llojeve dhe kategorive;

-Ka llogaritur e administruar kompensimet për mbi 40,000 persona të varur ekonomikisht nga pensionisti, sidomos familjarë të invalidëve;

-Ka administruar dhe realizon pagesat për rreth 4,200 veteranë dhe invalidë të luftës dhe rreth 525 invalidë të punës etj.;

-ISSH vazhdon të administrojë skemën e pensioneve të posaçme, skemën e pensioneve suplementare të punonjësve që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skemën e sigurimeve suplementare të policisë dhe ushtarakëve të tjerë, skemën e përfitimeve të veçanta për minatorët, si dhe skemën e përfitimeve të veçanta për familjet e dëshmorëve me rreth 34,500 përfitues. Shpenzimet e pritshme për shpenzimet dhe përfituesit për vitin 2016, shpenzimet për vitin 2014, shpenzimet dhe përfituesit për vitin 2015, me programe, janë si në tabelën e mëposhtme.

Në milion lekë

		Fakti 2014		Fakti 2015		I pritshmi 2016	
		Shpenzime	Shpenzime	Nr.përfituesve	Shpenzime	Nr.përfituesve	
1	Shpenzime për përfitime	85,296	88,904	606,132	94,329	618,659	
2	Shpenzime për progr. të tjera	9,633	11,497	598,809	13,809	610,072	
3	Shpenzime skema suplement	4,475	4,892	53,493	5,449	63,391	
4	Shpenzimet administrative	1,862	2,016	0	2,262	0	
	TOTALI	101,266	107,309	659,625	115,849	682,050	

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të subjektivit.



Nga krahasimi i të dhënave të mësipërme, konstatohet se si shkak i rritjes së numrit të përfituesve dhe i zbatimit të disa politikave në fushën e pensioneve, në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015, transfertat në buxhetet familjare priten të rriten me mbi 8,540 milionë lekë. Gjatë programimit të pensioneve janë mbajtur parasysh politikat në fushën e pensioneve, të cilat janë: - Rritjen e pensioneve për të gjithë përfituesit, me efekt vjetor rreth 1,600 milionë lekë; - Ngushtimin e diferencave të pensioneve për personat që kanë dalë në pension në periudhën 1993-1996, me efekt vjetor rreth 320 milionë lekë; - Faljen e detyrimeve të ushtarakeve nga rillogaritja e pensioneve, si dhe kthimin e detyrimeve të shlyera prej tyre, efekti financiar i kthimit të detyrimeve të mbajtura, vetëm për këtë vit është rreth 180 milionë lekë; - Shpërblimin e fund vitit 2016 për pensionistet me një vlerë prej 6,000 lekë për sejcilin.

Programimi i buxhetit fillon me **kuadrin makroekonomik e fiskal** për periudhën 2017-2019, i cili është miratuar me VKM nr.80, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017-2019". Në pasqyrën 2/1 të këtij vendimi, të adhurat dhe shpenzimet për fondet speciale, sigurimet shoqërore, janë përcaktuar si në tabelën e mëposhtme: *Në milion lekë*

	Emërtimi	2017	2018	2019
I	Shpenzimet	119,609	127,400	133,500
II	Të ardhurat	119,609	127,400	133,500
1	Kontributet	69,295	73,988	79,038
2	Financimet nga buxheti	50,314	53,412	54,462

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të subjektit.

Programimi i buxhetit afat mesëm (PBA) **2017-2019, në fazën e parë**, është hartuar vetëm në qendër të ISSH, pa marë pjesë drejtoritë rajonale. Ky programim, është hartuar brenda limitit të përcaktuar nga Ministria e Financës dhe të udhëzimit të saj nr.4, datë 29.02.2016. Me shkresën e MMSR nr.1329/1, datë 18.03.2016 "Mbi përgatitjen e procesit të programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019, faza e parë", do të përgatitet kjo fazë brenda datës 15.04.2016 dhe brenda tavaneve të miratuara me VKM nr.80, datë 03.02.2016. Tavanet janë përcjellë për vitin 2017 nga ku për **Shpenzimet gjithsej** janë përcaktuar **119,609 milion lekë**, të ndara për tu plotësuar nga:

- Shuma e transfertës buxhetore (604), në vlerë 50,314 milion lekë; dhe
- Të ardhurat nga sigurimet shoqërore, në vlerë 69,295 milion lekë.

ISSH me shkresën nr.2794/1, datë 15.04.2016 "Dërgohet programi i shpenzimeve të sigurimeve shoqërore për (Faza I)", ka dërguar programimin fazës së parë të PBA 2017-2019 brenda afatit, me **3** programe shpenzimesh, ndërsa shpenzimet administrative janë të shpërndara në tre programet kryesore në bazë të peshës specifike të çdo programi, në vlerë **120,510 milion lekë**. Në këtë shumë janë edhe kërkesa shtesë prej 901 milion lekë, nga të cilat 400 milion lekë janë si shkak i një politike të re për ngushtimin e diferencave të pensioneve të periudhës 1993-1996 dhe shtesa tjetër është për kompensimin e energjisë elektrike që rrjedh nga VKM nr.8, datë 14.01.2015. Programimi është hartuar në varjantin pasiv, duke programuar veçantë politikat e indeksimit të pensioneve, si dhe të kompensimeve shtesë për rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Programimi në **fazën e dytë të PBA 2017-2019**, është hartuar në zbatim të shkresës së Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr.1329/5, datë 11.07.2016 "Mbi përgatitjen e procesit të programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 (Faza II)", Në këtë shkresë janë përcaktuar limitet e fondeve të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe është përcaktuar data e detajimit dhe për përcjelljes



së projektit buxhetit fazës së dytë më 10.08.2016. Gjithashtu tavanet për shpenzimet janë në vlerë 119,609 milion lekë, ndërsa totali i të ardhurave, është ndarë:

-Shuma e transfertës buxhetore (604), në vlerë 48,489 milion lekë;

-Të ardhurat nga kontributet e sigurimet shoqërore, në vlerë 71,120 milion lekë.

Për realizimin e një programi cilësor të shpenzimeve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nga ISSH është përgatitur udhëzimi përkatës, për kriteret, afatet dhe grupet e punës të hartimit të projekt buxhetit 2017. Në zbatim të tij dhe në bazë të kalendarit të miratuar për këtë qëllim, të gjitha **Drejtoritë Rajonale** kanë dërguar hartimin e projektbuxhetit të vitit 2017, mbi bazën e të cilave ISSH ka hartuar projektprogramin e përgjithshëm të ISSH^{së}, të ndarë me programe.

Me shkresën ISSH nr.7065, datë 02.09.2016 (22 ditë me vonesë), është dërguar e detajuar faza e dytë e programimit, pra vlera e shpenzimeve në këtë fazë është përlogaritur në vlerë **120,510 milion lekë**, (duke shtuar 901 milion lekë nga tavanet e përcaktuara).

Shqyrtimi dhe miratimi i PBA 2017-2019 në Këshillin Administrativ, është detyrim ligjor dhe mbështetet në nenin 75 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se Këshilli Administrativ “Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore”. Në statutin e ISSH, neni 11, përcaktohet se ISSH përgatit raportin vjetor dhe programin e veprimtarisë së ardhshme financiare, të cilat miratohen nga Këshilli Administrativ i ISSH dhe i paraqiten çdo vit Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu në projektbuxhetin e paraqitur për miratim, janë të pasqyruara në total efektet financiare që parashikohet si pasojë e shtesës së ritmit të numrit të përfituesve, krahasuar me vitet e mëparshme, për shkak të mbarimit të reformës së rritjes graduale të moshës së daljes në pension, të shtesës së numrit të përfituesve të pensioneve suplementare shtetërore, të pensioneve suplementare të ushtarakëve, të reduktimit të numrit të pensionisteve femra për shkak të rritjes graduale të moshës së pensionimit etj.

Janë përcaktuar katër faktorë kryesorë, që ndikojnë në ritjen e shpenzimeve të vitit të ardhshëm kundrejt vitit 2016, të cilët janë:

-Politika e rritjes së pensioneve, e cila parashikohet të ketë një efekt financiar prej 2,600 milionë lekë, ndërkohë që në vitin 2016 ato kishin një efekt financiar prej 680 milionë lekë.

-Kundrejt vitit 2014, i cili është viti i fundit pas të cilit fillon zbatimi i reformës së pensioneve, transfertat në buxhetet familjare rriten me një vlerë me 18.9 miliard lekë, ose mbi 18,2%.

-Pensionistët përveç pensionit mujor, marin edhe një serë të ardhurash të tjera të formës së kompensimeve, ose programeve.

-Ndërkohë që rreth 90 mijë pensionistë kryefamiljarë marin edhe kompensime të veçanta të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, në shumën 1,288 lekë në muaj.

Financimi i shpenzimeve të buxhetit të sigurimeve shoqërore do të realizohet nëpërmjet:

a.Të ardhurave nga kontributet e personave juridike dhe fizikë, në shumën 70,268 milionë lekë me rreth 3,4 miliard lekë më shumë se realizimi i pritshëm i vitit 2016.

b.Në total financimet e buxhetit të shtetit për skemën e sigurimeve shoqërore për vitin 2017 parashikohen në shumën 49,932 milionë lekë, nga të cilat:

-Politikat e rritjes së pensioneve në vlerë 2,600 milionë lekë janë politikat e rritjes së pensioneve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-Nga financimet buxhetore për skemat kompensuese dhe suplementare për rreth 15,726 milione lekë, që u përgjigjen rreth 679 mijë përfituesve.

-Nga financimet e kontributeve që lidhen me pagesën e kontributeve të personave të papunë në pagesë papunësie, të personave që u shërbejnë paraplegjikeve, për personat që përfitojnë pensione të parakohshme si ish ushtarakët, apo punonjës policie për rreth 3,700 lekë dhe që mbulojnë 34,100 persona.

-Financime të diferencës së kontributeve për rreth 70 mijë fermerë, që do të vazhdojnë të paguajnë kontribute me një tarifë të diferencuar, kundrejt të vetpunësuarve në aktivitete jo bujqësore me rreth 3,150 milionë lekë;

-Subveçione të buxhetit për mbulimin e diferencës së të ardhurave me shpenzimet në skemat e pensioneve në shumën 27,356 milionë lekë.

Ashtu sikurse deri me sot, Këshilli i Ministrave do të përcaktojë masën e kontributit për personat e vetpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetpunësuar, duke mbuluar nga Buxheti i Shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetpunësuar në qytet. Programimi i shpenzimeve dhe të ardhurat vitit 2017, të programuara nga strukturat e ISSH, krahasuar me të pritshmin e vitit 2016, u aprovuan kështu nga Këshilli Administrativ:

Në milion lekë

Emërtimi	Viti 2016 i pritshmi		Viti 2017 programimi	
	Nr. përfituesve	shpenzimet	Nr. përfituesve	shpenzimet
1 Shpenzime për përfitime	618,659	96,232	631,533	103,990
a Shpenzime të drejtpërdrejta		94,329		102,046
b Shpenzime administrative		1,903		1,944
2 Shpenzime për programe të tjera	610,072	10,109	623,225	10,041
a Shpenzime të drejtpërdrejta		9,905		9,850
b Shpenzime administrative		204		191
3 Shpenzime për sig. suplementare	63,391	5,449	56,133	5,823
a Shpenzime të drejtpërdrejta		5,294		5,668
b Shpenzime administrative		155		155
TOTALI I SHPENZIMEVE	682,050	112,149	687,666	120,200
a Shpenzimet për përfitime		109,887		117,910
b Shpenzimet administrative		2,262		2,290
KONTRIBUTE & FINANCIMI		112,149		120,200
1 Nga kontributet		65,170		70,268
2 Nga transfertat art. 604		46,979		49,932

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të subjektivit.

Pra për vitin 2017, shpenzimet janë programuar për 120,200 milion lekë, në tre programe:

1. Programi i “Shpenzimeve për përfitime”, në vlerë 103,990 milion lekë dhe që përbën 86.5% të totalit të shpenzimeve;

2. Programi i “Shpenzimeve për programe të tjera”, në vlerë 10,041 milion lekë dhe që përbën 8.4% të totalit të shpenzimeve;

3. Programi i “Shpenzimeve për sigurime suplementare”, në vlerë 5,823 milion lekë dhe që përbën 5.1% të totalit të shpenzimeve.

Për vitin 2017, të ardhurat, programuar që të mbulojnë shpenzimet në vlerë 120,200 milion lekë, të realizuara:

1. Nga kontributet e sigurimeve shoqërore, në vlerë 70,268 milion lekë dhe që përbën 58.5% të totalit të të ardhurave;

2. Nga financimet e buxhetit të shtetit, në vlerë 49,932 milion lekë dhe që përbën 41.5% të totalit të të ardhurave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

c. Miratimi i buxhetit të vitit 2017 me ligjin nr.130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017” dhe aktet normative që e ndryshojnë këtë ligj gjatë vitit.

1. Buxheti i sigurimeve shoqërore me ligjin e buxhetit nr.130/2016, datë 15.12.2016 për vitin 2017 është miratuar, si më poshtë:

Në milion lekë

	Emërtimi	Skema e detyrueshme	Skema suplementare	Shuma
I	TË ARDHURAT	114,264	5,936	120,200
1	kontributet	69,168	1,100	70,268
2	Trasferta nga buxheti i shtetit	42,634	4,698	47,332
3	Trasferta për ritjen e pensioneve	2,462	138	2,600
II	SHPENZIMET	114,264	5,936	120,200

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna nga ligji 130/2016.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga Buxheti i Shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2017, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se **2,290 milionë lekë** dhe janë të ndara sipas skemave, në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Çelja e buxhetit është bërë në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe me ligjin nr.130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, ISSH ka përcaktuar limitet e fondeve për shpenzimet administrative të saj, ka bërë ndarjen e këtij buxheti për 12 Drejtoritë Rajonale, Drejtoria Qendrore e Arkivit dhe 2 njësitë e administrimit financiar të Drejtorisë Qendrore, ku administrohet llogaria e shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH (Sektori i Buxhetit të Brendshëm) dhe transfertat nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH dhe nga këtu në Drejtoritë Rajonale. Është bërë detajimi i tij në artikuj buxhetor dhe më pas ky buxhet është miratuar në Këshillin Administrativ.

Në programin e shpenzimeve të vitit 2017, janë parashikuar e plotësuar në mënyrë të mjaftueshme të gjithë nevojat për fonde e shpenzime për funksionimin dhe kryerjen e detyrave të çdo Drejtorie Rajonale.

Ndryshimet e buxhetit gjatë vitit 2017:

Ndryshimet e buxhetit të sigurimeve shoqërore janë bërë me dy akte normative, pra me Aktin Normativ **nr.2**, datë 16.08.2017 dhe me Aktin Normativ **nr.3**, datë 06.11.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, janë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

	Emërtimi	Skema e detyrueshme			Skema suplementare			Shuma		
		Ligji 130	AN nr.2	AN nr.3	Ligji 130	AN nr.2	AN nr.3	Ligji 130	AN nr.2	AN nr.3
I	TË ARDHURAT	114,264	113,664	115,264	5,936	5,936	5,936	120,200	119,600	121,200
1	Kontributet	69,168	69,168	70,868	1,100	1,000	1,000	70,268	70,168	71,868
2	Trasferta nga buxheti i shtetit	42,634	42,034	41,933	4,698	4,798	4,798	47,332	46,832	46,731
3	Trasf. për ritjen e pensioneve	2,462	2,462	2,462	138	138	138	2,600	2,600	2,600
II	SHPENZIMET	114,264	113,664	115,264	5,936	5,936	5,936	120,200	119,600	121,200

Shënim: Tabela hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të ligjit nr.130/2016 dhe të akteve normative.

Në aktin normativ nr.2, datë 16.08.2017, shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve janë ulur në krahasim me ligjin nr.130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2016” me **600 milion lekë**,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

pra: -Kontributet janë ulur me 100 milion lekë ; dhe -Trasfertat nga buxheti i shtetit janë ulur me 500 milion lekë.

Në aktin normativ nr.3, datë 06.11.2017, shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve janë shtuar në krahasim me ligjin 130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2016 me **1,000 milion lekë**, si: -Kontributet janë ritur me 1,600 milion lekë; dhe -Transfertat nga buxheti i shtetit janë ulur me 600 milion lekë. Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabarte me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga Buxheti i Shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2017, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se **2,360 milionë lekë** dhe janë të ndara sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta. Si përfundim, fazat e programimit për vitin 2017 të shpenzimeve, krahasuar me faktin e viteve 2015 dhe 2016 për të tre programet, totali i të ardhurave nga kontributet dhe financimet nga buxheti i shtetit ,janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme: Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2017								
		Fakti 2015	Fakti 2016	Tavanet	Faza I	Faza II	Mir. KA	Ligji vjetor	Ligji me ndrysh	Fakti 2017
I	Totali i shpenzimeve:	107,309	114,276	119,609	120,510	120,510	120,200	120,200	121,200	119,081
1	Shpenz për përfitime	88,904	93,457	101,619	102,280	102,280	102,046	102,046	101,428	100,169
2	Shpe per prog.të tjera	11,497	13,687	10,200	10,446	10,446	10,041	10,041	11,989	11,829
3	Shp për skemën supl.	4,892	4,973	5,540	5,537	5,537	5,823	5,823	5,423	4,939
4	Shpenzime administ	2,016	2,159	2,250	2,247	2,247	2,290	2,290	2,360	2,144
II	Totali i të ardhurave	108,629	115,361	119,609	120,510	120,510	120,200	120,200	121,200	122,261
1	Nga kontributet	60,148	68,118	69,295	71,120	71,120	70,268	70,168	71,868	73,556
2	Nga buxheti i shtetit	48,481	48,978	50,314	49,390	49,390	49,932	50,032	49,332	48,705

Shënim: Tabela e hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të mara nga subjekti.

Realizimi i shpenzimeve në masën 122,261 milion lekë, është më shumë se plani fillestar për 2,061 milion lekë, ose 1.7% më shumë, nga plani i ndryshuar është më shumë për 61 milion lekë; Po ta krahasojmë realizimin e këtij viti me një më parë shpenzimet e 2017, janë më shumë se viti 2016 për 6,900 milion lekë, ose 9.7% më shumë.

Realizimi i kontributeve në masën 73,556 milion lekë është më shumë se plani fillestar për 3,388 milion lekë, ose 4.8% më shumë; nga plani i ndryshuar është më shumë për 1,688 milion lekë; Po ta krahasojmë realizimin e këtij viti me një më parë kontributet e 2017, janë më shumë se viti 2016 për 5,438 milion lekë, ose 8% më shumë.


Realizimi i financimeve për vitin 2017, janë realizuar në masën 48,705 milion lekë, financime më pak se plani fillestar për 1,327 milion lekë, ose 2.7% më pak; ndërsa nga plani i ndryshuar janë më pak për 627 milion lekë. Po ta krahasojmë realizimin e këtij viti me një më parë financimet e 2017, janë më pak se viti 2016 për 273 milion lekë,

Sa më lart, të shprehura grafikisht si vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”



Në procesin e **zbatimit të buxhetit**, si dhe të plotësimit të nevojave të procesit të administrimit me fonde është udhëzuar që:

-Shpenzimet e administrimit janë dërguar në nivel llogarie (artikulli), ndërkohë që ndarja në zëra do të bëhet nga Drejtoritë Rajonale në bazë të programimit;

-Ndarja në zëra e fondeve të vëna në dispozicion, mund të rishikohet nga ana e DRSSH-së, sipas nevojave të konstatuara aktualisht, por brenda shpenzimeve totale, duke mos prekur zërin komisione për shërbimin e pagesave.

-Ndryshimet të koordinohen me Drejtorinë e Financës në ISSH, me qëllim që të reflektohen në programin analitik të përgjithshëm. Programi administrativ, i ndarë në zëra, do të dërgohet në Drejtorinë e Financës të ISSH brenda datës 20.01.2017,

-Gjatë vitit, kërkesat shtesë mund të bëhen vetëm për raste shumë të veçanta dhe të mirë argumentuara duke kërkuar rialokimin e fondeve të vëna në dispozicion dhe duke bërë ndryshimet e programit të shpenzimeve midis artikujve dhe zërave. Miratimi i ndryshimeve të nevojshme në limitet e shpenzimeve për përfitime, të përcaktuara në pasqyrat bashkëlidhur, është e drejtë e Drejtorit të Përgjithshëm, ose e Këshillit Administrativ, sipas rastit, ndërsa ndryshimet e zërave të tjerë brenda një artikulli miratohen nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale.

-Fondi i veçantë përdoret deri në limitet e çeljeve në buxhet dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM e në udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave dhe pas miratimit nga ISSH. Nga ky fond do të përballohet edhe primi për sigurimin vullnetar të punonjësve si kontribut i punëdhënesit, në masën 2% të pagës.

-Fondet në dispozicion për dieta e shërbime do të përdoren konform procedurave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.997, datë 10.12.2010, me ndryshimet në VKM nr.329, datë 20.4.2016 dhe shkresës së ISSH nr 108/1, datë 11.01.2011.

-Procedurat e kryerjes së shpenzimeve do të zbatohen konform përcaktimeve në Rregulloren Financiare të ISSH dhe parimeve e normave të përcaktuara në kreun III, V dhe VI, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”.

-Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore nuk kanë të drejtë të prokurojnë, autorizojnë, apo të paguajnë fatura që lidhen me shpenzimet e administrimit. Procedurat e përgatitjes së dokumentacionit për shpenzimet, sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore, në aktet nën ligjore dhe rregulloret përkatëse, si edhe në vitet e mëparshme, mund të realizohen edhe në Agjencitë e Sigurimeve Shoqërore.



-Zbatimi i buxhetit të Drejtorisë Rajonale raportohet në Drejtorinë e Financës të ISSH dhe në Drejtorinë e Kontributeve, sipas përkatësisë, çdo muaj deri në datë 4 të muajit pasardhës. Raportimi bëhet sipas formatit të përcaktuar, mbi bazën e evidencës kontabile, për zbatimin e planit të muajit dhe progresiv.

Titulli i çështjes: **Auditim mbi programimin e buxhetit për vitin 2017.**

Gjetja 1: **Pasaktësi dhe formalitet në programimin e buxhetit për vitin 2017**

Situata :

Nga auditimi i programimit të buxhetit të ISSH për vitin 2017, i cili realizohet në 15 njësitë e sistemit, u konstatua se procesi i programimit buxhetor ka hasur vështirësi e problematika në vlerësimin dhe përlllogaritjen e tij, duke mos zbatuar në të gjitha fazat e programimit të buxhetit, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.4, datë 29.02.2016 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019", që lidhen me sa vijon:

a. Programi i **të ardhurave** (kontributeve të sigurimeve shoqërore) të subjekteve që mbliidhen nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe për rrjedhojë ISSH ka marrë tregues të gatshëm për to. Si rezultat në programimin fillestar të ardhurave të vitit 2017, në shumën 67,566 mijë lekë, kishte rezerva e kjo u konstatua me faktin që, megjithëse me aktin normativ nr.3/2017, programi i të ardhurave u shtua me 1,600 milion lekë, përsëri të ardhurat e programuara u tejkaluan me mbi 1,572 milion lekë, kundrejt planit me ndryshime dhe 3,168 milion lekë, ose mbi 5,2% më shumë me planin fillestar

b. Gjatë programimit të **shpenzimeve**, ISSH ka mbajtur në konsideratë për llogaritjen e përfitimeve rreth 603,000 pensionistë të të gjitha llojeve dhe kategorive, ka llogaritur e administruar kompensimet për mbi 40,000 persona të varur ekonomikisht nga pensionisti, sidomos familjarë të invalidëve, ka administruar pagesat për rreth 4,200 veteranë dhe invalidë të luftës dhe rreth 525 invalidë të punës etj. Gjithashtu ISSH vazhdon të administrojë skemën e pensioneve të posaçme, skemën e pensioneve suplementare të punonjësve që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skemën e sigurimeve suplementare të policisë dhe ushtarakëve të tjerë, skemën e përfitimeve të veçanta për minatorët, si dhe skemën e përfitimeve të veçanta për familjet e dëshmorëve me rreth 34,500 përfitues. Janë hasur vështirësi e problematika ne programin e këtyre përfitimeve si:

-Gjatë programimit të Fazës së parë të PBA 2017-2019 të shpenzimeve ky institucion, nuk ka angazhuar strukturat e varësisë së tij, por vetëm strukturën qendrore, e cila parashikon dhe programon në kohë afat-mesme vetëm shpenzimet e ISSH.

-Mungesa e një baze të plotë të dhënash ka sjellë vështirësi edhe në programimin e shpenzimeve për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë, e për pasojë edhe baza e vlerësuar për efekt të



Kriteret:	<p>përlllogaritjes së pensionit, kalkulohet rast pas rasti.</p> <p>-Mbi bazë parashikimesh përlllogaritet edhe numri i invalidëve, pensioneve familjare etj, si dhe e pensioneve të parakohshme e suplementare, e numri i tyre varet nga reformat që parashikojnë institucione të tjera si ushtria, policia, administrata publike etj.</p> <p>-Për numrin e pensioneve të reja pleqërisë, për të cilët ka informacion të plotë nga regjistri i shtetasve, përsëri ka problematika planifikimi, që lidhen me paraqitjen e kërkesave për përfitimet, sepse rreth 40% e popullsisë shqiptare të regjistruar, ndodhet jashtë shtetit Në ligjet: nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në RSH", i ndryshuar; ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar; të ligjit vjetor të buxhetit nr.130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017"; të ligjit 104/2014, datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.05.1193 "Për sigurimet shoqërore në RSH", i ndryshuar, në nenet: 66, 74, 75, 77, 82</p> <p>Në VKM nr.77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi sigurimeve shoqërore dhe sigurimit shëndetësor".</p> <p>Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave për veprimet e mbylljes së vitit 2017.</p>
Ndikimi:	<p>Ndikimi i ulët i strukturave të ISSH në programimin e PBA dhe buxhetin vjetor sidomos në programimin e të ardhurave, krijon antikap dhe veshtirësi edhe ne programimin e shpenzimeve të këtij institucioni.</p>
Rëndësia:	<p>E mesme</p>
Rekomandimi:	<p>Strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese të ISSH, të marrin masa që:</p> <p>a.Të riorganizojnë dhe mundësojnë programimin e të ardhurave të mbledhura nga DPT dhe programimin e shpenzimeve në të gjitha fazat edhe nga strukturat e ISSH, duke shtuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese, të cilat mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhura të mos vijnë të gatshme në ISSH, por të programohen mbas një analize të drejtë e pa rezerva nga të dyja strukturat.</p> <p>b.Strukturat drejtuese të ISSH, të mundësojnë programimin e shpenzimeve nga të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit, duke patur parasysh zgjidhjen e problematikave në shpejtimin e plotësimit të <u>bazës së të dhënave</u> për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë.</p>
Afati i zbatimit të Rekomandimit:	<p>Brenda vitit 2018</p>

**Gjetja 2
Situata****Saktësia në programimin e të ardhurave të bujkut**

Nga auditimi i programimit të buxhetit të të ardhura që mbliidhen nga strukturat e ISSH (**kontribute të vetpunësuarve në bujqësi-fermerit**) që për vitin 2017 janë programuar në vlerë 2,382 milion lekë, janë ndryshuar me aktin normativ nr.3, në vlerë 2,112 milion lekë, ose më pak se programimi fillestar për 270 milion lekë dhe janë realizuar në masën 2,127 milion lekë, u konstatua se ka vështirësi në përlogaritjen e tyre, nisur nga fakti që koncepti fermer, lidhet me tokën që kanë në përdorim si të vetpunësuar në bujqësi, referuar përcaktimit në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 të ndarjes së tokës, por për shkak të ndryshimeve demografike, ky koncept për përcaktimin e "fermerit, ose të vetpunësuarit në bujqësi" ka ndryshuar. Në këto kushte është e vështirë që përcaktimin e qartë të termit "fermer, ose i vetpunësuar në bujqësi" ta zgjidhin vetëm strukturat e ISSH", në mënyrë që parashikimi i shpenzimeve për përfitime dhe kontributet e derdhura nga fermerët, të jenë të shoqëruara me ndryshimet ligjore për këtë proces.

Kriteret:

ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, nr.9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në RSH", i ndryshuar; ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar; të ligjit vjetor të buxhetit nr.130/2016, datë 15.12.2016 "Për buxhetin e vitit 2017"

Ndikimi:

Vështirësi në përcaktimin e qartë të termit "fermer, ose i vetpunësuar në bujqësi" për tu zgjidhur vetëm nga vetëm strukturat e ISSH", në mënyrë që parashikimi i shpenzimeve për përfitime dhe kontributet e derdhura nga fermerët, të jenë të shoqëruara me ndryshimet ligjore për këtë proces

Rëndësia:

I lartë

Rekomandimi:

Me qëllim rritjen dhe saktësimin e programimit të të ardhurave nga kontributet në **sektorin e bujqësisë**, strukturat drejtuese të ISSH dhe njëkohësisht përgjegjëse për kontributet në ISSH (bujkut), në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MBZHR të bëjnë të mundur përcaktimin e qartë termin "fermer, apo i vetpunësuar në bujqësi", duke shoqëruar këtë ri-përcaktim me ndryshimet ligjore përkatëse

**Afati i zbatimit të
Rekomandimit:**

Brenda vitit 2018

**Gjetja 3
Situata**

Planifikim jo i sakte në Aparatin e ISSH

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të **buxhetit të Aparatit** rezultoi se:

-Planifikimi fillestar i shpenzimeve për investime për vitin 2017, ishte zero, kur kishte kontrata e investimit në vazhdim;

-Realizimi i buxhetit administrativ të Aparatit gjatë vitit 2017, është 31% më shumë se një vit më parë, e kjo kryesisht në shpenzimet operative. Nga



analiza e shpenzimeve operative (artikulli 602) dhe ndryshimi që pësojnë ato nga viti në vit, rezultoi se planifikimi i tyre megjithëse ishte bërë i detajuar, kishte ndryshime të mëdha në zëra të ndryshëm gjatë krahasimit të tyre me realizimin e vitit të kaluar dhe ndryshime të theksuara gjatë fazave të programimit të tyre.

Kriteret:

Në ligjet: nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në RSH”, i ndryshuar; ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; të ligjit vjetor të buxhetit nr.130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”; Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Ndikimi:

Ndryshimet në zërat analitikë të shpenzimeve administrative, riskojnë të mos justifikojnë dhe dokumentojnë domosdoshmërinë e ndryshimit nga viti në vit dhe gjatë vitit buxhetor

Rëndësia:

I lartë

Rekomandimi:

Të programohen në mënyrë të detajuar shpenzimet administrative të Aparatit të ISSH, si për kostot operative, ashtu edhe për ato e investimeve, në mënyrë që ndryshimet në zërat analitikë të tyre, të justifikojnë dhe dokumentojnë domosdoshmërinë e ndryshimit nga viti në vit dhe gjatë vitit buxhetor.

Afati i zbatimit të

Brenda vitit 2018

Rekomandimit:

I/2. Auditimi i fondit të Sigurimeve Shoqërore (të ardhurat) të mbledhura nga kontributet e detyrueshme, vullnetare dhe suplementare.

Auditimi për vitin 2017 u mbështet në:

Në ligjet: nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në RSH”, i ndryshuar; ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; të ligjit vjetor të buxhetit nr.130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”; të ligjit 104/2014, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.05.1193 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, në nenet:

-Në nenin 66“Të ardhurat”citohet: Të ardhurat e fondit të sigurimeve shoqërore përbëhen nga: Kontributet e personave të siguruar dhe e punëdhënësve të tyre; Kontributet nga Buxheti i shtetit për personat që nuk mund të paguajnë kontribucione, veçanërisht për: shtetasit që shërbejnë në shërbimin e detyrueshëm ushtarak; punonjësit që marrin një pagesë nga sigurimi i papunësisë; shtetasit që mbulohen nga skema e përfitimit me Vendim të Këshillit të Ministrave;Subvencione të Buxhetit të Shtetit për të mbështetur shpenzimet shtesë, si pasojë e: indeksimit që bëhet sipas këtij ligji, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe që përcakton ky ligj; mbulimit të shpenzimeve, kur të ardhurat nuk mjaftojnë;Pagesa për veprimtari shtesë, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave; Subvencione të Buxhetit të Shtetit, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;Të ardhurat nga investimet e fondit të sigurimeve shoqërore;Të ardhura të tjera, duke përfshirë gjokat, të ardhura nga veprimtaritë administrative të sigurimit shoqëror, dhurata, trashëgimi etj.



-Në nenin 74 “Kompetencat e Këshillit Administrativ” të këtij ligji citohet: Këshilli Administrativ ka këto kompetenca, pika b. Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore; Pika d. Vendos për lidhjen e marrëveshjeve dhe të kontratave të rëndësishme; Me kërkesë të punëdhënësve vendos për ngrirjen e kamatëvonesave për një periudhë të caktuar kohe dhe për pagimin e tyre në një periudhë të mëvonshme, por jo më shumë se një vit financiar, pa të drejtë përsëritjeje, në ato raste kur pagesa e menjëherëshme e kamatë-vonesave do të bënte të pamundur vazhdimin e veprimtarisë ekonomike, që ndodhet në vështirësi financiare.

-Në nenin 75 “Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm”, citohet: Pika ë. Propozon në Këshillin Administrativ buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, planin financiar, paraqet raportin vjetor, parashikimin financiar 3-vjeçar, si dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për kontributet dhe problemet financiare.

-Në nenin 77 “Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me ministrinë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore” Raportimi: Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore do t’i paraqesë çdo vit nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore Këshillit të Ministrave: a. raportin vjetor dhe bilancin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore; b. buxhetin vjetor të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe planin financiar; c. zhvillimin financiar 3-vjeçar dhe perspektivën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, një herë në 5 vjet do t’i paraqesë ministrit përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore dhe, nëpërmjet tij, Këshillit të Ministrave perspektivën për 5 vjet. Instituti i Sigurimeve Shoqërore raporton te ministri përgjegjës për çështjet e sigurimeve shoqërore për realizimin e politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për realizimin e programit vjetor të zhvillimit të skemës së sigurimeve shoqërore, si dhe probleme të tjera të ngarkuara nga Ministri.

-Neni 79 “Detyrimet e punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit” citohet: Rregullat e lëvizjes së informacionit dhe të dokumentacionit ndërmjet punëdhënësit, strukturave tatimore dhe strukturave të sigurimeve shoqërore përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

-Neni 82 “Procedura për transferimin dhe pagimin e kontributeve”, citohet: Të gjitha të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nga kamatëvonesat e tyre, të mbledhura nga organet tatimore, transferohen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe organeve në vartësi të tij. Procedurat e transferimit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave; Instituti i Sigurimeve Shoqërore i shpërndan kontributet e mbledhura në të 5 degët e sigurimit shoqëror dhe i përdor veçmas.

-Në **VKM nr.77**, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi sigurimeve shoqërore dhe sigurimit shëndetësor”.

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave për veprimet e mbylljes së vitit 2017.


-**Marëveshja midis DPT dhe ISSH**, lidhur me procedurat dhe rregullat për dërgimin, apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributeve sipas subjekteve dhe individëve, komunikimin midis palëve të të dhënave statistikore dhe problematikave që dalin pas inspektimit nga ISSH të të dhënave të kontributeve të procesuara në llogaritë individuale. Gjithashtu qëllimi i saj është edhe plotësimi i mungesave të konstatuara në listë pagesat në format shkresor të personave juridikë dhe fizikë për periudhat e “pa informatizuara”.

Të ardhurat e ISSH përbëhen nga dy grupe të mëdha:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”



I. Nga kontributet e sigurimet shoqërore, të derdhura nga subjektet fizike e juridike, privatë e buxhetore, kontribues të bujqësisë dhe vullnetarë dhe të ardhura të tjera (të cilat grumbullohen 95% e tyre nga strukturat e DPT dhe 5% nga strukturat e ISSH);

II. Financime të buxhetit të shtetit, për mbulimin e disa skemave të pensioneve, të cilat janë grande nga buxheti i shtetit për mbulimin e shpenzimeve të këtyre skemave dhe Financime nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve.

Të ardhurat e realizuara për vitin 2017 dhe të konfirmuara përfundimisht nga DPT dhe MFE, por edhe për tre vite më parë, ndryshimet e tyre nga viti në vit, si për kontributet dhe financimet, janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

	EMËRTIMI I TË ARDHURAVE	2014		2015		2016		2017	
		Në%	Në vlerë	Në%	Në vlerë	Në%	Në vlerë	Në%	Në vlerë
1	Nga DPT	48	53,103	56	57,563	55	63,901	58	70,543
2	Nga ISSH (bujqësi & vullnetar)	7	8,035	2	2,375	2	2,337	2	2,610
3	Të tjera	1	582	0	210	0	145	0	402
I	Të ardhura nga kontributet (1+2+3)	56	61,720	58	60,148	57	66,383	60	73,556
-	Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë				-1,572		+6,235		7,172
-	Ndryshimi në % nga një vit më parë			+2%	-2.6%	-1%	+10.4%	+3%	+10.8%
1	Financime për mbulimin e skemave	17	18,097	19	18,968	19	21,885	15	18,146
a	kontribute te buxhetit	3	3,292	3	2,876	3	3,712	3	3,237
b	grant nga buxheti per pagesa te posacme	10	10,815	11	11,090	12	13,365	8	9,858
c	grant nga buxheti per trajtime te vecanta	4	3,990	5	5,002	4	4,808	4	5,051
2	Grant nga buxheti per mbulimin e deficitit	27	29,618	23	23,466	24	27,093	25	30,559
II	Financime nga buxheti i shtetit gjithsej (1+2)	44	47,715	42	42,434	43	48,978	40	48,705
-	Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë			-2%	-5,281		6,544		-273
-	Ndryshimi në % nga një vit më parë				-11%	+1%	+15.4%	-3%	-0.6%
	TOTALI TË ARDHURAVE & FINANCIMI. (I+II)	100	109,435	100	102,582	100	115,361	100	122,261
-	Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë				-6,853		+12,779		6,900
-	Ndryshimi në % nga një vit më parë				-6.3%		+12.5%		+6%

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit, me të dhënat e mara nga Drejtoria e Kontributeve dhe të miratuara për shumat nga Drejtoria e Financës së ISSH.



Të ardhurat gjithsej për vitin 2017 janë realizuar në vlerë **122,261 milion lekë**, nga 115,361 milion lekë të realizuara një vit më parë, pra janë realizuar këtë vit 6,900 milion lekë, ose 6% më shumë se në vitin 2016, të ndara:

I. Të ardhurat nga kontributet për vitin 2017, zënë 60% të të hyrave në këtë institucion, janë realizuar për **73,556 milion lekë**, nga 66,383 milion lekë realizuar një vit më parë, pra janë realizuar më tepër për 7,173 milion më shumë, ose rreth 11% më shumë se në vitin 2016;

II. Financime nga buxheti i shtetit për vitin 2017, janë realizuar për **48,705 milion lekë**, nga 48,978 milion lekë, realizuar një vit më parë, pra janë realizuar për 273 milion më pak, ose 0.6% më pak se në vitin 2016. Duke patur parasysh që realizimi i të ardhurave sipas programeve, është kryesisht detyrë e Drejtorisë të Kontributeve dhe për kontabilizimin e tyre e Drejtorisë së Financës, nga grupi i auditimit u hartua një pyetësor i fokusuar në: bashkëpunimin e ISSH me organet tatimore për nxitjen e plotësisht të planit të të ardhurave nga subjektet në përgjegjësi të organeve tatimore, të ndjekjes të protokollit të komunikimit elektronik të listëpagesave, si dhe të dërgimit të listëpagesave të munguara të formatit letër, nga Drejtoritë Rajonale Tatimore për në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore; Sa ka ndikuar ky institucion në përfshirjen e skemës së sigurimeve shoqërore të sa më shumë fermerëve, e në veçanti të kontribuesve të rinj; Sa ka ndikuar ky institucion në përfshirjen dhe publikimin në skemën e sigurimit vullnetar të personave që nuk përfshihen në skemën e sigurimit të detyrueshëm; Si ka ndikuar zbatimi i ligjit të kushtëzuar të faljes së kamatëvonesave për pagesat e kontributeve të prapambetura nga të vetëpunësuarit në bujqësi për vitin 2017; A është plotësuar baza elektronike e të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe të kontribuesve në skemën e sigurimit vullnetar?; Si realizohen rakordimet mujore dhe vjetore me Drejtorinë e Përgjithëshme të Tatimeve, me Bankën e Shqipërisë dhe me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë për të gjitha të ardhurat e realizuara si kontributet dhe transfertat për llogari të këtij institucioni dhe koha e kryerjes së tyre; Si kryet kontabilizimi i të ardhurave që vijnë nga DPT, nga fermerët, vullnetarët, të ardhurat e tjera, gjithashtu si kontabilizohen dhe rakordohen të ardhurat nga financimet e buxhetit të shtetit nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit si për mbulimin e disa skemave dhe për mbulimin e deficitit; A rakordojnë shumat e kontabilizuara, me raportimet mujore të Ministrisë së Financave, DPT dhe me të dhënat statistikore nga Drejtoria e Kontributeve në këtë institucion. *Nga verifikimi dhe auditimi rezultoi se:*

Drejtoria e Kontributeve, ka ndjekur planin e ardhurave të detajuar për çdo DRSSH dhe Degë dhe planin e detajuar për çdo inspektor, ka ndjekur rakordimet mujore të detajuara me DPT për kontributet. Këtë vit, është bërë rakordimi i të gjitha të dhënave me DPT me këtë drejtori, kjo e realizuar me punonjësit që mbajnë kontakt me Degët e Tatimeve në Rrethe, si e vetmja mundësi për mbledhjen e listpagesave. Edhe këtë vit vazhdon bashkëpunimi mes ISSH dhe DPT për dorëzimin e listpagesave nga ana DPT, proces i cili kryet në mënyrë periodike ditore nëpërmjet transferimit të të dhënave në formë elektronike në segmentin DPT-AKSHI-ISSH. Por janë konstatuar edhe raste kur cikli periodik, nuk është zbatuar me korrektësi nga ana e DPT për ato raste kur ka pasur probleme të transmetimit elektronik nga ana e DPT, ose nga AKSHI. Janë bërë identifikime të subjekteve debitore, nëse kanë rifilluar aktivitet tjetër me licencë të re. Degët e Tatime në Rrethe dhe DRSSH për vitin 2017 kanë bashkëpunuar për të vjelur debitorët nga tatimet, duke verifikuar mundësinë e gjetjes së këtyre bizneseve të mbyllura nga hulumtimi i të dhënave elektronike të marra nga DPT. Drejtoria e Financës në ISSH, ka kryer rakordimin mujor dhe vjetor me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve (DPT) e të kaluara përmes llogarisë së Unifikuar të Thesarit "Depozitë"



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

qeverie”, si e vetmja **llogari ku të ardhurat e ardhura nga DPT kontabilizohen**. Ndërsa për të ardhurat nga sigurimi i fermerëve dhe sigurimi vullnetar, rakordimi është kryer me Drejtorinë Rajonale të sigurimeve. Drejtoria e Financës edhe për grupin e dytë të të ardhurave, pra për trasfertat e kryera për mbulimin e skemave dhe për mbulimin e Deficitit ka kryer rakordimin mujor dhe vjetor me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ato kontabilizohen në nënlllogari të specifikuar për çdo skemë.

I. Të ardhurat nga kontributet.

Për vitin 2017, rreth 60% të të ardhurave të ISSH, në vlerë **73,555 milion lekë**, e përbëjnë kontributet e derdhura për sigurimet shoqërore nga subjektet fizike e juridike, privatë e buxhetore, kontribues të bujqësisë dhe vullnetarë, të cilat ndahen në **dy grupe të mëdha**:

1. Kontribute të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve për llogari të ISSH;
2. Kontribute të mbledhura nga vetë ISSH (fermeri dhe vullnetarët).

Kontributet e realizuara, krahasuar me planin dhe me realizimin e një viti më parë, janë paraqitur si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Të ardhurat	Fakti 2016	VITI 2017				Nga këto:							
			Plan	fakt	Në %		ISSH				Tatime			
					/PL	/16	Plan	fakt	Në %		Plan	fakt	Në %	
								/PL	/16			/PL	/16	
I	Sektori Publik	26,816	30,066	30,427	101	113	-	-	-	-	30,066	30,427	101	113
1	Buxhetore	23,138	25,766	26,267	102	114	-	-	-	-	25,766	26,267	102	114
2	Jo Buxhetore	3,678	4,300	4,160	97	113	-	-	-	-	4,300	4,160	97	113
II	Sektori privat	35,709	37,850	38,802	103	109	-	-	-	-	37,850	38,803	103	109
1	Biznesi i madh	29,723	31,400	33,711	107	113	-	-	-	-	31,400	33,711	107	113
2	Biznesi i Vogël	5,986	6,450	5,092	79	85	-	-	-	-	6,450	5,092	79	85
III	Sigurim Suplem.	1,204	1,250	1,314	105	109	-	-	-	-	1,250	1,314	105	109
IV	“ Vullnetar	418	470	483	103	116	470	483	103	116	-	-	-	-
V	Të vet pun. në buj	1,919	2,112	2,127	101	111	2,112	2,127	101	111	-	-	-	-
VI	Të tjera	309	120	384	161	124	120	194	161	134	-	190	-	-
VII	Derdh në llog e sig	3	-	19	-	633	-	19	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej (I+II)	66,383	71,868	73,556	102	111	2,702	2,823	104	113	69,166	70,734	102	116

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit, me të dhënat e detajuara nga Drejtoria e Kontributeve dhe konfirmuar për totalin e të ardhurave me drejtorinë e Kontabilitetit të ISSH.

Realizimi në total i kontributeve për vitin 2017 është **73,560 milion lekë**, kundrejt 71,868 milion lekë të programimit përfundimtar, ose realizuar në masën **102%**, pra janë mbledhur kontribute më tepër se programimi 1,692 milion lekë, ndërsa krahasuar realizimi i këtij viti me një vit më parë, janë realizuar më shumë për 7,177 milion lekë, ose **10.8%** më shumë se viti 2016, të ndara në:

1. Të ardhura kontributesh mbledhur nga strukturat (DPT), janë realizuar në vlerë **70,734 milion lekë** nga 69,166 milion lekë të programuara me ndryshimet gjatë vitit, pra realizuar më shumë se plani 2%, ose 1,568 milion lekë; dhe **2. Të ardhura kontributesh, mbledhur nga strukturat e ISSH**, janë realizuar në vlerë 2,823 milion lekë nga 2,702 milion lekë të programuara me ndryshimet gjatë vitit, pra realizuar më shumë se plani për 4%, ose 121 milion lekë më shumë. **Të ardhurat nga kontributet** dhe të konfirmuara përfundimisht, por edhe për tre vite më parë, janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme

Në milion lekë

	EMËRTIMI I TË ARDHURAVE	2014		2015		2016		2017	
		Në%	Në vlerë	Në%	Në vlerë	Në%	Në vlerë	Në%	Në vlerë
1	Nga DPT	86%	53,103	96%	57,563	96%	63,901	96%	70,543
-	<i>Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë</i>				4,460		6,338		6,642
-	<i>Ndryshimi në % nga një vit më parë</i>				+8.4%		+11%		10.4%
2	Nga ISSH (bujqësi & vullnetar)	13%	8,035	4%	2,375	4%	2,337	4%	2,610
-	<i>Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë</i>				-5,660		-38		273



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-	Ndryshimi në % nga një vit më parë					-70.4%		-1.6%		+11.7%
3	Të tjera (DPT & ISSH)	1%	582	0%	210	0%	145	0%	402	
-	Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë					-372		-65		257
-	Ndryshimi në % nga një vit më parë					-63.9%		-31%		+177%
	Shuma e të ardhurave nga kontribut (1+2+3)	100%	61,720	100%	60,148	100%	66,383	100%	73,555	
-	Ndryshimi në vlerë nga një vit më parë					-1,572		6,235		7,172
-	Ndryshimi në % nga një vit më parë					-2.6%		+10.4%		+10.8%

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e detajuara nga drejtoria e kontributeve dhe konfirmuar për totalin e të ardhurave me drejtorinë e Kontabilitetit të ISSH.

Pra nga tabela e mësipërme rezulton një ritje e të ardhurave nga kontributet nga viti 2017, duke e krahasuar me vitin 2016 me 10.8%, kështu edhe për vitin 2016 ritur nga një vit më parë për 10.4%, ndërsa në vitin 2015, krahasuar me një vit më parë janë ulur me 2.6%.

Të paraqitura në formë grafike të ardhurat gjithsej, është si më poshtë:



Edhe numri i kontribuesve është ritur këtë vit në krahasim me një vit më parë me 44,217 kontribues, ose me 6.7% më shumë se viti 2016, i ndarë për: a. Kontribuesit që derdhin kontributet në DPT, janë më shumë për 38,153 kontribues, ose 6.3% më shumë se një vit më parë; dhe b. Kontribuesit që derdhin kontributet në ISSH, më shumë për 6,064 kontribues, ose 10% më shumë se një vit më parë.

1. Kontributet (të ardhurat) e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve (DPT).

Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Drejtorinë e Përgjithëshme të Tatimeve dhe marrëdhëniet e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me Drejtoritë Rajonale Tatimore janë ndërtuar dhe mbështeten në VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”. Ndër të tjera nëtë është përcaktuar se DPT dërgon në ISSH, të gjithë të dhënat statistikore dhe të kontributeve të paguara, bazuar në procedurën e komunikimit “on-line”, midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet. Bazuar në këto dispozita, këtë vit janë zbatuar procedura më të plota bashkëpunimi institucional ndërmjet ISSH-së dhe DPT-së, të mbështetura në Marrëveshjen e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Bashkëpunimit nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017. Gjatë vitit 2017 dhe për çdo muaj, ka vazhduar hedhja në sistemin për menaxhimin e kontributeve në sistemin CMIS, të dhënat e listëpagesave të subjekteve juridike e fizike, të cilat dërgohen nga Drejtoria e Tatimeve nëpërmjet Eëb-services, të ndërtuar për këtë qëllim. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve deri në datë 25.01.2018, për të gjithë periudhën 2012-2017 ka dërguar në ISSH gjithsej 5,344,627 listë/pagesa të formatit elektronik që i përkasin kësaj periudhe. Për vitin 2017, janë dërguar dhe kaluar në bazën e të dhënave **920,107 listë/pagesa** të periudhës janar-nëntor, muaji dhjetor është akoma në proces hedhjeve. Të përmbledhura kontributet e mbledhura nga strukturat dhe sistemet e DPT për llogari të ISSH, të ndara me sektorin publik dhe privat, sigurimin suplementar planin faktin e 2017, të krahasuar me faktin e një viti më parë, kontributet janë analizuar si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Kontribuesit	Fakt 2016	2017		Ndryshimet faktit 2017 me:			
			Plan	Fakt	Planin 2017		Fakt 2016	
					vlerë	Në %	vlerë	Në %
I	Sektori Publik	28,026	30,066	30,427	361	1.2	2,401	8.6
1	Buxhetore	23,138	25,766	26,267	501	1.9	3,129	13.5
2	Jo Buxhetore	3,678	4,300	4,160	-140	-3.3	482	13.1
II	Sektori privat	35,709	37,850	38,803	953	2.5	3,094	8.7
1	Biznes i madh	29,723	31,400	33,711	2,311	7.4	3,988	13.4
2	Biznesi i Vogël	5,986	6,450	5,092	-1,358	-21.1	-894	-15.0
III	Sigurim Suplementar	1,204	1,250	1,314	64	5.1	110	9.1
IV	Të tjera	164	0	190	190	-	26	15.9
	Totali (I+II+III+IV)	63,893	69,166	70,734	1,568	2.3	6,841	10.7

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e detajuara nga Drejtoria e Kontributeve dhe të konfirmuar për totalin e të ardhurave me Drejtorinë e Kontabilitetit të ISSH.

Për vitin 2017 ka një tejkalim të realizimit të të ardhurave në subjektet juridike dhe fizike, edhe pse gjatë këtij vitit, me aktin normativ të ndryshimit të buxhetit nr.3/2017, programi i të ardhurave u shtua me 1,600 milion lekë, përsëri të ardhurat e programuara u tejkaluan me mbi 1,572 milion lekë, kundrejt planit me ndryshime. I krahasuar realizimi me planit fillestar të ardhuravetë kontributeve nga subjektet juridike dhe fizike, rezultoi më tepër për 3,170 milion lekë, ose mbi 5,2% më shumë. Ndër faktorët që kanë ndikuar në këtë realizim të kontributeve janë:

- Rritja e pagës minimale në shkallë vendi, nga muaji maj 2017, dhe si rezultat për 8 muaj pati një efekt financiar për 2,100 milion lekë, ose rreth 3% më shumë.
- Zbatimi i ligjit të faljes së kamatëvonesave dhe gjobave, e cilan dha një efekt financiar për rreth 570 milion lekë;
- Rritja e numrit të kontribuesve me një efekt financiar rreth 470 milion lekë.

Ritja e këtyre kontributeve së fundi do të ndikojë në ritjen e drejtpërdrejtë të masës së pensionit, sepse formula e reformuar e kalkulimit fillestar të pensionit e garanton këtë ritje. Drejtoria e Kontributeve, referuar analizave të lëvizjes dhe dinamikës së tregut të punës, pjesmarjes së individëve dhe sidomos të analizës së pagave mesatare, mbi të cilat llogariten dhe paguhen kontributet, evidenton problematika, si dhe evazion fiskal, kryesisht:

- Në subjektet e biznesit të madh, subjektet fason, në disa subjekte që zhvillojnë veprimtari profesionale, në medja etj, ku rezervat për rritjen e të ardhurave nga kontributet janë për t'u



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

ndjekur nga të dy institucionet si nga DPT dhe ISSH, me qëllim rritjen e të ardhurave të fondit nga kontributet.

b. Konstatohetse ka mungesa në numrin e listëpagesave vjetore që duhet të dërgojë DPT-ja në ISSH dhe veçanërisht këto të identifikuar për vitin 2014, ku mungojnë një sasi e konsiderueshme listëpagesash dhe kryesisht për muajt tetor-nëntor. Për këtë çështje është vënë në dijeni zyrtarisht DPT-ja dhe po merren masat që ky informacion të kalohet, pasi ato listëpagesa gjenden në bazën e të dhënave të DPT-së. Kjo çështje është në proces zgjidhje teknike, por ka krijuar problematika në përdorimin online të kësaj baze, për caktimin e pensioneve të atyre personave që kanë mungesa. Krahas kësaj shqetësuese mbetet mungesa e informacionit për ato raste kur subjektet gjenden me detyrime të papaguara, ose të paguara pjesërisht, pasi gjendemi përpara situatës së mungesës së periudhave të sigurimit. (analiza e debitorëve). Mangësi dhe probleme të mbartura të periudhave të kaluara, në marrëdhëniet ndërmjet organeve të sigurimeve shoqërore dhe organet tatimore dhe që aktualisht janë në ndjekje, nga Degët e Kontributeve në DRSSH dhe në ISSH dhe duke u bërë rast pas rasti rregullimi dhe plotësimi i tyre.

c. Problematike mbetet çështja e listëpagesave të munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012, ndërsa gjatë vitit 2017, janë saktësuar dhe përditësuar inventarët e mungesave dhe për këtë janë njoftuar rregullisht Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Gjendja dhe lëvizja e mungesave të **listëpagesave** për fundi vitit 2017, janë si në tabelën e mëposhme:

Nr	E m e r t i m i	Mungesat 01.01.2017	Pakesimet e (terheqjes nga tatimet muaj listë pagesa)	Mungesat e 31.12.2017	% ndaj totalit
1	Subjektet publike	6,265	469	5,796	0.32
2	Firma	121,601	20,375	101,226	5.59
3	Te vetepunesuar	1,743,746	39,888	1,703,858	94.09
	Gjithsej	1,871,612	60,732	1,810,880	100

Kështu gjatë vitit 2017, janë dërguar nga ana e Drejtorive Rajonale Tatimore, Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, gjithsej 60,732 muaj listë/pagesa të munguara të subjekteve që i përkasin periudhave tatimore 2006-2012 dhe konkretisht janë:

469 listëpagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore);

20,375 listëpagesa të subjekteve juridike (firma);

39,888 listëpagesa të subjekteve biznes i vogël.

Në fund të 2017 rezultojnë gjithsej **1,810,880 listë/pagesa të munguara** dhe nga këto:

1,703,858, ose rreth 95% janë listë/pagesa të munguara të të vetëpunësuarve (biznes i vogël);

101,226, ose rreth 6% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private);

5,796 janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë).

Vetëm në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ku është e përqëndruar dhe pjesa më e madhe e biznesit, situata paraqitet me 1,504,072 listë pagesa të munguara gjithsej **apo 86.7%** të numrit të përgjithshëm të listëpagesave të munguara, në shkallë vëndi. Ndërkohë në 1,569,941 listëpagesat e munguara në Drejtorinë Rajonale Tiranë 1,504,072 janë listëpagesa të munguara të subjekteve të biznesit të vogël. Mbetet të meren në mënyrë manuale fotokopjet e regjistrave të pagesave të kontributeve, për ato subjekte fizike që janë të lidhur dhe i kanë pasur llogaritë në degët e tatimeve të painformatizuara në periudhën 2004-2011. Gjithashtu në liste pagesat e munguara janë edhe ato muaj për të cilat subjektet janë debitorë. Në këto raste grumbullimi i tyre do të ndjekë likuidimin e borxhit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Debitorë në organet tatimore, të raportuara nga Drejtoria e Kontributeve.

Në zbatim të pikës 5.19, të kreut 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.23, datë 09.12.2014 dhe të nën/pikës “iv”, shkronja “a”, të kreut II, të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit” nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.5.2017, ndërmjet DPT-së dhe ISSH-së, Drejtoria e Kontributeve në ISSH ka bashkëpunuar me Drejtorinë e IT të DPT dhe më pas me Drejtorinë e IT të ISSH. Të dhënat e marra i janë dërguar DRSSH-ve për vazhdimësi të evidentimit dhe të përpunimit të mëtejshëm të tyre dhe konkretisht DRSSH-të kanë bërë grupimet e subjekteve debitorë në: buxhetorë, jo buxhetorë, biznes i madh dhe biznes i vogël. E krahasuar me vitin 2016, gjendja e debitorëve në fund të vitit 2017, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Nr	EMERTIMI	Detyrimet e paguara nga subjektet						Dif. krahasuese 2017-2016	
		2015		2016		2017		Nr. i subj	Në vlerë
		Nr. i subj.	Në vlerë	Nr. subj.	Në vlerë	Nr. i subj.	Në vlerë		
I	SEKTORI PUBLIK	1,368	1,712	1,993	2,127	987	1,146	-1,006	-981
1	BUXHETORE	1,168	1,253	1,776	1,659	743	809	-1,033	-850
2	JOBUXHETORE	200	459	217	468	244	337	27	-131
II	SEKTORI PRIVAT	55,479	8,815	119,547	14,245	6,2544	9,706	-57003	-4542
3	BIZNES I MADH	11,752	6,252	23,386	9,428	15,675	6,970	-7,711	-2,458
4	BIZNES I VOGEL	43,727	2,563	96,161	4,817	46,869	2,733	-49,292	-2,084
	GJITHSEJ (I+II)	56,847	10,527	121,540	16,372	63,531	10,849	-58,009	-5,523

Shënim : Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH / Drejtorisë së Kontributeve.

Në analizë të detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë në organet tatimore, vihet re numri i lartë i subjekteve debitorë dhe detyrime të mëdha, për kontribute të paguara nga këto subjekte. Numri i tyre aktualisht është rreth 63,531 subjekte debitorë dhe detyrimet kontributive të prapambetura të tyre janë rreth 9.1 miliard lekë për vitin 2017 nga 9.3 miliard lekë për vitin 2016, pra shumat e detyrimit kontributiv janë pothuajse të barabarta për të dy vitet. Debitorët e sigurimeve shoqërore që evidentohen në DPT, prodhon një problem mjaft të madh social dhe financiar për organet e sigurimeve shoqërore, sepse pas subjekteve debitorë dhe shumave të paguara të kontributeve, janë një numër i konsiderueshëm personash të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu ka efekt financiar sepse deri tani, fondit të sigurimeve shoqërore, nuk i janë vënë në dispozicion rreth 9.1 miliard lekë detyrime kontributive të prapambetura. Për këtë vit, po dhe në vazhdimësi ISSH ka bërë bërë prezent organeve eprorë problemin shqetësues të numrit të lartë dhe detyrimet e prapambetura, për kontribute të paguara, të subjekteve debitorë, në organet tatimore.

Ka rezultuar një rënie e konsiderueshme e numrit të subjekteve debitorë, nga viti 2016 për 58,009 subjekte dhe të detyrimeve të prapambetura me 5,523 milion lekë. Kjo rënie e konsiderueshme është kryesisht nga ligji nr.33/2017, datë 30.3.2017 “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore” dhe nga Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.14, datë 03.05.2017, në zbatim të këtij ligji. Megjithatë detyrimi kontributiv, kundrejt situatave krahasuese të mësiparshme, pra principliali është pakësuar vetëm për rreth 267 milion lekë, pjesa tjetër e pakësimeve janë gjoba dhe interesa. Debitorët e krijuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për kontributet e sigurimeve shoqërore të deklaruar dhe të pa derdhura, ose të deklaruar më shumë e të derdhura me pak, në financën e këtij institucioni, nuk janë të regjistruar, por janë vetëm si evidence statistikore në Drejtorinë e Kontributeve të tij.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Drejtoria e Financës, kontabilizimin e kontributeve nga DPT e ka realizuar me 131 kërkesa për transferta kontributesh, e kjo në varësi të kërkesave ditore të shpenzimeve. Në tabelën fiskale të nxjerrë nga kjo drejtori, këto kontribute rezultojnë të regjistruar me një llogari 512100 “Të ardhura të hyra nga llogaria e unifikuar e thesarit TSA”, në vlerë **70,734,052,482 lekë**, ndërsa në evidencën e rakordimit që vjen nga DPT e shoqëruar me tabelën e 15 nën/llogarive të specifikuar për të ardhurat nga kontributet, vlera është 70,738,168,120 lekë, pra menjë diference prej 4,115,669 lekë. Pra midis kontabilizimit të kryer dhe rakordimit të bërë me Drejtorinë e kontributeve, rezultoi kjo diferencë, e cila u sistemua me shkresën nr.309/1, datë 14.02.2018. Kjo shkresë diferencë është e indentifikuar me një numër llogarish të klasës 7, si:

-Llogaria 7502100 “Sigurime shoqërore nga të punësuarit në sektorin privat”, në vlerë 2,086,798 lekë rimbursime në rajonet Vlorë për 61,798 lekë dhe Korçë për 2,025,000 lekë;

-Llogaria 7510100 “Sigurime shoqërore punëdhënës sektori buxhetor në elbasan për 372,482 lekë;

-Llogaria 7512100 “Sigurime shoqërore punëdhënës sektori privat” në vlerë 1,656,389 lekë rimbursime në rajonin Durrës. Pra Drejtoria e Financës në ISSH, kontributet e derdhura nga DPT, nga personat juridike e fizikë, subjektet publike dhe private dhe sistemimet e mëvonshme të këtyre kontributeve, nuk i rregjistron në kontabilitet me nr.llogarish të specifikuar për çdo lloj kontributi, por i rregjistron në një llogaritë vetme 512100 “Të ardhura të hyra nga llogaria e unifikuar e thesari-TSA”, llogari e cila nuk jep sigurinë analitike të krijimit të të ardhurave.

2. Kontributet e sigurimeve shoqërore të mbledhura nga ISSH.

Për realizimin e të ardhurave në përgjegjësi të organeve të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), evidentimin dhe kontabilizimin e tyre, janë të organizuara dhe të ndara:

a. Kontribute të vetpunësuarve në bujqësi;

b. Kontribute të siguruarve vullnetarë;

c. Të ardhura dhe kontribute të tjera.

Të ardhurat nga kontributet, të planifikuara në buxhetin vjetor 2017, të realizuar nga ISSH në drejtoritë rajonale, janë të evidentuara si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Rajonet	GJITHSEJ		Ndrysh fakt-plan		Vet/sigurur bujqësi		Sigurim vullnetar		Të tjera	
		plan	fakt	Në vlerë	Në%	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
1	BERAT	138.5	139.5	1	101	120.0	119.0	18.5	20.4	0	0.1
2	DIBER	127.5	117.5	-10	92	125.0	114.4	2.5	3.0	0	0
3	DURRES	179.0	159.9	-19.1	89	127.0	108.3	52.0	51.5	0	0.1
4	ELBASAN	311.5	309.8	-1.7	99	291.0	284.0	20.5	25.6	0	0.1
5	FIER	360.0	353.0	-7	98	325.0	314.4	35.0	37.0	0	1.6
6	GJIROKAS.	183.5	180.1	-3.4	98	161.0	155.9	22.5	21.0	0	3.1
7	KORÇE	370.4	309.3	-61.1	84	336.0	271.7	34.4	35.2	0	2.4
8	KUKES	63.7	58.3	-5.4	92	62.0	57.6	1.7	0.6	0	0.1
9	LEZHE	174.6	160.8	-13.8	92	160.0	148.2	14.6	12.5	0	0.1
10	SHKODER	200.5	179.7	-20.8	90	185.0	163.3	15.5	16.3	0	0.1
11	TIRANE	397.0	413.5	16.5	104	192.0	187.6	205.0	212.5	0	13.3
12	VLORE	345.8	316.3	-29.5	91	298.0	269.2	47.8	47.1	0	0.1
	SHUMA	2,852.0	2,697.8	-154.2	95	2,382.0	2,193.7	470.0	482.9	0	21.1

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Kontributeve.

Të ardhurat e programuara për t'u mbledhur nga strukturat e sigurimeve shoqërore janë realizuar për 2,697.8 milion lekë, kundrejt 2,852 milion lekë të planifikuara, pra janë realizuar në masën 95% me një mosrealizim prej 154.2 milion lekë, e ndarë për:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Të vetpunësuarit në bujqësi realizuar për 2,194 milion lekë nga 2,382 milion lekë të planifikuar pra realizuar në masën 92.1%, me një mosrealizim prej 188.3 milion lekë;
- Sigurimi vullnetar realizuar për 483 milion lekë nga 470 milion lekë të planifikuar, pra realizuar në masën 102.8%, me një tejkalim prej 13 milion lekë.

Drejtoria e kontabilitetit, llogaritë për kontributet nga fermerët, nga vullnetarët, kontribute të tjera, si dhe të ardhurat e tjera, që regjistrohen nga strukturat e ISSH, janë procesuar kështu në tavelën fiskale të saj. Me llogari të specifikuara të ardhurat nga kontributet, të planifikuara, janë të procesuara, të raportuara dhe të kontabilizuara si më poshtë:

Në lekë

Nr. llog.	Emërtesa e llogarisë	Plani 2017	Fakti në kontabilitet	Audituar deri tani
7530100	Sigurime shoqërore fermerë	2,382,000,000	2,110,882,956	
7115500	Kamat vonesa	0	15,836,031	15,836,031
753	Shuma kontributi i fermerëve	2,382,000,000	2,126,718,987	15,836,031
7540100	Kontribute të shtetasve me banim jashtë	350,000,000	356,136,819	
7540200	Sigurime shoqërore, jo kontribues të perkohshëm	120,000,000	126,784,409	
754	Shuma vullnetarëve	470,000,000	482,921,228	
752/0100	Contribute nga subjekte të tjera	0	18,495,867	18,495,867
765/101	Të ardhura nga intersat e depozitave	20,000,000	56,311,423	56,311,423
765/102	Të ardhura nga intersat e bonove të thesarit	100,000,000	135,093,073	135,093,073
765	Të ardhura nga interesat	120,000,000	191,404,496	191,404,496
711	Të ardhura nga komisione për shërbime		502,620	502,620
710	Të ardhura nga pronësia		11,100	11,100
719	Të ardhura jo tatimore		1,695,438	1,695,438
	Totali i të ardhurave nga strukturat e ISSH	2,972,000,000	2,821,749,736	227,945,552

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Financës

a. Kontributet e të vetpunësuarve në bujqësi.

Në zbatim të pikës 4, të kreut V, të VKM nr.77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe të shkresës së ISSH nr.3838, datë 04.05.2015 “Për evidentimin e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesave, për personat e vetpunësuar në bujqësi”, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë evidentuar, për çdo tremujor, numrin dhe detyrimet e debitorëve, të vetpunësuar në bujqësi për vitin 2017.

Debitorët e mbetur në organet e sigurimeve shoqërore ISSH. Mbështetur në shkresën e ISSH, nr. 4519, datë 8.7.2014 “Për mbylljen e evidencës të subjekteve debitorë me detyrime të prapambetura në organet e sigurimeve shoqërore” të gjithë Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë riparë edhe një herë subjektet debitorë pasivë dhe detyrimet e tyre të prapambetura, të mbetura në llogaritë e organeve të sigurimeve shoqërore. Numri i subjekteve debitorë dhe detyrimet e të tyre të prapambetura, janë ndjekur në vazhdimësi që nga vitit 2001 dhe kanë patur pakësim të konsiderueshme gjatë gjithë viteve. Kështu në fillim të vitit 2014 kemi patur 197 subjekte debitorë me 364 milion lekë detyrimeve të prapambetura gjithsej, nga të cilat 333 milion lekë kontribute dhe 31 milion lekë kamatëvonesa. Gjatë kësaj periudhe janë pakësuar 12 subjekte debitorë dhe detyrimet e tyre të prapambetura në shumën 37,729,637 lekë. Nga këto 9 subjekte për shumën e detyrimit të prapambetur prej 15,045,234 lekë janë pakësim të bëra nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër dhe Vlorë në zbatim të shkresës së ISSH nr. 4519, datë 8.7.2014, pasi në dosjet e 9 subjekteve pasivë nuk disponoheshin listëpagesat përkatëse që të konfirmoheshin shumën e detyrimit të prapambetur të tyre, në organet e sigurimeve shoqërore. Ndërsa Drejtoria




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë ka pakësuar 3 subjekte debitorë së bashku me detyrimet e tyre të prapambetura, në shumën 22,684,403 lekë si rrjedhojë e transferimit të tyre në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë. Me transferimet e mësipërme detyra e transferimit të subjekteve debitorë aktivë, nga organet e sigurimeve shoqërore në organet tatimore, konsiderohet e përfunduar në të gjithë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Në përfundim mbeten ende për ndjekje detyrimet për 325,9 milionë leke për rreth 185 subjekte. Tabela përmbledhëse e numrit të debitorëve të vetëpunësuar në bujqësi dhe e detyrimeve të papaguara nga të vetëpunësuarit në bujqësi, për periudhën 01.01.2017-31.12.2017.

Nr.	Emërtimi	Nr. fizik	Det. gjithësej	Nga këto:	
				Detyr. Kontr.	Kam/von
1	Gjendja progresive në fillim të vitit 2017	34,196	1,769	1,753	16
2	Shtuar gjatë 2017	453	984	977	7
3	Pakësuar në 2017	4,198	427	424	3
4	Gjendja progresive në fund të vitit 2017	30,451	2,327	2,306	20

Si pjesë e procesit të auditimit të të ardhurave të mbledhura nga ISSH, kemi analizuar procesin e mbledhjes së të ardhurave të fermerit:



★ Risqe që lidhen me mosnjohjen në kohë dhe kontabilizimin e detyrimeve për t'u paguar nga bujq, që vijnë si pasojë e përlllogaritjeve të gabuara.

★ Risqe që lidhen me mosnjohjen në kohë dhe kontabilizimin e detyrimeve për t'u paguar nga bujq, që vijnë si pasojë e përlllogaritjeve të gabuara.




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Lloji i te Ardhures	Vlera (leke)	Risk Factor (can be 0.7 or 2 or 3)	Çeshtjet për shqyrtim
Total kontribute - klasa 75	408,700,522	2.00	123
Materialiteti në përqindje		1%	
Materialiteti në vlerë		4,087,005	

Zgjedhëm kampionin prej 500 çështjesh në DRSSH/Tiranë, në rastin konkret 500 kontribues për vitin 2017, nga ku na rezultuan 104 raste me diferenca (detyrimi për t’u paguar me vlerën e paguar faktikisht), në shumën totale prej 286,014 lekë, pra me një diferencë debitore mesatare rreth 2,750 lekë/kontribues. Këto diferenca kanë ardhur si pasojë e përlogaritjes jo të saktë të detyrimit të nënshkruar në urdhërveprimin e inspektorit të të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilat kur hidhen në system rezultojnë me diferenca. Për këto diferenca, inspektori i të ardhurave përgatit urdhërveprimin dhe e dërgon përsëri te inspektori i të vetëpunësuarit, i cili ky i fundit ia dorëzon bujktut për të arkëtuar diferencën e kontributit, por ky informacion nuk i shkon Degës së Financës për të kryer veprimet kontable.

Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Financës ndjek dhe kontabilizon në pasqyrat financiare vetëm vlerën e likuiduar, duke lënë jashtë kontabilitetit të dhënat mbi debitorët e krijuar si pasojë e gabimeve të sipërpërmendura, ndjekja e të cilëve vijon të bëhet vetem nga dega e kontributeve të institucionit. Moskontabilizimi i debitorëve për diferencat e papaguara shtrembëron vlerën e regjistruar të debitorëve në kontabilitet. Diferenca e konstatuar nga ana jonë është nën pragun e materialitetit për të ardhurat, e megjithatë merr rëndësi sa i takon **rregullimit të procesit në tërësi**, që lidhet me ndjekjen e debitorëve (gjurmimin e zërit respektiv) dhe minimizimin e riskut që ky fenomen paraqet nëse shtrihet në të gjitha njësitë shpenzuese.



Moskontabilizimi i debitorëve për diferencat e papaguara, shtrembëron vlerën e regjistruar të debitorëve në kontabilitet. Diferenca e konstatuar nga ana jonë është nën pragun e materialitetit për të ardhurat, e megjithatë merr rëndësi sa i takon **rregullimit të procesit në tërësi**, që lidhet me ndjekjen e debitorëve (gjurmimin e zërit respektiv) dhe minimizimin e riskut që ky fenomen paraqet nëse shtrihet në të gjitha njësitë shpenzuese.

b. Të ardhurat e kontributeve nga Sigurimi vullnetar.

Sigurimit vullnetar u realizua për vitin 2017 për **483 milion lekë**, nga 470 milion lekë të programuara dhe 418 milion lekë realizuar një vit më parë. Kjo vlerë e kontributeve vazhdon të jetë minimale, sepse pjesa dërrmuese e klientëve të skemës, sigurohet vetëm për të mbuluar minimumin prej 15 vitesh për përfitim të pensionit të pjesshëm dhe më pas largohen nga skema (kryesisht janë kontribues emigrantë). Numri i emigrantëve nga viti në vit vjen në rënie në këtë skemë, si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjeve qeveritare me shtete të ndryshme. Të dhënat për skemën e sigurimit vullnetar, janë regjistruar në programin informatik CMIS për gjithë periudhën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

2017. Procedurat janë informatizuar dhe kryhen në kohë reale si pritja e dokumentacionit, përpunimi i të dhënave dhe pajisja e kontribuuesve me dokumentet e parashikuara e të kërkuara prej tyre. Kontabilizimi i tyre ndjek të njëjtën rjedhe dhe process si sigurimi i bujktut.

c. Të ardhura të tjera, realizuar për vitin 2017 në vlerë **193 milion lekë**, përbëhen nga të ardhura nga interesat e depozitave e blerjes së titujve të qeverisë dhe të ardhura të tjera jo tatimore.

-Kontributet nga interesat dhe nga ankandet e titujve janë audituar mbështetur në udhëzimin nr.30, datë 26.12.2013 të Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të Thesarit në formë rregjistrimi”, në marrëveshjen për organizimin e ankandeve të titujve të shtetit shqiptar shlyerjen e veprimeve dhe mbajtjen dhe regjistrimin e këtyre titujve”, me shkresat e Bankës së Shqipërisë/Departamenti i Operacioneve Monetare, ka njoftuar ISSH për rregjistrin e titujve dhe maturimin në datat e përcaktuara në portofolin bashkëlidhur shkresave. Procesi i kontabilizimit të këtyre vlerave ka ndjekur këtë rrugë: Njoftimin zyrtar të BOA për zhvillimin e ankandit; Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm/Drejtoria e Financës/Spektori i Buxhetit të Brendshëm, drejtuar BOA “Kërkesë për pjesmarje në titujt e qeverisë” shoqëruar me aneksin nr.2 të plotësuar e cikluar; Vertetimin për shpalljen e fituesit; Portofolin e BOA të nxjerrë për ISSH; Regjistrimin e tyre në ditarin e të ardhurave; Rakordimin periodik me BOA për gjendjen e llogarisë së fondit rezervë të ISSH. U verifikuan dhe audituan gjithë lëvizjet e vitit 2017 dhe rezultoi e regjistruar brenda kuadrit regullator.

Pra për vitin 2017, ankandet e maturuara të titujve të qeverisë, interesat e përfituara nga sejcili prej tyre, tatimi mbi këto të ardhura dhe interesat neto të përfituar si të ardhura, rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Shuma e futur në tituj	Shuma e intresit bruto nga titujt	Tatimi 15%	Neto nga interesat
	1,734.38	52.99	7.95	45.04
	817.99	8.16	1.22	6.93
	502.13	8.37	1.26	7.12
	680.23	13.17	1.98	11.20
	338.00	6.93	1.04	5.89
	1,443.00	32.36	4.85	27.50
	454.91	10.20	1.53	8.67
Shuma	5,970.60	132.18	19.83	112.35

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Financës

Pra për vitin 2017 janë bërë 7 trasferta nga Banka e Shqipërisë për pjesmarjen në blerjen e titujve të qeverisë të shumës së fituar në ankande për 5,970,640 mijë lekë, duke përfituar një interes bruto prej 132,176 mijë lekë dhe duke zbritur 15% të vlerës së tatimit mbi të ardhura prej 19,827 mijë lekë, të ardhurat e përfituara nga interesat për pjesmarje në titujt e qeverisë janë 112,349 mijë lekë. Po të bëjmë krahasimin edhe për tre vite më parë, vlera e titujve të fituar në ankandë, interesat e përfituara, të cilat që u shtohen të ardhurave që kontabilizohen për këtë insttucion, rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Emërtimi	2014		2015		2016		2017	
	Vlera e titujve	Interesat neto	Vlera e titujve	Interesat neto	Vlera e titujve	Interesat neto	Vlera e titujve	Interesat neto
Vlera e titujve të qeverisë	3,969.81	114.60	4,308.14	115.74	4,650.52	69.40	5,970.64	112.35
shtesa nga një vit më parë në vlerë			338.33	+1.14	342.38	-46.34	1,320.12	+42.95
shtesa nga një vit më parë në %			8.5 %	+1 %	+8 %	-40 %	28 %	+62 %

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Financës



Pra në vitin 2017, janë futur në blerjen e titujve të qeverisë vlera prej 5,970,640 mijë lekë, ose 1,320,120 mijë lekë më shumë se një vit më parë, apo 28% më shumë. Po të bëjmë krahasimin dhe me vitet e tjera, afërsisht kjo diferencë ruan këto nivele si për vitin 2015 dhe 2014.

Pra në vitin 2017, janë përfituar neto të ardhura nga interesat në pjesmarje nga fondi rezervë në titujt e qeverisë 112 milionë lekë, ose 43 milion lekë më shumë se një vit më parë dhe afërsisht në të njëjtat nivele me vitin 2015 dhe 2014.

U verifikuan dhe audituan gjithë lëvizjet e vitit 2017 dhe rezultoi se interes nga depozitat dhe interes nga blerja e titujve të qeverisë janë, regjistruar brenda kuadrit regullator.

II. Të ardhura për mbulimin e skemave të veçanta të pensioneve dhe mbulimin e deficitit.


Për vitin 2017, rreth 40% të të ardhurave (të hyrave), e përbëjnë financimet e buxhetit të shtetit për: **1.** Mbulimin e skemave të vecanta të pensioneve; dhe **2.** Financime nga buxheti i shtetit për mbulim deficitit. Për 4 vite financimet nga buxheti i shtetit, si për mbulimin e skemave dhe për mbulimin e deficitit janë si në tabelën e mëposhme:

Në million lekë

	Emërtimi i trasfertave	2014	2015	2016	2017
1	Për mbulimin e skemave	18,096	18,968	21,885	18,146
2	Për mbulimin e deficitit	29,619	23,466	27,093	30,559
	Financimi nga Buxheti i shtetit	47,715	42,434	48,978	48,705
-	<i>Ndryshimi nga një vit më parë në vlerë</i>		-5,281	+6,544	-273
-	<i>“ në %</i>		-11%	+15%	-0.6%

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Financës

Në mënyrë grafike trendi i shumave të financimit nga buxheti i shtetit ka qene pothajse i njëjtë.



Në fund të vitit 2017, ISSH/Drejtoria e Financës/Sektori i Buxhetit të Brendshëm, ka hartuar dhe miratuar nga Dega e Thesarit Tiranë Akt rakordimin për artikullin 604 “Financime nga buxheti i shtetit”, për skemat:

Në lekë

	Emërtimi	Planifikuar	Realizuar	Audituar
1	Gr.25Tit.10220;Kapitulli 1;Art.604	44,380,000,000	46,091,623,260	46,091,623,260
-	Mbulimi i skemave të pensioneve		17,892,491,706	17,892,491,706
-	Mbulim deficitit		28,199,131,554	28,199,131,554
2	Gr.10Tit.10270;Kapitulli 1;Art.604 (mbulim deficit)	4,951,500,000	2,360,000,000	2,360,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

3	Gr.17,Tit.10270;Kapitulli 1;Art.604	0	253,376,740	253,376,740
	FINANCIME NGA BUXHETI I SHTETIT GJITHSEJT	49,331,500,000	48,705,000,000	48,705,000,000

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Financës

Grupi 25 planifikuar 44,380 milion lekë dhe realizuar 44,380 milion lekë;

Grupi 10 planifikuar 4,951.5 milion lekë dhe realizuar 4,325 milion lekë;

Gjithësej planifikuar 49,331.5 milion lekë dhe realizuar 48,705 milion lekë, pra realizuar në masën 98.7%, ose 626.5 milion lekë më pak se planifikimi.

Urdhër shpenzimet kanë të bashkëlidhur kërkesën për tërheqje financimi për muajin ,të specifikuar në kërkesë sa për sigurimin suplementar, pagesa të vecanta për minatorë, për statusin e dëshmorëve, për punonjësit e ndërmarjeve ushtarake, për statusin profesor, shpenzime varrimi dhe sigurim suplementar ushtarakë mbrojtjes për të gjitha kategoritë e pensioneve të vecanta.

1. Të ardhura për mbulimin e skemave të pensioneve për vitin 2017, në vlerë 18,146 milion lekë, është programuar për çdo lloj skeme po në këtë vlerë dhe tërheqja e tyre është e barabartë me planifikimin. Është audituar gjithë procesi i tyre dhe ka rezultuar me kërkesa e transferata, të ndara si në tabelën e mëposhme:

Në lekë

Ilogaritë	Emërtimi i llogarive	Plan	Fakti	Audituar
755	Kontribute te buxhetit per mbulimin e skemave:	3,236,754,523	3,236,754,523	3,236,754,523
7550200	sig.shoq.per te papunet	455,764,320	455,764,320	455,764,320
7550300	sig.shoq.per ushtarake ne reforme e pension te parakoh	176,963,837	176,963,837	176,963,837
7550300	sig.shoq.per police ne ref dhe pension te parakoh	254,146,303	254,146,303	254,146,303
7550400	sig.shoq.per ish-funksionaret	17,447,401	17,447,401	17,447,401
7550300	sig.shoq.per ushtarake ne ref, e pension te parakoh	1,042,819,062	1,042,819,062	1,042,819,062
7550600	sig. shoq. per gra te pensionuara	1,227,327,552	1,227,327,552	1,227,327,552
7550700	sig.shoq.per punonj. e industri ushtarake+sigu per pun. e min.	62,286,048	62,286,048	62,286,048
720	Grant nga buxheti per pagesa te posacme :	9,858,343,256	9,858,343,256	9,858,343,256
7202001	grande per komp. e rritjes se c nga pens e te ardhura per pens.	9,541,897,186	9,541,897,186	9,541,897,186
7202002	grande per pensione shteterore te posacme	64,208,250	64,208,250	64,208,250
7202004	grande per shtesa te parashikuara per veteranet	206,793,149	206,793,149	206,793,149
7202005	grande per shtesa te parashikuara per invalidet e punes	45,444,671	45,444,671	45,444,671
720	Grant nga buxheti per trajtime te vecanta	5,050,770,667	5,050,770,667	5,050,770,667
7202060	grande per shtesa te parash. per pensi e ushtarakeve te tjere	3,550,303,171	3,550,303,171	3,550,303,171
7202068	perfitime per ushtaraket e nendetseve ne pension.	11,064,312	11,064,312	11,064,312
7202007	grande per pagesa kalimtare e pensione te ish funksionareve	229,000,446	229,000,446	229,000,446
7202008	grande per pagesa per shtesa te parashikuara per dëshmoret	27,666,241	27,666,241	27,666,241
7202009	grande per pagesa per shtesa te parashikuara per minatorët	555,106,957	555,106,957	555,106,957
7202010	grande per pagesa per shtesa te parashikuara per pilotët	65,348,591	65,348,591	65,348,591
7202011	grande per pagesa per shtesa te parashiku per industry. usht.	82,471,771	82,471,771	82,471,771
7202012	per shpenzime varrimi	214,975,886	214,975,886	214,975,886
7202013	perfitime per statusin e profesorit	132,471,771	132,471,771	132,471,771
7202014	pensione sociale	182,361,521	182,361,521	182,361,521
	TOTALI I KOMPESIMIT TË SKEMAVE	18,145,868,446	18,145,868,446	18,145,868,446

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Financës

2. Të ardhura për mbulimin e deficitit për vitin 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Buxheti i shtetit transferon fondet e veta në ISSH edhe për mbulimin e shpenzimeve kundrejt të ardhurave të realizuara nga kontributet dhe financimit të disa skemave të pensioneve. Çdo muaj dhe në fund të vitit 2017, ISSH/Drejtoria e Financës/Spektori i Buxhetit të Brendshëm, ka hartuar dhe miratuar nga Dega e Thesarit Tiranë “Akt rakordimin” për artikullin 604 “Financime nga buxheti i shtetit” për skemat:


Në lekë

Ilogaritë	Emërtimi i llogarive	plani	realizuar	Dif.fakt-plan	Audituar
7203001	Përmbulimin e deficitit(subvencion)	28,825,631,554	28,199,131,554	626,500,000	28,199,131,554
7203001	Përmbulimin e deficitit (per finan. Shpen.admin)	2,360,000,000	2,360,000,000	0	2,360,000,000
720	Financimepërmbulimdeficiti	31,185,631,554	30,559,131,554	626,500,000	30,559,131,554

Shënim: Tabela hartuar nga audituesit me të dhënat e ISSH, Drejtoria e Financës

Këto transferta janë programuar për të dy skemat, në vlerë 31,185,631,554 lekë, janë realizuar për 30,559,131,554 lekë dhe nuk është tërhequr vlera prej 626,500 mijë lekë. U audituan të gjitha transfertat dhe ishin të plotësuar me dokumentacionin ligjor.

Nga krahasimi i të dhënave të gjeneruara nga sistemi i Thesarit (Ministria e Financave) për klasën 604; të dhënave të gjeneruara nga sistemi Oracle i Drejtorisë së Financës në ISSH dhe evidencës fiskale të përgatitur nga Njësia e Buxhetit të Përgjithshëm në ISSH, për këtë kategori të ardhurash rezultoi se, vlera totale e transfertave nga buxheti I shtetit për mbulimin e deficitit edhe për mbulimin e skemave ishte e njëjtë në vlerën **48,705 milion lekë**, por sipas transfertave të specifikuar në llogari të ndryshme, këto vlera paraqesin diferenca²⁰.



Ndër të tjera nga auditimi u konstatua se, me urdhër shpenzimit nr.15, datë 12.01.2017, dërguar nga ISSH na rezultoi se, ISSH ka kërkuar transferimin nga llogaria 6042002 respektivisht me objekt shpenzimi “Pensione të posaçme” për shumën 5,117,430 lekë dhe “pension social” për shumën 14,534,304 lekë. Nga verifikimi që i bëmë nënlllogarive të Thesarit na rezultoi se Thesari ka prekur llogarinë 6042002 “Transferim për pensione të veçanta shtetërore” në total për vlerën 226,918,037 lekë për vitin 2017, ndërkohë që ISSH në llogarinë 7202002 “Pensione të posaçme” ka regjistruar shumën 64,208,250 lekë dhe në llogarinë 7202014 “Pensione sociale”, shumën prej 182,361,521 lekë. Në total 246,569,771 lekë (ose 19,651,734 lekë më shumë nga Thesari, por në përputhje me kërkesën e ISSH sipas urdhër shpenzimit nr.15, datë 12.01.2017). *Sa më sipër, nxjerr në pah dy problematika:*

1. Sistemi i Thesarit dhe ISSH në disa raste kanë mospërputhje të klasave 604 dhe 7, të cilat në fakt duhet të përputhen plotësisht, pasi vetëm kështu mund të gjurmohet të ardhura dhe përdorimi i saj sipas destinacionit të planifikuar nga burime të ndryshme;
2. Konstatohen diferenca edhe në vlera individuale për secilën llogari, edhe pse vlera totale e transfertës nga buxheti i shtetit rakordon me të ardhurat e ISSH. Sa më sipër tregoj se rakordimi

²⁰Në disa raste ndryshojnë tërësisht llogaritë, në disa raste të tjera, vlerat dhe në raste të tjera të dyja. Për këtë referoju Aneks 1.



me Ministrinë e Financave bëhet për shumën totale të transfertës dhe jo sipas nënllogarive të tyre. **Problematikat e mësipërme diktojnë nevojën e krijimit të një nomenklature të përbashkët llogarish e nënllogarish, mes ISSH dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për transfertat e buxhetit të shtetit, si për mbulimin e deficit, ashtu edhe për mbulimin e skemave të pensioneve.**

Titulli i çështjes: Auditim mbi realizimin e të ardhurave të ISSH në vitin 2017.

Gjetja 4 : Problematika dhe mangësi në hedhjen analitike të kontributeve të mbledhura nga DPT për ISSH.

Situata: Të ardhurat nga kontributet dhe të ardhura të tjera të realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) për vitin 2017, zënë rreth 96.2% të totalit të kontributeve të hyra në ISSH, në vlerë 70,543 milion lekë, për të cilat evidentohen problematika si vijon:

a- Konstatohet se ka mungesa në numrin e listë pagesave vjetore që duhet të dërgojë DPT-ja në ISSH dhe veçanërisht këto të identifikuar për vitin 2014, ku mungojnë një sasi e konsiderueshme e tyre dhe kryesisht për muajt tetor dhe nëntor të këtij viti. Megjithëse është vënë në dijeni zyrtarisht DPT-ja dhe po merren masat që ky informacion të kalojë në ISSH, teknikisht kjo çështje vijon të jetë në proces, duke krijuar problematika në përdorimin online të kësaj baze, sa i takon caktimit të pensioneve të personave që kanë mungesa të dhënash. Konkretisht, në fund të vitit 2017 rezultojnë gjithsej 1.810.880 listë pagesa të munguara dhe nga këto: 1.703.858, ose rreth 94% janë listëpagesa të munguara të të vetëpunësuarve (biznes i vogël); 101.226, ose rreth 6% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private); 5.796 janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë).

Gjithashtu konstatohen parregullsi e problematika, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 464, datë 22.07.1998 "Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë ISSH", që lidhen me procesin e dixhitalizimit dhe të skanimit të regjistrave të vjetërsisë në punë dhe të listëpagesave". Gjithashtu problematika konstatohen edhe në zbatimin e marrëveshjes midis DPT dhe ISSH, lidhur me procedurat dhe rregullat për dërgimin, apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributeve sipas subjekteve dhe individëve, komunikimin midis palëve mbi informacionin statistikor, si dhe çështjeve që dalin pas inspektimit nga ISSH të të dhënave mbi kontributet të procesuara në llogaritë individuale.

b- Ka mungesë informacioni për ato raste kur subjektet gjenden me detyrime të papaguara, ose të paguara pjesërisht, e cila ka sjellë mos-arkëtimin e të ardhurave nga kontributet, si pasojë e rritjes së numri të subjekteve debitorë dhe vlerës respektive të pambledhur nga këto subjekte.



-Konkretisht, në vitin 2017 kanë rezultuar **63,531 subjekte debitoare**, në vlerë **9.1 miliardë lekë**, të evidentuara në DPT, të cilët prodhojnë një problem të madh social dhe financiar. Për këtë vit, po dhe në vazhdimësi ISSH u ka bërë prezent organeve eprore, numrin e lartë dhe detyrimet e prapambetura për kontribute të papaguara, të subjekteve debitorë në organet tatimore. Këta debitorë të krijuar në DPT, për kontributet e sigurimeve shoqërore, të deklaruara dhe të pa derdhura në ISSH, ose kontribute të deklaruar më shumë se sa janë derdhur për llogari të ISSH, e të pa shoqëruara me listë pagesat përkatëse, janë të evidentuar në kontabilitetin e DPT. Debitorët për kontributet, janë evidentuar dhe ndiqen edhe nga drejtoria e kontributeve në ISSH, në zbatim të pikës 5.19, të kreut 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 09.12.2014 dhe të nën/pikës “iv”, shkronja “a”, të kreut II, të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit” nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr. 11422, datë 19.5.2017, ndërmjet DPT-së dhe ISSH-së, por nuk ka një plan veprimi midis dy institucioneve, për të mundësuar mbledhjen në kohë të detyrimeve të prapambetura për kontributet dhe mbajtjen nën kontroll të nivelit të borxhit subjektet kontributese të skemës së kontributeve.

-Gjithashtu në subjektet e biznesit të madh, subjektet fason, si dhe në disa subjekte që zhvillojnë veprimtari profesionale në media etj., ka rezerva dhe informalitet të konstatuar nga të dy institucionet (ISSH dhe DPT) për vlerën e kontributeve të derdhura. Konkretisht mbështetur në problematikat sa i takon listëpagesave që DPT i sjell ISSH.

Kriteret:

Në ligjet: nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në RSH”, i ndryshuar; ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; të ligjit vjetor të buxhetit nr.130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”; të ligjit 104/2014, datë 31.07.2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.05.1193 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, në nenet: 66, 74, 75, 77, 82

Në VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi sigurimeve shoqërore dhe sigurimit shëndetësor”.

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave për veprimet e mbylljes së vitit 2017.

Marëveshja midis DPT dhe ISSH, lidhur me procedurat dhe rregullat për dërgimin, apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributeve sipas subjekteve dhe individëve, komunikimin midis palëve të të dhënave statistikore dhe problematikave, që dalin pas inspektimit nga ISSH të të dhënave të kontributeve të procesuara në llogaritë individuale. Gjithashtu qëllimi i saj është edhe plotësimi i mungesavetë konstatuara në listë pagesat në format shkresor të personave juridikë dhe fizikë për periudhat e “pa informatizuara”.

Ndikimi:

Ndikimi i ulët i strukturave të ISSH në mbledhjen e të ardhurave, sidomos në

**Rëndësia:
Rekomandimi**

subjektet që nuk paguajnë kontribute dhe në rakordimin e tyre me listë pagesat e dërguara nga DPT dhe subjektet debitore të kontributeve.

E lartë

Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/DPT, të hartojnë dhe monitorojnë një plan-veprimi për të mundësuar zgjidhjen e problematikave të mbartura. Ky plan veprimi, duhet të përmbajë objektiva specifike, të matshme, të arritshme, përkatëse, dhe të mbështetura mbi afate konkrete për realizimin e tyre (objektiva SMART), që lidhen me:

a. Zgjidhjen e problematikave sa i takon mungesës së listëpagesave vjetore që DPT-ja duhet të dërgojë në ISSH dhe veçanërisht listëpagesat e muajve tetor dhe nëntor 2014, për të shmangur problematika në përdorimin online të kësaj baze, për caktimin e pensioneve të atyre personave me listëpagesa të munguara dhe zgjidhjen me prioritet të listë pagesave të munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012.

b. Plotësimin e informacionit të munguar për ato raste kur subjektet gjen detyrime të papaguara (debitore), ose të paguara pjesërisht, për të eliminuar mungesën e periudhave të sigurimit nëpërmjet analizës së debitorëve për periudhë më parshme, si dhe duke bërë rast pas rasti rregullimin dhe plotësimin e të vecanti plani i veprimit të përcaktoj kohën e evidentimit të subjekteve të të madh, subjektet fason, dhe subjektet që zhvillojnë veprimtari profesio media etj., të cilat nuk paguajnë në rregullisht, apo nuk derdhen fare kontr sigurimeve shoqërore për të punësuarit e tyre për minimizimin e evazionit f derdhjen e kontributeve.

Afati i zbatimit të rekomandimit:

Brenda vitit 2018

Gjetja 5:

Mbi kontabilizimin jo analitik të të ardhurave të kontributeve, mbledhur nga DPT dhe mos kontabilizimin e subjekteve debitore.

Situata:

Nga auditimi mbi kontabilizimin e të ardhurave të mbledhura nga DPT u konstatua se nuk janë parashikuar llogari të ardhurash sipas degëve të parashikuara nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi. Si pasojë, për vitin 2017, Drejtoria e Financës në ISSH, kontributet nga DPT, **në vlerën 70,734 milion lekë lekë**, të derdhura nga personat juridike e fizikë, subjektet publikë dhe private, dhe sistemimet e mëvonshme të këtyre kontributeve, nuk i ka regjistruar në kontabilitet me numër llogarie të specifikuar për çdo lloj kontributi, por i ka regjistruar vetëm në një llogari - 512100 "Të ardhura të hyra nga llogaria e unifikuar e thesari-TSA"-, llogari e cila nuk **jep sigurinë analitike** të krijimit të këtyre të ardhurave dhe verifikimin e dyfishtë të një veprimi kontabël, pra të dhënat statistikore të ardhura nga Drejtoria e Kontributeve të këtij institucioni, të mara nga DPT, të jenë të barabarta me shumatat e regjistruara në kontabilitet dhe të mara nga Ministria e Financës/Drejtoria e Thesarit për të gjitha kategoritë e kontributeve të ndara sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.



Kriteret:	Nenin 10, pika 3 e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku parashikohet se: "Paraqitjet e grupuara për të dhëna dhe elementë që ndikojnë në vendimmarrjet ekonomike të përdoruesve paraqiten veçmas në pasqyrat financiare. Paraqitjet e grupuara lejohen vetëm për elemente me natyrë të ngjashme, shumat e të cilave nuk janë materiale"
Ndikimi:	Ndikimi i ulët i strukturave të ISSH/Drejtoria e Financës dhe MFE, në kontabilizimin e të ardhurave me llogari analitike, në mënyrë që pasqyrat financiare të dalin me të dhënat e veta analitike të kontributeve të ardhura nga DPT dhe debitorët që rrjedhin prej tyre.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi	Strukturat drejtuese të ISSH/Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/DPTH, të riorganizojnë dhe mundësojnë regjistrimin e kontributeve të të ardhurave të sigurimeve shoqërore të derdhura në DPT dhe të trasferuara në ISSH <u>me nënlogari përkatëse analitike</u> , të specifikuar për çdo lloj kontributi dhe çdo lloj dege, konform legjislacionit në fuqi.
Afati i zbatimit të rekomandimit:	Brenda vitit 2018.
Gjetja 6:	Mos kontabilizim i debitorëve nga fermerët.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi për vitin 2017, referuar bilancit përmbledhës ²¹ janë realizuar në vlerën 2,126.67 milion lekë dhe se Drejtoria e Financës ndjek dhe kontabilizon në pasqyrat financiare vetëm vlerën e likuiduar nga fermerët, duke lënë jashtë kontabilitetit të dhënat mbi debitorët e krijuar si pasojë e gabimeve. Ndjekja e tyre vijon të bëhet vetëm nga Dega e Kontributeve të institucionit. Moskontabilizimi i debitorëve për diferencat e papaguara shtrembëron vlerën e regjistruar të debitorëve në kontabilitet. Diferenca e konstatuar nga auditimi, edhe pse nën pragun e materialitetit të vlerësuar nga grupi i auditimit, merr rëndësi sa i takon rregullimit të procesit në tërësi, që lidhet me ndjekjen e debitorëve (gjurmimin e zërit respektiv) dhe minimizimin e riskut që ky fenomen paraqet nëse shtrihet në të gjitha njësitë shpenzuese.
Kriteret:	Manuali Kontabël i ISSH, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.758/2, datë 04.03.2004, ku përcaktohet se: "në klasën 4 evidentohen edhe detyrimet për kontribute dhe kamatëvonesa të papaguara brenda vitit ushtrimor. Llogaritja e detyrimit për kontribute dhe kamatëvonesa të papaguara realizohet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe në akte të tjera nënligjore".
Ndikimi:	E mesme
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi	Strukturat drejtuese të ISSH/Drejtoria e Financës, të riorganizojnë në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, regjistrimin e detyrimeve të

²¹ Llogaritë kontabël 753 kontribute & 711 kamatëvonesa



kontributeve të ardhura nga fermerët në pasqyrat financiare, jo vetëm vlerën e likuajduar nga fermerët, por edhe vlerën e debitorëve të krijuar si pasojë e gabimeve në llogaritje të dala nga sistemi, në mënyrë që ndjekja dhe likuidimi i diferencave të jetë pjesë e ndjekjes së strukturave financiare të institucionit.

Brenda vitit 2018.

Afati i zbatimit të rekomandimit**Gjetja 5:**

Diferenca midis llogarive që përdor MFE dhe ISSH për transfertat nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit dhe skemave.

Situata:

Vlera totale e transfertave nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit dhe skemave (nga Ministria e Financave, MFE) rezultoi në shumën 48,705 milion lekë. Këto transferta janë pasqyruar nga MFE në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit, dhe regjistrohen si e ardhur në sistemin Oracle, nga Drejtoria e Financës në ISSH. Nga auditimi u konstatua se, emërtimet e llogarive që përdor MFE ndryshojnë nga emërtimet e llogarive që përdor ISSH.

Mospërputhjet mes nomenklaturës së llogarive midis dy institucioneve të sipërpërmendura, ka shkaktuar mospërputhje mes klasave të transfertave që tregojnë edhe qëllimin e përdorimit të tyre, si dhe mospërputhje mes vlerave respektive të tyre (edhe pse vlera totale e transferuar nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit dhe skemave është e njëjtë - 48,705 milion lekë). Sa më sipër vështirësojnë gjurmimin e transferimit dhe përdorimit të të ardhurave sipas destinacionit të parashikuar/kërkuar.

Kriteret:

Neni 4, pika 18 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollit", i ndryshuar, parashikon se kontrollet pas faktit verifikojnë nëse fondet publike arkëtohen e shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, si dhe për arritjen e rezultateve të pritshme nga përdorimi i fondeve publike; si dhe Neni 22, pika 5 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollit parashikon se, kontrollet pas faktit nuk kryhen nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit.

Rëndësia:

E mesme

Ndikimi:

Edhe pse nuk identifikua gabime gjatë auditimit, sa i takon vlerës totale të transfertës prej 48,705 milion lekë, nga buxheti i shtetit për ISSH, mospërputhja e emërtimeve dhe vlerave, të llogarive, mes dy sistemeve mbart rrisje potencialë që këto fonde të mos përdoren për qëllimin e parashikuar si rezultat i gabimeve ose veprimeve të qëllimshme.

Rekomandimi

Strukturat drejtuese të ISSH/Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të iniciojnë krijimin e një nomenklature të përbashkët llogarish e nënllogarish, mes ISSH dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për transfertat nga buxheti i shtetit, si për mbulimin e deficitit, ashtu edhe për mbulimin e skemave të pensioneve, me qëllim forcimin e kontrolleve për minimizimin e rrisqeve që lidhen me ndryshimin e destinacionit të të ardhurave. Nga ana e Ministrisë së



Financave, çdo fundmuaji të përpilohet një tabelë përmbledhëse ku të identifikohen llogaritë respektive sipas kësaj nomenklature të përbashkët, dhe shumat respektive të transferuara nga buxheti i shtetit sipas destinacionit të kërkuar nga ISSH. Ky dokument të shërbejë si akt-rakordim mes dy institucioneve dhe të firmoset nga të dy palët e përfshir anë proces. Është detyrë e menaxhimit të ISSH, të përcaktojë në procedurat e ushtrimit të kontrolleve pas faktit, personat përgjegjës që marrin pjesë në këtë proces.

Brenda 30.09.2018

Afati i zbatimit të rekomandimit

I/3. Auditimin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore (përfitimet e pensioneve) për vitin 2017.

Auditimi i shpenzimeve për vitin 2017, në Insitutin e Sigurimeve Shoqërore u krye duke u bazuar në : Ligji nr.130/2016 “Pë buxhetin e vitit 2017”; Aktin Normativ nr.2, datë 16.08.2017 “Për buxhetin e vitit 2017”; Akti Normativ nr.3, datë 06.11.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016”; Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “ Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregulloren financiare e Insitutit të Sigurimeve Shoqërore nr.5, datë 25.05.2009; Vendimin e Këshillit Administrativ nr.26, datë 22.12.2016 “Për buxhetin e drejtorive rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2017”; Në përfundim të auditimit rezultoi se për vitin 2017 në total fondet buxhetore për shpenzimet për sistemin e sigurimeve shoqërore janë 121,200 milion lekë dhe të grupuara në dy grupe kryesore:

- A.** Shpenzime për përfitime: Administrimi i këtyre shpenzimeve është realizuar nëpërmjet tre programeve bazë të transferimit të fondeve nga buxheti i ISSH, në buxhetet familjare, të cilat janë:
 - I. Shpenzime të skemës së pensioneve;
 - II. Shpenzime për programe të tjera;
 - III. Shpenzime të skemës së sigurimeve suplementare; dhe
- B.** Shpenzime administrative.

Baza ligjore mbi të cilën u bazua auditimi i shpenzimeve konsiston në sa vijon:

Për pensionet pleqërie, invaliditeti, pensione familjare

Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “ Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregulloria nr.1, datë 21.10.2008 “për caktimin , administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar; VKM nr.482, datë 29.06.2016 “Për disa çështje të dokumentimit të periudha të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioni”; VKM nr.1114, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, e ndryshuar; Udhëzimi i ISSH nr.2, datë 05.10.2005 “Për llogaritjen dhe indeksimin e bazës së vlerësuar për efekt pensioni sipas pagës referuese dhe pagës neto të indeksuar”; VKM nr.730, datë 02.09.2015 “Për një ndryshim të VKM nr.420, datë 12.09.2007 “Për kushtet e përfitimit , shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posacme”; Vendimi i Këshillit Administrativ nr.12, datë 29.06.2017 “Për miratimin e rregullores për llogaritjen dhe procedurën e indeksimit të



bazës së vlerësuar për efekt të përfitimeve”; Rregulloria nr.1, datë 21.10.2008 Për caktimin , administrimin dhe pagesën e pensioneve ”, e KA të ISSh, e ndryshuar me Rregulloren nr.1/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në rregulloren nr.1, datë 21.10.2008”.

Për pensione suplementare

1-Ligji nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, i ndryshuar (suplementi shtetëror)

VKM nr.548, datë 27.07.2017, “Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit ”, të ndryshuar; Rregullore nr.3, datë nr.3, date 15.8.1996 “Për përcaktimin , administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplimentare”, të ndryshuar; Ligji nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në RSH”, i ndryshuar (ushtarakët); VKM nr.793, datë 24.09.2010 “Për zbatimin e ligjit nr.10 142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplimentar të ushtarakëve të FA, të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të SHISH, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri”, të ndryshuar; Rregullore nr. 25, datë 3.9.1999 “caktimin , administrimin dhe pagimin e përfitimeve suplimentare të ushtarakëve”; Ligji nr.10139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, qendrës së studimeve albanologjike, akademisë së shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, i ndryshuar; VKM nr.651, datë 14.09.2016 “ Për zbatimin e ligjit nr.10139 , datë 15.05. 2009 “ Për pensionet shtetërore suplimentare të punonjësve të universiteteve, shkollave të larta, qendrës së studimeve albanologjike, akademisë së shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore në RSH të cilët kanë tituj shkencorë” , i ndryshuar; Ligji nr.150/2014, datë 06.11.2004“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”; VKM nr.78, datë 28.01.2015; në zbatim të ligjit nr.150/2014 datë 06.11.2004; Ligji nr. 8685 datë09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë financiar të punonjësve që kanë punuar në minera në nëntokë”, i ndryshuar; VKM nr.73, datë 15.02.2001, në zbatim të ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të ndryshuar; Ligji nr.9179 datë 29.01.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”; VKM nr.161, datë 18.03.2004;në zbatim të ligjit nr. nr.9179 datë 29.01.2004; Ligji nr. 8607 datë 27.04.2000 “Statusi dëshmorit të atdheut”, i ndryshuar; VKM nr.151, datë 25.04.2002; në zbatim të ligjit nr. 8607 datë 27.04.2000; Ligji nr. 9128, datë 29.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, i ndryshuar, VKM nr.53, datë 29.01.2004, VKM 644, datë 16.06.2010 në zbatim të ligjit nr.9128, datë 29.07.2003; Ligji nr. 9361, datë 24.03.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundrues, të nëndetësëve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”; VKM nr.69, datë 27.01.2006; në zbatim të ligjit nr.9361, datë 24.03.2005. Në mënyrë analitike, realizimi i zërave të shpenzimeve për vitin 2017, plani me ndryshime dhe realizimi i tij dhe për tre vite më parë, është si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2014 (1)	Fakti 2015 (2)	Fakti 2016 (3)	VITI 2017			
					Plani ndrysh (4)	Fakti (5)	Diferenca	
							Fakt- Plan (5-4)	17-16 (5-3)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	SHPENZIME PER PERFITIME (I+II+III)	99,636	105,293	112,117	118,840	116,937	-1,903	4,820
I	SHPENZIME TE SKEMES SË PENSIONEVE	85,296	88,904	93,457	101,428	100,174	-1,254	6,717
1	Shpenzime për sëmundje	393	331	337	375	371	-4	34
2	Shpenzime për barrë lindje	2,536	2,490	2,578	2,783	3,018	235	440
3	Shpenzime për pensione	82,357	86,071	90,529	98,257	96,771	-1,486	6,242
4	Shpenzime për aksidente e sëmundje profesionale	10	12	13	14	14	0	1
II	SHPENZIME PËR PROGRAME TË TJERA	9,633	11,497	13,687	11,989	11,829	-160	-1,858
1	Kom. supl për çmimin për pens.(energji,buke, ngarkesë)	3,918	4,336	4,378	4,588	4,582	-6	204
2	Kompensim të ardhura për pensionet e shtetit	5,323	6,084	8,239	6,071	6,221	151	-2,017
3	Kompensim të ardhura për pensionet e fshatit	0	633	614	830	597	-233	-17
4	Pensione të veçanta shtetërore (Pensione të posacme)	81	64	68	64	73	10	6
5	Komp. supl. për ish të persekutuarit (Pensione Sociale)	0	99	140	182	155	-27	15
6	Kompensim për veteranet dhe invalidët e luftës	267	236	206	207	161	-46	-45
7	Kompensim suplementar për invalidët e punës	43	45	41	45	39	-6	-2
III	SHPENZ PËR SKEMËN E SIGUR.SUPLEMENT	4,707	4,892	4,973	5,423	4,933	-490	-40
1	sigurime suplementare të ushtarakëve	2,678	3044.7	3,375	3,560	3,520	-40	145
2	“ të policisë së shtetit	232	191.3	67		65	65	-2
3	“ dëshmorët e atdheut	20	19.2	27	28	27	-1	0
4	“ Pilotëve	82	71.3	50	66	70	4	20
5	“ detarët	12	10.1	17	11	12	1	-5
6	Punonjës të ndërmarrjeve ushtarake	116	93.3	90	87	86	-1	-4
7	“ shtetërore	891	651.2	467	579	450	-129	-17
8	“ minorëve	441	521.7	582	555	403	-152	-179
9	“ pagesa varrimi	149	179.7	187	215	188	-27	1
10	“ statusi i profesorit	86	109.2	111	132	112	-20	1
11	Kontigjence për politika pensionesh				190		-190	0
IV	SHPENZIME ADMINISTRATIVE	1,862	2,016	2,159	2,360	2,144	-216	-15
1	Paga e shtesa 600	925	908	967	1,087	1,000	-86	34
2	Kontribute të sigurimeve shoqërore	143	145	149	165	160	-5	11
3	Blerje mallra e shërbime	763	867	906	1,016	970	-46	64
4	Investime	31	96	137	92	14	-78	-123
	TOTALI (I+II+III+IV)	101,498	107,309	114,276	121,200	119,081	-2119	4,805

(burimi i të dhënave: aktrakordimet e sektorit të buxhetit të përgjithshëm)

Realizimi i shpenzimeve gjithsej për vitin 2017, në vlerë 119,081 milion lekë, krahasuar me planin me ndryshime në vlerë -2,119 milion lekë, pra janë realizuar për 98,3%, ose realizuar më pak për -2,119 milion lekë, apo 1,7% më pak. Po ta krahasojmë realizimin e shpenzimeve gjithsej për vitin 2017 me planin fillestar të miratuar rezultojnë më pak 1%. Po ta krahasojmë realizimin e shpenzimeve gjithsej për vitin 2017 me realizimin e një viti më parë 2016 rezultojnë më shumë për 4%. Po ta krahasojmë realizimin e shpenzimeve gjithsej për vitin 2017 me realizimin e vitit 2015, rezultojnë më shumë për 11%. Nëpërmjet këtyre programeve, janë mbuluar me përfitime mbi 655 mijë përfitues të gjitha llojeve e kategorive (621 mijë përfitues të skemës së detyrueshme dhe 34 mijë të skemave suplementare) dhe rreth 17 mijë përfitues për përfitime afatshkurtra, duke transferuar në buxhetet familjare vlerën prej 116,937 milionë lekë, ose 4,2% më shumë se një vit më parë. Në tabelën e mëposhtme janë të evidentuara përfitimet e pensionisteve sipas 3 programeve në buxhetet familjare për vitet 2014, 2015, 2016 dhe 2017:

Në milion lekë

Nr.	Përshkrimi i zërave të shpenzimeve	Viti 2014	Viti 2015	2016	Viti 2017
1	Skema e detyrueshme e pensioneve	85,302	89,226	93,457	100,174
-	Shtesa e transferertës nga një vit më parë	5,670	3,924	4,231	6,717
-	Shtesa e transferertës në % nga një vit më parë	7.1	4.6	4.7	7.2
2	Programe te veçanta shtetërore	10,928	11,478	13,687	11,829
-	Shtesa e transferertës nga një vit më parë	1,726	550	2,209	-1,858
-	Shtesa e transferertës në % nga një vit më parë	18.8	5.0	19.2	-13.5
3	Skema suplementare	4,703	4,589	4,973	4,933
-	Shtesa e transferertës nga një vit më parë	-86	-114	384	-40
-	Shtesa e transferertës në % nga një vit më parë	-1.8	-2.4	8.4	-1




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

	TOTALI	100,933	105,293	112,117	116,937
-	Shtesa e transferertës nga një vit më parë	7,309	4,360	6,824	4,820
-	Shtesa e transferertës në % nga një vit më parë	6.4	4.3	6.5	4.2

Burimi i të dhënave (aktrakordimet nga sektori të buxhetit)

Pra shpenzimet e buxheteve familjare për të tre programet (shpenzimet gjithsej, pa shpenzimet administrative), rezultojnë në vitin 2017 për 116,937 milion lekë me një shtesë nga viti i kaluar për 4,820 milion lekë, ose 4.2% më shumë e kështu me radhë për të 2 vitet e tjera, me programe janë: 1) Shpenzimet e skemës së detyrueshme e pensioneve janë realizuar për 100,174 milion lekë me një shtesë nga viti i kaluar për 6,717 milion lekë, ose 7.2% më shumë e kështu me radhë për të 2 vitet e tjera; 2) Shpenzimet e programit të pensioneve të veçanta shtetërore, janë realizuar për 11,829 milion lekë me një pakësim nga viti i kaluar për -1,858 milion lekë, ose 13.5% më pak e kështu me radhë për të 2 vitet e tjera; 3) Shpenzimet e skemës së pensioneve suplementare, janë realizuar për 4,933 milion lekë me një pakësim nga viti i kaluar për -40 milion lekë, ose 1% më pak e kështu me radhë për të 2 vitet e tjera. Në formë grafike për 4 vite radhazi, të tre programet që përbëjnë buxhetet familjare (shpenzimet gjithsej - shpenzimet administrative), paraqiten kështu:



Bazuar në **raportet mujore financiare**, rezulton se janë ndjekur e respektuar çdo muaj limitet e programuara të shpenzimit të fondeve për transferata në buxhetet familiare, sipas kufijve të përcaktuar në ligjin për buxhetin e shtetit të vitit 2017, të ndryshuar, dhe me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave dhe në përfundim, ato janë realizuar në masën 98.4%, me një mos realizim prej 1, 903 milionë lekë. Gjithashtu evidentohet se janë respektuar limitet e programuara për shpenzimet administrative, ku ky program është realizuar në masën 91%, pra nga 2,360 milionë lekë të programuara janë shpenzuar 2,144 milionë lekë, me një mos realizim prej 216 milionë lekë. Kosto e administrimit të sistemit zë këtë vit 1,8% të shpenzimeve gjithsej nga 5% të shpenzimeve që parashikohet si limit në pikën 3, të nenit nr.67 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” i ndryshuar. Programi Sigurimi i Detyrueshëm Shoqëror nga 101,428 milionë lekë të programuara është realizuar 100,174 milionë lekë ose 98,8%.

b.Auditimi me programe i realizimit të buxhetit të shpenzimeve.

I.Programi “Shpenzimeve për skemën e detyrueshme të pensioneve”, zë 84,1% të shpenzimeve totale në vlerë 100,174 milion lekë. Duke e krahasuar me një vit më parë ky program ka shpenzuar 6,717 milion lekë,ose 7,2% më shumë se viti 2016. Realizimi i dy viteve më parë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

parashikimi në projekt buxhetin e vitit 2017, ndryshimet gjatë vitit 2017 dhe realizimi i tij, është si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016	2017			Diferen. 17-16	
					Prog.fillestar	Pr. i #	Fakti	Në vlerë	Në %
1	Shpenzime për sëmundje	393	331	337	375	375	371	34	110
2	Shpenzime për barrë lindje	2,536	2,490	2,578	2,783	2,783	3,018	440	117
3	Shpenzime për aksidente e sëmundje profesionale	10	12	13	13	13	14	1	108
4	Shpenzime për pensione	82,357	86,071	90,529	98,875	98,257	96,771	6,242	107
	Shuma (1+2+3+4)	85,296	88,904	93,457	102,046	101,428	100,174	6,717	107

(Burimi i të dhënave nga akt-rakordimet e sektorit të buxhetit)

Duke analizuar ritmet e rritjes së transfertës evidentohet se të gjithëzërat (sëmundje dhe barrë lindje, pensione dhe aksidente) janë rritur, kjo kryesisht si pasojë e ndryshimeve ligjore dhe futjes së nocionit të përfitimeve të përlllogaritura mbi pagën neto. Ky koncept ligjor i miratuar me reformën e pensioneve, jo vetëm që ka frenuar rritjen e shpenzimeve, por ka shmangur detyrimin për rritjen e normës së kontributeve për mbulimin e shpenzimeve. Për më tepër kjo masë mbetet mjaft e rëndësishme për arsye të shtimit të pjesëmarrjes së kontribuesve në sistem, që natyrisht krahas realizimit të të ardhurave do të krijojë edhe detyrime për mbulim me sigurim shoqëror. Ky program përbëhet nga këto produkte dhe është realizuar si më poshtë:

1.Shpenzime për sëmundje të përgjithshme, është realizuar në vitin 2017 për 371 milion lekë, në masën 98.9% dhe duke e krahasuar me një vit më parë ky zë ka shpenzuar 34 milion lekë,ose 10% më shumë dhe përfaqëson 2,949 raste të përfituara për paftësi të përkohshme në punë për vitin 2017 të regjistruara, sipas listës nr. bashkëlidhur.

2.Shpenzime për barrë lindje, është realizuar në vlerë 3,018 milion lekë, në masën 108.6% dhe duke e krahasuar me një vit më parë ky zë ka shpenzuar 440 milion lekë,ose 17,1% më shumë. Arsye e rritjes së këtyre shpenzimeve ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të përfituesve me leje barrë lindje nga 14,6 mijë në 2016 në 15,3 mijë në vitin 2017. Gjithashtu kjo rritje ka ardhur si rezultat i përfshirjes në skemën e barrë lindjes dhe përfitues baballarë të cilët për vitin 2017 rezultojnë 455 përfitues (e përfshirë në numrin total 15,3 mijë) për 12 drejtori rajonale të sigurimeve shoqërore në zbatim të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 27 / pika 1 dhe pika 7 dhe VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar.

3.Shpenzime për aksidente e sëmundje profesionale është realizuar në vlerë 14 milion lekë, në masën 101% dhe duke e krahasuar me një vit më parë ky zë ka shpenzuar 1 milion lekë,ose 6% më shumë.Për vitin 2017 numri i përfituesve për sëmundje profesionale është 36 raste në total 229 raste nga viti 2014.

4.Shpenzimet për pensione.

Ky zë i shpenzimeve përbën **96,6%** të shpenzimeve në gjithë skemën e përfitimeve të sigurimeve shoqërore dhe janë realizuar në vitin 2017 për 96,771milion lekë, në masën 98.5% të programimit. Duke e krahasuar me një vit më parë ky zë ka shpenzuar 6,242 milion lekë,ose 6.8% më shumë se viti 2016. Ky zë shpenzimesh është i ndarë në 3 grupe pensionesh (fshat-qytet), si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016	2017			Difer. 17-16	
					Prog.fille	Pr. i #	Fakti		N



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

					star			Në vlerë	ë %
1	Pensione pleqërie	68,510	72,012	76,429	83,706	83,088	82,241	5,812	108
-	“ qyteti	56,397	58,695	63,266	71,278	70,660	69,221	5,955	109
-	“ fshati	11,918	13,119	13,015	12,241	12,241	12,851	-164	99
-	shpenzime varrimi	195	198	148	187	187	169	21	111
2	Pensione invaliditeti (paaftësie)	9,647	9,955	10,131	10,784	10,784	10,561	430	104
-	“ qyteti	9,104	9,357	9,529	10,163	10,163	9,990	461	105
-	“ fshati	543	598	602	621	621	571	-31	95
3	Pensione familjare	4,207	4,104	3,969	4,385	4,385	3,968	-1	100
-	“ qyteti	3,869	3,788	3,711	4,107	4,107	3,760	49	101
-	“ fshati	338	316	258	278	278	208	-50	81
	Shuma (1 +2+3+4)	82,364	86,071	90,529	98,875	98,257	96,771	6,242	107
a	Shpenz.Pensione fshati	12,799	14,033	13,875	13,140	13,140	13,691	-184	98
b	Shpenz.Pensione qyteti	69,565	72,038	76,654	85,735	85,117	83,080	6,426	108

Burimi i të dhënave (aktrakordimet e sektorit të buxhetit)

Rritja e nivelit të shpenzimeve të pensioneve, si përbërës kryesor i Programit “Shpenzime për skemën e detyrueshme të pensioneve”, është pasojë e indeksimit të pensioneve në masën 3%, duke filluar nga muaji Mars i viti 2017, si dhe e rritjes neto të numrit të përfituesve u arrit njehësimi e masës së rritjes së pensionit për të gjitha kategoritë e pensioneve si në qytet dhe fshat. Numri i pensioneve të reja të lidhura për periudhën Janar deri më Dhjetor të vitit 2017 është 34,458 ose 601 pensione më pak se viti 2016. Rënia e numrit të përfituesve të rinj ka sjellë si pasojë edhe rënie të lehtë të ritmit të rritjes së numrit të pensioneve, krahasuar me diferencën e vitit 2017 - 2016. Kështu realizimi i shpenzimeve të pensioneve për vitin 2017 është në masën 98,8% ose 96,771 **milion lekë**, dhe krahasuar me vitin 2016 për 6,242 milion lekë më shumë, ose 6,8% më të larta. Rritja e shpenzimeve për pensione, vjen si rezultat i rritjes së numrit të pensioneve dhe indeksimit të masës së pensioneve. Pjesën më të madhe të shpenzimeve për pensione, e zënë pensionet urbane rreth 86,3% ndërsa pensionet rurale zënë 13,7% të shpenzimeve por me një ritëm drejt uljes deri në shuarje për shkak të reformës së pensioneve. Të ndara shpenzimet për pensione paraqiten si më poshtë vijon:

1. Shpenzimeve për pensione pleqërie, në masën 82,241 milion lekë, pra më shumë se në vitin 2016 për 5,812 milion lekë, ose 8% më shumë. Duke e krahasuar me vitin 2015 është ritur me 14.2%, ose në vlerë 10,229 milion lekë;

2. Realizimi i shpenzimeve të pensioneve të invaliditetit në masën 10,561 milion lekë, pra më shumë se viti 2016 për 430 milion lekë, ose 4.2% më shumë. Duke e krahasuar me vitin 2015 është ritur me 6%, ose në vlerë 606 milion lekë. Janë lidhur për vitin 2017 pensione të reja invaliditeti gjithsej 4,028 për 12 drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Invaliditet dhe ekspertiza mjekësore e punës. Janë trajtuar me përfitime 69,716 invalidë. Nga të dhënat mujore statistikore mbi aktivitetin e KMCAP-ve të rajoneve, rezulton se gjatë vitit 2017 janë komisionuar për herë të parë 5,102 raste gjithsej. Duke e krahasuar me vitin 2016 konstatohet se ka një rritje të numrit të rasteve që janë komisionuar e konkretisht gjatë vitit 2016 numri i rasteve ishte 4,988 dhe në fund të vitit 2017 rezulton se janë 5,102 raste. Vlen të përmendet fakti se me ulje të numrit të komisionimit për herë të parë gjatë vitit 2017 janë Drejtoritë Rajone Sigurimeve Shoqërore Berat, Dibër dhe Fier, ndërsa rajonet e tjera rezultojnë me rritje sikurse është DRSSH Korçë nga 561 raste të reja për vitin 2016 në fund të vitit 2017 ky numër rezulton në 705 raste.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

3. Realizimi i shpenzimeve të pensioneve familjare në masën 3,968 milion lekë, pra më pak se viti 2016 për 1 milion lekëmë pak. Duke e krahasuar me vitin 2015 është pakësuar me 3.2%, ose në vlerë 136 milion lekë. Numri i pensioneve familjare të rezultuara në fund të vitit 2017 është 2,208 ose 139 pensione më shumë se viti 2016. Në rritjen e vlerës së pensioneve ka ndikuar edhe rritja e numrit të pensionistëve nga viti në vit. Në mënyrë të përmblodhur sipas 12 DRSSH për vitin 2017 totali i pensioneve sipas të dhënave nga sektori i përfitimeve afatgjatë paraqitet si më poshtë vijon:

RAJONET Viti 2017	Pensione pleqërie		Pensione invaliditeti		Pensione familjar		Pensione gjithsej		Totali pensioneve
	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural	
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
BERAT	20,184	7,939	2,544	555	1,815	363	24,543	8,857	33,400
DIBER	10,833	7,349	2,513	304	2,959	452	16,305	8,105	24,410
DURRES	34,555	8,819	6,555	794	4,540	773	45,650	10,386	56,036
ELBASAN	29,424	14,390	9,403	1,059	4,548	1,002	43,375	16,451	59,826
FIER	41,436	16,618	5,508	1,007	4,222	981	51,166	18,606	69,772
GJIROKASTER	15,341	5,550	1,770	247	1,648	161	18,759	5,958	24,717
KORÇE	35,410	11,470	6,124	588	4,143	490	45,677	12,548	58,225
KUKES	7,552	3,770	2,605	90	2,206	194	12,363	4,054	16,417
LEZHE	15,098	5,784	3,517	398	2,864	326	21,479	6,508	27,987
SHKODER	28,753	11,070	3,616	492	3,826	465	36,195	12,027	48,222
TIRANE	103,540	16,195	13,972	1,307	11,010	1,266	128,522	18,768	147,290
VLORE	36,905	10,012	3,998	514	3,026	258	43,929	10,784	54,713
TOTAL	379,031	118,966	62,125	7,355	46,807	6,731	487,963	133,052	621,015

RAJONET	Pensione gjithsej		Totali pensioneve	% urbanit	% ruralit
	Urban	Rural			
1	8	9	10	11	12
BERAT	24,543	8,857	33,400	73	27
DIBER	16,305	8,105	24,410	67	33
DURRES	45,650	10,386	56,036	81	19
ELBASAN	43,375	16,451	59,826	73	27
FIER	51,166	18,606	69,772	73	27
GJIROKASTER	18,759	5,958	24,717	76	24
KORÇE	45,677	12,548	58,225	78	22
KUKES	12,363	4,054	16,417	75	25
LEZHE	21,479	6,508	27,987	77	23
SHKODER	36,195	12,027	48,222	75	25
TIRANE	128,522	18,768	147,290	87	13
VLORE	43,929	10,784	54,713	80	20
TOTAL	487,963	133,052	621,015	79	21

Kështu në fillim të vitit 2017 ishin **611,544** pensionistë dhe në fund të vitit 2017 rezultuan **621,015 pensionistë**, ose janë shtuar këtë vit **9,471** pensionistë (shtesa e numrit vjen si rezultat i e njerëzve që dalin në pension (përfshihen në skemën e pensioneve) , me pensionistët që dalin nga skema e pensioneve /vdesin). Numri i pensionistëve në tre grupe rezultojnë:

- Pensione pleqërie që rezultojnë në fund të 2017, janë 497,997 pensionistë;
- Pensione invaliditeti që rezultojnë në fund të 2017, janë 69,480invalidë;
- Pensione familjare që rezultojnë në fund të 2017, janë 53,538 pensione.

Nga evidencat statistikore konstatohet se, masa e pensionit mujor dhe të ardhurat mujore fshat qytet për 4 vite radhazi kanë ndryshuar, si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë/muaj




KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Emërtimi	Viti 2014		Viti 2015		Viti 2016		Viti 2017	
	minim	maksim	minim	maksim	minim	maksim	minim	maksim
Masa pensionit në muaj në qytet	12,264	24,528	12,436	24,871	12,635	25,269	13,014	26,028
Masa e ndryshimit nga një vit më parë			172	343	199	398	379	759
Masa e ndryshimit në %			1.4	1.4	1.6	1.6	3%	3%
Masa e pensionit në muaj në fshat	8,398	12,264	8,516	12,436	8,652	12,635	8,911	13,014
Masa e ndryshimit nga një vit më parë			118	172	136	199	259	379
Masa e ndryshimit në %			1.4	1.4	1.6	1.6	3%	3%
Masa e të ardhurave në muaj në qytet	14,414	25,028	14,586	25,371	14,785	25,769	15,228	26,542
Masa e ndryshimit nga një vit më parë			172	343	199	398	443	773
Masa e ndryshimit në %			1.2	1.4	1.4	1.6	3%	3%
Masa e të ardhurave në muaj në fshat	9,288	12,464	9,406	12,636	9,542	12,835	9,828	13,220
Masa e ndryshimit nga një vit më parë			118	172	136	199	286	385
Masa e ndryshimit në %			1.3	1.4	1.4	1.6	3%	3%

Nga tabela e mësipërme vërehet se në vitin 2017 masa e pensionit është ritur 3%, ndërsa një vit më parë me 1.6% si në qytet dhe në fshat (ndërsa aktualisht diferencia e pensionit maksimal me minimal nuk është i ndryshëm si në fshat dhe qytet). Në zbatim të VKM nr.161, datë 01.03.2017 “Për disa ndryshime në VKM nr.409, datë 01.06.2016 ” u bë ngushtimi i diferencave në masën e pensioneve për të gjitha kategoritë si në qytet e në fshat në përmushje kjo edhe të **objektivave të institucionit**. Masa e pensionit mujor minimal dhe maksimal, për 3 vite të njëpasnjëshëm, në qytet dhe në fshat paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Realizimi i shpenzimeve të pensioneve të fshatit, të cilat këtë vit zënë **14.1%** të shpenzimeve të pensioneve janë në masën 13,691 milion lekë, pra më pak se viti 2016 për 184 milion lekë, ose 1.8% më pak. Duke e krahasuar me vitin 2015 është ulur me 15.4%, ose në vlerë 342 milion lekë;

Realizimi i shpenzimeve të pensioneve të qytetit, të cilat këtë vit zënë **85.9%** të shpenzimeve të pensioneve gjithsej, janë në masën 83,080 milion lekë, pra më shumë se viti 2016 për 6,426 milion lekë, ose 8.5% më shumë. Duke e krahasuar me vitin 2015 pensionet e qytetit janë ritur me 15.4%, ose në vlerë 11,042 milion lekë. Numri i pensioneve të reja për periudhën nga Janari i vitit 2017 deri më 31.12.2017 të lidhura është 34,458 dhe krahasuar me vitin 2016 (i cili rezulton 35,059 numri i pensioneve) rezulton një numër më i vogël prej 601 pensione të reja më pak, nga të cilët: -93%, e tyre, ose 32,136 pensione janë të lidhura në afat mesatarisht për 21 ditë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-7%, e tyre ,ose 2,322 pensione janë të lidhura jashtë afatit, mesatarisht për 89 ditë. Mesatarisht për caktimin e një pensioni janë dashur 25 ditë. Për vitin 2017 sipas 12 DRSSH paraqiten më hollësisht pensionet e lidhura brenda afatit dhetë lidhura jashtë afatit si më poshtë vijon:

Nr	Rajoni	Pensione Gjithsej	Dite mesatare te nje pensioni	Pensione brenda afatit (Nr)	Afatit (dite mesatare/pension)	%	Dite mesatare te nje pensioni	Brenda afatit	Jashte afatit
1	Diber	1,182	20	1,110	14	72	118	94	6
2	Durres	3,203	27	2,734	22	469	57	85	15
3	Elbasan	3,079	23	2,758	16	321	90	90	10
4	Fier	3,841	30	3,653	24	188	147	95	5
5	Gjirokastr	1,465	18	1,440	17	25	88	98	2
6	Korce	3,547	21	3,473	20	74	56	98	2
7	Kukes	591	21	566	20	25	52	96	4
8	Lezhe	1,470	18	1,459	17	11	172	99	1
9	Shkoder	2,521	11	2,517	11	4	49	100	0
10	Tirane	8,632	35	7,882	29	750	104	91	9
11	Vlore	3,267	16	3,201	15	66	55	98	2

(burimi i të dhënave: Sektori i përfitimeve afatgjatë)

Në zbatim të Rregullores nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin , administrimin dhe pagesën e pensioneve” , i ndryshuar për vitin 2017për 12 DRSSH afati i lidhjes së pensioneve të reja rezultojn ;

a.Për kategorinë e pensioneve të pleqërisë , numri gjithsej është 28,222 nga të cilët:

-96% e tyre ose 27,081 pensione janë të lidhura në afat mesatarisht për 21 ditë dhe 4% e tyre ose 1,141 pensione janë të lidhura jashtë afatit mesatarisht për 69 ditë.

Për pensionet familjare numri gjithsej është 2,208 nga të cilët ;

-95% e tyre ose 2,100 pensione janë të lidhura në afat mesatarisht për 19 ditë dhe 5% e tyre ose 108 pensione janë të lidhura jashtë afatit mesatarisht për 67 ditë.

Për sa i përket lidhjes së pensioneve rezultojn se numri i pensioneve të reja të pleqërisë për periudhën objekt auditimi është 28,222 pensione ose 1,1259 pensione më pak se viti 2016.

Numri i pensioneve të invaliditetit është 4,028 ose 519 pensione më shumë se në vitin 2016, ndërsa numri i pensioneve familjare është 2,208 ose 139 pensione më shumë se në vitin 2016.

Gjatë vitit 2017janë përcaktuar 34,459 pensione të reja nga 35,059 pensione të reja të caktuara në vitin 2016. Nga evidencat rezultojn se në vitin 2017 evidentohen edhe një rënie lehtë e pensioneve të reja ndaj vitit 2016 të moshës së daljes në pension të grave. Rënia e numrit të përfituesve të rinj ka sjellë si pasojë edhe një rënie të lehtë të ritmit të rritjes së numrit të pensioneve , krahasuar me diferencën e vitit 2017 dhe vitit 2016.Referuar pikës 3 të nenit 85 të ligjit 7703, datë 11.05.1993

“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores nr.1,datë 21.10.2008 “Për caktimin , administrimin dhe pagesën e pensioneve” rezultojn se % e lidhjes në afat e pensioneve e paraqitur në pasqyrën e mësipërme rezultojn se:

a.Mesatarisht për caktimin e një pensioni janë dashur 25,4 ditë nga 45 ditë që është koha maksimale ligjore për lidhjen e një pensioni. Nga 34,458pensione të reja 88,1% e tyre ose 32,132 pensione janë lidhur brenda afatit ligjor dhe koha mesatare e caktimit të tyre është 20,9 ditë .Janë të lidhura jashtë afatit ligjor të përcaktuara në aktet e sipërpërmendura 6,8% e pensioneve të cilat janë caktuar mesatarisht për 88,1%.

Për vitin 2017 DRSH Berat, Tiranë dhe Elbasan rezultojnë 150 pensione të lidhura jashtë afatit ligjor me 2 deri në 5 muaj dhe DRSSH Fier, Lezhë dhe Dibra rezultojnë 280 pensione të cilat janë vonuar lidhja e tyre nga 3 deri në 5 muaj.



Shkaqet kryesore janë vonese në aktverifikimet e vjetërsisë në punë brenda degë rajonale të sigurimeve shoqërore dhe nga vonesat e konstatuara nga konfirmimet e pagave nga arkivat e DRSSH dhe mungesat e dokumentacionit si borderotë para vitit 1993 dhe të listëpagesave pas vitit 1994. Për 12 DRSSH për vitin 2017 në mënyrë të detajuar numri i pensioneve të reja dhe % e lidhjes në afat e tyre referuar të dhënave nga sektori i përfitimeve afatgjatë dhe sektori i statistikës në Issh paraqiten si më poshtë vijon:

II. Programi "Shpenzime për programe të tjera".

Për këtë kategori përfituesish janë kryer gjatë vitit shpenzime në shumën totale **11,829 milion lekë** dhe krahasuar me planin e vitit janë realizuar më pak në shumën 160 milion lekë ose janë realizuar 98.7%. Po të krahasojmë këto shpenzime me vitin 2016, kemi ulje të përfitimeve në total në vlerën 1,858 milion lekë, ose 14% më pak. Realizimi i një viti më parë, parashikimi në projekt buxhetin e vitit 2017, ndryshimet gjatë vitit 2017 dhe realizimi i tij, është si në tabelën e mëposhme:

Në milion lekë

Nr	Emërtimi	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016	2017			Difer. 17-16	
					Prog.fill estar	Pr. i #	Fakti	Në vlerë	Në %
1	Kom. supl për çm per pens.(energj,buke,ngarkesë)	3,918	4,336	4,378	4,588	4,588	4,582	204	105
2	Kompensim të ardhura për pensionet e shtetit	5,323	6,084	8,239	4,358	6,071	6,221	-2,017	76
3	Kompensim të ardhura për pensionet e fshatit	0	633	614	596	830	597	-17	97
4	Pensione të veçanta shtetërore (Pensione të posaçme)	81	64	68	64	64	74	6	108
5	Shpenzimet per komp supl. (Pensione Sociale)	0	99	140	182	182	155	15	111
6	Kompensim për veteranet dhe invalidët e luftës	267	236	206	207	207	161	-45	78
7	Kompensim suplementar për invalidët e punës	43	45	41	45	45	39	-2	95
II	Shumapër programe të tjera	9,633	11,497	13,687	10,040	11,989	11,829	-1,858	86

Sipas zërave këto shpenzime janë realizuar si më poshtë vijon:

1.Kompesim suplementar për çmimet për pensionistët (energji, bukë, ngarkesë) janë realizuar në shumën **4,582 milion lekë** dhe paraqiten me realizim në masën 99.9%, ose janë shpenzuar më pak 6 milion lekë. Këto shpenzime kryhen në zbatim të VKM nr.8, datë 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kë në muaj" dhe masa e kompensimit të energjisë është 648 lekë në muaj. Aktualisht nga ky shpenzim përfitojnë si pensionistë që jetojnë në qytete edhe ato në fshatra në bazë të VKM nr.495, datë 29.06.2016 " Për disa ndryshime dhe shtesa të VKM nr.8 datë 14.01.2015 për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kë/muaj".

2.Kompensim të ardhura për pensionet e shtetit janë realizuar në shumën **6,221 milion lekë** dhe paraqiten me realizim në masën 102,4%, ose janë shpenzuar më shume 151 milion lekë. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime janë ulur me 2,017 milion lekë, ose 24%.

3.Kompensim të ardhura për pensionet e fshatit, janë realizuar në shumën **597 milion lekë** dhe paraqiten me realizim në masën 71.9% ose janë shpenzuar më pak 233 milion lekë. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime janë ulur me 17 milion lekë, ose 3%.

4.Shpenzimet për pensione speciale dhe të posaçme, janë realizuar në shumën **74 milion lekë** dhe paraqiten me realizim në masën 115,6%, ose janë shpenzuar më shume për 10 milion lekë. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime janë ritur me 6 milion lekë, ose 8 %. Aktualisht kanë përfituar pensione suplimentare dhe trajtime të veçanta sipas dispozitave ligjore të cituara më sipër rreth 33,383 përfitues në totali për 12 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, dhe numri i përfituesve për pagesë për suplementarin për persona që kanë kryer funksione kushtetuese dhe të



tjerë punonjës shteti është 2,589 përfitues, në zbatim të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplimentare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, VKM nr.548, datë 27.07.2017, i ndryshuar dhe rregulloren nr.3, datë 15.08.1996, i Këshillit Administrativ të ISSH, i ndryshuar.

Në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, këto shpenzime kryhen për rastet e përfitimeve për pensione të posaçme që jepen nga shteti për personat që: kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare (neni 5 i ligjit), në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve, në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta, kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës; kanë vuajtur nga persekutimi politik në regjimin komunist, etj. Kushtet e përfitimit, shuma dhe procedura për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore përcaktohen nga KM. Sipas VKM nr.730, datë 02.09.2015, masa e pensionit të posaçëm është përcaktuar që të mos jetë më e ulët se katërfishi i pensionit social.

5. Shpenzime për pensione sociale, janë realizuar në shumën **155 milion lekë** dhe paraqiten me realizim në masën 85,1%. Kjo skemë sa vjen dhe është në ulje për shkak të moshës së vjetërsisë të përfituesve. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime janë ritur në vlerë 15 milion lekë, ose 11%. Në fund të vitit 2017 numri i përfituesve të pensionit social rezulton 2,589 përfitues nga 2,412 përfitues që rezultuan në fund të vitit 2016, të cilët rezultojnë se nuk plotësojnë kushtet për pension nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore dhe nuk kanë asnjë të ardhur. Këto shpenzime realizohen në zbatim të nenit 5/1 të ligjit nr.7 703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

6. Shpërblim për veteranët dhe invalidët e luftës, janë realizuar në shumën **161 milion lekë** dhe paraqiten me realizim në masën 77,7% ose janë shpenzuar më pak 46 milion lekë. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime janë ulur në vlerë 45 milion lekë, ose - 22%, për shkak të uljes së numrit të përfituesve (vdekur).

7. Shpenzime për shtesë nga statusi për invalidet e punës, janë realizuar në shumën **39 milion lekë** dhe paraqiten me realizim në masën 86.7%, ose janë shpenzuar më pak 6 milion lekë. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime janë ulur me 2 milion lekë, ose me 5% dhe i përkasin 6 raste pensione invaliditeti pune që janë lidhur gjatë vitit 2017, nga 4,028 raste pensione invaliditeti gjëndje në fund të vitit 2016, si pasojë e ndryshimit të ligjit nr.7 703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Rshqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7 703, datë 11.05.1993 Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 21 në të cilën përcaktohet se periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i pafte dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurimi shoqëror.

Këto shpenzime përfaqësojnë kundra vleftën e furnizimeve me karburant për invalidët e punës që janë pajisur me mjete lëvizjeje nga ISSH, si dhe invalid që i kanë blerë vetë mjetet motorike, në zbatim të VKM nr.723, datë 19.11.1998 “për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar me VKM nr.1692, datë 17.12.2008 “Për një ndryshim në VKM nr.723, datë 19.11.1998”.

Aktiviteti i KMCAP-ve Eprore bazohet në pikën 1, të nenit 39/2 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe komisionet eprore zgjidhen në zbatim të VKM nr.787, datë 22.09.2015 “Përbërjen e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë”, aktualisht në ISSH funksionin 6 KMCAP dhe funksionimi i komisioneve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

epre përcaktohet me VKM nr.505, datë 10.06.2015 “Për organizimin dhe funksionimin dhe shpërblimin e komisioneve epre të KMCPA”.

Gjatë vitit 2017 rezulton se numri total i pensioneve të reja të invaliditetit arrin në 4,028 raste nga 3,509 raste që ishte në fund të vitit 2016. Nga këto 6 pensione invaliditeti janë lidhur si pasojë e aksidenteve në punë. Përfitimet sipas kategorisë së pensionit ndahen për invalidë në fshat 217, invalidë shteti 993 dhe invalidë të rezultuara nga zbatimi të ndryshimeve pas vitit 2015 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar janë **2,818 përfitues**.

III. Programi “Shpenzime për skemën e sigurimeve suplementare”.

Këto shpenzime janë realizuar në shumën 4,939 milion lekë, kundrejt 5,423 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 91%, ose realizuar më pak për 294 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar ky program është realizuar më pak për 0,7%, ose në vlerë absolute për 34 milion lekë. Realizimi i tre viteve më parë, parashikimi në projekt buxhetin e vitit 2017, ndryshimet gjatë vitit 2017 dhe realizimi i tij, është si në tabelën e mëposhtme: *Në milion lekë*

Nr	Emërtimi	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016	2017			Difer.viti 17-16	
					Prog.fill.	Pl. me #	Fakti	Në vlerë	Në %
1	sigurime suplementare të ushtarakëve	2,678	3044.7	3,375	3,960	3,560	3,520	144	104
2	“ të policisë së shtetit	232	191.3	67			65	-2	96
3	“ dëshmorët e atdheut	20	19.2	27	27,6	27,6	27	0	101
4	“ Pilotëve	82	71.3	50	65,3	65,6	70	20	141
5	“ detarët	12	10.1	17	11	11	12	-5	72
6	Punonjës të ndërmarrjeve ushtarake	116	93.3	90	87	87	86	-4	95
7	“ shtetërore	891	651.2	467	579	579	450	-17	96
8	“ minatorëve	441	521.7	582	555	555	403	-179	69
9	“ pagesa varrimi	149	179.7	187	215	215	188	7	104
10	“ statusi i profesorit	86	109.2	111	132	132	112	1	101
11	Kontigjenca per politikat e pensioneve				190	190			
	TOTALI	4,707	4,892	4,973	5,823	5,423	4,933	-34	99.3

(Burimi i të dhënave: Sektori i buxhetit të përgjithshëm)

Programi për sigurimet suplementare përmban në vetvete shpenzimet për përfitime nga pensionet, si dhe përfitime të tjera, të cilat nuk lidhen me skemën publike të pensioneve. Në këtë program administrohen: skema e pensioneve të posaçme, skema e pensioneve suplementare të punonjësve që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skema e sigurimeve suplementare të ushtarakëve, pilotëve, ushtarakëve të nëndetëseve, policisë së shtetit, skema e trajtimeve financiare të veçanta për minatorët dhe punonjësit e industrisë ushtarake, si dhe skema e trajtimeve të veçanta për familjet e dëshmoreve, të cilat në total kanë **33,883 përfitues**. Në këtë program gjithashtu përfshihen edhe pagesat për rimbursimin e shpenzimeve të funeraleve. Numri i kërkesave për përfitime suplementare është 3,531 nga të cilat janë 2,560 të llogaritura. Problematikë paraqiten numri i personave të punësuar të cilët trajtohen me përfitime suplementare. Konkretisht rezulton se për vitin 2017 nga verifikimi i 1,402 përfitues të skemave suplementare rezultuan të punësuar 884 dhe dëmi financiar i shkatuar është 220,839,379 lekë. *Sipas zërave shpenzimet e këtij programi, janë realizuar si më poshtë vijon:*

1. Sigurime suplementare të ushtarakëve, realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 3,520 milion lekë, dhe i përket 26,275 përfitues dhe kundrejt 3,560 milion lekë të planit të ndryshuar, është realizuar në masën 98.9%, ose realizuar më pak për 40 milion lekë. Duke e krahasuar me



vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 145 milion lekë, ose për 4% më shumë.

2.Sigurime suplementare të policisë së shtetit, realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 65 milion lekë, dhe krahasuar me vitin 2016 është realizuar më pak për 2 milion lekë, ose për 4% më pak.

3.Sigurime suplementare për dëshmorët e atdheut, realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 27,2 milion lekë, dhe i përket 26,275 përfitues dhe kundrejt 27,6 milion lekë të planit të ndryshuar, është realizuar në masën 98,5%. Duke e krahasuar me vitin e kaluar nuk ka ndryshim.

4.Sigurime suplementare për pilotët, realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 70 milion lekë, kundrejt 65,6 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 107,1%, ose realizuar më shumë për 20 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 20 milion lekë, ose për 41% më shumë dhe i përket 236 përfitues.

5.Sigurime suplementare për detarët, realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 12 milion lekë, kundrejt 11 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 109.8%, ose realizuar më shumë për 1 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më pak për 5 milion lekë, ose për 28% më shumë dhe i përket 62 përfituesve.

6.Sigurime suplementare për punonjës të ndërmarrjeve të ushtarakëve, realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 85,6 milion lekë, kundrejt 87 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 98,3.5%, ose realizuar më shumë për 1,4 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më pak për 4 milion lekë, ose për 5% më pak.

7.Sigurime suplementare për punonjës të tjerë shtetërorë, realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 450 milion lekë, kundrejt 579 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 77.8%, ose realizuar më pak për -128 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më pak për 17 milion lekë, ose për 4% më pak.

8.Sigurime suplementare për minatorët, realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 403 milion lekë, kundrejt 555 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 72.6%, ose realizuar më pak për 151 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më pak për 179 milion lekë, ose për 31 % më pak.

9.Sigurime suplementare për pagesa varrimi, shpenzimet faktike janë në shumën 188 milion lekë, kundrejt 215 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 87,4%, ose realizuar më pak për 27 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 7 milion lekë, ose për 3.9% më shumë.

10.Sigurime suplementare për statusin e profesorit, shpenzimet faktike janë në shumën 112 milion lekë, kundrejt 132 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 84.6%, ose realizuar më pak për 20 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 1 milion lekë, ose për 1% më shumë.

B. Programi "Shpenzimet administrative".

Këto shpenzime janë realizuar në shumën 2,144 milion lekë, kundrejt 2,360 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 90.9%, ose realizuar më pak për 216 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar ky program është realizuar më pak për 0,7%, ose në vlerë absolute për 15 milion lekë. Shpenzime administrative përdoren nga ISSH për kryerjen veprimtarisë së saj, për pagat e punonjësve, shpenzime operative, investime, etj. Këto shpenzime në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" planifikohen 2% të buxhetit total të ISSH. Pra edhe realizimi i tyre është brenda këtij kufiri. Miratimi i shpenzimeve administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

shumë se 2,360 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta. Realizimi i dy viteve më parë, parashikimi në projekt buxhetin e vitit 2016, ndryshimet gjatë vitit 2016 dhe realizimi i tij, është si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2014	Fakti 2015	Fakti 2016	2017			Difer.Fakt Plan	
					Plani fillest.	Plani #	Fakti	Në vlerë	Në %
1	Paga e shtesa 600	925	908	967	1,079	1,087	1,000	- 87	92
2	Kontribute të sigurimeve shoq.	143	145	149	156	165	160	-5	96
3	Blerje mallra e shërbime	763	867	906	964	1,016	970	-46	95
4	investime	31	96	137	91	92	14	-78	16
	TOTALI	1,862	2,016	2,159	2,290	2,360	2,144	-216	90,9

(burimi i të dhënave: sektori i buxhetit të përgjithshëm)

Në mënyrë analitike shpenzimet e këtij programi, janë realizuar si vijon:

1.Paga e shtesa (600), realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 1000 milion lekë, kundrejt 1,087 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 92%, ose realizuar më pak për 87 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 34,6 milion lekë, ose për 3.5% më shumë.

2.Kontribute Sigurime shoqërore (601), realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 160 milion lekë, kundrejt 165 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 96%, ose realizuar më shumë për 7 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 11 milion lekë, ose për 6,2 % më shumë.

3.Blerje mallra e shërbime (602), realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 970 milion lekë, kundrejt 1,016 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 95.5%. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 64 milion lekë, ose 7 % më shumë. Nga auditimi rezulton se zëri i shpenzimeve (602) për Administratën e institucionit për vitin 2017 është realizuar në shumën prej 141, 877 mijë lekë nga 143,171 mijë lekë e planifikuar.

Në 000/lekë

Nr.llog. analitike	Emërtesa	Plani	Fakti	Realizimi %
602	Mallra e Shërbime	1,016,202	969,692	95,42%
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	20,898	19,813	94,8%
6021	Materiale dhe shërbime speciale	120	-	0
6022	Shërbime nga te trete	816,607	745,100	91,22%
6022007	Komisione shërbimesh posta dhe banka	711,076	656,720	92,33%
6023	Shpenzime transporti	10,029	8,404	83,80%
6024	Shpenzime udhëtimi	23,850	19,704	82,61%
6025	Mirembajtje te zakonshme	111,519	108,261	97,11%
6026	Shpenzime qiramarrje	11 698	10,129	85,56%
6027	Detyrimeper kompensime ligjore (vendime gjyqesore)	7,587	29,699	391,44%
6029	Shpenzime te tjera operative	9,793	26,862	275,65%

(Burimi i të dhënave është sektori i buxhetit të përgjithshëm)

Referuar të dhënave rezulton se në përgjithësi shpenzimet janë realizuar në total në masën prej 95%. Me tejkalim të shpenzimeve paraqiten zëri 6027 (kryesisht shpenzime gjyqësore për të larguar nga puna) dhe zëri 6029(shpenzime gjyqësore për vendime gjyqësore për pensione të ushtarakëve dhe pensione të tjera) të kryera në 12 Degë Rajonale SSHoqërore, të cilat janë kryer gjatë vitit 2017 në bazë të kërkesave të bëra nga degët rajonale dhe të cilat janë miratuar në ISSH, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

4.Shpenzime për investime (231), realizimi i shpenzimet faktike është në shumën 14 milion lekë,



kundrejt 92 milion lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 15,6%, ose realizuar më pak për 78 milion lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më pak për 122,6 milion lekë, ose për 89.6% më pak. Kjo për faktin se nuk janë kryer 8 procedura tenderi në Administratën e ISSH-së në shumën prej 84,833,340 lekë nga 9 procedura të planifikuara si pasojë e VKM nr.473, datë 01.06.2017 " Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të Administratës Shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017 ". Gjithashtu vlen të përmendet fakti se prokurimet nuk janë realizuar kryesisht në Drejtorinë e Arkivit Qendror Tiranë (në shumën prej 77,257 mijë lekë), për ngritjen e murit rrethues dhe disiplinimin nga ujrat e lumit Farkë të godinës së institucionit në shumën prej 51,687 mijë lekë dhe blerje pajisje kompjuterike në 12 degët rajonale të sigurimeve shoqërore në shumën prej 25, 570 mijë lekë.

Titulli i çështjes:	Mbi auditimin e shpenzimeve në nivel të konsoliduar
Gjetja 6:	Per rritjen e efektivitetet te shpenzimeve që lidhen me qeratë.
Situata	Vlen të theksohet se gjatë vitit 2017 janë kryer pagesa për qera sipas kontratave vjetore për zyra dhe për nevoja magazinimi në shumën prej 10,001 mijë lekë për 8 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me një sipërfaqe totale 2,490 m2. Këto ambiente me qira të marra për nevoja pune janë nga viti 2009 (DRSSH Berat) dhe nga viti 2012 e në vazhdim për (DRSSH Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë, DSSH Sarandë).
Shkaku:	Mos kryerja e saktë e analizimit të eficiencës në planifikimin e shpenzimeve
Ndikimi	Risku i mospërdorimit të fondeve me efektivitet
Kriteri:	Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.
Rekomandimi:	Në institucion të merren masa që të shikohet mundësia e përdorimit të ambienteve të tjera pronë shtetërore të pushtetit vendor / ose në planifikimin e shpenzimeve të parashikohen fonde investimi për blerje ambiente zyresh për nevojat e institucionit.
Afati i zbatimit të rekomandimit	Në vazhdim

I/4. Mbi deficitin e sigurimeve shoqërore dhe mbulimi i deficitit nga fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2017.

Deficiti i skemës së pensioneve (fshat & qytet) për vitin 2017 është më shumë se një vit më parë për **317 milion** lekë, apo 1.17% më shumë. Kjo si rezultat i tejkalimit të shpenzimeve me 7.09%, apo 6,752 milion lekë, ndërsa të ardhurat janë rritur më pak, me 9.45%, ose 6,110 milion lekë. Në total për vitet 2015, 2016 dhe 2017, deficitin e sigurimeve shoqërore për skemën e pensioneve, rezulton si në tabelën e mëposhtme:

					<i>Në milion lekë</i>	
Nr.	Deficiti i Sigurimeve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Ndryshimi 2017-2016	
	Shoqërore për Skemën e Pensioneve			Në %	Në vlerë	
1	Shpenzimet gjithsej:	90,606.20	95,259.50	102,011.58	107.09%	6,752
-	Shpenzimet gjithsej të qytetit	75,679.30	80,438.10	87,086.77	108.27%	6,649
-	Shpenzimet gjithsej të fshatit	14,926.90	14,821.40	14,924.81	100.70%	103
2	Të ardhurat gjithsej:	62,974.00	68,118.00	74,553.39	109.45%	6,435



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-	Të ardhurat gjithsej të qytetit	58,763.40	64,889.80	70,999.69	109.42%	6,110
-	Të ardhurat gjithsej të fshatit	4,210.60	3,228.20	3,553.70	110.08%	326
3	Deficiti i financiar gjithsej:	(27,632.20)	(27,141.50)	(27,458.19)	101.17%	-317
-	Deficiti i financiar të qytetit	(16,915.90)	(15,548.30)	-16,087.08	103.47%	-539
-	Deficiti i financiar të fshatit	(10,716.30)	(11,593.20)	-11,371.11	98.08%	222
4	Prodhim i përgjithshëm bruto:	1,444,700.00	1,530,500.00	1,555,200		
	Deficiti /PPB	1.91	1.77	1.03		

Paralelisht me analizën e deficitit nominal dhe ecurisë së tij, gjykojmë se deficiti i skemës, gjithashtu duhet trajtuar dhe interpretuar edhe në raport me PBB, sepse pikërisht zhvillimet lidhur me PBB i mundësojnë Qeverisë percaktimin e politikave të veçanta në fushën e pensioneve, kur kemi të bëjmë me një skemë publike. Nga auditimi u konstatua se, Deficiti Nominal për vitin 2017, është rritur me 317 milion lekë (ose 1.17% më shumë) në krahasim me vitin e mëparshëm, ndërsa në raport me PBB-në ky tregues është përmirësuar nga 1.77 pikë në vitin 2016, në 1.03 pikë në vitin 2017. Rezultat i rritjes së deficitit, krahasuar me një vit më parë, është rritja e shpenzimeve më shumë se të ardhurat.

Ecuria e deficitit nga një vit në tjetrin, ndër të tjera lidhet me ecurinë e politikave të reja që ndërmerren, dhe që kanë impakt në rritjen e shpenzimeve/përfitimeve të pensionisteve, ku ndër më kryesoret janë politikat e rritjes së pensioneve.

Konkretisht, ndërsa të ardhurat janë rritur me 6,435 milion lekë, shpenzimet kanë njohur rritje më të madhe prej 6,752 milion lekë. Kështu u konstatua se, në vitin 2017, rritja e pensioneve sipas indeksit të cmimeve është implementuar që në **muajin mars 2017**, ndërkohë që një vit më parë implementimi **nisi 4 muaj më vonë (korrik 2016)**, duke dhënë një

impakt prej 1,120 milion lekë shpenzime më shumë se në vitin 2016. Në rritjen e shpenzimeve për pensione përveç shtesës së periudhës 4 mujore, ndikoi edhe vetë **niveli i rritur i indeksimit të cmimeve**, duke sjellë një impakt prej rreth 780 miliona lekë rritje të shpenzimeve. Në vitin 2016 indeksi rezultoi 1.6 %, ndërsa në vitin 2017, ky indeks ishte 3%, duke sjellë një impakt prej rreth 780 miliona lekë shpenzime më shumë. Pra në total, efektet shtese nga indeksimi i pensioneve, rezultojnë rreth 1,900 miliona lekë më shumë.

E arsyeshme nga pikpamja metodologjike është që, në momentin e rritjes së pensioneve, duhet të behet edhe indeksimi i pages minimale. Rritja e të ardhurave kontributive nga rritja e pages minimale perlllogaritet te jetë mesatarisht rreth 5 %. Por ndërsa pensionet u rriten me efekte nga 01.03.2017, pagat u rriten me efekt nga muaji maj kontributet e të cilit derdhen në muajin qershor. Pra kemi një diferencë prej 3 muaj me një efekt në të ardhura, të vlerësuar në rënie nga ISSH, me rreth 300 miliona leke në muaj, ose në total 900 milionë leke. **Keta janë dy faktorë që nese do të zhvilloheshin në dyja vitet në kushte të njëjta, do të kishin impakt pozitiv në uljen e deficitit nominal.** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 2013-2017, për cdo vit, Këshilli I Ministrave ka miratuar datën e indeksimit të pensioneve, në mbështetje të kërkesave të nenit 61 të ligjit për sigurimet shoqërore, të cilat kanë hyrë në fuqi më datë 01.08 për cdo vit, duke filluar nga vitin 2013; përjashtim bën viti 2017 ku me VKM nr. 130, datë 22.02.2017 “Për indeksimin e pensioneve”, ky indeksim për vitin 2017 është bërë në **muajin Mars 2017**²². Nga auditimi i deficitit i skemës së pensioneve (fshat&qytet) për vitin 2017 rezultoi se:

22

Viti	VKM	Hyn ne fuqi
2013	583, date 17.07.2013	01.08.2013
2014	456, datë 09.07.2014	01.08.2014
2015	651, datë 22.07.2015	01.08.2015



*Eshtë e rëndësishme **qëndrueshmëria** në implementimin e politikave, sa i takon indeksimit të pensioneve, në mënyrë që të shmangët rritja e shpenzimeve si pasojë e diferencave në kohë nga viti në vit të implementimit në vecanti të politikave të pensioneve. Gjithashtu nevojitet që paralelisht me rritjen e pensioneve të bëhet edhe indeksimi i pagës minimale.*

1. Deficiti i degës së pensioneve të qytetit, ka një rritje në vlerë absolute nga një vit më parë për 539 milionë lekë, ose më shumë 3.47%; ndërsa deficit i fshatit është ulur me 222 milion lekë (ose 1.02% më pak). Në total vlera e deficitit është rritur me 317 milion lekë, ndërsa ka pësuar rënie ndaj PBB, në krahasim me vitin 2016, konkretisht nga 1.77 pikë, në 1.03 pikë. Deficiti i financiar i degës së pensioneve të fshatit, ka rezultuar 11,371.11 milion lekë, nga 11,593.2 milion lekë një vit më parë, pra 222 milion lekë më pak, ose 1.92% më pak se një vit më parë. Edhe pse në vlerë nominale, skema e pensioneve në fshat dhe rezultati financiar i kësaj dege, duket disi i përmirësuar²³, vëmë re që skema e fshatit vijon të subvencionohet nga shteti në masën 41% (tregues ky i cili nuk është përmirësuar në krahasim me vitin 2016) ose në masën rreth 1,443 milion lekë, vlerë kjo e cila duke iu shtuar deficitit direkt, e con vlerën e financimit nga buxheti I shtetit në masën 12,814 milion lekë.

Edhe pse deficitin pr skemën e fshatit pwr vitin 2017 rezulton 1.02% mw pak se viti 2016, ky deficit ka vijuar të subvencionohet nga shteti në masën 41% (tregues ky i cili nuk është përmirësuar në krahasim me vitin 2016).

Ndërsa skema e qytetit kontribuon në totalin e të ardhurave të skemës së pensioneve në masën 95%, ndërsa në shpenzime vetëm 85% (pra me një diferencë prej 10% të ardhura mbi shpenzimet), ky raport paraqitet në kah të kundërt për skemën e fshatit, ku kjo e fundit rezulton të kontribuojë në të ardhurat e mbledhura vetëm 5%, ndërkohë që përthith shpenzime rreth 15% të total shpenzimeve të skemës së pensioneve. Skema e fshatit, edhe pse me një kontribut relativisht të ulët në të ardhura (prej 5%), vërehet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme të total deficitit prej 41%.

Gjithashtu, bazuar në VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar me VKM nr. 551, datë 27.07.2016, të vetpunësuarit në bujqësi paguajnë kontribute sipas një tarife kontributeve vjetore, e cila për zonat fushore është 38,400 lekë në vit dhe për zonat kodrinore malore është 29,400 lekë në vit. Periudha e sigurimit të vetpunësuarve në bujqësi për efekt pensioni njihet e njëjtë si për të vetpunësuarit në qytet, pavarësisht se, tarifa e kontributit vjetor është mesatarisht rreth 57%²⁴ më e ulët se e qytetit dhe diferenca për kontributet e tyre mbulohet nga buxheti i shtetit. Me qëllim sigurimin e parimit kontributiv të skemës, rritjen e përgjegjësisë individuale për pensionin, si edhe drejtësi të sistemit në trajtimin e barabartë kontributive të

2016	549, datë 27.07.2016	01.08.2016
2017	130, datë 22.02.2017	01.03.2017

²³Përmirësimi ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve nga 53,168 që ishin në vitin 2016, në 58,528 në vitin 2017, duke dhënë një impakt të vlerësuar prej 203,6 milion lekë në kontributet e vitit korent.

²⁴Kontributi vjetor qytet është 5,520 leke/muaj (përfshirë barrë lindje dhe pensione). Kontributi për fshatin është 38,400 lekë (përfshirë barrë lindje dhe pensione).



kontribuesve/qytetarvë rekomandojmë rishikimin e skemës së pensioneve të fshatit dhe reflektimin e sa më sipër në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë si më poshtë:

- Neni 9, paragrafi 5 të ndryshohet si vijon: "Të vetëpunësuarit në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrë lindje dhe pensione të llogaritura mbi një pagë mujore që përcaktohet me VKM. Kontributi minimal mujor nuk mund të llogaritet e caktohet nën një pagë më të vogël se ajo e përcaktuar nga Këshilli I Ministrave dhe në një pagë më të lartë se paga maksimale e kontributeve".


- Neni 10, paragrafi I tretë të ndryshohet si vijon: "Kontributi minimal për personin e vetëpunësuar në bujqësi llogaritet mbi bazën e pagës së përcaktuar nga Këshilli I Ministrave, që mund të jetë deri në 45%²⁵ më e vogël se paga minimale në shkallë vendi"

I/4. Mbi deficitin të sigurimeve shoqërore dhe mbulimi i deficitit nga fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2017.

Në milion lekë

	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Shpenzimet gjithsej:	90,606.20	95,259.50	102,011.58
Të ardhurat gjithsej:	62,974.00	68,118.00	74,553.39
Deficiti i financiar gjithsej:	(27,632.20)	(27,141.50)	(27,458.19)
Deficit fshat	(10,716.30)	(11,593.20)	(11,371.11)
Deficiti qytet	(16,915.90)	(15,548.30)	(16,087.08)

Deficiti për vitin 2017 rezulton me rritje prej 316 milion lekë krahasuar me vitin 2016, ndërkohë që deficit për vitin 2016 shënoi rënie në krahasim me vitin e mëparshëm, 2015 për vlerën 490 milion lekë. Nga grafiku më poshtë vihet re senë këto 3 vite, deficit ka shënuar vlerën e tij më të vogël në vitin 2016, dhe gjatë vitit 2017, vlera e tij është rritur përsëri (174 milion lekë më shumë se në vitin 2015):




Nëse e analizojmë të ndarë sipas dy skemave kryesore, atë të fshatit dhe qytetit, vëmë re se deficitin I fshatit shënon vlerën e tij më të ulët në vitin 2015, ndërsa ai i qytetit në vitin 2016. Luhatjet e vlerave të deficitit (kryesisht deficitin i fshatit paraqitet i paqëndrueshëm) për periudhën 3 vjecare, flasin ende për paqëndrueshmëri të skemës së pensioneve:

²⁵ Paga minimale 14,000 lekë * 23% (kontributi barrë lindje & pension) = 3,220 * 12 muaj = 38,640 lekë në vit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”



a. Auditimi i deficitit të sigurimeve shoqërore. Respektimi dhe ruajtja e deficitit të miratuar të sigurimeve shoqërore në tërësi dhe financimi i tij nga fondet e buxhetit të shtetit.

Të hyrat për buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në përgjithësi dhe të Fondit të Sigurimeve Shoqërore, në veçanti, formohen nga kontributet e personave ekonomikisht aktive dhe punëdhënësit e tyre, si dhe nga kontributet dhe financimet buxhetore me destinacion.

Nga auditimi u konstatua se, transferata nga Buxheti i Përgjithshëm, për buxhetin e ISSH nga 49,331 milion të programuara është tërhequr (realizuar) në shumën 48,705 milion lekë, me një mosrealizim (kursim ndaj planit) prej 626,000 mijë lekë. Nga total vlera e tërhequr prej 48,705 milion lekë, deficitin faktik I skemës së detyrueshme është 27,458 milion lekë (pra me një kursim real të fondeve buxhetore prej 816 milion lekë.

Për vitin 2017, bazuar në dispozitat e aktit normativ nr. 3 datë 06.11.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar” ishte parashikuar që Buxheti i Shtetit, të mbështesë buxhetin e sigurimeve shoqërore me 49,331,000 mijë lekë, të cilat së bashku me 71,868,000 mijë lekë, do të mbulojnë programin e përgjithshëm të shpenzimeve të sistemit të sigurimeve shoqërore prej 121,200,000 mijë lekë. Të ardhurat (kontributet dhe të ardhurat e tjera), shpenzimet, deficitin dhe mbulimi i tij për vitet 2015 dhe 2016, dhe 2017 rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
I	Kontribute e të ardhura të drejtpërdrejta	60,148	66,383	73,556
1	Kontribute të personave juridikë e fizikë	59,058	65,173	72,237
2	Kontribute suplementare	1,090	1,210	1,320
II	Shuma e financimeve nga buxheti për kontributet	21,407	22,829	20,430
1	Financime nga buxheti për kontributet	5,795	5,022	4,680
2	Financime nga buxheti për skemën e tjera & suplementare	15,612	17,807	15,750
	TOTALI TË HYRAVE (I+II)	81,555	89,212	93,986
I	Shpenzime të skemës së detyrueshme	90,606	95,259	102,012
II	Shpenzime për programe të tjera	11,711	13,948	12,046
III	Shpenzime për skemën suplementare	4,991	5,069	5,024
	TOTALI I SHPENZIMEVE (I+II+III)	107,309	114,276	119,081
	DEFICITI (TË ARDHURA – SHPENZIMET)	-25,754	-25,064	(25,095)
	DEFICITI DEGËS SË PENSIONEVE	-27,632	-27,142	(27,458)
	Diferenca deficitit (vlera e fondit të papunësisë)	1,878	2,077	2,363



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

TOTALI I FINANCIMIT NGA BUXHETI (faktiku)	48,481	48,978	48,705
TOTALI I FINANCIMIT QË DUHET	47,161	47,893	45,525
Rezultati financiar	1,320	1,085	3,180

Pra **totali i të hyrave** gjithsej për vitin 2017, është 99,986 milion lekë, nga 89,212 milion lekë realizuar një vit më parë, ose janë realizuar më shumë për 4,774 milion lekë, apo 5% më shumë se në vitin 2016, e ndarë në :

-Të ardhurat nga kontributet të drejtpërdrejta në vlerë 73,556 milion lekë, nga 66,383 milion lekë realizuar një vit më parë, ose janë realizuar më shumë për 7,173 milion lekë, apo 11% më shumë se në vitin 2016;

-Të ardhura të financuara nga buxheti i shtetit për kontributet në vlerë 20,430 milion lekë, nga 22,829 milion lekë financuar një vit më parë, ose financuar më pak për 2,399 milion lekë, apo 11% më pak se në vitin 2016.


Shpenzimet gjithsej për vitin 2017, janë realizuar në vlerë 119,081 milion lekë, nga 114,276 milion lekë realizuar një vit më parë, ose janë realizuar më shumë për 4,805 milion lekë, apo 4% më shumë se në vitin 2016, të ndara në :

-Shpenzimet e skemës së detyrueshme të pensioneve gjithsej për vitin 2017, janë realizuar në vlerë 102,012 milion lekë, nga 95,259 milion lekë realizuar një vit më parë, ose janë realizuar më shumë për 6,753 milion lekë, apo 7% më shumë se në vitin 2016;

-Shpenzimet për programe të tjera gjithsej për vitin 2017, janë realizuar në vlerë 12,046 milion lekë, nga 13,948 milion lekë realizuar një vit më parë, ose janë realizuar më pak për 1,902 milion lekë, apo 14% më pak se në vitin 2016.

-Shpenzimet për skemën suplementare janë realizuar në vlerë 5,024 milion lekë, nga 5,069 milion lekë realizuar një vit më parë, ose janë realizuar më pak për 45 milion lekë, apo 1% më pak se në vitin 2016.

Total financimi nga buxheti i shtetit për sigurimet shoqërore për vitin 2017 ka rezultuar për 48,705 milion lekë, nga 48,978 milion lekë një vit më parë, ose është ulur për 273 milion lekë, apo 1% më pak, i përbërë:



-Deficiti i degës së pensioneve në shumën 28,275 milion lekë nga të cilat realizuar (deficiti real) 27,458 milion lekë (pra me kursim 817 milion lekë). Në krahsim me vitin e mëparshëm, deficiti real rezultoi 316 milion lekë më pak.

-Subvencione nga buxheti për skemat e tjera të sigurimeve shoqërore ka rezultuar 20,430 milion lekë, nga 22,829 milion lekë një vit më parë, ose më pak 2,399 milion lekë, apo 11% më shumë se një vit më parë.

b.Auditimi i deficitit të skemës së detyrueshme²⁶ të sigurimeve shoqërore dhe financimi i tij nga fondet e buxhetit të shtetit.

²⁶ Dega e pensioneve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Nga auditimi konstatuam se, mbështetur në ligjin për sigurimet shoqërore, shpenzimet për programe të tjera, shpenzimet për sigurimet suplementare, së bashku me pjesën e shpenzimeve administrative që i përket programit respektiv, do të mbyllen me kontributet e drejtpërdrejta, të derdhura për programin/skemën përkatëse si dhe me financimet me destinacion nga Buxheti i Shtetit. Rezultati i këtyre programeve rezulton i mbyllur, pra të hyrat janë të barabarta me shpenzimet dhe në total, tepricat e secilës skemë, transferohen në programin e sigurimit shoqëror të detyrueshëm dhe në veçanti për degën e pensioneve, që kjo e fundit trajtohet sipas dy nënskemave: (1) Skema e pensioneve për qytetin, dhe (2) Skema e pensioneve për fshatin.

Kjo ndarje është bërë për shkak të periudhës kontributeve për fshatin, e cila lidhet me ish kooperativat bujqësore, si dhe me formulën e llogaritjes së përfitimit të pensioneve. Në përfundim, deficitin I skemës së pensioneve për vitin 2017 ka rezultuar 27,459 milion lekë, respektivisht i ndarë në 11,371 milion lekë për skemën e fshatit dhe 16,088 milion lekë për skemën e qytetit:

Në milion lekë

Viti 2017	Skeme e Fshatit	Skema Qytetit
Kontribute	3,554	70,999
Shpenzime	14,925	87,087
Deficiti	(11,371)	(16,088)

Në vijim, po trajtojmë në mënyrë analitike realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për të dyja skemat, sipas degëve të parashikuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar. **Realizimi i të ardhurave** të skemës së pensioneve për 3 vite ushtrimore të njëpasnjëshme, detajohet sipas tabelës së mëposhtme:

Skema e detyrueshme (pa suplementin)

Në milion lekë

Emërtimi i të ardhurave	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Ndryshimi 2016-2015 (%)	Në vlerë
Sëmundje	640	692	788	114%	96
barrë lindje	3,329	3,712	4,115	111%	403
fshat	119	117	128	110%	11
qytet	3,210	3,595	3,987	111%	392
pensione	52,491	57,999	64,183	111%	6,184
fshat	1,830	1,801	1,982	1.1	181
qytet	50,660	56,197	62,200	1.11	6,003
Aksidente	640	692	788	114%	96
Papunësi	1,878	2,077	2,363	114%	286
Shuma kontributeve	58,978	65,173	72,236	111%	7,063
barrë lindje	20	20	28	139%	8
pensione	3,513	3,692	3,209	87%	-483
Kontribute nga Buxheti (qyteti)	3,533	3,712	3,237	87%	-475
barrë lindje	138	80	88	110%	8
pensione	2,124	1,230	1,355	110%	125
Kontribute nga Buxheti (fshati)	2,262	1,310	1,443	110%	133
TOTALI (I+II+III), të ndara:	64,872	70,195	76,916	110%	6,721
Kontribute nga persona juridikë e fizikë	58,978	65,173	72,236	111%	7,063
Kontribute nga buxheti i shtetit	5,794	5,022	4,680	93%	-342



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

Të ardhurat për skemën e detyrueshme për vitin 2017, janë realizuar në vlerë 76,916 milion lekë, nga 70,195 milion lekë realizuar një vit më parë, ose realizuar më shumë për 6,721 milion lekë (rritur me 10%)

Rreth 94% e të ardhurave të skemës së detyrueshme e zënë kontributeve të derdhura nga personat fizikë dhe juridikë në vlerë 72,236 milion lekë, nga 65,173 milion që rezultuan një vit më parë (ose rritur me 11% më

shumë). Rreth 6 % të ardhurave të skemës së detyrueshme e zënë kontributet nga buxheti i shtetit për barrë lindje e pensione, për skemën e qytetit dhe atë të fshatit. Kontributet nga buxheti I shtetit për financimin e skemës së detyrueshme, për vitin 2017 janë 4,680 milion lekë, nga 5,022 milion lekë që ishin në vitin 2016 (ose zvogëluar financimi me 342 milion lekë, pra 7% më pak se një vit më parë). Nëse e zhveshim skemën e detyrueshme nga Fondi I Papunësisë, atëherë mund të analizojmë vetëm **skemën e pensioneve** për vitin 2017, në drejtim të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të kësaj skeme, si më poshtë:

Skema e pensioneve (pa suplementin, pa fondin e papaunesise)

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi i të ardhurave	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Ndryshimi 2016-2015	
					Në %	Në vlerë
1	Sëmundje	640	692	788	114%	96
2	barrë lindje	3,329	3,712	4,115	111%	403
-	fshat	119	117	128	110%	11
-	qytet	3,210	3,595	3,987	111%	392
3	pensione	52,491	57,999	64,183	111%	6,184
-	fshat	1,830	1,801	1,982	110%	181
-	qytet	50,660	56,197	62,200	111%	6,003
4	Aksidente	640	692	788	114%	96
I	Shuma kontributeve te dpd	58,978	63,095	69,873	111%	6,778
1	barrë lindje	20	20	28	139%	8
2	pensione	3,513	3,692	3,209	87%	-483
II	Kontribute nga Buxheti (qyteti)	3,533	3,712	3,237	87%	-475
1	barrë lindje	138	80	88	110%	8
2	pensione	2,124	1,230	1,355	110%	125
III	Kontribute nga Buxheti (fshati)	2,262	1,310	1,443	110%	133
TOTALI (I+II+III), të ndara:		64,872	70,195	74,553	106%	4,358
1	Kontribute nga persona juridikë e fizikë	58,978	63,095	69,873	111%	6,778
2	Kontribute nga buxheti i shtetit	5,794	5,022	4,680	93%	-342

Të ardhurat për skemën e pensioneve, për vitin 2017, rezultojnë 74,553 milion lekë, nga 70,195 milion lekë në vitin 2016 (pra rritur me 4,358 milion lekë, ose 6% më shumë), rritje kjo e cila vjen si pasojë e rritjes së kontributeve të personave juridike e fizikë me 6,778 milion lekë (ose 11% më shumë se në vitin 2016), dhe rënies së financimit nga buxheti me 342 milion lekë (ose ulur financimi me 7%, krahasuar me vitin 2016). Paralelisht me analizën e të ardhurave, për skemën e pensioneve kemi analizuar edhe realizimin e shpenzimeve si vijon:

Konkludojmë se, shpenzimet gjithsej të skemës së pensioneve, për vitin 2017 rezultojnë rreth 102 milion lekë (nga 93,457 milion në vitin 2016), duke rezultuar këtë vit 8,553 milion lekë më shumë, ose rritur 9% më shumë se një vit më parë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

Skema e pensioneve (pa suplementin, pa fondin e papunesise)

Në milion lekë

Nr.	Emërtimi i shpenzimeve të skemës së pensioneve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Ndryshimi 2016/2015	
					Në %	Në vlerë
1	Sëmundje	331	337	378	112%	41
2	barrë lindje	2,490	2,577	3,074	119%	497
-	fshat	568	613	644	105%	32
-	qytet	1,922	1,964	2,429	124%	465
3	pensione	86,071	90,529	98,546	109%	8,017
-	fshat	14,078	13,928	14,280	103%	352
-	qytet	71,993	76,602	84,266	110%	7,664
4	Aksidente	12	13	14	107%	1
I	Shuma shpenz. sipas skemave	88,904	93,457	102,012	109%	8,555

Deficiti i Sigurimeve Shoqërore për Skemën e Pensioneve.

Deficiti i Sigurimeve Shoqërore për Skemën e Pensioneve përbëhet nga: (1) Deficiti i degës së pensioneve të fshatit, dhe (2) Deficiti i degës së pensioneve të qytetit. Deficiti i sigurimeve shoqërore për skemën e pensioneve në total, për 3 vite të njëpasnjëshme paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Nr.	Deficiti i Sigurimeve Shoqërore për Skemën e Pensioneve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Ndryshimi 2017-2016	
					Në %	Në vlerë
1	Shpenzimet gjithsej:	90,606.20	95,259.50	102,011.58	107%	6,752
-	Shpenzimet gjithsej të qytetit	75,679.3	80,438.1	87,086.77	108%	6,649
-	Shpenzimet gjithsej të fshatit	14,926.9	14,821.4	14,924.81	101%	103
2	Të ardhurat gjithsej:	62,974.00	68,118.00	74,553.39	109%	6,435
-	Të ardhurat gjithsej të qytetit	58,763.4	64,889.8	70,999.69	109%	6,110
-	Të ardhurat gjithsej të fshatit	4,210.6	3,228.2	3,553.70	110%	326
3	Deficiti gjithsej:	-27,632.2	-27,141.5	-27,458.19	101%	-317
-	Deficiti i skemës së qytetit	-16,915.9	-15,548.3	-16,087.08	103%	-539
-	Deficiti i skemës së fshatit	-10,716.3	-11,593.2	-11,371.11	98%	222
4	Prodhim i përgjithshëm bruto:	1,444,700	1,530,500	1,555,200		
	Deficiti /PPB	1.91	1.77	1.03		

Deficiti i skemës së pensioneve për vitin 2017 është në vlerën 27,458.19 milion lekë, nga 27,141.5 milion lekë që ishte një vit më parë, ose është rritur me 317 milion lekë apo rreth 1% më shumë. Deficiti analizohet sipas 2 skemave: skemës së fshatit dhe asaj të qytetit.

-Deficiti i degës së pensioneve të fshatit ka rezultuar 11,371.11 milion lekë, nga 11,593.2 milion lekë një vit më parë, ose është 222 milion lekë më pak, apo 2% më pak se një vit të parë;

-Deficiti i degës së pensioneve të qytetit ka rezultuar 16,087.08 milion lekë, nga 15,548.3 milion lekë një vit më parë, ose është 539 milion lekë më shumë, apo 3% më shumë se një vit të parë. Konstatohet se, skema e qytetit kontribuon në totalin e të ardhurave të skemës së pensioneve në masën 95%, ndërsa në shpenzime vetëm 85% (pra me një diferencë prej 10% të ardhura mbi shpenzimet). Ky raport paraqitet në kah të kundërt për skemën e fshatit ku kjo e fundit rezultojnë të kontribuojë në të ardhurat e mbledhura vetëm 5%, ndërkohë që përthith shpenzime rreth 15% të total shpenzimeve të skemës së pensioneve (pra një diferencë prej 10% shpenzime mbi të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ardhurat). Skema e fshatit, edhe pse me një kontribut relativisht të ulët në të ardhura (prej 5%), vërehet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme të total deficitit prej 41%.

Nr	Pesha specifike	Qytet	Fshat
1	Te Ardhura	95%	5%
2	Shpenzime	85%	15%
3	Deficiti	59%	41%

1. Deficiti i degës së pensioneve të fshatit.

Bazuar në VKM nr.77, datë 28.01.2015, I ndryshuar të vetpunësuarit në bujqësi paguajnë kontribute sipas një tarife kontributeve vjetore, e cila për zonat fushore është 38,400 lekë në vit dhe për zonat kodrinore malore është 29.400 leke në vit.

Periudha e sigurimit të vetpunësuarve në bujqësi për efekt pensioni njihet e njëjtë si për të vetpunësuarit në qytet pavarësisht se, tarifa e kontributit vjetor është mesatarisht rreth 57% më e ulët se e qytetit dhe diferenca për kontributet e tyre vijon të mbulohet nga buxheti i

Vlerësojmë se kjo tarifë nevojitet të rritet në mënyrë graduale, për tu barazuar me kontributin e qytetit të paktën brenda 3 viteve²⁷. Tabela në vijim paraqet ecurinë e deficitit të fshatit sipas kategorive të kontributeve dhe shpenzimeve:

Në mijë lekë

Nr I Llogarise	Skema e Fshatit	2016	2017	Ndryshimi
nuk ka llogari	Barrelindje fshat	196,499	216,312	19,813
nuk ka llogari	Pensione fshat	3,031,704	3,337,392	305,688
	Total kontribute per fshatin	3,228,203	3,553,704	325,501
	Shpenzime per fshatin	14,821,359	14,924,811	103,452
6060032	Barrelindje fshat	625,122	644,489	19,367
6060052	Pensione fshat	14,196,237	14,280,322	84,085
	Deficiti fshat	-11,593,155	-11,371,107	222,048
	Deficiti fshat/GDP	-0.79	-0.73	

Deficiti I skemës së barrëindjes ka vijuar pothuajse me të njëjtin trend (për vitin 2017, rezulton në vlerën 428,2 milion lekë, nga 428.6 milion lekë në vitin 2016); ndërsa ka përmirësim deficitit i pensioneve konkretisht pakësuar me 221 milion lekë, në krahasim me vitin 2017 (realizuar 10,942 milion lekë, nga 11,164 milion lekë që ishte në vitin 2016).

Të ardhura nga kontributet e skemës së fshatit janë në shumën 3,553.7 milion lekë në të cilën përfshihen kontributet e drejtpërdrejta nga fermerët (rreth 59%), dhe kontributi i pjesës së shtetit për këta fermerë (rreth 41%), si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Skema e Fshatit	2015	2016	2017
Total kontribute nga të cilat:	4,211,000	3,228,203	3,553,704
Sa subvencionuar	2,262,000	1,309,681	1,442,876
Sa subvencionuar (%)	54%	41%	41%
Skema e Qytetit			
Total kontribute nga të cilat:	58,683,000	64,889,874	69,424,366
Sa subvencionuar	3,533,000	3,712,000	3,236,754
Sa subvencionuar (%)	6%	6%	5%

Sic vihet re, skema e fshatit vijon të subvencionohet nga shteti në masën 41% (tregues ky i cili nuk është përmirësuar në krahasim me vitin 2016). Nëse do të përfshijmë në vlerën e deficitit të skemës së fshatit, edhe vlerën e subvencionit për barrëindje dhe pensione, vlera e

²⁷ Periudha 3 vjecare është rezultat i analizave të ISSH



deficitit të skemës së fshatit do të rritet edhe më, duke shkuar në 12,813 milion lekë, nga 11.371 milion lekë, që është deficit i skemës.

-Shpenzimet për pensionet e fshati janë në shumën 14,925 milion lekë (të ndarë për pensione 14, 280 milion lekë dhe për shpenzime barrë lindje për 644 milion lekë), nga 14,821.4 milion lekë që ishin një vit më parë. Pra këtë vit shpenzimet janë rritur me 103,5 milion lekë, ose 0.7% më shumë se në vitin 2016.

Deficiti i skemës së pensioneve të fshatit (shpenzimet-kontributet) i vitit 2017, është në shumën 11,371.1 milion lekë, nga 11,593.2 milion lekë një vit më parë, pra këtë vit deficitit është më i ulët se një vit më parë për 222 milion lekë, ose 2% më pak se në vitin 2016, i ndarë si më poshtë:

-Deficiti i skemës së pensioneve për barrë lindje i vitit 2017, është në shumën 428.2 milion lekë, nga 428.6 milion lekë një vit më parë, pra këtë vit deficitit është më i vogël se një vit më parë për 0.4 milion lekë;

-Deficiti i skemës së pensioneve të fshatit për pensione, viti 2017, është në shumën 10,942.9 milion lekë, nga 11,164.5 milion lekë një vit më parë, pra këtë vit deficitit është më i vogël se një vit më parë për 221 milion lekë, ose 2% më pak se në vitin 2016.

Deficiti i degës së pensioneve të qytetit

Sikundër është përmendur edhe më sipër, kontributet e subjekteve juridike dhe fizike ndahen sipas degëve të sigurimit, sepse edhe norma e përgjithshme e kontributit është e ndarë sipas degëve të sigurimit. Për pasojë, shpenzimet për çdo degë sigurimi, mbulohen nga të ardhurat kontributive që siguron çdo degë. Gjithashtu, kontributet e secilës degë dhe financimet me destinacion, të Buxhetit të Shtetit, të cilat janë të formës së “mbulimit të shpenzimeve” dhe “subveicioneve”, do të përballojnë shpenzimet e vete degës ose programit dhe bazuar në nenin nr. 4, të Ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, tepricat e të ardhurave të degëve dhe programeve, kalojnë për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve. Në vazhdim, hap pas hapi do të trajtohen rregullat e transferimit të kontributeve nga një degë në tjetrën, deficitit i degës së pensioneve si dhe rezultati financiar i degëve të sigurimit të barrë lindjes, sëmundjes dhe aksidenteve si dhe kalimi i tepricave për mbulimin e humbjes së degës së pensioneve. Të ardhurat e skemës së sigurimeve shoqërore të qytetit për vitet 2015, 2016 dhe 2017, rezultojnë si në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

	Emërtimi i kontributeve (të ardhurat) e qytetit	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Ndryshimi 2017/2016	Në vlerë
					Në %	Në vlerë
1	Të ardhura nga kontributet	60,641.60	66,966.90	73,361.68	110%	6,394.78
-	sëmundje	640	692.4	787.66	114%	95.26
-	Barrë lindje	3,230.10	3,616.00	4,014.38	111%	398.38
-	pensione	54,253.30	59,889.00	65,408.99	109%	5,519.99
-	aksidente	640	692.4	787.66	114%	95.26
-	papunësi	1,878.20	2,077.10	2,362.99	114%	285.89
2	Transferimet drej degës së pensioneve neni 8 i ligjit	891.7	1,001.40	1,153.68	115%	152.28
-	sëmundje	129.8	120.5	142.42	118%	21.92
-	Barrë lindje	758.6	878.4	1,007.96	115%	129.56
-	aksi në punë dhe sëm. profesionale	3.3	2.4	3.31	138%	0.91
3	Të ardhurat pas transfer të parë	60,641.60	66,966.90	73,362.68	110%	6,395.78
-	sëmundje	510.2	571.8	645.25	113%	73.45
-	Barrë lindje	2,471.50	2,737.70	3,006.42	110%	268.72
-	pensione	55,145.00	60,890.40	66,563.67	109%	5,673.27



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-	aksidente	636.7	689.9	784.35	114%	94.45
-	papunësi	1,878.20	2,077.10	2,362.99	114%	285.89
4	Teprica që transferohen në degën e pension, neni 68 i ligjit	1,310.50	1,640.50	1,614.97	98%	-25.53
-	sëmundje	173.2	227.9	267.26	117%	39.36
-	Barrë lindje	512.8	735.6	577.24	78%	-158.36
-	Aks. në punë dhe sëm. profesiona	624.5	677	770.47	114%	93.47
5	Të ardhurat pas transfer të dytë	60,641.60	66,966.90	73,362.68	110%	6,395.78
-	sëmundje	337	343.9	377.98	110%	34.08
-	Barrë lindje	1,958.70	2,002.00	2,429.18	121%	427.18
-	pensione	56,455.40	62,530.90	68,178.64	109%	5,647.74
-	aksidente	12.2	12.9	13.88	108%	0.98
-	papunësi	1,878.20	2,077.10	2,362.99	114%	285.89
6	Të ardhurat mbi të cilat llogaritet deficit (minus papunësia)	58,763.40	64,889.80	70,999.69	109%	6,110

Të ardhura nga kontributet për pensione të qytetit janë realizuar pas dy transferimeve sipas nenit 8 dhe 68 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shumën 70,999.6 milion lekë, nga 64,889.8 milion lekë një vit më parë, pra këtë vit kontributet janë më të mëdha se një vit më parë për 6,110 milion lekë, ose 9% më shumë se në vitin 2016. Skema e pensioneve për qytetin, në vitin 2017 rezultojnë më deficit në shumën 16,087 milion lekë, nga 15,548 milion lekë që ishte në vitin 2016 (pra rritur deficitin me rreth 538.9 milion lekë, ose 3.4% më shumë se në vitin 2016).

Në mijë lekë

Nr I Llogarise	Kontributet skema e qytetit	2016	2017	Ndryshimi
	Kontribute sipas degeve	64,889,874	70,999,690	6,109,816
nuk ka llogari	semundje	343,928	787,662	443,734
nuk ka llogari	barrelindje qytet	2,002,014	4,014,378	2,012,364
nuk ka llogari	pensione qytet	62,530,986	65,409,988	2,879,002
nuk ka llogari	aksidente	12,947	787,662	774,715
	Shpenzime sipas degeve	80,438,063	87,086,770	6,648,707
6060010	semundje	343,928	377,983	34,055
6060031	barrelindje qytet	2,002,014	2,429,181	427,167
6060051	pensione qytet	78,079,175	84,265,722	6,186,547
6060020	aksidente	12,947	13,884	937
	Deficiti	-15,548,189	-16,087,080	-538,891

Shpenzimet për pensionet e qytetit janë realizuar në shumën 87,086.7 milion lekë, nga 80,438.1 milion lekë një vit më parë, pra këtë vit shpenzimet janë më të mëdha se një vit më parë për 6,648,7 milion lekë, ose 8.2% më shumë se në vitin 2016.

Titulli i çështjes: Mbi deficitin e sigurimeve shoqërore

Konstatim 1 Mbi Deficitin për Skemën e Fshatit

Situata:

Deficiti i financiar i degës së pensioneve të fshatit, ka rezultuar 11,371.11 milion lekë, nga 11,593.2 milion lekë një vit më parë, pra 222 milion lekë më pak, ose 1.92% më pak se një vit më parë. Edhe pse në vlerë nominale, skema e pensioneve në fshat dhe rezultati financiar i kësaj dege, duket disi i përmirësuar²⁸, vëmë re që skema e fshatit vijon të subvencionohet nga shteti në masën 41% (tregues ky i cili nuk është përmirësuar në krahasim me vitin 2016) ose në masën rreth 1,443 milion lekë, vlerë kjo e cila duke iu shtuar deficitit direkt, e con vlerën e financimit nga buxheti I shtetit në masën 12,814 milion lekë.

²⁸Përmirësimi ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve nga 53,168 që ishin në vitin 2016, në 58,528 në vitin 2017, duke dhënë një impakt të vlerësuar prej 203,6 milion lekë në kontributet e vitit korrent.



Ndërsa skema e qytetit kontribuon në totalin e të ardhurave të skemës së pensioneve në masën 95%, ndërsa në shpenzime vetëm 85% (pra me një diferencë prej 10% të ardhura mbi shpenzimet), ky raport paraqitet në kah të kundërt për skemën e fshatit, ku kjo e fundit rezulton të kontribuojë në të ardhurat e mbledhura vetëm 5%, ndërkohë që përthith shpenzime rreth 15% të total shpenzimeve të skemës së pensioneve. Skema e fshatit, edhe pse me nje kontribut relativisht të ulët në të ardhura (prej 5%), vërehet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme të total deficitit prej 41%.

Gjithashtu, bazuar në VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar me VKM nr. 551, datë 27.07.2016, të vetpunësuarit në bujqësi paguajnë kontribute sipas një tarife kontributeve vjetore, e cila për zonat fushore është 38,400 lekë në vit dhe për zonat kodrinore malore është 29,400 lekë në vit.

Konstatim 2: Mbi analizën e faktorëve që kanë ndikuar në rritjen e deficitit

Situata:

Në vitin 2017, rritja e pensioneve sipas indeksit të cmimeve është implementuar që në muajin mars 2017. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 2013-2017, Këshilli I Ministrave ka miratuar datën e indeksimit të pensioneve, në mbështetje të kërkesave të nenit 61 të ligjit për sigurimet shoqërore, të cilat për cdo vit, duke filluar nga vitit 2013, kanë hyrë në fuqi më datë 01.08, ndërsa me VKM nr.130, datë 22.02.2017 “Për indeksimin e pensioneve”, indeksimi për vitin 2017 është bërë në muajin Mars 2017²⁹. Në vitin 2017, si pasojë e indeksimit 4 muaj më herët, impakti në rritjen e shpenzimeve ka qenë 1,120 milion lekë më shumë se në vitin 2016.

Në rritjen e shpenzimeve për pensione përveç shtesës së periudhës 4 mujore, ndikoi edhe vetë niveli i rritur i indeksimit të cmimeve. Në vitin 2016 indeksi rezultoi 1.6 %, ndërsa në vitin 2017, ky indeks ishte 3%, duke sjellë një impakt prej rreth 780 milione lekë shpenzime më shumë. Pra në total, efektet shtese nga indeksimi i pensioneve, rrezultojne rreth 1,900 milione lekë më shumë. Por ndërsa pensionet u rriten me efekte nga 01.03.2017, pagat u rriten me efekt nga muaji maj kontributet e të cilit derdhen në muajin qershor. Pra kemi edhe nje diference prej 3 muaj me nje efekt në të ardhura, të vlerësuar në rënie nga ISSH, me rreth 300 milionë lekë në muaj, ose në total 900 milionë lekë. Këta janë tre faktorë që nëse do të zhvilloheshin në të dy vitet në kushte të njëjta, do te kishin impakt pozitiv në uljen e deficitit nominal.

II. AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ISSH

II/1: Organizimi dhe funksionimi i ISSH në përputhje me rregulloret e miratuara.

29

Viti	VKM	Hyn ne fuqi	
2013	583, date 17.07.2013	01.08.2013	
2014	456, datë 09.07.2014	01.08.2014	
2015	651, datë 22.07.2015	01.08.2015	
2016	549, datë 27.07.2016	01.08.2016	
2017	130, datë 22.02.2017	01.03.2017	



Nga auditimi i ushtruar në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në përputhje me rregulloret e miratuara, rezulton se ISSH organizon veprimtarinë e saj në bazë të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, miratuar sipas vendimit nr. 161 datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Rregullores së Personelit, miratuar sipas vendimit nr. 3, datë 26.02.2008, si dhe disa rregulloreve të tjera mbi veprimtarinë e drejtorive që kanë karakter specifik.

Në kuadër të kryerjes së auditimit, u vendos në dispozicion **Statuti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore**, i përbërë nga 33 nene përkatëse, miratuar me vendimin nr. 161 datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, dhe ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1022, datë 09.07.2014, si dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 07.05.2014. Nga auditimi konstatohet se Statuti i ISSH, përcakton strukturën që do të ngrihet nga KA, për kontrollin e veprimtarisë së ISSH, nën emrat Komisioni Kontrolli dhe Kontrolli Revizioni, duke mos përcaktuar qartë nëse i referohemi të njëjtës strukturë, apo dy të ndryshmeve. Në statut, Kontrolli Revizioni parashikohet se duhet të kryejë një kontroll të veprimtarisë së ISSH, specifikisht, atë të të ardhurave dhe shpenzimeve të saj në përputhje me rregulloren financiare të ISSH. Nga auditimi, rezulton se Kontrolli Revizioni në ISSH, nuk kryhen një auditim të mirëfilltë të institucionit, por vetëm certifikon rezultatin financiar të përgatitur nga vetë personeli i ISSH. Për këtë arsye evidentohet nevoja për një përshkrim më të hollësishëm të emërimit, përbërjes dhe detyrave dhe përgjegjësisve specifike të funksionimit të veprimtarisë së Kontrollit Revizionit, si dhe dokumentimit të punës së kësaj strukture në përputhje me rregulloren financiare të ISSH. Gjithashtu, statuti përmban disa pasaktësi në renditjen dhe emërtimin e neneve, ku neni 10 dhe 11 rezulton të jetë i përsëritur me përmbajtje të ndryshme për të njëjtin numër, duke mos lejuar citimin e saktë të nenit.

Në lidhje me **Rregulloren e Brendshme të ISSH**, u vendos në dispozicion një dokument i përgatitur nga Richard Trigano, në Nëntor të vitit 2007, i cili shërbente si bazë për organizimin e brendshëm të drejtorive dhe personelit përkatës të ISSH. Nga pyetësorët që u zhvilluan me stafin e ISSH, rezultoi se ata i përmbaheshin kësaj rregulloreje për evidentimin e detyrave dhe përgjegjësisve të personelit. Ky dokument përcakton organizimin dhe rregullat kryesore për funksionimin dhe për marrëdhëniet e punës brenda ISSH, strukturës organizative të saj, drejtimin, detyrat për çdo njësi, statusin e personelit dhe kushtet e personelit. Kjo rregullore ka dy pjesë:

Pjesa I: Organizimi dhe funksionimi i ISSH në tre seksione (ISSH, ISSH në nivel qendror, ISSH në nivel rajonal dhe lokal);

Pjesa II: Rregullat e kontratës së punës, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të ISSH, të ndara në disa seksione;

Nga auditimi konstatohet se me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 të Këshillit Administrativ të ISSH, është miratuar vetëm pjesa e dytë e Rregullores së Brendshme të ISSH, dhe disa Aneksa të saj. Pjesa e parë e Rregullores së Brendshme të ISSH (Richard Trigano, 2007), e cila përcakton edhe organizimin dhe funksionimin e institucionit, **nuk rezulton të jetë miratuar nga KA**. Dokumenti që na u vu në dispozicion si Rregullore e Brendshme të ISSH, e përcakton fare qartë qëllimin e tij, i cili është “Propozimi i një projekti të rregullores për organizimin dhe funksionimin e ISSH”. Aktualisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, personeli ka përdorur pikërisht këtë rregullore për të bazuar punën e tij dhe përgjegjësisve sipas pozicionit



përkatës në drejtoritë e ISSH. Nga auditimi rezulton se kjo projekt rregullore, përmban një sërë pasaktësish në format, gramatikë, plotësi, rend logjik. Dhe gjithashtu, pozicionet e punës në strukturën organizative të rregullores, nuk janë plotësisht të njëjta me atë të miratuar me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 të KA si dhe strukturën aktuale të ISSH. Më hollësisht, rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Juridike është e organizuar në tre sektorë: Sektori i Legjislacionit, Sektori i Korrespondencës dhe Apelit Administrativ, dhe Sektori i Procedurave Civile dhe Penale, kur faktikisht ndarja aktuale është në Sektorin e Legjislacioneve dhe Rregulloreve dhe Sektori i Ndjekjes së Procedurave Gjyqësore të Ankimimit. Drejtoria e Auditimit është organizuar sipas Sektorit të Raporteve dhe Sektori i Koordinimit Metodologjik: Grupi i Audituesve, në një kohë ku sipas organigramës aktuale të institucionit, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm është e ndarë sipas Degës së Auditimit Financiar dhe Sektori i Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut. Mos përcaktimi i saktë i detyrave sipas sektorëve në rregullore paraqet risk. Në lidhje me Drejtorinë e Përfitimeve, përshkrimi i pozicioneve të punës është bërë në 2 sektorë: Sektori i Përfitimeve Afatgjata dhe ai i Përfitimeve Afatshkurtra, ndërsa në organikën aktuale të institucionit, janë shtuar nën Drejtorinë e Përfitimeve edhe Sektori i Ekzaminimeve Mjekësore, Sektori i Përfitimeve Suplementare, me përgjegjësit dhe specialistët përkatës, detyrat e të cilëve nuk paraqiten në rregullore. Në rregullore, Drejtoria e Arkivës është e ndarë në Sektorin e Kontrollit të Arkivës dhe Sektori i Teknologjisë së Informacionit, ndërsa në organigramën aktuale, nuk pasqyrohet një organizim i tillë. Gjithashtu edhe përshkrimi i detyrave sipas pozicioneve në drejtoritë përkatëse, nuk është bërë në mënyrë të saktë në rregulloren e pa miratuar të Trigano, për Organizimin dhe Funksionimin e ISSH. Kjo pjesë do të trajtohet në vijim më hollësisht në këtë material. Për sa më sipër, evidentohet nevoja për përgatitjen dhe miratimin e një rregulloreje të re të ISSH, e cila të parashikojë organizimin dhe funksionimin e ISSH dhe drejtorive përkatëse, sipas pozicioneve të punës së personelit.

Në lidhje me **rregulloret e tjera** sipas së cilave drejtoritë e ISSH bazohen për koordinimin e veprimtarisë së tyre, u vendosën në dispozicion rregulloret e miratuara të institucionit të sipërcituara në këtë dokument.

- 1) Rregullorja e Personelit, miratuar me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 të KA;
- 2) Rregullore nr. 1, datë 21.10.2008 "*Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve*";
- 3) Rregullore nr. 494 datë 05.10.1993 "*Për Lëshimin e Raporteve për Paaftësi të Përkohshme në Punë*";
- 4) Rregullore 30.05.2005 "*Për Organizimin, të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve*";
- 5) Rregullore nr. 37, datë 23.12.2004 "*Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Përfitimeve Afatshkurtra*";
- 6) Rregullore nr. 3 datë 15.08.1996 "*Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare*";
- 7) Rregullore nr. 25 datë 03.09.1999 "*Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve*";
- 8) Rregullore nr. 1/1 datë 04.03.2011 "*Për një Shtesë në Rregulloren nr. 3, datë 15.08.1996 "Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplementare", e ndryshuar*";
- 9) Rregullore nr. 25/1 datë 04.03.2011 "*Për një shtesë në rregulloren nr. 25, datë 03.09.1999 "Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve suplementare të ushtarakëve", e ndryshuar*;



10) Rregullore "Financiare nr. 5, datë 25.05.2009 e Institucionit të Sigurimeve Shoqërore";
11) Rregullore "Për Strukturën, Përbërjen, Numrin dhe Procedurën e Funkcionimit të Komisioneve të Ankimimit pranë Drejtorive Rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", të miratuar me Vendimin nr. 22, datë 30.11.2016 të KA; Me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 Këshilli Administrativ i ISSH, ka miratuar strukturën organizative të ISSH si dhe Rregulloren e Personelit të ISSH dhe gjithashtu është autorizuar Drejtori i Përgjithshëm i ISSH për nxjerrjen e rregullores së detyrave për çdo post pune në ISSH. Rregullorja e Personelit të ISSH, ka përcaktuar kriteret ligjore dhe procedurat e nevojshme për:

I. Rekrutimin dhe Komandimin e përkohshëm në detyrë

II. Kontrata e Punës, të Drejtat, Detyrat, Kodi Etik dhe Dosja Personale

III. Koha e Punës dhe Pushimit

IV. Kategoritë, klasat dhe pagat

V. Shkeljet, Masat Disiplinore dhe Procedimi Penal

VI. Transferimi, Pezullimi dhe Largimi nga puna

Nga auditimi u konstatua se në **Rregulloren e Personelit të ISSH** nuk janë të përfshira përshkrimet e pozicioneve të punës të personelit të ISSH sipas organigramës të miratuar në vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 të KA, edhe pse në vendimet për ndryshime në strukturën e ISSH, është ngarkuar Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtuesit e Drejtorive për kryerjen e ndryshimeve dhe përshtatjeve në përshkrimin e pozicioneve të punës, detyrë kjo që nuk rezulton të jetë kryer për më shumë se 5 vite radhazi. Nga auditimi konstatohet se evidentohet nevoja për rishikimin e kësaj rregulloreje, dhe përshtatjen e saj me aktivitetin aktual të ISSH, veçanërisht në lidhje me procedurat e rekrutimit dhe ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me personelin.

Drejtoritë kryesore të ISSH, të cilat kanë një aktivitet specifik, kanë miratuar rregulloret përkatëse sipas të cilave është bazuar edhe puna e tyre.

Më hollësisht, Drejtoria e Financës së ISSH disponon Rregulloren Financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Kjo rregullore është e organizuar në krerë si më poshtë:

I. Fondi i sigurimeve shoqërore

I. Fondi rezervë I sigurimeve shoqërore

III. Buxheti

IV. Procedurat Financiare dhe Pagesat

V. Llogaritë

VI. Kontrolli Financiar dhe Raportimi

VII. Shërbimi Financiar, Struktura, Detyrat Bazë dhe Raportet.

Në këtë rregullore, janë përcaktuar detyrat specifike të punonjësve të drejtorisë së financës në agjensitë e ISSH, drejtoritë rajonale dhe drejtoritë qendrore. Megjithatë, vërehet se në detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të Shërbimit Financiar, mungojnë përcaktimet për punonjësit që punojnë në Sektorin e Buxhetit të Përgjithshëm dhe Thesarit, Sektori i Pagesave dhe Kontrollit të Pagesave si dhe Sektori i Statistikës, sektorë këto që përfshihen në Drejtorinë e Financës. Në mënyrë të ngjashme me Rregulloren Financiare të ISSH rezultojnë të evidentohen problematika edhe në rregulloret e drejtorive me karakter specifik, si ajo e Kontributeve, Përfitimeve, IT, etj; ku u konstatua se jo në të gjitha prej tyre ishin trajtuar përshkrimet e pozicioneve të punës, detyrave dhe përgjegjësiive të personelit përkatës, dhe në rastet e ristrukturimit të drejtorive përkatëse, nuk ishin pasqyruar këto ndryshime në rregulloret përkatëse.



DREJTIMI II/1:	Auditimi i Organizimit dhe Funkcionimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore
Gjetja³⁰:	Mungesa e një Rregulloreje të miratuar mbi Organizimin dhe Funkcionimin e ISSH
Situata:	Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore u konstatua se ISSH ka funksionuar mbi bazën e rregullores së brendshme, e cila në fakt rezultoi të jetë projekt rregullore, e pa miratuar nga KA për më shumë se 10 vite radhazi, që paraqet mangësi në përmbajtjen e saj dhe nuk i përshtatet plotësisht strukturës aktuale të institucionit. Për më tepër që kjo projekt rregullore nuk ka reflektuar ndryshimet e ndodhura në strukturë dhe as detyrat e personelit përkatës.
Kriteri:	Nenit 20 i ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “ <i>Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin</i> ”.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mos identifikimit të saktë të detyrave dhe përgjegjësive të çdo drejtorie dhe sektorit përkatës në bazë të strukturës organizative, nuk mund të bëhet ndjekja dhe realizimi i këtyre detyrave dhe të garantohet ndarja e saktë e detyrave në varësi të pozicionit.

II/2 Vlerësimi i organizimit dhe funksionimit të Këshillit Administrativ.

2.1. Kuadri ligjor në bazë të së cilit janë organizuar dhe funksionojnë organet drejtuese të ISSH-së:

Nga auditimi i ushtruar për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të ISSH-së rezulton se ato janë organizuar dhe funksionojnë në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, VKM Nr.161, datë 11.04.1994 “*Për miratimin e Statutit të ISSH’ si dhe Rregullores Nr.1 datë 30.04.1996 “ Për funksionimin e Këshillit Administrativ të ISSH”*”.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, mbështetur në nenin 72, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar drejtohet nga Këshilli Administrativ i përbërë nga 12 anëtarë nga të cilët:

- 6 përfaqësues nga Këshilli i Ministrave;
- 3 përfaqësues të punëdhënësve;
- 3 përfaqësues të sindikatave të cilët përzgjidhen dhe vendosen me VKM.

2. Në mbështetje të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr. 161, datë 11.04.1994 “*Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore*” të ndryshuar.

3. Në mbështetje të nenit 71, pika 4 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar organet drejtuese të këtij institucioni përbëhen nga Këshilli Administrativ dhe Drejtori i Përgjithshëm, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë

³⁰ Ky konstatim do të dal në një të vetëm me gjetjen 12 në këtë Raport Auditimi. Por janë trajtuar të ndarë pasi I takojnë dy drejtimeve të ndryshme të auditimit. Si pasojë është dalë me një rekomandim të përbashkët .



të Neneve 72 - 75, të po këtij Ligji.KA-ja përbëhet nga 12 anëtarë, konkretisht nga nga të cilët 6 anëtarë përfaqësues të qeverisë, të ndarë si më poshtë:

- një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për çështjet e financave
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë,
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore;
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
- një nga ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë si dhe
- një përfaqësues nga Instituti i Statistikave.

Funksionet e këtyre përfaqësuesve caktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Konkretisht caktimi i funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të Këshillit Administrativ është bërë me VKM Nr.263, datë 07.05.2014, si më poshtë

- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministër;
- Ministria e Financave, zëvendësministër (që mbulon veprimtarinë e të ardhurave);
- Ministria e Ekonomisë, Drejtor i Drejtorisë së Administrimit Ekonomik, Tregtisë dhe të

Pronës Publike dhe Sipërmarrjes

- Ministria e Shëndetësisë, Drejtor i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

- Ministria e Drejtësisë, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit;
- Instituti i Statistikave, Drejtor i Përgjithshëm

Ndërsa 6 anëtarët e tjerë të ndarë si vijonë:3 anëtarë caktohen nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve, të cilat përzgjidhen me *Vendim të Këshillit të Ministrave* dhe 3 anëtarë caktohen nga sindikatat më të përfaqësuara, të cilat edhe këto përzgjidhen me *Vendim të Këshillit të Ministrave*.

4. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 72, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave me VKM Nr.263 datë 07.05.2014 vendosi Funksionet e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 72, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në përbërje të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janë si më poshtë vijon:

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ministër;

Ministria e Financave zëvendësministër (që mbulon veprimtarinë e të ardhurave);

Ministria e Zhvillimit dhe Sipërmarrjes drejtor i Drejtorisë së Administrimit Ekonomik, Tregtisë dhe të Pronës Publike;

Ministria e Shëndetësisë drejtor i përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;

Ministria e Drejtësisë drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Kodifikimit;

Instituti i Statistikave drejtor i përgjithshëm

2. Vendimi nr. 562, datë 12.8.2005, i Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e funksioneve të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore", i ndryshuar, shfuqizohet.

5. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe shkronjave "b" dhe "c" të pikës 1, të nenit 72 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

ndryshuar Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 702, datë 10.11.2005 “Për përzgjedhjen e organizatave të punëdhënësve”, të shfuqizuar me VKM nr.262, datë 07.05.2014 “Për përzgjedhjen e organizatave më të përfaqësuara në Këshillin Administrativ të ISSH-së”, me të cilin ka miratuar përbërjen e Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore nga organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat më të përfaqësuara si më poshtë vijon:

A. Për punëdhënësit:

- Biznes Albania një përfaqësues;
- Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije një përfaqësues;
- Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë një përfaqësues;

B. Për sindikatat:

- Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) një përfaqësues;
- Bashkimi i Sindikatave të Pavarura (BSPSH) një përfaqësues;
- Sindikata Autonome Ushqim, Tregtisë, Turizmit një përfaqësues;

Në zbatim të VKM së mësipërme nëpërbërjen e Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore nga organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat më të përfaqësuara janë propozuar persona si më poshtë

A. Nga pala punëdhënëse:

- Biznes Albania L.B
- Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije N.H
- Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë A.K

B. Për sindikatat:

- Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) K.N
- Bashkimi i Sindikatave të Pavarura (BSPSH) G.K
- Sindikata Autonome Ushqim, Tregtisë, Turizmit B.K

Për sa trajtuam më sipër rezultoi se është zbatuar drejtë pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr. 263, datë 07.05.2014 dhe VKM nr. 262, datë 07.05.2014. Përmbledhtazi përbërja e Këshillit Administrativ, deri në shtator të vitit 2017 paraqitet si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni nga vjen	Nr.data e emërimit	Pozicioni	Emërtesa e Bordit/Këshilli	Me pagese
1.		M P Ç S Ministria e Finances dhe Ekonomise	VKM nr.263, date 07.05.2014	Ministër Ministër	Kryetar i Këshillit Administrativ	Po
2.		Biznes Albania	Shkresa nr.3036/2, dt.04.06.2014 e MMSR	President i Biznes Albania	Nënkryetar i Këshillit Administrativ	Po
3.		Konfederata e Sindikatave	Shkresa nr.71, dt.11.06.2014 e Konf. se Sindikatave	President	Nënkryetar i Këshillit Administrativ	po
4.		Ministria e Financave Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor F S D K SH	Shkrese nr.9318/1 prot,dt. 18.11.2016	Zv. Ministër	Anëtar	Po
5.			Shkrese nr.8983/1 rot, dt. 25.11.2016 Shkresa nr.4864/1prot, date 27.09.2017	Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Po



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

6.		INSTAT	Shkresë nr.9401/1 prot, dt. 30.11.2016	Drejtor i Përgjithshëm	Anëtar	Po
7.		Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.	Shkresë nr.4129/1 prot, dt. 20.06.2014	Dr. i Drejtorisë së Administrimit të Pronës Publike	Anëtar	Po
8.		Ministria e Drejtësisë	Shkresa nr.1829/1 prot,dt.13.03.2015 Shkresa nr.9891/1 prot, dt.20.12.2017	Dr. e Përgjithshme e Drejtorisë së Kodifikimit	Anëtar	Po
9.		Shoqata e Biznesve të Ushqim Pije	Shkresa nr.3036/2,dt.04.06.2014 e MMSR	Anëtar i shoqatës	Anëtar	Po
10.		Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë	Shkresa nr.2801 prot,dt.11.06.2014 e SH N SH	N/Kryetar i Bordit Drejtues të SHNSH	Anëtar	Po
11.		Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë	Shkresa nr.626prot, dt.27.05.2014 e B S P SH	President i B S P SH	Anëtar	Po
12.		Sindikata Autonome Ushqim, Tregti, Turizëm	Shkresa nr.3295/1 prot,dt.05.06.2014 e S A U T T	President	Anëtar	Po

Koha e shërbimit të anëtarëve të KA-së si përfaqësues të organizatave dhe sindikatave më të përfaqësuara është jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë. Drejtori i Përgjithshëm, megjithëse e ka të përcaktuar si në Ligj ashtu edhe në Statut, konkretisht në nenin 74, pika 1a) të Ligjit dhe neni 24 i Statutit, duhet të zgjidhet nga Këshilli Administrativ. Konstatohet se Drejtori i Përgjithshëm ka ardhur i emëruar. Drejtori i Përgjithshëm nuk është anëtar i Këshillit Administrativ. Këshilli Administrativ ka nxjerrë Vendime të cilat ndihmojnë në realizimin e misionit kryesor të ISSH-së, duke rregulluar marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore. ISSH-ja ka për mision zbatimin e strategjive dhe politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore si dhe ngritjen dhe menaxhimin e sistemit të informacionit për fushën e vet të përgjegjësi. Gjatë vitit 2017 Kryetar i KA-së është ndryshuar 3 herë, deri në muajn prill Kryetar i KA-së ka qenë Ministri i Punëve dhe Çështjeve Sociale, zgjedhur në mbledhjen e datës 29.04.2015, në muajn prill të vitit 2017 Kryetar i KA-së është vendosur Znj. O.Xh, zgjedhur në mbledhjen e datës 10.04.2017 e cila ka vazhduar në këtë detyrë deri në muajn shtator ku si Kryetar i KA-së është zgjedhur Ministri i Financave, konkretisht në mbledhjen e datës 27.09.2017. Konstatohet se në të gjitha rastet e zgjedhjes së Kryetarit të Këshillit Administrativ veprimi është kryer **pa votim të fshehtë** duke mos respektuar nenin 73 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, i cili përcakton se: “Kryetari zgjidhet nga KA-ja me votim të fshehtë”. Funkcionet e Sekretarit të Këshillit Administrativ qysh prej vitit 20.12.1999 kryhen nga znj. Hortenca Deliallisi si detyrim që i vinte nga organigrami e asaj kohe. Aktualisht këtë funksion vazhdon ta mbajë po i njëjti person. Por në kundërshtim me Nenin 19, të VKM Nr.161 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së” ku specifikohet se *Kryetari i KA-së duhet të autorizoj një person të përhershëm për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes*, si dhe nenit 2 pika 1 të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” mungon autorizimi i kësaj detyre.

2.2. Veprimtaria e Këshillit Administrativ

Gjatë vitit 2017, Këshilli Administrativ, ka zhvilluar gjithsej 5 mbledhje, me rend dite të përcaktuar sipas njoftimeve përkatëse që u janë dërguar çdo anëtar. Në këto mbledhje janë



shqyrtuar çështje të përcaktuara në rendin e ditës dhe procesverbalet janë mbajtur nga personi përgjegjës për mbajtjen e tyre. KA-ja, në mbledhjet e tij për vitin 2017, bazuar në projektvendimet e paraqitura, të shoqëruara me relacionet përkatëse ka nxjerrë gjithsej 16 vendime.

Çështjet e trajtuara në mbledhjet e Këshillit Administrativ përcaktohen në rendin e ditës së mbledhjeve, sikundër është specifikuar në pikën 2.4 të “Rregullores për funksionimit të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore” duke specifikuar se përbëhet nga tre pjesë, ku pjesa e parë ka të bëjë me projekt ligjet dhe projekt aktet nënligjore, pjesa e dytë ka të bëjë me projektet me karakter urgjent, sipas vlerësimit të dy nënkryetarëve ose Drejtorit të Përgjithshëm dhe pjesa e tretë me raportime, informacione dhe probleme të tjera të ISSH.

2.3. Mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Administrativ për vitin 2017

Mbledhja e parë e KA, është mbajtur në datën 17.02.2017. Në dokumentacionin përbërës së dosjes së mbledhjes së parë mungon njoftimi për mbledhje i cili duhet të dërgohet nga Drejtori i Përgjithshëm 10 ditë përpara tek të gjithë anëtarët e Këshillit Administrativ bashkëngjitur edhe rendi i ditës. Në këtë mbledhje është diskutuar janë diskutuar projekt VKM Për disa ndryshime në vendimin nr.77 datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar; miratimi i projekt VKM “Mbi listën e grupmallrave e shërbimeve të zgjedhura për llogaritjen e indeksit të ndryshimit të çmimeve të shportës së pensionistëve, përcaktimin e llojit të indeksit dhe të përfitimeve të indeksueshme”; miratimi i projekt VKM “për indeksimin e pensioneve” dhe projekt VKA për disa ndryshime në rregulloren nr.3/2, datë 26.02.2008 “ për personelin e ISSH” dhe rritjen e pagave; për miratimin e projekt vendimit të KM, për një shtesë në Vendimin nr.78, datë 28.01.2015 të KM “ Për zbatimin e ligjit nr.150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, si dhe përmbledhje e vendimeve të mbledhjes. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e datës 17.02.2017 kanë marr pjesë 11 anëtarë të KA-së dhe sekretarja, ka munguar vetëm një anëtar, konkretisht G.K. Në këtë mbledhje janë miratuar:

- **Vendimi Nr.1** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt VKA për miratimin e projekt VKM për disa ndryshime në vendimin nr.77 datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar

- **Vendimi Nr.2** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt VKM “Mbi listën e grupmallrave e shërbimeve të zgjedhura për llogaritjen e indeksit të ndryshimit të çmimeve të shportës së pensionistëve, përcaktimin e llojit të indeksit dhe të përfitimeve të indeksueshme”

- **Vendimi Nr.3** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt VKA “Për miratimin e projekt VKM “Për indeksimin e pensioneve”.

- **Vendimi Nr.4** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt “Për miratimin e projekt VKM “Për një shtesë në vendimin nr.78 datë 28.01.2015 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.15/2014 “për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”

Këshilli Administrativ vendosi të shqyrtojë në një mbledhje tjetër projekt VKA “Për disa ndryshime në rregulloren nr.3/2, datë 26.02.2008 “ për personelin e ISSH” dhe rritjen e pagave” deri në daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat në sektorin publik.

- **Vendimi nr.5** është përmbledhje e vendimeve të mbledhjes

Mbledhja e dytë e KA, është mbajtur në datën 12.04.2017, me nr. 7931 prot. Në këtë mbledhje, kanë qenë të pranishëm 8 nga anëtarët e Këshillit Administrativ. Njoftimi është bërë rregullisht nga



Drejtori i Përgjithshëm, protokolluar më datë 10.04.2017 me nr.3182 prot, dhe bashkëngjitur gjendet rendi i ditës. Në këtë mbledhje është diskutuar Zgjedhja e Kryetarit të KA-së; projekt vendim i KA për miratimin e projekt VKM 'Për disa ndryshime në Vendimin nr.77, datë 28.01.2015 të Këshillit të Ministrave "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor të ndryshuar"; projekt vendim i KA "Për disa ndryshime në Rregulloren nr.3/2, datë 26.02.2008 " Për personelin e ISSH" dhe rritjen e pagave; projekt Vendim i KA " Për autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm për përdorimin e fondit të veçantë për shpërblimin e anëtarëve të KMCAP-ve Eprore dhe relatorëve të këtyre komisioneve"; projekt vendim i KA " Mbi Përbërjen e Komisionit Qendror të Ankimit" si dhe përmbledhje e vendimeve të mbledhjes. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e radhës kanë qenë të 12 anëtarët e KA-së dhe sekretarja. Konfirmuar nga Urdhër transferta e bankës (dt 20.04.2017) dhe prezenca e firmosur në procesverbal. Në këtë mbledhje janë miratuar:

- **Vendimi Nr.6** Këshilli Administrativ miratoi me me 11 vota pro dhe 1 kundër të z. Kolë Nikollaj, projekt VKA për miratimin e projekt VKM për disa ndryshime në vendimin nr.77 datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar

- **Vendimi Nr.7** Këshilli Administrativ miratoi me me 11 vota pro dhe 1 kundër të z. Kolë Nikollaj, projekt VKA "Për disa ndryshime në rregulloren nr.3/2, datë 26.02.2008 " për personelin e ISSH" dhe rritjen e pagave"

- **Vendimi Nr.8** Këshilli Administrativ miratoi me me 11 vota pro dhe 1 kundër të zj. Katrin Treska, të projekt VKA "Për autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm për përdorimin e fondit të veçantë për shpërblimin e anëtarëve të KMCAP-ve Eprore dhe relatorëve të këtyre komisioneve"

- **Vendimi Nr.9** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt projekt vendim i KA "Mbi Përbërjen e Komisionit Qendror të Ankimit"

Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro dhe pa votim të fshehtë znj.O.Xh si Kryetare të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

- **Vendimi nr.10** është përmbledhje e vendimeve të mbledhjes.

Mbledhja e tretë e KA, është mbajtur në datën 27.09.2017. Njoftimi është bërë rregullisht nga Drejtori i Përgjithshëm në datën 26.09.2017 me nr.prot 7931 dhe bashkëngjitur gjendet rendi i ditës. Në këtë mbledhje është diskutuar Zgjedhja e Kryetarit të KA-së, informacion mbi skemën e Sigurimit Suplementar Shtetëror si dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së shkuar si dhe përmbledhje e vendimeve të mbledhjes. Në mbledhjen e radhës kanë qenë 8 anëtarë të KA-së dhe sekretarja. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e radhës kanë qenë të 10 anëtarët e KA-së dhe sekretarja, mungonin A.K dhe D. I. Konfirmuar nga Urdhër transferta e bankës (dt 04.11.2017) dhe prezenca e firmosur në procesverbal. Në këtë mbledhje janë miratuar:

- **Vendimi Nr.11** Këshilli Administrativ miratoi me me 11 vota pro dhe pa votim të fshehtë z. Arben Ahmetaj si Kryetar të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Mbledhja e katërt e KA, është mbajtur në datën 20.10.2017. Njoftimi është bërë dhe bashkëngjitur gjendet rendi i ditës por mungojnë ekstremitetet e dokumentit zyrtar. Në këtë mbledhje është diskutuar për miratimin e projektligjit 'Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në republikën e shqipërisë", i ndryshuar; miratimi i projekt VKM " për caktimin e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të KA së ISSH"; Për një shtesë në Rregulloren nr.3 datë 15.08.1996 "Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplementare"; për disa shtesa e ndryshime në Rregulloren nr.3/2



datë 26.02.2008 “ Për personelin e ISSH”, i ndryshuar; si dhe përmbledhje e vendimeve të mbledhjes. Në mbledhjen e radhës kanë qenë 7 anëtarë të KA-së dhe sekretarja. Sipas procesverbalit të mbledhjes, në mbledhjen e radhës kanë qenë të 10 anëtarët e KA-së dhe sekretarja, mungonin A.K dhe G.K. Konfirmuar nga Urdhër transferata e bankës (dt 03.11.2017) dhe prezenca e firmosur në procesverbal. Në këtë mbledhje janë miratuar:

- **Vendimi Nr.12** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt Ligjin “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me ndryshimet e propozuara dhe të pasqyruara në proces verbalin e mbledhjes.

- **Vendimi Nr.13** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt VKM “Për caktimin e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të KA së ISSH”.

- **Vendimi Nr.14** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt VKA Për një shtesë në Rregulloren nr.3 datë 15.08.1996 “Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplementare”.

- **Vendimi Nr.15** Këshilli Administrativ miratoi me të gjitha votat pro projekt VKA Për një shtesë në Rregulloren nr.3/2 datë 26.02.2008 “ Për personelin e ISSH”, i ndryshuar.

- Vendimi nr.16 është përmbledhje e vendimeve të mbledhjes.

Mbledhja e pestë e KA, si dosje nuk na është vendosur ende në dispozicion për arsye se pritet firma e Kryetarit të Këshillit Administrativ. Nga informacioni mbi njoftimin e mbledhjes u konstatojmë se është mbajtur në datën 20.12.2017 dhe rendi i ditës i propozuar rezulton si më poshtë: miratimi i proces verbalit të mbledhjes së datës 20.10.2017, projekt VKA “Për miratimin e rezultatit financiar të sigurimeve shoqërore për vitin 2016”, projekt VKA “Për buxhetin e Drejtorive Rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2018” dhe të tjera. Në këtë mbledhje është diskutuar për miratimin e projektligjit ‘Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në republikën e shqipërisë”, i ndryshuar, miratimi i projekt VKM “ për caktimin e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të KA së ISSH”, Për një shtesë në Rregulloren nr.3 datë 15.08.1996 “Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplementare”, për disa shtesa e ndryshime në Rregulloren nr.3/2 datë 26.02.2008 “ Për personelin e ISSH”, i ndryshuar si dhe përmbledhje e vendimeve të mbledhjes. Në mbledhjen e radhës kanë qenë 7 anëtarë të KA-së dhe sekretarja.

Gjatë auditimit në lidhje me mbledhjet e kryera nga Këshilli Administrativ u konstatua se, së pari materiali i mbledhjes së kaluar përfshihet në pikën II të rendit të ditës së mbledhjes së radhës, dhe procesverbali i shkon çdo anëtar të Këshillit bashkangjitur me materialin. Ky procesverbal firmoset veç Kryetarit të KA dhe sekretares edhe nga anëtarët prezent në mbledhjen e shkuar. Verifikimin në lidhje me prezencën e anëtarëve në mbledhje e kryem në bazë të urdhër shpenzimeve të financës mbështetur mbi firmat e hedhura në procesverbal.

Në lidhje me numrin e anëtarëve të Këshillit Administrativ konstatohet se, në mbledhjet e realizuara pas datës 13 shtator, numri i anëtarëve ka qenë 11 nga 12 të përcaktuar në nenin 72 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga subjekti specifikohet se ky ndryshim ka ardhur si rrjedhojë e riformulimit të Qeverisë, më Vendim të Këshillit të Ministrave datë 13 Shtator 2017, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.90/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”.



Prej auditimit konstatohet se, për periudhën shtator-dhjetor të vitit 2017 është operuar jo në përputhje me nenin 72 të numrit të anëtarëve sepse ky person mund të zëvendësohej nga një tjetër për të mos patur çedim në numër. Por në mbledhjen e datës 20.10.2017 janë marr dy vendime për të rregulluar pikërisht numrin e anëtarëve të KA, konkretisht VKA nr.12 “ Për miratimin e projekt ligjit “ Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “ Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKA nr.13 “ Për miratimin e projekt VKM “Për caktimin e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore në përbërje të Këshillit Administrativ të ISSH”. Nëpërmjet këtyre vendimeve rezulton se tanimë pjesë e anëtarëve të Këshillit Administrativ do të jenë dy përfaqësues të Ministrisë së Financave, një në rolin e Kryetarit të KA konkretisht Ministri i Financave dhe tjetri zëvendësministri i financave ndërkohë që duke pastur në fokus të tyre edhe veprimtarinë e fermerëve mund të ishte pjesë e këtij Këshilli Administrativ edhe ministri i kësaj fushe.

2.4. Vendimet e Këshillit Administrativ

Nga analiza e çështjeve të shqyrtuara, vendimmarrja e KA-së është adresuar në disa tematika të ndryshme, të cilat më poshtë po i paraqesim të grupuara sipas fushave:

- Për buxhetin dhe financën, janë nxjerrë 0 vendime;
- Për Legjislacionin dhe aktet nënligjore, janë nxjerrë 8 vendime;
- Për personelin dhe pagat, janë nxjerrë 3 vendime;
- Për zgjedhjen e Kryetarit të KA, është nxjerrë 1 vendim;
- Për Krijimin dhe ndryshimin e komisionit Qendror të Ankimit të ndryshme, është nxjerrë 1 vendim;

Për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjeve, janë nxjerrë 3 vendime.

Të tjera gjatë auditimit:

Nga auditimi konstatohet se, Këshilli Administrativ ka ngritur Komisionin e Kontroll Revizionit me Vendim nr.16 datë 29.06.2016, e drejtë që i buron nga neni 12 pika 1 e statutit, i cili specifikon se ...*Këshilli Administrativ miraton Komisionin e Kontrollit për revizionimin e veprimtarisë së ISSH...Rregullorja financiare, në pikën a të çështjes ‘kontrolli financiar dhe raportimi’,parashikon që... të ardhurat dhe shpenzimet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore duhet të ndiqen rregullisht dhe për çdo vit të kontrollohen nga Komisioni i Kontrollit. Nga ana tjetër pika 4 e çështjes A. Vëzhgimi i rregullt, në rregulloren financiare specifikon se ... Komisioni i Kontroll Revizionit do të nxjerrë një raport për KA. Raporti do të jap informacion mbi aktivitetin e Komisionit si dhe përmirësimet e propozuara në operimin dhe administrimin e sistemit. Nga auditimi u konstatua se ky Komision është ngritur dhe ka angazhuar në vitin 2016 Drejtorinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e kontroll revizionit në aparat. Ndërkohë që vet neni 6 i ligjit të auditit të brendshëm nr. 114 datë 22.10.2015 pika ii dhe v specifikon se, Roli i auditit të brendshëm të njësisë publike është ti jap mbështetje titullarit të njësisë publike. Pra ky auditim nuk është e nevojshme të marr angazhimin e KKR për tu kryer nga AB. Nga auditimi u konstatua se ky komision kryen thjesht delegimin e kryerjes së kontrollit duke angazhuar DAB dhe më pas firmos mbi materialin e auditit të brendshëm. Nga ana tjetër Rregullorja Financiare specifikon që ky komision të raportoj për KA por njekohësisht anëtarët e tij janë edhe anëtar të KA, pra ky komision është pjesë përbërëse e Këshillit Administrativ dhe do të raportoj po në të.*

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se, anëtarët e këtij komisioni marrin pagë edhe si anëtar të KA edhe si anëtar të KKR, ku pagesa si anëtar i KKR është 34,986 lekë dhe si anëtar i KA është



17,000 lekë. Numri i anëtarëve të komisionit është përcaktuar me VKA nr.16 datë 29.06.2016 dhe është pesë ndërkohë që në Urdhërin e DP për pagesën e KKR specifikohet se referuar VKA 16 numri i anëtarëve është katër. Gjatë gjithë kohës ky komision ka operuar me katër anëtar dhe pa kryetarin. Nga të dhënat e marra nga drejtoria e financës konstatohet se, pagesa është kryer vetëm për mbledhjen e kryer në vitin 2016.

Gjatë auditimit konstatohet se, nuk është zbatuar pika 1b e nenit 74 të Ligjit 7703 datë 11.05.1993, i ndryshuar ku në zërin “Kompetenca” specifikon se ...“*Këshilli Administrativ miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore*. Në mbledhjet e vitit 2017 nuk gjendet e trajtuar kjo çështje dhe për më tepër në mbledhjen e datës 20.12.2017 është kaluar rezultati financiar i vitit 2016.

Në Rregulloren financiare, pika *Kontrolli financiar dhe raportimi*, çështja D. Raportimi, nënçështja 3 specifikon se ... *Raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet*. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2017 nuk është zbatuar në ISSH kjo çështje.

Gjatë auditimit në lidhje me mbledhjet e kryera nga Këshilli Administrativ u konstatua se, së pari materiali i mbledhjes së mëparshme përfshihet në pikën II, të rendit të ditës në mbledhjen e radhës. Procesverbali i mbledhjes firmoset edhe nga anëtarët prezent në mbledhjen e shkuar. Në vijim u konstatua se në mbledhjen e dytë edhe të tretë afati i njoftimit të mbledhjes së radhës nuk është zbatuar sipas nenit 17 të Statutit të Sigurimeve Shoqërore (njoftimi i mbledhjes së radhës duhet dërguar 10 ditë përpara). Për sa më sipër gjykojmë se është e nevojshme marrja e masave me qëllim shmangien e praktikës së firmosjes së proces verbalit të mbledhjes së shkuar në mbledhjen e radhës, si dhe të formalizohet dërgimi i njoftimit qoftë shkresërisht qoftë me e_mail.

Në bazë të Rregullores Financiare të ISSH mbi çështjen e Kontrollit Financiar dhe Raportimit, pika A4 specifikon se ...*Komisioni i Kontrollit të Brendshëm do të nxjerr një raport për Këshillin Administrativ. Raporti do të jap informacion mbi aktivitetin e Komisionit si dhe përmirësimet e propozuara në operimin dhe administrimin e sistemit*” edhe në lidhje me këtë çështje konstatohet se në mbledhjet e vitit 2017 nuk gjendet asnjë material i trajtuar nga ky komision.

Nga auditimi u konstatua mungesë e autorizimit të personit mbajtës të procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit Administrativ, kjo për arsye se është vazhduar me të njëjtën praktik që ka funksionuar dhe më parë dhe nuk është parë e arsyeshme për ta ndryshuar. Në mbështetje të Nenit 19, të VKM Nr.161 “Për miratimin e Statutit të ISSH-së” ku specifikohet se *Kryetari i KA-së duhet të autorizoj një person të përhershëm për mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes*, si dhe nenit 2 pika 1 të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Nga auditimi u konstatua se, në faqen e internetit të institucionit nuk është një artikull i veçantë informimi i publikut mbi vendimet e mara nga KA-ja.

Titulli i çështjes: Vlerësimi i organizimit dhe funksionimit të KA-së

Gjetja 7:

Mbi organizimin dhe funksionimin e KA-së

Situata:

Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ (KA) u konstatua sa më poshtë vijon:



- Në kushtet ku Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë u bashkuan në një ministri të vetme³¹, nga auditimi u konstatua se, në mbledhjet e Këshilli Administrativ (KA) të ISSH, realizuar pas datës 13.10.2018, ky këshill ka funksionuar me 11 anëtarë, nga 12 të përcaktuar në nenin 72 të ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në mbledhjen e KA-së, të datës 20.10.2017 për të rregulluar pikërisht numrin e anëtarëve, u miratua caktimi i dy anëtarëve, përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konkretisht Ministri në rolin e Kryetarit të KA, dhe zëvendësministri në rolin e një anëtari. Caktimi i dy përfaqësuesve të së njëjtës strukturë në Këshillin Administrativ, mbart riskun e mungesës së përfaqësimit të institucioneve të tjera.

- Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Administrativ, është kryer pa votim të fshehtë, në kundërshtim me nenin 73, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili përcakton se: “Kryetari zgjidhet nga KA-ja me votim të fshehtë”.

- Në mbledhjet e KA-së së vitit 2017 nuk gjendet i trajtuar miratimi i raportit vjetor, *bilancit vjetor, buxhetit vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore*. Në mbledhjen e datës 20.12.2017 është miratuar rezultati financiar i vitit 2016. Në Rregulloren financiare, pika “Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D “Raportimi”/nënçështja 3, specifikon se, raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2017 nuk është zbatuar në ISSH kjo çështje.

Kriteri:

Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar; Statuti i ISSH.

Nenin 72 i ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku parashikohet se numri I anëtarëve të KA-së është 12.

Rregullorja Financiare e ISSH, pika *Kontrolli financiar dhe raportimi*, çështja D. “Raportimi” / nënçështja 3 specifikon se, raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet.

Ndikimi:

Thyerje e bazës ligjore të Institucionit (risqe të thyerjes së kontrolleve)

Rekomandime

- Përsa më sipër të vlerësohet dhe gjykohet mundësia që, për të shmangur praninë e dy përfaqësuesve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të konsiderohet në përbërjen e KA-së, një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke qenë se Instituti i Sigurimeve Shoqërore operon me skemat e fermerëve. Sa më sipër të reflektohet në nenin 72, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i

³¹ Pas ristrukturimit të ministrive sipas VKM datë 13 Shtator 2017, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.90/2012.



ndryshuar.

- Të merren masa që në rastet e ardhshme, zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Administrativ të kryhen me votim të fshehtë.
- Këshillit Administrativ, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, duhet të miratojë pasqyrat financiare dhe rezultatin financiar të ISSH-së brenda afateve ligjore të përcaktuara në Rregulloren Financiare të institucionit. Projektvendimi duhet të shoqërohet me relacionin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe me pasqyrat financiare të nënshkruara nga hartuesi i llogarive vjetore dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike.

Në vazhdim

Afati për zbatimin e rekomandimit

Në kuadër të mbajtjes së plotë të proces verbaleve nga ana e sekretares së Këshillit Administrativ, referuar edhe natyrës delikate të temave të trajtuara në këto mbledhje sugjerojmë si të nevojshëm krijimin e një sistemi audio për regjistrimin e tyre.

II/3. Auditimi mbi funksionimin e Auditimit të Brendshëm dhe vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

II/3-a Mbi organizimin dhe funksionimin e Auditimit të Brendshëm.

Drejtoria e Auditit të Brendshëm për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar sipas përcaktimit në Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", ndryshuar me Ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010; Ligjin nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"; Ligji Nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 "Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik"; VKM nr. 212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"; Udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012 i Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Karta e Auditit, Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe praktikat profesionale të publikuara nga Instituti i Auditimit të Brendshëm; Nga auditimi u konstatua se Instituti i Sigurimeve Shëndetësore nuk ka një Manual specifik të Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe as Rregullore të brendshme të organizimit dhe funksionimit të tij por funksionon mbi bazën e Manualit të Auditit të Brendshëm. Veprimtaria e AB trajtohet në Seksionin 2g) të Rregullores së Brendshme të ISSH si dhe në nenin 12 të Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Misioni i Auditimit të Brendshëm.

Misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së institucionit, mbulim i popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore në cdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, akordimi i përfitimeve për pension, paaftësi të përkohëshme në punë, barrëlindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale e përfitime suplementare në momentin e lindjes dhe nevojës për to. Rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar, përmirësim i efikasitetit në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore.



Në ushtrimin e misionit dhe veprimtarisë, Drejtoria e Auditit të Brendshëm në ISSH, është bazuar dhe i përmbahet parimeve, drejtimeve dhe objektit të auditimit të brendshëm të përcaktuara në objektivat strategjik të institucionit, duke dhënë siguri se sistemet funksionale zhvillohen me efikasitet, efikasitet dhe ekonomi.

Objektivat kryesore të DAB

Nga auditimi konstatohet se, disa nga objektivat kryesore të vendosura në planin strategjik dhe vjetor të auditimit për vitin 2017 kanë qenë:

- Identifikimi i subjekteve që do të auditohen

Universi i auditimit i përcaktuar nga DAB është mbështetur në strukturën organizative të ISSH-së dhe përfshin të gjitha njësitë shpenzuese në sistemin e sigurimeve shoqërore të cilat janë: Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, 12 drejtoritë rajonale të ndara në nivel qarku, 2 degët e veçanta të DSSH Sarandë dhe DSSH Tropojë, si dhe Drejtoria Qendrore e Arkivës së ISSH-së. Në total do të auditohen nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm 16 subjekte.

- Identifikimi i sistemeve dhe funksioneve prioritare

DAB në bazë të vlerësimit të riskut ka vlerësuar sistemet dhe funksionet prioritare që do të jenë pjesë e angazhimeve të auditimit në funksion të zbatimit dhe përmbushjes së objektivave strategjike të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Angazhimet e auditimit do të kryhen për ato sisteme dhe funksione që janë vlerësuar me risk të lartë, të cilat do të kenë një frekuencë të lartë vit pas viti. Ndërsa sistemet dhe funksionet me risk të ulët do të auditohen me një frekuencë të ulët çdo dy vite.

a. Analiza dhe vlerësimi i Auditimit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm në ISSH funksionon në nivel drejtorie e cila raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Drejtorit të Përgjithshëm, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të DAB në sektorin publik”, i ndryshuar. Organika për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm është e miratuar me VKA nr. 3 datë 26.02.2008 “Miratimi i Rregullores së personelit” si dhe paraqitet si vijon:

Tabela Nr. 6.1

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësish
1	Drejtor Drejtorie	1
	Dega e Auditimit Ekonomik dhe Financiar	6
2	Kryetar i Degës	1
3	Specialist	5
	Dega e Kontrollit të Përfitimeve	8
4	Kryetar Dege	1
5	Specialist/Auditues	7
	Spektori i Raportëve dhe Menaxhimit të Riskut	2
6	Specialist për raportet	1
7	Specialist për menaxhimin e riskut	1
Total	17	

Në vitin 2014 pas Vendimit të Këshillit Administrativ të ISSH nr.5, datë 20.07.2010 “Për ndryshimin e Strukturës Organizative të ISSH” miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj.V.B, me shkresë nr.1570 prot, datë 11.03.2014 është kryer ndryshim në strukturën organizative të Drejtorisë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

Qëndrore. Duke bërë që numri i punonjësve për këtë drejtori të shkoj në 12. Si më poshtë vijonë:

Tabela Nr. 6.2

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish
1	Drejtor Drejtorie	1
	Dega e Auditimit Financiar	6
2	Kryetar i Degës së Auditit Ekonomik Financiar	1
3	Auditues	5
	Spektori i Auditimit të Përfitimeve	3
4	Përgjegjës i sektorit të auditimit të përfitimeve	1
5	Auditues	2
	Spektori i Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut	2
6	Specialist për raportet/Auditues	1
7	Specialist/Auditues	1
Total	12	

Aktualisht Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) është e organizuar në dy degë të emërtuar dega e auditimit financiar dhe sektori i raporteve dhe menaxhimit të riskut. Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ISSH për vitin 2017 ka pësuar këto ndryshime, deri në muajin Gusht 2017 ka funksionuar me 12 punonjës dhe nga muaji shtator e në vijim pas ndryshimeve në organik si rrjedhojë e zhvendosjes së 3 punonjësve nga DAB në Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve. Veprim i kryer bazuar në shkresën nr.7386 prot, datë 07.09.2017. Aktualisht DAB, pas miratimit të strukturës nga Drejtori i Përgjithshëm funksionon me 9 punonjës. Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm i miratuar prej Drejtorit të Përgjithshëm z.A.H prej 25.04.2016 e në vijim është z. S.L.

Tabela Nr. 6.3

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish
1	Drejtor Drejtorie	1
	Dega e Auditimit Financiar	6
2	Kryetar i Degës së Auditit Ekonomik Financiar	1
3	Auditues	5
	Spektori i Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut	2
4	Specialist për raportet/Auditues	1
5	Specialist/Auditues	1
Total	9	

Pjesë përbërëse e strukturës së ISSH është edhe njësia e auditimit të përfitimeve, të cilës prej 11.03.2014 i është shtuar edhe njësia e auditimit të përfitimeve afatgjata e cila ka pas qenë pjesë e DAB. Ndarje kjo e kryer mbështetur edhe në rekomandimin e KLSH-së nr.190/8 datë 13.07.2017 me qëllim shmangien e dublimit të punës prej dy drejtorive.

Ajo që konstatohet është se, përshkrimet e punës për DAB janë të përcaktuara në Kartën e Auditit, miratuar nga Drejtori Përgjithshëm, me shkresën nr.7356 prot, datë 05.09.2017.

Dega e Auditimit Financiar ka në përbërje kryetarin e degës si dhe pesë auditues të profilit ekonomist, sektori i raporteve dhe menaxhimit të riskut ka në përbërje dy specialist një me profil juristë dhe një financë. Për vitin 2017 janë të pajisur me çertifikatën e audituesit të brendshëm publik 8 nga punonjësit e kësaj drejtorie dhe kanë përvojë pune si auditues në sektorin publik që varion nga 3-9 vjet. Organizimi dhe funksionimi i DAB bazohet në Neni 10 të Ligjin Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, në



kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 83 datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të DAB në sektorin publik", i ndryshuar Manuali i Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik miratuar prej Ministrisë të Financave me Urdhrin Nr. 69 datë 29.09.2010 dhe Urdhrin Nr. 100 datë 25.10.2016. Ndërkohë që një prej punonjësve është në proces për certifikim si Auditues i Brendshëm.

b. Përgatitja e planeve strategjike dhe vjetorë për vitin 2017 bazuar në vlerësimin e riskut:

Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm në ISSH është hartuar plani strategjik dhe vjetor për vitet 2017 – 2019. Ky plan është dërguar në Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NJQH/AB) me shkresën Nr. 7076/1 prot. datë 01.11.2016, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institucionit z. A.H. Përsa i përket afatit të dërgimit të planeve nuk është respektuar, pasi Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, bazuar në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar, neni 18 "Detyrat e njësisë së auditimit të brendshëm, pika 2 dhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kap. II, pika 2.1 "Plani strategjik i auditimit", pika 2.2 "Plani vjetor i auditimit" dhe pika 2.3 "Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor", pika 3.2 "plani vjetor i auditit të brendshëm", pika 3.3 "afati i përgatitjes dhe dërgimit të planit vjetor dhe strategjik të auditit të brendshëm" ka dërguar një kopje në Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, por nuk ka respektuar afatin e dërgimit që është Brenda datës 20 tetor të çdo viti. ...*Plani Strategjik dhe Plani Vjetor, miratohen nga titullari i institucionit dhe ato dërgohen jo më vonë se data 20 Tetor e çdo viti, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.*Më pas me ndryshimin e strukturës së drejtorisë së auditit të brendshëm, në bazë të shkresës nr.7376 prot, dt 09.07.2017 për një ndryshim Brenda strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së, struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm reduktohet në total nga 12 në 9 punonjës. Si rjedhojë e këtyre ndryshimeve në strukturë është ridërguar tabela e planit vjetor të rishikuar me shkresën nr.9013 prot, datë 08.11.2017. Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2017 janë parashikuar për tu kryer gjatë vitit 2017 gjithsej 21 auditime të përcaktuara. Nga DAB në ISSH nuk janë paraqitur planet mujore dhe realizimet mujore. Planet vjetore dhe strategjike të paraqitura janë hartuar nga Drejtori i AB dhe janë miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm. Në hartimin e planit fillestar të auditimit për vitin 2017, i cili është pjesë e planit strategjik 2017 -2019, DAB pranë ISSH -së është mbështetur në: përfshirjen e subjekteve që kanë risk; përfshirjen e subjekteve të kontraktuara siç janë qendrat shëndetësore me risk; frekuencën e auditimit të institucioneve të varësisë; në fondet e institucioneve të varësisë të menaxhuara prej tij; dhe në renditjen kronologjike të kohës së kryerjes së auditimit, rezultatet përfundimtare të auditimit të mëparshëm dhe në rekomandimet e lëna. Mbështetur mbi Standartin 2060 drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet t'i raportojë periodikisht menaxhimin të lartë dhe bordit mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatin e aktivitetit të auditimit të brendshëm në raport me planin e tij. Raportimi duhet të përfshijë ekspozime ndaj rrezikut material dhe çështje të kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes së organizatës dhe çështje të tjera të nevojshme ose të kërkuara nga menaxhimi i lartë dhe bordi. Ky dokument i paraqitet komitetit të auditimit për mendim (aty ku ekziston), i dërgohet për miratim titullarit të njësisë publike si dhe dërgohet Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm. Gjatë auditimit nuk na u vendos në dispozicion korrespondenca me menaxhimin e lartë apo bordin e institucionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

c. Identifikimi i Sistemeve dhe Fushat me risk për tu audituar:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në fazën e planifikimit vjetor është mbështetur në auditimin e atyre sistemeve apo subjekteve që kanë një risk më të lartë në realizimin e objektivave të ISSH. Mbi bazën e përvojës së fituar ka vlerësuar risqet sipas sistemeve dhe subjekteve. Nisur nga fakti që strukturat e ISSH duke përfshirë dhe Drejtorinë e Përgjithshme përdorin fonde të mëdha publike ku niveli i riskut është vlerësuar *nivel i lartë* Sipas këtij vlerësimi referuar Manualit të Auditimit *Pika 2.1.1.4 Faza e katërt – Përlllogaritja e burimeve të auditimit “Sisteme me risk të lartë - kërkojnë më më tepër kohë se ata me risk të mesëm dhe se ata me risk të ulët”*.

Fushat prioritare, në të cilat është fokusuar DAB për hartimin e programeve të auditimit për vitin 2017 kanë qenë:

<i>Vlerësimi i sistemeve:</i>	<i>Vlerësimi i funksioneve</i>
v Sistemi i caktimit të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra	v Funksioni i degës së financës;
v Sistemi i rishqyrtimit të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra;	v Funksioni i degës së përfitimeve;
v Sistemi i kontributeve vullnetare, vetëpunësuarve në bujqësi, suplementare;	v Funksioni i degës së administrimit;
v Sistemi i buxhetimit;	v Funksioni i degës së teknologjisë së informacionit;
v Sistemi i prokurimit;	v Funksioni i degës juridike;
v Sistemi i personelit;	v Funksioni i degës së arkivës;
v Sistemi i arkivës;	v Funksioni i agjencive;

Gjatë auditimit *konstatohet se në të gjithë subjektet e planifikuar për auditim është identifikuar një nivel risku mesatar ndërkohë që vetëm për për DAQ niveli i riskut të identifikuar është i ulët. Sipas gjyqimit tonë Drejtoria e Arkivës Qendrore mbart një nivel mesatar deri të lartë risku në vetvete përse i përket informacionit që ruan, ndaj edhe duhet planifikuar për tu audituar gjatë viteve 2017-2019, në mënyrë prioritare. Specifikojmë se, përse më sipër bëhet fjalë për impaktin social që ka në popullatë dokumentacioni i ndodhur në këtë drejtori.*

d. Përmbushja e detyrave dhe arritja e qëllimeve

Për vitin 2017 sipas planit 12-mujor janë parashikuar gjithsej 24 auditime. Në muajin shtator të vitit 2017 në kushtet e reduktimit të punonjësve është kryer një rishikim i planit vjetor duke ndryshuar numrin nga 24 në 21 misione auditimi, me shkresë nr.9013 prot, datë 08.01.2017.

Objekt i auditimit	Nr. Auditimesh të parashikuar për vitin 2017	Nr. Auditimesh të parashikuar pas ndryshimit	Realizuar 2017	Te pa realizuar 2017
ISSH (Drejtori e Përgjithshme)				
DRSSH Tirane	2	2	3	0
DRSSH Berat	2	2	2	0
DRSSH Diber	1	1	1	0
DRSSH Durres	2	2	2	0
DRSSH Elbasan	1	1	1	0
DRSSH Fier	2	1	1	0
DRSSH Korçe	2	2	2	0
DRSSH Kukes	2	2	2	0
DRSSH Lezhe	2	2	2	0
DRSSH Shkoder	2	2	2	0
DRSSH Vlore	1	1	1	0
DRSSH Gjirokstaer	2	1	1	0
DSSH Sarande	1	1	1	0
DSSH Tropoje	2	1	2	0
Total		21	23	0



Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ISSH, për vitin 2017 ka realizuar 23 misione auditimi nga 21 misione të parashikuara, si më poshtë:

- 5 auditime të plota financiare në DRSSH Korçë, DRSSH Berat, DRSSH Lezhë, DRSSH Kukës, DSSH Tropojë, (4 auditime financiare, nga të cilat 3 në DRSSH Korçë, Lezhë, Kukës dhe një në DSSH Tropojë dhe 1 auditim financiar dhe ligjshmëri në DRSSH Berat)
- 14 auditime përputhshmërie në Drejtoritë Rajonale dhe Degët, ku konkretisht janë zhvilluar në DRSSH Berat, DRSSH Dibër, DRSSH Durrës, DRSSH Elbasan, DRSSH Fier, DRSSH Korçë, DRSSH Kukës, DRSSH Lezhë, DRSSH Shkodër, DRSSH Vlorë, DRSSH Gjirokastrë, DRSSH Tiranë, DSSH Sarandë dhe DSSH Tropojë.
- 4 auditime tematike prej të cilave, 2(dy) auditime tematike në Drejtorinë e Tiranës, 1 (një) auditim tematik në DRSSH Shkodër dhe 1 (një) auditim tematik në DRSSH Durrës.

Nr.	Emërtimi	Realizimi		Realizimi në (%)
		Fakt	Plan	
1	Auditime të plota dhe të kombinuara Drejtori Rajonale, Varësie	19	21	90.1
2	Auditime tematike	4	0	400
	Totali	23	21	109

Janë realizuar jashtë normave të parashikuara auditimet në DRSSH Tiranë dhe DRSSH Tropojë.

Për sa më sipër konstatohet se, në planin e auditimeve (dërguar në NJQH) janë parashikuar 21 auditime për tu kryer nga të cilat 14 përputhshmërie dhe 7 të kombinuara³².

Nga auditimi rezultoi se në vitin 2017 përveç masave të zhdëmtimit, DAB në rekomandimet që ka lënë ka dhënë: 53 *rekomandime* për masa organizative dhe 5 *rekomandime* për kallëzim penal si dhe 22 *rekomandime* për masa disiplinore si vijon: Vërejtje 21 *raste*; dhe zgjidhje kontrate 1 *rast*. Bazuar në rezultatet e angazhimeve të auditimeve të evaduar për vitin 2017 kanë rezultuar 248 gjetje shkelje të disiplinës financiare me dëm financiar në vlerën 6,853,799 lekë. Një peshë të rëndësishme në masat e lëna e zënë 2 auditimet e kryera prane Drejtorisë Rajonale Berat dhe në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Ndarja e dëmit ekonomik konkretisht është në masën:

-83.79% ose 5,742,851 lekë nga rastet e evidentuara për përfitime të padrejta, këto përfitues janë shpallur debitorë dhe vjelja e debisë kryet konform përcaktimeve në nenin 62 të ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993;

-16.01% ose 1,097,174 lekë nga kryerja e pagesave në mënyrë jo të rregullt nga ana e qendrave paguese të Postës Shqiptare sh.a. vlerë e cila është arkëtuar plotësisht sipas përcaktimeve në marrëveshjes mes ISSH dhe Posta Shqiptare sh.a.;

-0.2% ose 13,774 lekë është në ngarkim të punonjësve të ISSH, dhe kjo ka ardhur si rezultat i keq llogaritjeve sipas VKA nr 9, datë 20.10.2014. Në të gjitha rastet e konstatuara grupi i auditimit ka arritur në konkluzion se kjo ka ndodhur nga gabime njerëzore në llogaritje, dhe në asnjë rast nuk është konstatuar veprim i qëllimshëm për shpërdorim apo përvetësim të fondeve të ISSH-së. Kjo vlerë është arkëtuar plotësisht, duke kryer ndalesat përkatëse nga paga e punonjësve.

³² Shiko Aneksin 6

**Bazuar në fushat e gjetjeve**

Struktura e gjetjeve sipas sistemeve për auditimet e kryera nga DAB për vitin 2017 paraqitet në vijim. Auditime të plota të aktivitetit ekonomiko-financiar të DRSSH-ve, ku rezulton se për vitin 2017 janë zbuluar 164 gjetje me dëm financiar prej 5,167,228 lekë, duke konstatuar këto probleme:

-Janë konstatuar probleme me shtesat kreditore për përfituesit të cilat janë dhënë në kundërshtim me Vendimin e Caktimit të Përfitimeve (VCP) duke dhënë shtesa të përsëritura dhe përtej periudhës së përcaktuar.

-Është konstatuar se nuk zbatohet drejtë Regullorja nr. 3/2 datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSH-së”, për vlerësimin në mënyrë periodike, shkallë pas shkalle dhe vit pas vit për punonjësit me të cilën bëhet rritja në detyrë dhe shkallë pagese.

-Për dhënien e masave disiplinore nuk të zbatohet Rregullore nr.3/2 datë 26.02.2008 “Për personelin e ISSH-së”, Kap V.3 “Komisioni disiplinor”.

-Është konstatuar ka mangësi në hartimin e rregjistrimit/strategjia e risqeve, bazuar në nenin 10 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

-Janë konstatuar dosje pensionesh të parregullta në shkelje të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me dëm financiar të pasqyruara në raportet përfundimtare të DRSSH-ve.

-Është konstatuar se pagesat për shpenzimet e varrimit nuk ishin të shoqëruara me kasë fiskale, çertifikata të vdekjes sipas modularit të miratuar nga Z.GJ.Civile.

-Është konstatuar se ka mangësi në veprimet me magazinën hyrje – dalje në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap.III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”.

-Është konstatuar se në veprimet me bankat mungojnë dokumentat justifikues për të ardhurat nga sigurimet vullnetare dhe të bujkut si urdhër veprimi apo mandat arkëtimi, në zbatim të akt – marrëveshjes me bankat e nivelit të dytë, nr. 258/1, datë 17.02.2006.

Auditime të përputhshmërisë dhe ligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 46/2016 “Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve, në zbatim të ligjit nr.10142 datë 15.05.2009, i ndryshuar dhe të VKM nr.704 datë 12.10.2016”, nga të cilat rezulton se për vitin 2017 janë konstatuar këto probleme:

-Në zbatimin të ligjit 46/2016 në sistemin e sigurimeve shoqërore është kryer rillogaritja dhe përpunimi i të dhënave për 5080 dosje përfituesish. Ky proces u auditua i plotë për të gjitha dosjet nga ku rezultuan pasaktësi në llogaritjen e vlerave debitore e kreditore për 83 raste ose 1.63.

-Në çdo raport auditimi kur janë konstatuar pasaktësi në llogaritje është lënë detyrë të bëhet rillogaritja dhe sistemimi i vlerave debitore ose kreditore sipas secilit rast. Të gjitha rekomandimet e lëna janë pranuar dhe zbatuar nga DRSSH përkatëse.

-Përveç auditimit të fushave të vlerësuara me rrisht të lartë ose të mesëm, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka kryer edhe aktivitete të tjera audituese të cilat janë në ndihmë të drejtimit për përmirësimin e vazhdueshëm të efikasitetit dhe efikasitetit në veprimtarinë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

e. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të auditimeve tematike për vitin 2017

Auditime me tematika të ndryshme në lidhje me përputhshmërinë dhe ligjshmërinë në zbatimin e ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet regullative në fushën e sistemit të sigurimeve.



Auditimet tematike të zhvilluara gjatë vitit 2017, në tre raste janë nisur kryesisht nga problematika të ngritura nga strukturat qeveritare të antikorrupsionit si dhe mediat e ndryshme. Nga kryerja e këtyre angazhimeve është konstatuar dëm financiar me vlerë 1,036,248 lekë, si dhe janë konstatuar këto probleme:

-Vonesa në dorëzimin e dokumentacionit nga ALSSH-të në DRSSH-të përkatëse.

-Vonesa në kryerjen e rishqyrtimeve të përfitimeve, në ato raste kur kërkohet nga vet përfituesi ose kur kërkohet marrja e vërtetimeve nga DAQ / DRSSH të tjera, të cilat merren me vonesë. Mos përcaktimi i qartë i afateve kohore për kryerjen e rishqyrtimeve të përfitimeve në aktet rregullative. Nga auditimi i kryer mbi dosjet e evaduar u konstatuan 4 raste të auditimeve tematike të zhvilluara gjatë vitit 2017, të iniciuara kryesisht nga problematika të ngritura në strukturat qeveritare të antikorrupsionit si dhe media. Konkretisht është kryer auditim tematik në DRSSH Durrës, si rezultat i ankesës së qytetarit në portalin ‘stop korrupsionit’. Ky auditim është kryer mbështetur në programin e auditimit nr.7819, datë 25.09.2017, me objekt auditimi “Përputhshmëria dhe rregullshmëria e lidhjes së përfitimit më nr.132671”. Është kryer auditim tematik në DRSSH Shkodër, me program auditimi nr.368 datë 16.01.2017 dhe me objekt auditimi “Ligjshmëria e caktimit të përfitimeve në bazë të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, si dhe të gjithë akteve ligjore e nënligjore që veprojnë në fushën e Sigurimeve Shoqërore”.Në përfundim të auditimit nga ana e audituesve të ISSH rezultuan problematika si më poshtë vijnë:

- vonesa në dorëzimin e dokumentacioneve në DRSSH-të përkatëse.

- vonesa në kryerjen e rishqyrtimeve të përfitimeve, në ato raste kur kërkohet nga vet përfituesi ose kur kërkohet marrja e vendimeve nga DRSSH të tjera.

- mos përcaktim i qartë i afateve kohore për kryerjen e rishqyrtimeve të përfitimeve në aktet rregullative.

- dhënie e më shumë të drejtave të inspektorëve përpunues në programin elektronik të pagesave PCAMS.

- mos arkivim i saktë i dokumentacionit në dosjet e përfitimeve

- mos koordinim i degëve brends së njëjtës Drejtori Rajonale dhe mangësi në zbatimin e Kontrollit të Brendshëm.

f. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të auditimeve të plota rezultoi se:

Në dosjen e auditimit mbi faljen e detyrimeve të ish-ushtarakëve në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve, në zbatim të ligjit ne.10142 datë 15.05.2009, i ndryshuar, u audituan dosjet e auditimeve të kryera në DRSSH Tiranë me program nr.2032 prot, datë 06.03.2017; me program nr.627 prot, datë 23.01.2017 në DRSSH Lezhë, Fier, Dibër, Tropojë dhe Shodër ; me program nr.629 prot, datë 23.01.2017 në DRSSH Elbasan, DRSSH Durrës, DRSSH Gjirokastër, DRSSH Berat; me program nr.628 prot, datë 23.01.2017 DSSH Sarandë, DRSSH Korçë, DRSSH Vlorë,

- Në auditimin e kryer në DRSSH Tiranë mungonte akt konstatimi dhe procesverbali i mbajtur me subjektin, të cilëve u janë referuar në raportin final. Po ashtu totali i masës zhdëmtuese nga përfituesit është 317,189 lekë dhe jo 317,159 lekë.

- Në auditimin e kryer në DRSSH Dibër munonte akt konstatimi të cilit i ishin referuar edhe në raportin final të auditimit, ku sipas këtij të fundit rezultonte i mbajtur më datë 01.02.2017, por në dosjen e këtij auditimi rezultonte një proces verbal, i mbajtur më datë 01.03.2017



- Në auditimin e kryer në DRSSH Berat, u konstatua se, në raportin e auditimit mungonte firma e njërit prej anëtarëve të grupit, konkretisht z.M.T.
- Në auditimin e kryer në DRSSH Elbasan, u konstatua se në raportin e auditimit mungonte firma e njërit prej anëtarëve të grupit, konkretisht znj.M.T si dhe firma e Kryetarit të degës së financës për DRSS-në.
- Në auditimin e kryer në DRSSH Durrës me program nr.629 prot, datë 23.01.2017 u konstatua se, në raportin e auditimit mungonte firma e njërit prej anëtarëve të grupit, konkretisht z. Marjeta Terpollari, në evidencën e dërguar ISSH nga ana e DRSSH Durrës mungonin ekstremitetet e dokumentit zyrtar si dhe në faqën e fundit firma e kryetarit të degës së përfitimeve, znj.Mendime Jella.
- Në auditimin e kryer në DRSSH Gjirokastrë, u konstatua se në raportin e auditimit mungonte firma e njërit prej anëtarëve të grupit, konkretisht z.Marjeta Terpollari.
- Është kryer auditim tematik në DRSSH Kukës, me program auditimi nr.627 datë 23.01.2017 dhe me objekt auditimi “Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve sipas Ligjit nr.10142, datë 15.05.2009”.

Gjithashtu u konstatua se megjithëse kishim të bënim me dëm ekonomik në disa raste prej grupit të auditimit mbahej akt konstatim (Berat, Elbasan, Durrës, Gjirokastrë) dhe në disa të tjera mbahej proces verbal (Tropojë, Lezhë, Fier, Kukës). Për këtë gjykojmë se nevojitet të unifikohet mënyra e nxjerrjes së përfundimit në raportin final, sepse ka raste që specifikohet numri i rasteve dhe shuma e dëmit financiar dhe në raste të tjera raporti ngelet në terma narrative (Tiranë, Berat, Durrës).

Në të gjitha dosjet e audituara, konstatohet mungesa periodike e shkresës së inventarit të dosjeve respektive si dhe dokumenti i projekt raportit të auditimit. **Veprime të tilla bien në kundërshtim me** kapitullin 4, pika 4.6 të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Standartin 2410 “Kriteret për komunikim”, ku thuhet “Menjëherë pasi të ketë përfunduar punën në terren, grupi i auditimit duhet të hartojë projekt raportin e angazhim auditimit. Projekt raporti është raporti i parë përmbledhës i veprimtarisë audituese që i dërgohet njësisë së audituar me shkresë përcjellëse sipas formatit të miratuar nga titullari i njësisë publike, Në këtë shkresë i kërkohet menaxhimit të njësisë së audituar **të reagojë** në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura në projekt raport sipas afateve të përcaktuara.

g. Nga auditimi i zbatimit të afateve të hartimit dhe dorëzimit të projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit u konstatua se:

- 1- Nga auditimi sipas programit nr. 7819, datë 25.09.2017 **në DRSSH-në Durrës** rezultoi se:
 - Objekti i auditimit është “Auditim tematik”, dhe afati i auditimit është periudha 25.09.2017 deri më 26.09.2017. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, mungon “Projekt raporti i auditimit” dhe është dërguar me shkresë përcjellëse “Raporti i auditimit sipas programit nr.7819 prot, datë 28.09.2017”.
- 2- Nga auditimi sipas programit nr.368, datë 16.01.2017 **në DRSSH-në Shkodër** rezultoi se:
 - Objekti i auditimit është “Auditim tematik”, dhe afati i auditimit është periudha 17.01.2017 deri më 19.01.2017. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, është protokolluar me nr. 368/2 prot shkresa përcjellëse e dërgimit të projekt raportit me datë 21.02.2017. Dhe me shkresën përcjellëse nr. 368/3, datë 28.02.2016 është dërguar pranë DRSSH Shkodër “Raporti i auditimit sipas



programit nr.1642, datë 20.02.2015". Në projekt raportin e auditimit mungonte firma e njërit prej anëtarëve të grupit, konkretisht znj.F.H.

Nuk është respektuar afati i dërgimit të projekt raportit, *Normalisht raporti paraprak i dërgohet organizatës brenda 10 ditë pune pas përfundimit të punës audituese*, i cili është dërguar në subjekt pas 4 javë e 5 ditë.

3- Nga auditimi sipas programit nr.627, datë 23.01.2017 në **DRSSH-në Kukës** rezultoi se:

-Objekti i auditimit është "Auditim tematik", dhe afati i auditimit është periudha 20.02.2017 deri më 22.02.2017. Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, është dërguar me datën 25.04.2017 me shkresë përcjellëse nr.627/4 prot "Raporti i auditimit". Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se, në dosjen e auditimit mungon "Projekt raporti i auditimit".

Në dosjen e auditimit tematik, me program nr.438 prot, datë 18.01.2017 u konstatua se mungonte deklarata e pavarësisë së audituesve.

Veprime të tilla bien në kundërshtim me kapitullin 4, pika 4.6 të Manualit të Auditimit të Brendshëm ku thuhet "Njësia e audituar jep komente në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në fazën e diskutimit të gjetjeve për hartimin e projekt-raportit. Projekt-raporti, i dërgohet njësisë së audituar brenda 10 ditë pune pas përfundimit të angazhimit të auditimit.

Drejtuesit e njësisë së audituar mund të bëjnë me shkrim shpjegime në lidhje me përmbajtjen e projekt-raportit brenda 10 ditë pune nga data e marrjes së tij. Nëse subjekti i audituar paraqet përgjigje me shkrim për gjetjet dhe rekomandimet e pa pranuar (kundërshtitë/observacionet), grupi i auditimit i analizon ato brenda 7 ditë pune dhe i pasqyron në raportin përfundimtar të cilin ja dërgon subjektit të audituar."

Si përfundim mund të themi se, nga auditimi i dosjeve të auditimit, është konstatuar se deri në muajin shtator të vitit 2017 janë kryer auditime mbi lidhjen e pensioneve nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, mbi procesin e lidhjes dhe jo mbi çertifikimin e tyre, ku këtë të fundit e kryen Njësia e Inspektimit të Përfitimeve. Ndërsa auditime të plota janë kryer më pak duke i kushtuar më tepër rëndësi auditimeve tematike.

Për sa më sipër rekomandojmë të merren masa nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ti kushtojë rëndësi kryerjes së auditimeve të plota, duke patur në konsideratë që struktura e gjetjeve sipas sistemeve për auditimet e kryera nga DAB të jap informacion mbi *sistemin e proceseve organizative, menaxhimin e burimeve njerëzore, në lidhje me programimin dhe zbatimin e buxhetit, në lidhje me sistemin e pagave dhe shpërblimeve, në lidhje me sistemin e prokurimeve, në lidhje me sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar*. Pasi në këto rrethana në nuk marrim asnjë siguri mbi veprimtaritë e institucioneve të vartësisë.

h. Evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Materialet e auditimit hartohen në dy -kopje, nga të cilat një kopje i lihet subjektit të audituar dhe një kopje e bëhet pjesë e dosjes për arkivim. Në protokollin e ISSH për auditimet e përfunduara mbahen shkresat përcjellëse të materialeve të cilat i përkasin këtyre auditimeve. Pas nisjes së raportit final dhe shkresës së bashku me rekomandimet dhe marrjes së plan veprimit nga subjekti i audituar, grupi i auditimit formulon **Memo** (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar) dhe ja paraqet titullarit të institucionit. Drejtoria e Auditimit Të Brendshëm ka krjuar një dosje të veçantë për çdo angazhim auditimi, e cila përveç dokumentacionit që gjykohet e rëndësishme nga grupi i punës, duhet të përmbajë *inventarin përkatës* edhe dokumentet standarte të përcaktuar në manualin



e auditimit. Dosjet depozitohen në arkivin e institucionit në zbatim të detyrimit ligjor përcaktuar në Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” (i ndryshuar) dhe “Normën Teknike –Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” pjesa II-C. Dorëzimi i dokumenteve në rrjetin arkivor . Dosjet e auditimit për vitin 2017 janë ende të pa arkivuara për arsye se ky process ndodh pas largimit të grupit të auditit të KLSH-së.

i. Karta e auditimit të brendshëm.

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm të ISSH ka hartuar kartën e auditimit të brendshëm në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” Neni 14 *Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike* , pika b) si dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 2.5 **Karta e auditimit të brendshëm** dhe pika 2.6.1 Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm pika c) e cila përcakton Drejtuesi i Njësisë së AB-së është përgjegjës për të siguruar: “*b) hartimin e Kartës së Auditimit, akteve të tjera specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm, si dhe dërgimin e tyre për administrim në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm pas miratimit nga titullari i njësisë publike*”. Kjo kartë Auditimit është miratuar nga Drejtori Përgjithshëm i ISSH me shkresën nr.7356 prot, datë 05.09.2017.

Auditimi i Brendshëm është një nga dy komponentët e kontrollit të brendshëm, i cili nëse nuk përmbush sic duhet funksionet e tij, në mbështetje të ligjit nr. Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, riskon të çënojë efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Konstatimet e grupit të auditimit të KLSH mbi NJAB si:

- mosrespektimi i afatit të dërgimit të planit strategjik dhe vjetor pranë Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.
- mungesa e unifikimit të përdorimit të dokumenteve konstatues në rastet e dëmit ekonomik dhe rastet e parregullsisve organizative dhe administrative;
- mungesa e ushtrimit të misioneve të auditimit mbi Aparatin e ISSH;
- raste të mungesës së firmës së njërit prej anëtarëve të grupit të auditimit si dhe një rast i mungesës së deklaratës së pavarësisë së audituesve;

forcojnë edhe më tej nevojën për mirëfunksionimin e kësaj njësie, si një “filtër i domosdoshëm”, për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

j. Prioritetet për periudhën 2017-2019

Prioritetet për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm mbetet siguridhënia objektive ndaj titullarit të ISSH se zbatim i i proceseve të punës kryhet me efikasitet, efikasitet dhe ekonomi në përmbushje të objektivave të përcaktuara.

Duke zhvilluar një veprimtari të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e mënaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit të brendshëm, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm do të shtojë vlerë dhe do të përmirësojë veprimtarinë e ISSH-së.

k. Në lidhje me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm

Në zbatim të pikës 13.2, Kap 4 të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhër nr. 100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm me



qëllim zhvillimin e angazhimeve të auditimit me ekonomi, eficensë dhe efikasitet kanë vendosur që zbatimin e rekomandimeve ta kryejnë në angazhimet e rradhës për subjektet e audituara.

Drejtimi II/3.a Vlerësimi i organizimit dhe funksionimit të Auditit të Brendshëm

- Gjetja 8:** Mbi mos-hartimin e projekt-raportit të auditimit nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB); dhe Mungesa e raportimit periodik te DAB.
- Situata:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) u konstatua se për vitin 2017 kjo drejtori ka realizuar 23 misione auditimi nga 21 misione të parashikuara, nga të cilat 5 auditime financiare, 14 përputhshmërie, dhe 4 tematike. Në përfundim rezultoi sa më poshtë vijon:
- DAB, në asnjë rast nuk ka hartuar, projektraportin e auditimit pas përfundimit të auditimit në terren, duke hartuar direkt raportin e auditimi, në kundërshtim me kërkesat që dikton Standardi 2410 “Kriteret për komunikim” si dhe me kapitullin 4/ pika 4.6 e Manualit të Auditimit të Brendshëm;
 - Gjatë auditimit nuk na u vendos në dispozicion korrespondenca e drejtuesit të DAB me Bordin dhe Drejtorin e Përgjithshëm, sa i takon raportimit periodik të DAB-së te menaxhimi i lartë dhe bordi, mbi qëllimin dhe njohjen me rezultatet e aktivitetit të Auditit të Brendshëm (AB), në raport me planin e tij, sikundër specifikohet në pikën 3.1 “Plani strategjik i auditimit”, te Manuali i AB-së, si dhe në Standardin 2060.
- Kriteri:** Standarti 2410 “Kriteret për komunikim” si dhe kapitulli 4, pika 4.6 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, ku parashikohet nevoja për hartimin e project raportit të auditimit.
Pika 3.1 “Plani strategjik i auditimit” te Manuali i Auditit të Brendshëm ; dhe Standarti 2060
- Ndikimi:** Nuk I jepet mundësia subjekteve të audituara për të observuar mbi gjetjet e auditimit. Mungesë e gjurmëve të raportimit.
- Rekomandime:**
- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të marr masa që në çdo auditim të respektojë formatet standarde të kërkuara si pjesë e dokumenteve zyrtare të procesit të auditimit, duke mos eliminuar në asnjë rast, fazën e hartimit të projekt raportit, në mënyrë që t’i jepet mundësia subjektit të audituar që të reagojë brenda afateve të përcaktuara, në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura në projekt raport.
 - Drejtuesi i DAB-së të marr masa që në raportimet periodike tek menaxhimi i lartë dhe bordi, ndër të tjera të përfshijë ekspozime ndaj rrezikut material dhe çështje të kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes së organizatës dhe çështje të tjera të nevojshme ose të kërkuara nga menaxhimi i lartë dhe bordi. Ky dokument t’i paraqitet edhe komitetit të auditimit për mendim (aty ku ekziston) dhe t’i dërgohet për miratim titullarit të njësisë publike si dhe Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm. Nisur nga fakti se Bordi është I pranishëm në këtë institucion, të merren masa për të praktikuar korrespondencën e raportimit me Bordin dhe



Drejtorin e Përgjithshëm zyrtarisht, duke lënë gjurmë edhe për to.

Afati për zbatimin e rekomandimit **Në vazhdim**

Nga auditimi u konstatua se, përsa i përket zbatimit të rekomandimeve ato shihen si pikë më vete në auditimin pasardhës. Me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të tyre **sugjerojmë që**, të kryhet auditim i veçantë për të vlerësuar rekomandimet e lëna. Dhënia dhe ndjekja e rekomandimeve është e nevojshme me qëllim përmirësimin e performancës së institucionit dhe reduktimin e riskut dhe është më efektive të shihet kohë pas kohe se sa ta shohësh kur ti vij radha në auditimin pasardhës.

Auditimi i sistemit të auditimit të brendshëm merr formën e një kontrolli cilësie për subjektet e auditimit të brendshëm, duke i vlerësuar këto subjekte përkundrejt dispozitave të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet e tjera ligjore apo nënligjore nxjerrë në zbatim të tij. Mbështetur në nenin 10, pika 1, germa “d” dhe nenin 16, pika 2 dhe pika 3, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”) “Vlerësimi i sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm”:

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në ushtrim të kompetencave të tij, vlerëson funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm në organet subjekte të auditimit, duke dhënë, sipas rastit, opinionet dhe rekomandimet e duhura.
2. Në funksion të përmbushjes së detyrave të tij, dhe pa cenuar të drejtën për të kryer vetë auditimet, Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të përdorë gjetjet e auditimeve të kryera nga organe të tjera audituese.
3. Kontrolli i Lartë i Shtetit i merr në konsideratë këto gjetje, vetëm në rast se standardet e përdorura për këto auditime janë në përputhje me standardet e veta dhe ato ndërkombëtare të auditimit.

Nga auditimi I konstatua se DAB e ISSH nuk ka kryer asnjë mission auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, por vetëm në Drejtoritë Rajonale të ISSH për çështje lidhur me procesin e lidhjes së pensioneve si dhe auditime të plota, për të cilat ne arritëm në përfundimin se mund të mbështetemi plotësisht tek puna e tyre. Duke marrë në konsideratë objektin e auditimit të KLSH I cili është përgjegjës për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, ne dalim në përfundimin se mund të të mbështetemi pjesërisht në punën e Auditit të Brendshëm, pra vetëm për ato konstatime që lidhen me veprimtarinë e Drejtorive Rajonale, pasi evidentohet nevoja për përfshirjen e D.P në planet e AB.

- mosrespektimi i afatit të dërgimit të planit strategjik dhe vjetor pranë Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.
- mungesa e unifikimit të përdorimit të dokumenteve konstatues në rastet e dëmit ekonomik dhe rastet e parregullive organizative dhe administrative si dhe në hartimin e raportit final të auditimit kishte raste kur ishte lehtësisht i kuptueshëm për lexuesin, duke specifikuar edhe numrin e kazuseve dhe shumën e dëmit financiar dhe në raste të tjera raporti ngelej në terma narrative;
- mungesa e ushtrimit të misioneve të auditimit mbi Aparatin e ISSH;



- raste të dosjeve të paplota të auditimeve, si me mungesë së firmës së njërit prej anëtarëve të grupit të auditimit, mungesë të dokumentit të inventarizimit të dosjes si dhe një rast i mungesës së deklaratës së pavarësisë së audituesve.

Auditi i Brendshëm është një nga dy komponentët e kontrollit të brendshëm, i cili nëse nuk përmbush siç duhet funksionet e tij, në mbështetje të ligjit nr. Ligji Nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, padiskutim që riskon të çënojë kontrollin e brendshëm. **Konstatimet e grupit të auditimit të KLSH forcojnë edhe më tej nevojën për mirëfunksionimin e kësaj njësie, si një “filtër i domosdoshëm”, për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.**

II/3b: Mbi vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Nga auditimi u konstatua se në përputhje me kuadrin ligjor, Ministria e Financës ka konfirmuar si Nënpunës Autorizues të ISSH me shkresën nr. 2639/1, datë 24.02.2016, z. A.H, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i ISSH. Me shkresën nr. 277/1, datë 25.01.2017, znj. E.F, me detyrë Drejtoresh e Financës në ISSH, është konfirmuar nga Ministria e Financës si Nënpunëse Zbatuese për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me shkresën nr. 4532, datë 22.05.2017 është autorizuar me firmë të dytë zëvendësuese nëpunëse zbatuese, znj. K.N, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit të Brendshëm në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Nga auditimi u konstatua se në përputhje me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 18, pika ku citohet se “Nënpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”, ISSH ka depozituar raportin vjetor për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të institucionit, së bashku me pyetësin e vetëvlerësimit, dërguar në Ministrinë e Financës sipas shkresës nr. 924, prot datë 05.02.2018. Nga auditimi u konstatua se në këtë material nuk ishte dërguar deklarata e cilësisë e titullarit të ISSH në përputhje me Ligjin e MFK. Nga auditimi u konstatua se objektivat e institucionit të përcaktuara në raportin e funksionimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ishin kryesisht të një karakteri të përgjithshëm dhe jo të detajuar, me njësitë përgjegjëse apo afatet kohore, duke evidentuar kështu vështirësi në procesin e monitorimit të progresit të tyre. Nga auditimi u konstatua se pyetësi i vetëvlerësimit të ISSH nuk ka dokumentuar përgjigjet sipas çështjeve, duke cituar edhe dokumentet dhe shkresat përkatëse në varësi të pyetjeve, por është mjaftuar me përgjigje të përgjithshme dhe jo koncize. Gjithashtu konstatohet se në një sërë prej tyre komentet janë bërë duke ju referuar vitit të mëparshëm, duke mos reflektuar vëmendje të mjaftueshme për plotësimin e këtij dokumenti dhe azhurnimin e përgjigjeve për vitin 2017.

Nga auditimi konstatohet se ISSH ka përgatitur Deklaratën e Politikës së Programit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2017 në të cilin është trajtuar misioni i institucionit, objektivat tërësore për vitin 2017 si dhe ato afatmesme, produktet kryesore që do të realizohen, si dhe vizioni institucional.

Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”,



germa a, institucioni **nuk ka hartuar planin strategjik** i cili të përmbajë objektivat strategjike disa vjeçare, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, me njësitë përgjegjëse dhe afatet kohore, si dhe nuk u vumë në dijeni të nisjes së këtij procesi me urdhër përkatës të titullarit. Në dispozicion të grupit të auditimit u vendos “Dokumentin e Politikave të Pensioneve”, përgatitur në vitin 2015, me një kohëzgjatje 3 vjeçare, por ky material ishte kryesisht specifik referuar politikave të pensioneve, dhe jo për planet afatshkurtra dhe afatgjata të ISSH, siç duhet të jetë plani strategjik bazuar në kërkesat e MFK.

Në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 10296 date 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut IV pika 4.2.9 të manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në të cilin përcaktohet se “Çdo Titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin për Menaxhimin Strategjik me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. Grupi për Menaxhimin Strategjik është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike”, ISSH ka miratuarnjë rregullore të veçantë për Grupin e Menaxhimit Strategjik, sipas vendimit nr. 3739/12, datë 05.12.2012 të Kabinetit të ISSH, “Për Ngritjen dhe Funkcionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik”. Me këtë rregullore është përcaktuar përbërja e GMS, aktivitetet dhe çështjet që do ta analizohen, si dhe mbledhjet që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi. Për vitin 2017, ISSH nuk disponon një urdhër për miratimin nga titullari të përbërjes së GMS për vitin aktual. Gjithashtu, konstatohet se mbledhjet e GMS **nuk** janë të dokumentuara me protokolle dhe procesverbale të veçanta, por ato janë zhvilluar së bashku me Bordin Drejtues të institucionit, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të MFK.

Nga auditimi rezultoi se ISSH nuk ka miratuar Gjurmën e Auditimit, në përputhje me udhëzimin 30 të Ministrisë të Financave datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe gjithashtu në lidhje me urdhrin nr. 33 datë 11.07.2013 “Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimet me Vlerë të Vogël dhe të Lartë”, titullari i ISSH nuk e ka përshtatur dhe miratuar urdhrin e Ministrisë së Financave për miratimin e gjurmës së auditit në varësi të nevojave institucionale. Për shkak të karakterit specifik të ISSH, institucioni ka miratuar “Rregullat dhe gjurma e auditit për pranimin e dokumenteve, verifikimin e saktësisë së tyre dhe llogaritjen e caktimit dhe pagimin e përfitimeve”, në të cilin janë parashikuar proceset dhe dokumentacionet e nevojshme në llogaritjen dhe pagesën e pensioneve.

Nga auditimi u konstatua se Auditimi i Brendshëm i ISSH në Raportin dhe Deklaratën për Vlerësimin dhe Funkcionimin e MFK, ka përshkruar gjetjet kryesore të auditimit të brendshëm për vitin e raportimit si dhe rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, por këto gjetje kanë kryesisht të njëjtën tematikë dhe nuk përfshijnë programe të plota auditimi.

Nga auditimi u konstatua se ISSH ka ndërmarrë hapat e nevojshme për identifikimin e risqeve institucionale, duke hartuar kështu Regjistrin e Risqeve në të cilin është kryer dhe adresimi i drejtorisë përkatëse për secilin risk, konform përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Gjithashtu, në përputhje me nenet 10, 11/2, 12/3, 9.4/c dhe 21, të ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ISSH ka hartuar Raportin e Monitorimit, Vlerësimit dhe Menaxhimit të Riskut për vitin 2017. Në lidhje me koordinatorin e riskut, nga auditimi konstatohet se nuk rezultojnë të jetë kryer shkresërisht autorizimi për koordinatorin, por kjo detyrë kryhet nga auditimi i brendshëm. E njëjta gjë vlen edhe për koordinatorin e MFK, ku nga auditimi kjo detyrë nuk rezultojnë të jetë autorizuar dhe të jetë e ndarë nga pozicioni i koordinatorit të riskut.



Sipas kreut III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, në të cilin citohet se : “Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi”, ISSH ka përgatitur pyetësorin e vetëvlerësimit dhe më poshtë rendisim mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i Kontrollit

Sipas nenit 20 të Ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a, institucioni nuk ka hartuar planin strategjik i cili të përmbajë objektivat strategjike disa vjeçare, prioritet e institucionit dhe planet e veprimit, me njësitë përgjegjëse dhe afatet kohore dhe nuk u vumë në dijeni të nisjes së këtij procesi me ndonjë urdhër të titullarit.

1) Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues.

Institucioni nuk disponon një rregullore të miratuar mbi organizimin dhe funksionimin e ISSH, por me vendimin nr.3/2 datë 26.02.2008 është miratuar “Rregullorja e Personelit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, ku disa drejtori të institucionit kanë miratuar rregulloret e tyre në përputhje me aktivitetin specifik që ato disponojnë. Në lidhje me respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, ISSH ka miratuar Kodin Etik me vendimin nr. 3/3 datë 26.02.2008, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Kodi i Etikës”.

ISSH nuk disponon një rregullore të posaçmepër konfliktin e **interesit**, por kjo çështje është trajtuar në pikën 3/a të Kodit Etik të ISSH.

2) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se sipas ligjit nr 7703, datë 11.05.1993 e Sigurimeve Shoqërore, të ndryshuar, neni 74, pika 1 b/1, detyrat e Këshillit Administrativ përfshijnë edhe përcaktimin e strukturës dhe numrit të punonjësve të ISSH. Nga auditimi rezultoi se me vendimin nr. 3/1 , datë 26.02.2008 “Për miratimin e strukturës dhe numrit të punonjësve të institutit të sigurimeve shoqërore”, Këshilli Administrativ i ISSH, në përputhje me projekt rregulloren për përshtetimin e pozicioneve të punës të përgatitur nga Trigano në fund të vitit 2007, ka përgatitur dhe miratuar strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH dhe të Drejtorive Rajonale, ku numri i përgjithshme i punonjësve është përcaktuar të jetë 1153 persona. Nga auditimi rezulton se me VKA nr. 5, datë 20.07.2010 është miratuar organigrama e institucionit, dhe me vendimin nr. 1570 prot datë 11.03.2014, Drejtoresha e Përgjithshme e ISSH ka miratuar strukturën organizative të institucionit dhe numrin e punonjësve, specifikisht 144 punonjës. Në vijim të saj, janë miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH, shtesa në numrin total të punonjësve të ISSH, konkretisht VKA nr. 7, datë 29.04.2015 dhe VKA nr.26, datë 11.12.2015. Për vitin 2017 Drejtorja e Përgjithshme e ISSH



ka funksionuar me 155 persona, sipas urdhrat të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH nr. 955 prot datë 01.02.2017, për shtesë të një pozicioni. Nga auditimi konstatohet se për shkak të mosreflektimit të ndryshimeve në strukturë në Rregulloren e Brendshme të Institucionit, **riskohet të mos garantohet ndarja e qartë e detyrave dhe pozicioneve**, pasi drejtoritë e ISSH kanë funksionuar pa patur një bazë ligjore të miratuar për parashikimin e detyrave dhe përgjegjësive sipas pozicioneve të punës. Për shkak të mangësive dhe periudhës së hershme në të cilën është miratuar rregullorja aktuale e personelit të ISSH, institucioni ka përgatitur draft rregulloren e personelit e cila parashikohet të miratohet në vijim nga KA.

3) Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.

Punonjësit e ISSH trajtohen sipas Kodit të Punës. Institucioni **nuk disponon** rregulla të brendshme të miratuara nga titullari në lidhje me delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

4) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Institucioni **nuk disponon një rregullore të miratuar** për organizimin, funksionimin dhe përshkrimet e punës, ku të jenë përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, etj. Në rregulloren për personelin e ISSH janë përcaktuar procedurat e rekrutimit, trajnimet shkeljet disiplinore, orarin dhe kohën e punës, etj. Nga ana e institucionit është bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, por ato nuk janë të protokolluara për asnjë rast dhe jo gjithmonë janë vendosur në dosjet e personelit. Stafit ka mangësi të mëdha në trajnime, pasi jo të gjithë punonjësit janë përfshirë në programe trajnimi, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin rezultojnë të jenë të dobëta.

2. Menaxhimi i riskut.

Në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 11, “Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë”, pika 2, si dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 “Menaxhimi i Riskut”, si dhe neni 10 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 specifikohet se koordinatori i riskut, duhet të jetë Nënpunësi Autorizues, ose kjo detyrë të delegohet. Në përputhje me të, nënpunësi autorizues i ISSH është Drejtori i Përgjithshëm, z. A. H por përgatitja e dokumentacioneve përkatës është deleguar tek auditit të brendshëm. Ky proces nuk rezulton të jetë dokumentuar me urdhrat përkatës dhe shkresërisht **nuk** rezulton të jetë autorizuar koordinatori i riskut. ISSH ka përgatitur Raportin e Veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2017, ku bashkë me risqet e drejtorisë së auditimit të brendshëm, është dërguar edhe harta e riskut për Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Në këtë dokument është paraqitur përshkrimi i risqeve për çdo drejtor, niveli i risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet si dhe zotëruesi i riskut. Nga auditimi rezultoi se risqet e parashtruar në këto dokumente janë kryesisht të përgjithshëm dhe nuk janë parashikuar masa konkrete për t’u ndërmarrë nga personat përgjegjës sipas drejtorive, në mënyrë që të bëhet dhe ndjekja e tyre. Nga këto dokumente rezulton se një ndër risqet kryesore është ai i informatizimit të institucionit, si dhe garantimi i kapaciteteve të nevojshme për implementimin dhe vënien në zbatim të sistemeve. Gjithashtu, në PBA e miratuara nga ISSH është raportuar se buxheti i ISSH ka veçori edhe në disa tregues, megjithëse me efekte të konsiderueshme financiare, bazohet në parashikime specifike, që bartin edhe risqe e pasaktësi në programim. Këtu evidentojmë parashikimin e numrit të



pensioneve të reja dhe sidomos parashikimin e përfitimit mesatar vjetor të këtyre pensioneve. Pra ISSH, ende nuk ka një bazë të plotë të të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë dhe për pasojë edhe baza e vlerësuar për efekt të përlllogaritjes së pensionit kalkulohet rast pas rasti.

3. Aktivitetet e Kontrollit

Në kuadër të procesit të kontrollit institucional, ISSH ka listuar si njësi përgjegjëse për kontrollin, Drejtorinë e Auditit të Brendshëm e cila gjatë vitit 2017 ka funksionuar me 9 punonjës dhe nga 21 misione të planifikuara, ka realizuar 23 misione auditimi në DRSSH rajonale dhe kanë konkluduar me një dëm financiar në shumën 6,853,799 lekë. Gjithashtu, përgjegjëse tjetër për kontrollin është Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit bazuar në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ku me urdhrin nr. 533 prot datë 19.01.2017, është ngritur kjo strukturë në ISSH. Kjo strukturë, gjatë vitit 2017 ka trajtuar vetëm një rast sipas kërkesës ankimore të Ministrisë së Drejtësisë por nga studimi dhe analiza është dalë në përfundimin se kërkesa nuk përputhej me ndonjë shtetas me gjeratete të njëjta me dërguesin e sinjalizimit. Gjithashtu, në pikën B, të Statutit të ISSH është përcaktuar se instituti do të krijojë një grup të veçantë personash me status të veçantë për të kontrolluar çdo nivel të drejtimit, dhe raportimi do t’i bëhet direkt Drejtorit të Përgjithshëm. Sipas personelit të ISSH, kontrolli i brendshëm i referohet auditit të brendshëm, por edhe ky i fundit **nuk** ka kryer auditim në aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, siç përcaktohet edhe në statut. Kontrolli i dosjeve të pensionit, kryhet nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, e cila bën edhe certifikimin e tyre. Në kuadër të informatizimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, shumica e proceseve të regjistrimit, lidhjes dhe ndjekjes së pensioneve ndiqen nga sistemet informatike.

Nga auditimi u konstatua se në drejtoritë e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH nuk disponohen struktura të mirëfillta kontrolli për auditimin e veprimtarisë së tyre, duke rritur riskun e mos identifikimit të parregullsive që mund të ndodhin gjatë punës së tyre. Përfshirja e auditimit të drejtorive kryesore të ISSH në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, do të siguronte nivel më të lartë të integritetit të të dhënave që ato prodhojnë, duke evidentuar dobësitë e deri tek parregullsitë që mund të ndikojnë në vendimmarrje.

Institucioni **nuk** ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve dhe **nuk** ka të planin e masave për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës.

4. Informim komunikimi.

Drejtuesit e institucionit nuk rezulton të zotërojnë mjaftueshëm informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe të kenë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. ISSH disponon një rregullore të shkruar për qarkullimin e dokumentacionit, vendimmarrjes, etj. Nga auditimi u konstatua se, Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme. Nëpërmjet drejtorive, linjat e komunikimit janë tepër të dobëta, e reflektuar kjo edhe në mungesën e informacionit mbi rregulloret e ISSH, strukturën organizative, manualin e MFK, etj. Nga auditimi rezultoi se Back up-et e sistemeve të ISSH janë të ruajtura në të njëjtën godinë me institucionin, në mospërputhje me VKM nr. 710, dt. 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, duke pasur riskun e humbjes së informacionit në raste katastrofash.

5. Monitorimi.



Në këtë institucion, Drejtori i Përgjithshëm informohet vazhdimisht nga nëndrejtorët e Përgjithshëm, drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve, mujore dhe tremujore. Drejtoritë e ISSH kontribuojnë në përgatitjen e raporteve 4-mujore të monitorimit, të cilat dërgohen në Ministrinë e Financave. Çdo muaj dërgohen të dhëna statistikore nga drejtoritë e ISSH, por nuk përgatiten raporte të hollësishme për detajimin e tyre, Sipas Manualit Kontabël miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave, me shkresën nr. 738/2 datë 14.03.2004, është përcaktuar skema financiare dhe periodiciteti i paraqitjes së raporteve, sipas së cilës do të informohen drejtuesit ekzekutivë për mbarëvajtjen institucionale. Nga auditimi konstatohet së raportet e përcaktuar në manualin kontabël të ISSH, **nuk** janë përgatitur nga drejtoritë përgjegjëse dhe si pasojë ky informacion **nuk** është shpërndarë në drejtoritë e tjera, sipas llojeve të raporteve dhe afateve përkatëse, duke reflektuar kështu një nivel të ulët të bashkëpunimit institucional .

Drejtoria e Përgjithshme e ISSH nuk auditohet nga Auditi i Brendshëm i ISSH, por vetëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe **nuk** është audituar nga auditi i brendshëm dhe as nga një kompani ndërkombëtare e specializuar në 5 vitet e fundit, siç përcaktohet në Statutin e Institucionit.

DREJTIMI II/3-b : Mbi vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit

Titulli i çështjes:

Funksionimi i sistemeve të MFK-së

Gjetja 9:

Mangësi në komponentët dhe dokumentacionet e MFK

Situata:

Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u konstatua se, nuk është vepruar plotësisht në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe me ato të Manualit Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për sa vijon:

-në raportin e kontrollit të brendshëm të ISSH dhe pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2017, mungonte deklarata e cilësisë së titullarit si dhe u identifikuan mangësi dhe pasaktësi në përgatitjen e Pyetësorit të Vetëvlerësimit;

-nuk ishte kryer një delegim i dokumentuar mbi përgjegjësinë lidhur me përzgjedhjen e koordinatorit të riskut dhe të MFK në ISSH;

-ISSH nuk dispononte rregulloren për delegimin e detyrave, konfliktin e interesit, gabimeve, etj; ISSH nuk kishte përgatitur planin strategjik dhe vjetor lidhur me veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme;

-nuk ishin dokumentuar mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik;

-ISSH nuk kishte miratuar gjurmët e auditimit;

-paraqiten mangësi lidhur me dokumentimin e raportimit dhe shpërndarjes së informacionit nëpërmjet strukturave.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manuali Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Udhëzimi 30 i Ministrit të Financave datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, urdhri nr. 33 datë 11.07.2013 “Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimet me Vlerë të Vogël dhe të



Lartë” dhe Manuali i Kontabilitetit.

Ndikimi/Efekti:	Mangësi në mjedisin e kontrollit, sistemet e kontrollit të brendshëm, linjave të raportimit dhe menaxhimit institucional.
Shkaku:	Mos marrja e masave nga ana e titullarit dhe drejtuesve për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen dhe miratimin e dokumentacioneve në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.
Rekomandime:	Strukturat drejtuese të ISSH të marrin masat e nevojshme për përzgjedhjen e koordinatorit të riskut dhe të MFK në ISSH, forcimin e gjurmëve të auditimit nëpërmjet dokumentimit të mbledhjeve të GM-së, si dhe përgatitjen e rregulloreve për forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke reflektuar kërkesat që burojnë nga ligji për menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Afati për zbatimin e rekomandimit:	Brenda vitit 2018

III. Auditimi i Pasqyrave Financiare në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

1. Auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të ISSH

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), përfshijnë: Bilancin, Pasqyra e burimeve dhe shpenzimeve lidhur me investime për vitin 2016, lëvizjet e disponibiliteteve për vitin 2016, gjendjen dhe ndryshimet e Aktiveve të Qëndrueshme (Vlera bruto 2016), Pasqyrën e amortizimeve, pasqyrën e lëvizjes së fondeve 2016, numrin e punonjësve dhe fondin e pagave për vitin 2016 si dhe, aktrakordimi i ISSH me Degën e Thesarit Tiranë, i mbajtur më datë 20.01.2017.

Në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM nr.161, datë 11.04.1994 “Për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, dhe Rregullores Financiare të ISSH të miratuar me vendimin e Këshillit Administrativ nr.5, datë 25.5.2009, zbatimi i buxhetit, evidentimi i veprimtarisë financiare, mbajtja e kontabilitetit dhe konsolidimi i llogarisë vjetore, realizohet në **14 njësitë** e sistemit, pra 12 Drejtoritë Rajonale, Drejtoria Qendrore e Arkivit dhe Njësia e Zbatimit të Buxhetit Administrativ të Aparatit të ISSH (Sektori i Buxhetit të Brendshëm).

Për marrëdhëniet financiare të ISSH me Ministrinë e Financave, me Bankën e Shqipërisë, me Degën e Thesarit Tiranë nga njëra anë dhe shpërndarjen e fondeve në 14 njësitë e mësipërme, të destinuara për kryerjen e pagesave të përfitimeve dhe për administrimin e përgjithshëm, funksionon në këtë institucion një njësi e veçantë koordinuese “**Sektori i Buxhetit të Përgjithshëm**”, sektor i cili është në varësi të Drejtorisë Financiare të ISSH. *Në lekë*

Muaji	Të ardhura ISSH Viti 2017 (lekë)		Total të Ardhura	Total Shpenzime në lekë	Humbje/Fitim
	Të ardhura ISSH	Financime nga Buxheti			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Janar	4,507,382,401	4,650,000,000	9,157,382,401	8,644,923,548	512,458,853
Shkurt	5,339,962,727	2,880,000,000	8,219,962,727	8,752,154,894	-532,192,167
Mars	6,900,736,968	3,660,000,000	10,560,736,968	9,613,416,056	947,320,912
Prill	5,022,420,464	4,760,000,000	9,782,420,464	9,409,174,026	373,246,438
Maj	5,797,107,834	3,600,000,000	9,397,107,834	9,740,676,361	-343,568,527
Qershor	6,849,959,171	3,670,000,000	10,519,959,171	10,029,987,976	489,971,195
Korrik	5,812,467,301	4,900,000,000	10,712,467,301	9,930,462,100	782,005,201
Gusht	7,627,378,539	2,150,000,000	9,777,378,539	10,808,585,508	-1,031,206,969
Shtator	5,084,008,218	4,410,000,000	9,494,008,218	9,973,283,020	-479,274,802
Tetor	6,378,659,923	4,230,000,000	10,608,659,923	9,873,782,337	734,877,586
Nëntor	5,865,349,673	4,000,000,000	9,865,349,673	9,211,773,554	653,576,119
Dhjetor	8,370,823,637	5,795,000,000	14,165,823,637	13,093,043,244	1,072,780,393
Totali	73,556,256,855	48,705,000,000	122,261,256,855	119,081,262,626	3,179,994,232

Në Aneksin 1, gjeni tabelën fiskale të ISSH ku konstatojmë se “Të Ardhurat” dhe “Shpenzimet” kuadrojnë më vlerat sipas zërave reflektuar në Formatin 3/1, dhe Formatin 3/2 të Pasqyrave Fianciare të ISSH. Pra tabela fiskale, si bashkim i të gjitha rakordimeve me Drejtorinë e përgjithshme të Tatimeve, Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe me të gjitha njësitë e varësisë, është e barabartë me analizat e bilancit përmbledhës. Pasqyra përmbledhëse e llogarive është dorëzuar në Ministrinë e Financës me shkresën nr. 2403, datë 26.03.2018, me të gjitha pasqyrat e plotësuara dhe relacionin shpjegues të saj. Më poshtë po paraqesim llogaritë përmbledhëse, të aktivit, pasivit dhe pasqyrat shoqëruese përmbledhëse.

Llogaritë sintetike që përbëjnë **Aktivin** e bilancit per dy vitet e njëpasnjëshme ushtrimore 2017 dhe 2016, rezultojnë si më poshtë:

Në lekë

Nr. i Llogarisë	Emërtimi i llogarive të Aktivit	Viti ushtrimor	Viti mëparshëm
		2,017	2,016
	AKTIVE TË QËNDRUESHME	1,446,686,144	1,530,455,510
20, 230	Të pa trupëzuara	56,900,962	69,719,529
202	Studime dhe kerkime	312,000	312,000
203	Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme	146,700,111	146,700,111
209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara (-)	(90,111,149)	(77,292,582)
21, 23, 24,28	Akt. të Qëndrueshme të Trupëzuara	1,389,785,182	1,460,735,981
210	Toka, Troje , Terrene	29,151,123	29,151,123
212	Ndërtime e Konstruksione	1,025,210,438	1,013,956,621
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	3,922,829	3,922,829
214	Instalime teknike, makineri, pajisje vegla pune	317,955,408	319,009,649
215	Mjete transporti	60,207,221	63,017,721
218	Inventar ekonomik	745,690,292	751,516,679
219	Amortizimi Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara	(792,352,128)	(728,753,829)
231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		8,915,188
25,26	Aktive Financiare	-	-
	AKTIVE QARKULLUESE	27,879,134,728	24,541,967,077
Klasa 3	Gjendja e inventarit	45,553,454	54,080,424
31	Materiale	12,971,101.71	17,400,024.26
35	Mallra	32,582,352.47	36,680,400.04
Klasa 4	Kërkesa arkëtimi mbi debitorët	13,125,921,948	13,314,103,388
409	Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore	-	1,053,527
411-418	Klientë e llogari të ngjashme	30,961,613	2,823,633
423-429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	3,788,673	3,793,093
44	Inst. të tjera publike (Thesari – Banka e Shqipërisë)	691,065,672	546,154,084
45/2	Marrëdhënie me Postën e Shqipërisë	569,472,899	825,166,385
Të tjera kl. 4	Të tjera kërkesa debitorë	6,742,028,914	6,863,523,362
468	Debitorë të ndryshëm	27,762,659	57,569,552
471	Përfitime për tu paguar	5,060,841,518	5,014,019,752
50,59	Llogaritë financiare	14,707,659,326	11,173,783,265
50	Letrat me vlerë të vendosjes	7,055,640,000	4,650,520,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

520	Llogari në bankë	7,651,990,420	6,523,104,029
512	Disponibilitete në thesar	-	-
531	Llogari në arkë	28,906	159,236
64	LLOGARI TË TJERA AKTIVE	-	-
66	Shpenzime për tu shpërndarë në disa ushtrime	-	-
85	REZULTATI I USHTRIMIT (saldo debitore)	1,161,632,380	228,462,388
	TOTALI I AKTIVIT	30,487,453,253	26,300,884,975

Nga sa vihet re, Aktivet e Qëndrueshme zënë rreth 7% të total aktivitetit, ndërsa Aktivet Qarkulluese zënë 93%. Rreth 99.8% të Aktiveve të Qëndrueshme të Patrupëzuara, e zë llogaria 203 “Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme”, e cila paraqitet në vlerën 146,700,111 lekë më datë 31.12.2017. Kjo shumë, që përfaqëson sistemet e IT-së, i përket:

- ISSH (Aparati) për vlerën 58,107,600 lekë; dhe
- Njësisë së Arkivës për vlerën 88,592,511 lekë.

Kemi marrë në shqyrtim aktivet e qëndrueshme të Aparatit të ISSH, të cilat do të trajtohen në mënyrë më të detajuar në pikën b) të këtij kapitulli. Vlera e Aktiveve të Qëndrueshme të Aparatit zë rreth 40% të total Aktivitetit të Qëndrueshëm në nivel të konsoliduar: Në lekë

Nr.	Nr. Llog.	E M E R T I M I	I Konsoliduar	APARATI	Pesha specifike
1		I. TE PA TRUPEZUARA	147,012,111	58,107,601	40%
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			
3	202	Studime dhe kerkime	312,000		
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	146,700,111	58,107,601	40%
5		II. TE TRUPEZUARA	2,182,137,310	487,591,351	
6	210	Toka,troje, Terene	29,151,123		
7	211	Pyje,Kullota Plantacione			
8	212	Ndertime e Konstruksione	1,025,210,437	132,088,703	13%
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujqore	3,922,829		
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	317,955,408		
11	215	Mjete transporti	60,207,221	21,089,918	35%
12	216	Rezerva shtetore			
13	217	Kafshe pune e prodhimi			
14	218	Inventar ekonomik	745,690,291	334,412,730	45%
17	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			
18	28	Caktime			
19		T O T A L I (I + II)	2,329,149,421	545,698,952	23%

Aktivitet Qarkulluese për vitin 2017 rezultuan në shumën rreth 27,879 milion lekë, pra rreth 3,109 milionë lekë më shumë se një vit më parë (ose rritur me 13%). Aktivitet Qarkulluese përbëhen nga klasa 3 “Llogaritë inventariale” në shumën 45 milionë lekë (ose rreth 0.2% e total Aktiveve Qarkulluese); nga klasa 4 “Kerkesa arketimi mbi Debitoret” në shumën 13,126 milionë lekë (ose rreth 47% të total Aktiveve Qarkulluese, si dhe nga llogaritë 50 dhe 520, që zënë rreth 53% të totalit të Aktiveve Qarkulluese. Në mënyrë më të detajuar ky informacion jepet sipas tabelës së mëposhtme: Në lekë

AKTIVE QARKULLUESE	Viti 2017	Viti 2016	Ndryshimi	Varianca e zërit	Pesha specifike
I.Gjendja e Inventarit	45,553,454	54,080,424	8,526,970	16%	-100%
Materiale	12,971,102	17,400,024	(4,428,923)	-25%	-52%
Mallra(Libreza)	32,582,352	36,680,400	(4,098,048)	-11%	-48%
II.Kerkesa arketimi mbi Debitoret	13,125,921,948	13,314,136,398	(188,214,450)	-1%	100.0%
Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	-	1,053,527	(1,053,527)	-	0.6%
Kliente e llogari te ngjashme	30,961,613	2,823,633	28,137,980	997%	-14.9%
Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	3,788,673	3,793,093	(4,420)	0%	0.0%
Te drejta e taksa per t'u derdhur ne shtet	-	7,609	(7,609)	-100%	0.0%
Sigurime Shoqerore	-	22,303	(22,303)	-100%	0.0%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shqërore”

Sigurime Shendetesore	-	3,098	(3,098)	-100%	0.0%
Institucione te tjera publike(B SHQIP)	691,065,672	546,154,084	144,911,588	27%	-77.0%
Marrdh. me instit.jashte sistemi(Posta Shqipt.sh.a.)	569,472,899	825,166,385	(255,693,486)	-31%	135.9%
Te tjera kerkesa debitore(Deb Kontr + Perfitimesh)	6,742,028,914	6,863,523,362	(121,494,448)	-2%	64.6%
Debitore te ndryshem	27,762,659	57,569,552	(29,806,893)	-52%	15.8%
Perfitime per t'u paguar	5,060,841,518	5,014,019,752	46,821,766	1%	-24.9%
III.Llogarite financiare	14,707,659,326	11,173,783,265	3,533,876,061		100.0%
Letra me vlere te vendosjes	7,055,640,000	4,650,520,000	2,405,120,000	52%	68%
Llogari ne banke	7,651,990,420	6,523,104,029	1,128,886,391	17%	32%
Llogari ne arke	28,906	159,236	(130,330)	-82%	0%
TOTAL AKTIVE QARKULLUESE	27,879,134,728	24,770,462,475	3,108,672,253	13%	100%
IV. REZULTATI I USHTRIMIT(saldo debitore)	1,161,632,280	228,462,388	933,169,892		

Nga analiza e variancave konstatojmë se variancën më të lartë e paraqesin llogaritë 411-418, të cilat gjatë vitit 2017 janë shtuar me rreth 28 milion lekë (ose 997% në krahasim me vitin 2016). Kjo llogari njëkohësisht zë rreth 15% të total klasës 4. Duke konsideruar luhatjen, grupi i auditimit analizoi këtë llogari për të vlerësuar nëse ky aset ekziston dhe nuk ka mbivendosje (pohimi mbi ekzistencën); për të vlerësuar të drejtat që ISSH ka mbi këtë aset; për të verifikuar regjistrimin e tyre me vlerën e tyre të plotë (plotësia); dhe regjistrimi i tyre në periudhën e duhur (cut-off). Nga auditimi u konstatua se, llogaria “ Klientë e llogari te ngjashme” është shtuar me shumën 28,137,980 lekë, impaktin më të madh në të cilin e ka sistemim që i është bërë llogarisë 468 “Debitore te ndryshem” në Bilancin e Aparatit të ISSH. Konkretisht Vlera e sistemuar është 29,262,163 lekë³³ për të cilën është kredituar llogaria 468 për shumën 29,262,163 lekë në debi të llogarisë 411.

Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Llogaritë e Pagueshme dhe ato të Arkëtueshme mes njërive shpenzuese dhe Aparatit duhet të eliminohen.

Shuma e reflektuar në llogarinë 468 konsiston në librezave të kontributeve që Aparati ka shpërndarë në Rajonet e Sigurimeve Shqërore e që këta të fundit ua klientëve. Në kuptimin e të drejtave që ISSH ka për këtë aset, vlerësojmë se në pasqyrat e konsoliduara ky

zë **nuk** duhet reflektuar me kundërparti shumën repsketive në llogarinë 401-408 “Klientë e llogari të lidhura me to”.

Llogaria 44 “Institucione të tjera publike (BSH)”, në vlerë prej **691,065,672 lekë**, e cila përbëhet nga:

-Diferenca e pa derdhur e kontributeve të rakorduara me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në vitin 2011³⁴, në vlerë 275,495,272 lekë dhe pa derdhur nga Ministria e Financës edhe deri në këtë periudhë kur po auditojmë;

-Diferenca e pa derdhur e kontributeve të rakorduara³⁵ me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në vitin 2017 dhe e derdhur në janar të vitit 2018, nga Ministria e Financës është 415,570,400 lekë³⁶. Diferenca e pa derdhur e kontributeve të rakorduara me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që në vitin 2011, në vlerë 275,495,272 lekë dhe pa derdhur nga Ministria e Financës ka një procedurë interesimi nga ky institucion, disa shkresa drejtuar ministrisë së Financave, por deri më sot kjo shumë ende nuk është sistemuar. Nga auditimi u konstatua se, me shkresën nr.3158,

³³ Per to kemi listen analitike sipas rajoneve dhe vlera e sistemuar eshte rreth 29,262,163.57 leke.

³⁴ Korrespondenca në vijim të shkresës me nr. Prot. 4760, datë 02.06.2015 që ISSH I dërgon Drejtorisë së Thesarit

³⁵ Akt rakordimi datë 23.02.2018 nënshkruar mes ISSH, Sektorit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit në Ministrinë e Financave dhe Sektorit të Llogarisë Unike të Thesari.

³⁶ Evidenca: Dokumenti I Rakordimit për transferimet dhe arkëtimet nga TSA për të ardhurat nga kontributet, mes ISSH dhe Ministrisë së Financave



datë 29.07.2014, FSDKSH i drejtohet ISSH me kërkesën për xhirimin e shumës 215,495 mije lekë, që i përgjigjet pjesës së mbetur të detyrimit të sipërshënuar, kjo si detyrë për arkëtim, rekomanduar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Historikun e lindjes së detyrimit ISSH, e shpjegon në shkresën drejtuar MoF, si më poshtë:

“Deri në mars të vitit 2013, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, derdhen në llogarinë e konsoliduar të të ardhurave (TSA), së bashku, por të personalizuar si kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pra të ndara nga të ardhurat e tjera. Ato i janë transferuar ISSH-së me urdhër të Drejtorisë së Thesarit pranë MoF, në llogarinë e unifikuar të kontributeve, të çelur për këtë qëllim pranë Bankës së Shqipërisë dhe më tej ISSH, transferon (xhiron) në llogaritë e ISKSH shumat e kontributeve të sigurimeve shëndetësore të derdhura për llogari të saj.

Identifikimi fillestar i shumave të kontributeve shëndetësore, ndaj totalit transferues, bëhet duke ndarë proporcionalisht kontributin, bazuar në normën e kontributit, dhe në fund të muajit, diferencat xhirohen sipas evidencës së kontributeve, të hartuar nga DPT dhe e rakorduar midis institucioneve. Në fund të vitit, bazuar në të dhënat përfundimtare të DPT, ISSH dhe ISKSH hartohen akt rakordimin për njohjen e detyrimeve të palëve dhe xhirimin e shumave të kontributeve të pa derdhura. Këto procedura ishin të përcaktuara me udhëzim të Ministrit të Financave. Aktualisht zbatohet e njëjta procedurë e identifikimit të kontributeve, por tashmë xhirimi i shumave sipas institucioneve, bëhet me autorizim të Drejtorisë së Thesarit pranë MoF, veças për çdo institucion. Sa sipër, sipas evidencës përfundimtare të kontributeve të akumuluar, hartuar nga DPT, si dhe të dhënave përfundimtare të nxjerra nga sistemi informatik i MoF evidenca RCM, realizohet edhe evidentimi në bilancet e institucioneve. Sipas evidencave të sipërshënuara (RCM – DPT), shuma e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimeve shëndetësore të akumuluar për periudhën 01.01.2011 deri në 31.12.2011 ishte 51,526.5 milionë lekë³⁷, nga të cilat 6,357.5 milionë lekë është shuma e akumuluar e kontributeve të sigurimeve shëndetësore.

Mbi bazën e këtyre të dhënave dhe dokumenteve, ISSH ka hartuar bilancin financiar në versionin ACC, si dhe ka ndërtuar akt akordimet, e ka njohur detyrimin ndaj ISKSH. (bashkëlidhur gjendet fleta e fundit e raportit të nxjerrë nga sistemi i administrimit financiar të MoF raporti RCM, raporti për kontributet e realizuara për vitin 2011 sipas rretheve, subjekteve dhe llojit, nxjerrë nga DPT, akt rakordomi për kontributet e derdhura i mbajtur midis ISSH dhe ISKSH).

Ashtu siç është përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave, autorizimi dhe xhirimi ditor i shumave të kontributeve të akumuluar, nga llogaria e konsoliduar e Qeverisë TSA, në llogarinë e unifikuar të kontributeve në administrim të ISSH, si edhe aktualisht, është bazuar në evidencën e lëvizjes së llogarisë në bazë likuiditetesh (CASH), e cila në periudhën 01.01.2011 deri në 31.12.2011 për llogari të vitit 2011, rezulton të ketë të akumuluar 51,251 milionë lekë dhe të xhiruara në llogaritë e ISSH për 51,063.6 milionë lekë. Pra kanë mbetur në llogarinë e Qeverisë, për t'u xhiruar në vitin 2012, vlera prej 187.4 milionë lekë. Për shumën 187.4 milionë lekë, autorizimi nga thesari është dhënë dhe kalimi në llogaritë e ISSH, është realizuar në muajin janar 2012.

³⁷ Burimi: RCM dhe Evidenca vjetore e kontributeve nga DPT



Por, nga sa konstatohet më sipër, evidenca e akumulimeve (RCM³⁸ evidenca e tatimeve), me evidencën e lëvizjes së likuiditeteve, nuk janë të barabarta për shumën 275.5 milionë lekë, pra (51,526.5 milionë lekë -51,215 milionë lekë), shumë e cila ka mbetur dhe është evidentuar si detyrim i Buxhetit të shtetit ndaj ISSH dhe për pasojë edhe ndaj ISKSH.

Si konkluzion, bilanci financiar i ISSH i vitit 2011, është hartuar dhe pranuar nga Drejtoria e Thesarit në MoF, pasi treguesit janë rakorduar dhe evidentuar në pasqyrën e të ardhurave kontributet e akumuluar të evidentuara, bazuar në shumën e konstatuara, pra në shumën 51,526.5 milionë lekë, nga të cilat 6,357,5 milionë lekë është shuma e akumuluar e kontributeve të sigurimeve shëndetësore. Meqenëse shuma prej 275.5 milionë lekë nuk ishte xhiruar, natyrshëm mbeti si detyrim i Buxhetit të Shtetit për ISSH dhe në vijim mbeti i dokumentuar edhe si një detyrim i ISSH ndaj FSDKSH-së.

Detyrimet e ISSH ndaj FSDKSH në fund të vitit 2011: Bazuar në evidencat e mësipërme, në bilancet dhe akt rakordimet vjetore, në fund të vitit 2011, ISSH i detyrohej Fondit të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në shumën 682,427,433 lekë, nga të cilat kontribute të mbledhura nga DPT dhe të paderdhura në shumën 669,252,048 lekë dhe kontribute të mbledhura nga ISSH nga personat e vetëpunësuar në bujqësi prej 13,175,385 lekë. Në shumën e mësipërme të detyrimit është e përfshirë edhe shuma 275,5 milionë lekë. (akt rakordimi bashkëlidhur, i cili përmban detyrimet në fund të vitit 2010, kontributet e akumuluar, transfertat e bëra gjatë vitit 2011 si dhe detyrimin në fund të vitit 2011).

Gjatë vitit 2012, ISSH ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura, të evidentuara në bilancin e vitit 2011, duke lënë si gjendje të pa likuiduar shumën prej 275.5 milionë lekë, e cila me gjithë kërkesat verbale të bëra, nuk është xhiruar edhe aktualisht. Gjatë vitit 2013 nga ISSH, në momentin e ndarjes së procedurave të xhirimit të kontributeve të mbledhura, i ka xhiruar ISKSH vlerën 60 milionë lekë, të cilat kanë pakësuar detyrimin e sipërshënuar, por që mbeten si detyrim i buxhetit ndaj ISSH.

Duke qenë se shuma e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të akumuluar në vitin 2011, është konstatuar dhe raportuar në raportin e Ministrisë së Financave “Treguesit Fiskale sipas Buxhetit të Konsoliduar” në atë masë që është pasqyruar edhe :

-Në raportet RCM (Pra RCM viti 2011)kontribute për FSDKSH dhe ISSH, janë të dhënat e faqes së fundit, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nxjerrë nga sistemi i menaxhimit financiar të asaj Ministrie, në vlerë 51,526,531.077 lekë);

-Në evidencat e DPT_(Evidenca vjetore e kontributeve nga DPT për vitin 2011 është 51,527,272 lekë, e ndarë për sigurime shoqërore për 43,670,869 lekë, sigurimi shëndetsor për 6,357,506 lekë, sigurimi suplementar për 637,857 lekë dhe kamat vonesa e gjoba për 861,040 lekë). Lëvizja e llogarisë në një evidencë përmbledhëse³⁹,sipas lëvizjes së likuiditeteve në ISSH, paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

Viti	Gjendja në fillim vitit	Të ardhurat e vitit	Transferuar në llog. spec.	Gjendja në fund
31.12.2010	260,688	48,148,357	48,264,358	144,687
31.12.2011	144,687	51,251,036	51,208,287	187,436
31.12.2012	187,436	53,106,945	53,250,811	43,570

Lëvizja e llogarisë në një evidencë përmbledhëse, sipas lëvizjes së likuiditeteve në FSDKSH,paraqitet si vijon:

Në mijë lekë

³⁸RCM – Report of Cash Management

³⁹Burimi: Korrespondenca mes ISSH dhe Ministrisë së Financave, shkresa nr. 4760, datë 02.06.2015



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Viti	Gjendja në fillim vitit	Të ardhurat e vitit	Transferuar në llog. spec.	Gjendja në fund
31.12.2013	0	6,904,575	6,484,000	420,575
31.12.2011	420,575	4,565,881	4,721,000	265,456

Shënim: Deri në vitin 2013, burimi për evidentimin e të ardhurave ishte evidenca e Bankës së Shqipërisë, nga viti 2013 e në vazhdim, të ardhurat konfirmohen në fund të muajit nga sektori i financës në ISSH.

Xhirimi i shumës së mësipërme si detyrim ndaj ISSH, është kërkuar verbalisht dhe me email, drejtuar Drejtorisë së Thesarit. Gjithashtu zyrtarisht detyrimi midis palëve është kërkuar edhe me shkresën e ISSH nr. 9412, datë 26.11.2013 “ Mbi problematiken për detyrimet e ISSH dhe ISKSH” drejtuar atij Instituti si dhe Ministrisë së Financave.

Llogaria 45/2 Marrdhënie me institucione jashtë sistemit/Posta Shqiptare, në fund të vitit 2017, gjendja e paradhënies⁴⁰ në **Postën Shqiptare** në aktiv të bilancit për shërbimin e ofruara për pagimin e pensioneve, sipas marrëveshjes midis ISSH dhe Postës nr.4537/1932, datë 21.08.2008, është në vlerë 569,473 mijë lekë. Për vitin 2017, marrëdhëniet me Postën Shqiptare, evidentohen si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

Emërtimi	Shuma
Gjendja e paradhënies në fillim të periudhës	824,167
Dhënie paradhënie gjatë periudhës ushtrimore	106,770,831
Shpenzime të njohura nga paradhënia	-107,025,525
Gjendje paradhënie në fund të periudhës	569,473

Pra paradhënia, dhënë postës shqiptare është në fund të vitit 2017, rreth 31 % më pak se një vit më parë, sepse në vitin 2017 shpërblymi i fund vitit të pensionistëve ishte dy herë më pak se ai i vitit 2016. Shërbimi i pagesave të pensioneve realizohet nga agjenti Posta Shqiptare në zbatim të marrëveshjes nr. 4357, datë 21.08.2008 midis ISSH dhe Postës Shqiptare, i ndryshuar. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, për përmirësimin dhe lehtësimin e shërbimit të përfituesve vijuar puna për dixhitalizimin e sistemit të pagesave dhe të kontrollit të pagesave. Konkretisht, deri në fund të vitit 2017 pagesat dhe kontrolli i pagesave kryhet nëpërmjet sistemit të informatizuar në të gjitha qendrat e pagesës në Qytete si dhe në disa qendra të banuara në fshatra. Ndërkohë, realizohet kontrolli tërësor i pagesave edhe për qendrat e pa informatizuara në të cilën çdo pagesë e dokumentuar në mandat pagese të plotësuar me dorë, shkarkohet e kontrollohet në sistem sipas skemës që do të sqarohet te pjesa e shpenzimeve⁴¹.

Llogaria 14/1 “Të tjera kërkesa debitorë”, në vlerë 6,742,029 mijë lekë, e cila është rritur me rreth 2% krahasuar me një vit më parë (variancat nga viti në vit pothuajse janë të pandryshueshme). Kjo vlerë përbëhet nga debitorë për përfitime në vlerën 6,148,630 mijë leke⁴² dhe debitorë për kontribute në vlerën 593,399 mijë lekë. Nga analizat e të dhënave, mbështetur në akt-detyrimet tip të rajoneve sa i takon debitorëve për përfitime, gjendja në fillim të vitit, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit, si dhe gjendja në fund paraqiten në tabelën e mëposhme: *Në mijë lekë*

	Lloji i përfitimit	Gjendja në fillim të vitit		Shtuar gjatë vitit		Paksuar gjatë vitit		Gjendja në fund të 2017	
		Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma
1	Pensione Pleqerie	7,622	5,010,645	2,384	545,478	2,507	770,893	7,437	4,776,895

⁴⁰Evidenca: Akt rakordimi datë 08.01.2018 mes ISSH dhe Postës Shqiptare

⁴¹Referoju Aneksit 6

⁴²Evidenca: Janë verifikuar dosjet nga inspektime fizike të Drejtorisë së Financës në ISSH. Grupi I auditimit, për të verifikuar rezultatet e këtyre inspektimeve, përgjodhi në mënyrë rastësore shkresën nr. 6026/3, datë 24.07.2017 mbi inspektimin në DRSSH, Vlorë, shkresën 6026/1, datë 24.07.2017 mbi inspektimin në DRSSH, Korçë, ku njëzia e Financës së ISSH shprehet se: “Debitorët janë evidentuar saktë si në kontabilitet ashtu edhe në sistemin e pensione”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

2	Pensione Invalidite	884	232,430	548	42,445	869	151,636	612	130,662
3	Pensione familjare	479	150,339	368	53,771	356	28,744	514	176,277
4	Trajtime te vecanta	2,896	1,090,325	1,038	172,421	1,123	263,690	2,814	1,001,244
5	Kompensime	67	6,501	58	10,132	44	6,469	70	10,164
6	Te tjera	499	47,306	86	15,227	72	6,958	505	53,387
	Shuma	12,447	6,537,546	4,482	839,474	4,971	1,228,390	11,952	6,148,630

“Debitorëve për kontribute e kamat vonesa”, në fillim të vitit ishin në vlerën **325,978 mijë lekë**. Debitorët për kontribute janë subjektet me detyrime të prapambetura, të cilët kanë përfituar edhe faljen e kamatvonesave të tyre kundrejt disa ligjeve të faljes gjatë periudhës 2004-2014, megjithatë ato ishin debitorë dhe pa shpresë arkëtimi. Subjektet me këto detyrime janë subjekte aktualisht të mbyllura apo pasive të periudhës nga 01.01.1994 deri 31.12.2003. Duke qënë se këto detyrime kishin kaluar mbi 10 vjet nga momenti i krijimit të tyre, mbështetur në Nenin 13 të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore nme Republikën e Shqipërisë të ndryshuar”, ku përcaktohet detyrimi i punëdhënësit për pagesë brënda 5 viteve si dhe për faktin se nuk ka shpresë arkëtimi si edhe listë pagesa që të detyrojnë sigurimet shoqërore të pranojnë periudha sigurimi të individëve, këto detyrime së bashku me subjektet janë hequr nga bilanci kontabël i vitit 2017 dhe janë dokumentuar dhe ndiqen në një listë të veçantë jashtë bilancit. Gjithashtu në zbatim të VKM Nr.77, datë 28.01.2015 " Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të ndryshuar, Pika V “Procedurat e kalimit të kontributeve dhe mbledhja e borxheve”, në paragrafin 5 citohet: “Për personat e vetëpunësuar në bujqësi, shuma e detyrimit kontributiv dhe e kamatëvonesave llogaritet nga organet e sigurimeve shoqërore. Dokument bazë për llogaritjen dhe evidentimin e tij është akt-detyrimi tip, i cili plotësohet nga organet e sigurimeve shoqërore, jo më vonë se tre muaj nga kalimi i afatit ligjor për pagesën e kontributeve ose, përfundimisht, në datën e pagesës së kontributeve. Shuma e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesat evidentohet në kontabilitetin e sigurimeve shoqërore, sipas procedurave të miratuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, janë evidentuar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të vitit 2017 shuma e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatëvonesat që në kohën e hyrjes në fuqi të vendimit deri më datë 31.12.2017, vlera e të cilëve është 472,242 mijë lekë. Ne total gjëndja e debitorëve për kontribute në datën 31.12.2017 paraqitet 593,399 mijë lekë e përbërë nga kontribute 564,959 dhe kamata 28,440 lekë. Debitorët për kontribute e kamat vonesa janë analitikisht me rajone, si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

	Totali	Berat	Dibër	Durrës	Elbas	Fier	Gjiroka	Korçë	Kukës	Lezhë	Shkodër	Tiranë	Vlorë
Kontr	564,959	114,162	17,206	67,786	27,857	148,913	37,587	51,810	1,337	14,735	40,246	27,717	15,603
Kamat	28,440	28,440	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shuma	593,399	142,602	17,206	67,786	27,857	148,913	37,587	51,810	1,337	14,735	40,246	27,717	15,603

Siç shikohet nga tabela e mësipërme, Fieri mbart rreth 26% të gjithë shumës së debitorëveka rajoni i Beratit me 114,162 mijë lekë kontribute dhe 28,440 mijë lekë kamatëvonesa. Vlera e debitorëve të krijuar nga mos derdhja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore në afat për vitet 2016-2017 dhe ndryshimi midis tyre paraqitet I detajuar në piken 1, “Kontributet (të ardhurat) e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve (DPT)”.

Llogaria 471 “Përfitime për t'u paguar”, në vlerë **5,060,841 mijë lekë**, (me kundërparti llogarinë 4 në pasiv 67/2 “Detyrime (Kreditorë për përfitime të patërhequra)”, e ndarë me rajone



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

dhe është e analizuar për çdo rajon dhe për çdo lloj shtese përfitimi, rezulton si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Rajonet	Përfitime për t'u paguar për pensionet				Përfitimet e suplementarit	Gjithesëj përfitimet
	Gjendja	neni, 33,38,39	Shtesat	Shuma pensioneve		
1	3,322,868	8,426	306,990	3,638,284	112,594	3,750,878
2	766,683	1,439	68,295	836,417	25,709	862,126
3	354,474	502	29,919	384,895	10,113	395,008
4	47,785	95	3,613	51,493	1,336	52,829
Shuma	4,491,810	10,462	408,817	4,911,089	149,752	5,060,841

Nga auditimi mbi llogaritë e **Pasivit**⁴³ të bilancit, rezultoi se për vitin 2017, ky zë paraqitet në shumën 30,487,453,252 lekë dhe përbëhet nga llogaritë e klasës 10 “Fondet e veta” në masën 44%, llogaritë e klasës 4 “Detyrime afatshkurtër” në masën 40%; llogari të tjera 2%, dhe llogaria 85 “Rezultati I ushtrimit) në masën 14%. Sa i takon llogarive të klasës 10, rreth 89% të total vlerës e zënë: Fondi Rezervë në masën 7,056 milion lekë (ose rreth 52% e fondeve te veta); dhe Rezultati i Mbartur në shumën 5,004 milion lekë (ose rreth 37% të fondeve të veta).

Llogaria 12 “**Rezultati i Mbartur**” është kundërpartit e llogarisë 471 “Përfitime për tu paguar”. Gjendja e pensioneve të patërhequra nga llogaria 471 deri më 31.12.2017 rezultoi 5,060,841,581 lekë, ndërsa në rezultatit e mbartur vlera paraqitet 5,004,051,686 lekë (me një diferencë prej 56,789,895 lekë, vlerë e cila është parashikuar të mbyllet nga rezultati ushtrimor 2017⁴⁴).

Mbi auditimin e Pasivit të Bilancit Kontabël:

Llogaria 111 “Fondi Rezervë” paraqitet në vlerën 7,055,663,196 lekë ose shtuar me 1,085,017,068 lekë në krahasim me vitin 2016 (ose 18% më shumë). Kjo shtesë është bërë në zbatim të Vendimit të Këshillit Admisnitativ të ISSH nr. 17, datë 20.12.2017 “Për miratimin e rezultatit financiar të ISSH për vitin 2016”, për kalimin e tepricës së të ardhurave mbi shpenzimet në shtesë të fondit rezervë, duke kredituar llogarinë 111 “Fondi Rezervë” për shumën 1,085,017,068 lekë dhe debituar llogarinë 12 “Rezultati i Mbartur” për të njëjtën shumë. Mbjajtja e një fondi rezervë të sigurimeve shoqërore është detyrim që buron nga neni 70, i ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjendja e llogarive kreditore dhe ndryshimi nga një vit më parë, rezulton si në tabelën e mëposhtme:

në lekë

	Detyrimet afatshkurtra	2016	2017	Diferenca 2017/2016
419	Klientë (Kreditorë), parapagesë pjesore	68,145	181,181	113,036
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	28,601,881	28,010,561	-591,320
421-428	Personeli e llogari të lidhura me to	6,427,323	6,127,856	-299,467
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	10,287,589	7,184,605	-3,102,984
4341	Të tjera operacione me shtetin (kreditor)	133,567	115,804	-17,763
435	Sigurime shoqërore	17,947,439	19,176,073	1,228,634
436	Sigurime shëndetsore	833,416	1,019,079	185,663
44	Institucione të tjera publike	127,457	117,768	-9,689
451	Marrdh. me institucione brenda e jashtë sistemit	6,794,425	5,243,289	-1,551,136
470	Të ardhura për t'u marrë(deb perf/kontrib)	6,866,781,111	6,742,028,914	-124,752,197
467/2	Detyrime (Kreditorë për perfitime të patërhequra)	5,014,019,752	5,060,841,518	46,821,766
466	Kreditorë për mjete në ruajtje (FSDKSH)	222,130,185	221,533,111	-597,074
467	Kreditorë të ndryshëm	25,202,854	27,734,757	2,531,903
	Shuma	12,199,355,144	12,119,314,516	(80,040,628)

⁴³Referoju Aneksit 3

⁴⁴Pas miratimit nga VKA



Nga tabela e mësipërme rezulton që detyrimet që ky institucion u ka të tretëve për vitin 2017, janë më të vogla se një vit më parë për 80,040,628 lekë, ose rreth 0,7% më pak.

Llogaria 466 Kreditorë për mjete në ruajtje (FSDKSH), në mbyllje të periudhës ushtrimore 2017 gjendja e kësaj llogarie rezulton të jetë **221,533 mijë lekë**, ku shuma prej 215,495 mijë lekë në kontabilitetin e Buxhetit të Përgjithshëm, është detyrim i mbartur i llogaritur ndaj FSDKSH-së për shkak të transfertës së munguar nga Thesari i Ministrisë së Financës, në llogari të ISSH-së për shumën 691,065,672 lekë, reflektuar kjo vlerë në llogarinë 44 të Aktivit të Bilancit. Për vitin 2017 marrëdhëniet dhe lëvizjet e fondeve me FSDKSH-në, evidentohen si më poshtë vijon:

Në mijë lekë

Emërtimi	Shuma në mijë lekë
Gjendja e paradhënies në fillim të periudhës	222,130
Dhënie paradhënie gjatë periudhës ushtrimore	67,028
Shpenzime të njohura nga paradhënia	67,625
Gjendje paradhënie në fund të periudhës	221,533

Kjo llogari është pothuajse në të njëjtat nivele si një vit më parë për shkak të mos-derdhjes së detyrimit nga buxheti i shtetit të shumës së analizuar tek llogaria 44 në aktiv “Institucione të tjera publike”, gjë e cila duhet sqaruar dhe sistemuar midis këtij institucioni, FSDKSH-së dhe Ministrisë së Financave.

Mbi auditimin e pasqyrës nr.3/1 “Shpenzimet korrente të ushtrimit për vitin 2017”.

Totali i shpenzimeve është 119,081,262,626 lekë, nga të cilat rreth 98% (ose 116,936,752,842 lekë) janë shpenzimet për pensione, ndërsa 2% janë shpenzime administrative.

Për auditimin e shpenzimeve administrative zgjedhëm të testojmë llogaritë dhe transaksionet e lidhura me to, në Buxhetin Administrativ të ISSH (ose Aparatin

Ndërsa për shpenzimet e pensioneve Drejtoria e Financës në ISSH e merr të konfirmuar vlerën për pjesën e shpenzimeve off-line nga Rajonet, pasi dokumentat mbështetëse ndodhen nëpër Rajone, dhe nga sistemi IT këto të dhëna nuk vijnë në kohë reale.

Për të rritur nivelin e sigurisë për llogaritë që lidhen me shpenzimet e pensioneve në nivel të konsoliduar përzgjedhëm në mënyrë rastësore agjencinë e Fierit, konkretisht muajin nëntor ku në përfundim nuk na rezultuan diferenca. Procesi për këtë kategori shpenzimi paraqitet në Aneksin 5. Në përfundim konkludua se, për të rritur nivelin e sigurisë në nivel pohimi, për zërat respektivë të shpenzimeve në të gjitha rajonet e ISSH nevojitet që:

- Çdo pike postare dhe banke duhet të jete online (jo të gjitha rajonet janë); si edhe
- Informacioni nga IT duhet të përfshijë: (a) Shpenzimet e varrimit, (b) Leje lindjet, (c) karburantin, etj shtesa që përfshihen brenda vlerës totale.

Duke konsideruar se, pikërisht në këtë hallkë të procesit konstatojmë mungesë të kontrollit, përzgjedhëm 266 çështje⁴⁵, nëpërmjet kryerjes së testeve të detajeve, për të verifikuar saktësinë e shifrës së deklaruar, të shpenzimeve për pensione në muajin Nëntor, në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, Fier. Nga kryerja e testeve të detajeve mbi popullatën e përzgjedhur na rezultoi se vlera prej 500,679,072 lekë e njohur si shpenzim në kontabilitet rakordon me të dhënat e gjeneruara nga

⁴⁵Referoju Aneksit 4 për materialitetin; dhe linkut: [Teste Agjencia Fier.xlsx](#)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

sistemi PCAMS (për pjesën online të shpenzimeve), plus 52,919,856 lekë, të cilat janë verifikuar me dokumentat justifikues (raportet e postës⁴⁶) dhe stornuar një nga një nga specialisti i pagesave në Rajon.

Pasqyra nr. 5 “Lëvizja e disponibiliteteve për vitin 2016”, ku likuiditetet në banka janë në celje për 5,452,960 mijë lekë, janë arkëtuar gjatë vitit 6,523,263,264⁴⁷ lekë. Teprica në mbyllje rezulton në shumën 7,952,019 lekë⁴⁸. Flukset hyrëse rezultonë në shumën 74,328,834,583 lekë kontributet dhe 48,705,000,000 si financim nga buxheti (trajtuar më gjerësisht në pikën I.2 të këtij projekt raporti). Pagesa nga të ardhurat për shpenzimet korrente rezulton në shumën 119,066,898,640 lekë e cila rakordon me Shumen e shpenzimeve korrente ne pasqyrën e shpenzimeve. Për të verifikuar saktësinë e kësaj vlere, “përplasëm” të dhënat e financimit nga Sektori I Buxhetit të Përgjithshme në ISSH (daljet), me të dhënat (hyrjet) e rajoneve, si dhe kthimet (hyrjet) në Buxhetin e Përgjithshëm me daljet nga rajonet, nga ku nuk na rezultuan diferenca.

-Rezultati analitik i zbatimit të planit të të ardhurave dhe planit të transfertave në buxhetet e përfituesve, gjenden në pasqyrat 1-1-01 “Seksioni i shpenzimeve për përfitime” dhe 1-2-01 “Të ardhurat sipas subjekteve”. Pasqyrat financiare dhe llogaria vjetore shoqërohet me këto pasqyra të tjera standarde dhe anekse shpjeguese: pasqyrat e të ardhurave e shpenzimeve, të rezultatit financiar e të drejtave dhe detyrimeve, të kapitaleve dhe fondeve, si dhe pasqyrat rakorduese.

III/2. Auditimi i Aparatit të ISSH

a. Mbi planin e buxhetit të Aparatit të ISSH

Nga Aparati i ISSH, si njësi varësie e këtij institucioni është hartuar projektprogrami i vitit 2017, duke respektuar dispozitat ligjore dhe nënligjore në hartimin e buxhetit dhe udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme për hartimin e buxhetit të vitit 2017. Programimi i zerave buxhetore bëhet nga Përgjegjesi i Sektorit të buxhetit të brendshëm, bazuar në realizimin faktit të shpenzimeve, duke iu referuar vitit paraardhës. Programimi i buxhetit për vitin 2017 në të dy fazat e tij, aprovimi dhe realizimi i një viti më parë, është si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Llogaritë	Zërat e shpenzimeve	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Viti 2017		
				Faza e parë	Faza e dytë	Aprovimi buxhetit
600	Paga,shpërblime, dheshpenz.tjerpers	138,122	147,103	146,410	146,009	146,009
6001	Pagapersonel i përhershem	131,077	135,099	133,800	133,800	133,800
6003	Shpërblime personeli	4,140	4,345	5,610	5,209	5,209
6009	Shpenzime të tjera personeli honorare	2,905	7,660	7,000	7,000	7,000
601	Kontr. përsigurimeshoqërore e shënd.	20,840	21,744	21,900	20,900	20,900
602	Mallradheshërbimetëtjera	105,422	109,920	97,996	97,996	97,996
6020	Materialezyredhetëpërgjithshme	11,611	5,567	9,113	9,113	9,113
6022	Shërbime nga të tretë	11,442	11,436	12,936	12,936	12,936
6023	Shpenzime transporti	279	2,297	2,446	2,446	2,446
60241	Udhëtim i brendshëm	10,111	11,266	9,000	9,000	9,000
60242	Udhëtim i jashtëm	5,276	2,397	5,000	5,000	5,000
6025	Mirmbajtje të zakonshme	53,777	53,940	52,860	52,860	52,860
6027	Detyrime dhe kompesime legale	4,883	6,144	2,500	2,500	2,500
6029	Shpenzime të tjera operative	8,043	16,873	4,141	4,141	4,141

⁴⁶[praktika e nje qender paguese poste-sigurime.pdf](#)

⁴⁷E verifikuar me akt-rakordimet me secilen bankë

⁴⁸Verifikuar me akt-rakordimet me secilen banke



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

605	Për organizatat ndërk. dhe të tjera	4,060	1,910	2,085	2,085	2,085
231	Për rritjen e aktiveve të qendr. Të trup	81,971	109,874	0	0	0
	TOTALI SHPENZIME TË APARATIT	350,415	390,552	268,391	266,990	266,990

Shënim: Tabela e hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të mara nga subjekti.

Siç vërehet nga tabela e mësipërme për vitin 2017 nuk është planifikuar në asnjë fazë të tij asnjë fond për investime (artikujt 230 dhe 231), kështu buxheti i shpenzimeve të Aparatit është miratuar nga Këshilli i Administrativ në vlerë 266,990 mijë lekë, nga 390,552 mijë lekë realizuar në vitin 2016. Për buxhetin e brendshëm të Aparatit, plani fillestar, ndryshimet gjatë vitit 2017, realizimi i zërave të shpenzimeve, duke e krahasuar me planin dhe me 2 vite më parë, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Në mijë lekë

Art	Zërat e shpenzimeve	Realizimi		Viti 2017			Diferenca me planin		
		2015	2016	Plani fillestar	Ndrysh	Pl ndrysh	Fakti 2017	Në vlerë	Në %
600	Paga, shperbl. dhe shpenz. tjera pers.	138,122	147,103	146,009	34,610	180,619	163,337	-17,282	-9.6
6001	Pagapersonel i përhershëm	131,077	135,099	133,800	34,610	168,410	151,846	-16,564	-9.8
6003	Shpërblime personeli	4,140	4,345	5,209	0	5,209	4,696	-513	-9.8
6009	Shpenzimet tjera personeli honorare	2,905	7,660	7,000	0	7,000	6,795	-205	-2.9
601	Kontr. per sigurimeshoq.shëndet.	20,840	21,744	20,900	4,300	25,200	24,477	-723	-2.9
602	Mallra dhe shërbimet tjera	105,422	109,920	97,996	43,090	141,086	139,424	-1,662	-1.3
6020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	11,611	5,567	9,113	-6,104	3,009	2,797	-212	-7
6022	Shërbime nga te tretë	11,442	11,436	12,936	-329	12,607	12,416	-191	-1.5
6023	Shpenzimet transporti	279	2,297	2,446	-1,813	633	415	218	-34.4
60241	Udhëtim i brendshëm	10,111	11,266	9,000	4,223	13,600	13,600	0	0
60242	Udhëtim i jashtëm	5,276	2,397	5,000	-3,903	720	720	0	0
6025	Mirmbajtjet e zakonshme	53,777	53,940	52,860	49,666	102,526	102,307	-219	0.2
6027	Detyrimedhekompesimelegale	4,883	6,144	2,500	1,350	3,850	3,851	1	0
6029	Shpenzimet tjera operative	8,043	16,873	4,141	-	4,141	3,318	-823	-19.9
605	Për organizatat ndërk. dhe të tjera	4,060	1,910	2,085		2,085	1,862	-223	-10.7
231	Përrritjen e aktiv. te qendr. Te trup	81,971	109,874	0	746	746	824	78	+4.5
	TOTALI SHPENZIME APARATIT	350,415	390,552	266,990	82,746	349,763	329,925	-19,838	-5.7

Shënim: Tabela e hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të mara nga subjekti.

Gjatë vitit 2017, janë bërë ndryshime (shëna) në buxhet, me shkresa të Drejtorit të Përgjithshëm, në vlerë prej **82,746 mijë lekë**, ose shtuar në masën **31%** të planit fillestar, si më poshtë: -Paga e shtesa (600), për 34,610 mijë lekë, ose 26% më shumë; -Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetsore (601), për 4,300 mijë lekë, ose 20.6% më shumë; -Mallra e shërbime të tjera (602), për 43,090 mijë lekë, ose 44% më shumë; -Për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (231), për 746 mijë lekë, e gjithë vlera e shtuar me ndryshimet.

Ndryshimet e buxhetit administrativ të Aparatit gjatë vitit 2017, në vlerë 82,746 mijë lekë, ose në masë 31% më shumë se një vit më parë, tregon për një program formal në të gjitha fazat e përgatitjes së tij. Nga analiza e shpenzimeve operative (602) nga ndryshimi që pësojnë ato nga viti në vit, rezultojnë se planifikimi i tyre megjithëse është bërë i detajuar, nuk ka mbajtur mirë parasysh nevojat dhe përcaktimin e drejtë të tyre, në mënyrë që ndryshimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit, të jenë sa më të vogla e për ndryshime të domosdoshme.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2017, në vlerë **329,925 mijë lekë**, janë realizuar më pak se plani i ndryshuar për 19,838 mijë lekë, ose 5.7% më pak. Ndërsa me planin fillestar janë realizuar 62,935 mijë lekë, apo 23.6% më shumë se plani fillestar. Duke krahasuar realizimin e këtij viti me 2016 rezultojnë se këtë vit shpenzimet janë më pak për 60,627 mijë lekë, megjithëse shpenzimet për pagat dhe shpenzimet operative janë rritur me rreth 11% dhe 40%, por këtë vit janë ulur në mënyrë të ndjeshme shpenzimet për investime.

Me artikuj ndryshimet nga plani po dhe nga një vit më parë, janë si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Pagat, shpërblime e shpenzime të tjera personeli (**600**), janë realizuar në vlerë 163,337mijë lekë më pak se plani i ndryshuar për 9.6% dhe 11% më shumë se një vit më parë.
- Sigurime shoqërore e shëndetsore (601), janë realizuar në vlerë 24,477 mijë lekë, realizuar më pak se plani i ndryshuar për 2.9% dhe 12.6 më shumë se fakti i një viti më parë.
- Blerje mallrash e shërbimesh (602), janë realizuar në vlerë 134,424 mijë lekë, realizuar më pak se plani i ndryshuar për 1.3% dhe 26.8% më shumë se fakti i një viti më parë.
- Transferta të jashme për organizata ndërkombëtare (605), janë realizuar në vlerë 1,862 mijë lekë, realizuar më pak se plani i ndryshuar për 10.7% dhe 2.% më pak se fakti i një viti më parë.
- Shpenzime për investime (231), janë realizuar në vlerë 824 mijë lekë realizuar më shumë se plani i ndryshuar për 4.5% dhe 133 herë më pak se fakti i një viti më parë.

Trendi i i tre viteve i artikullit 602 “shpenzime per blerje mallrash dhe shërbime”, në mënyrë analitike, pasqyrohet si në tabelën e mëposhme:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	2015	2016	2017	Diferenca 2017-2016	
					Në vlerë	Në %
A	Materiale zyre dhe të përgjithme	11,611	5,567	2,797	-2,770	-49.8
1	Kanceleri	2,437	1,995	2,062	67	3.4
2	Materiapër pastrim, ngrohje, ndricim..	520	442	625	183	41.4
3	Blerje dokumentacion	8,654	3,130	110	-3,020	-96.5
B	Shërbime nga të tretë	11,442	11,436	12,417	981	8.6
1	Elektricitet	7,248	7,351	8,160	809	11.0
2	Ujë	602	525	325	-200	-38.1
3	Shërbime telefonike	1,580	1,367	1,493	126	9.2
4	Posta dhe shërbime korieri	1,061	830	907	77	9.3
5	Komisione të pagesës së përfitimeve	58	63	81	18	28.6
6	Shërbime të printimit dhe publikimit	893	1,300	1,450	150	11.5
C	Shpenzime transportit	279	2,297	415	-1,882	-81.9
1	Karburant dhe vaj	0	2,040	0	-2,040	-100
2	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	153	145	213	68	46.9
3	Shpenzime të sigurimit të mjeteve	109	84	202	118	140.5
4	Shpenzime te tjera transporti	17	28	0	-28	-100.0
D	Shpenzime udhëtimi	15,387	12,508	14,320	1,812	14.5
1	Udhëtim i brendshëm	10,111	10,111	13,600	3,489	34.5
2	Udhëtim i jashtëm	5,276	2,397	720	-1,677	-70.0
E	Mirëmbajtje e zakonshme	53,777	53,940	102,307	48,367	89.7
1	Mirëmbajtje ndërtesash	2,093	4,994	500	-4,494	90.0
2	Mirëmbajtje të rrjetit hidraulik, elektrike	24	84	353	269	320.2
3	Mirëmbajtje e aparateve dhe veglave	50,749	48,322	101,006	52,684	109.0
4	Mirëmbajtje e zakonshme e mjet transport	749	530	405	-125	-23.6
5	Mirëmb. zakonshme e pajisj të zyrës	162	10	43	33	330.0
F	Detyrime dhe kompensime legale	4,883	6,144	3,850	-2,294	-37.3
1	Shper ekzekut e vend gjyq për largim nga puna	4,883	6,144	3,850	-2,294	-37.3
G	Shpenzime të tjera operative	8,043	16,873	3,318	-13,555	-80.3
1	Shpenzime për pritje e përcjellje	228	775	400	-375	-48.4
2	Shpenz. Siguracionin e ndërtesës	5,356	5,000	0	-5,000	-100.0
4	Shpenzime për honorare	1,817	2,048	2,310	262	12.8
5	Shpenz. Pjesëmarrje konferenca, seminare	78	384	107	-277	-72.1
6	Shpenz tatime, taksa paguar për institucioni	101	239	95	-144	-60.3
7	Të tjera materiale dhe shërbime operative	463	8,428	406	-8,022	-95.2
	TOTALI OPERATIVE	105,422	111,831	139,427	27,596	24.7

Shënim: Tabela e hartuar nga grupi i auditimit me të dhëna të mara nga subjekti.

Realizimi i shpenzimeve operative për vitin 2017, është më i lartë se viti 2016 për 27,596 mijë lekë, por në disa zëra shpenzimesh kanë rezultuar ndryshime të mëdha si psh **shtuar** për vitin 2017 krahasuar me një vit më parë këto zëra shpenzimesh operative:



-Mirëmbajtje të zakonshme rezultojnë më shumë se viti 2016 për 48,367 mijë lekë, ose 89.7% më shumë ka rezultuar e tillë për shkak të mirëmbajtjeve të paisjeve dhe të veglave që janë më shumë se një vit më parë për 52,684 mijë lekë, pra më shumë se dyfishi i një viti më parë .

-Shpenzime udhëtimi të brendshëm, rezultojnë më shumë se viti 2016 për 3,489 mijë lekë, ose më shumë 34.5% më shumë.

Ndërkohë rezultojnë **më pak** për vitin 2017, krahasuar me një vit më parë këto zëra shpenzimesh operative:

-Blerje materiale zyre dhe të përgjithme, në vitin 2017, rezultojnë më pak se viti 2016 për 2,770 mijë lekë, ose 50% më pak dhe shumicën e uljes në këtë grup shpenzimesh operative e ka realizuar “Blerje dokumentash” të cilat janë ulur për 28 herë më pak se viti 2016.

-Shpenzime të tjera operative, në vitin 2017 rezultojnë më pak se viti 2016 për 13,555 mijë lekë, ose 5 herë më pak, dhe shumica e kësaj difference është mosbërja e sigurimit të ndërtesës në vlerë rreth 5,000 mijë lekë dhe ulja e shpenzimeve për pritje përcjellje, në vlerë 375 mijë lekë, apo 48.4%.

Nga analiza dhe auditimi i planifikimit dhe realizimit të **buxhetit të Aparatit**⁴⁹ rezultoi se:

-Planifikimi fillestar i shpenzimeve për investime për vitin 2017, ishte zero, kur kontrata e investimit ishte në vazhdim;

-Realizimi i buxhetit administrativ të Aparatit gjatë vitit 2017, është 31% më shumë se një vit më parë, e kjo kryesisht në shpenzimet operative;

-Nga analiza e shpenzimeve operative (artikulli 602) dhe ndryshimi që pësojnë ato nga viti në vit, rezultoi se planifikimi i tyre megjithëse ishte bërë i detajuar, kishte ndryshime të mëdha në zëra të ndryshëm gjatë krahasimit të tyre me realizimin e vitit të kaluar dhe ndryshime të theksuara gjatë fazave të programimit të tyre, në kundërshtim me kërkesat që burojnë nga Udhëzimi i Ministrisë së Financave (UMF) nr.4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019; dhe UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

b. Mbi pasqyrat financiare të Aparatit të ISSH

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

Mbi hartimin dhe plotësimin e pasqyrave financiare në përputhje me UMF nr.14 datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e llogarive vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhim zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006”. si dhe vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

-Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 61 i tij “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, sipas të cilit “...Nëpunësi i parë autorizues dhe nëpunësit autorizues të njësitë të qeverisjes së përgjithshme, përgjigjen për funksionimin e sistemit të kontabilitetit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera në zbatim të tij dhe me udhëzimet e Ministrit të Financave. Metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, për qëllim

⁴⁹ Ky konstatim I është shtuar gjetjes I (si pjesë e procedurave të programimit)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

të këtij ligji, ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës”.

-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në nenin 4 të ligjit, pika 25 “Sistemi i kontabilitetit” dhe në pikën 26 të tij, “Dokument financiar”.

-Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar;

-VKM nr.248, datë 10.04.1998 “Për Miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale, si dhe njësive që varen prej tyre”, të ndryshuar;

-VKM nr.25 datë 20.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.248, datë 10.04.1998”;

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre, si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, të ndryshuar.

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007“Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006”.

-Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar me udhëzimin nr.20, datë 17.11.2014.

Nga auditimi i bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare, për vitin 2017 rezultoi se pasqyrat financiare të përgatitura nga njësia publike janë: pasqyra e pozicionit financiar; pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve; pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/kapital neto; pasqyra e fluksit të mjeteve monetare; pasqyra e bilancit të konsoliduar; pasqyra e të ardhura/shpenzimeve të konsoliduar; shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Bilanci është shoqëruar me relacionin përkatës bashkëlidhur pasqyrave financiare.

Mbi rregullshmërinë e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore dhe raportimit financiar

Pasqyrat financiare të viteve 2017 të hartuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, janë përgatitur në zbatim të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare”, Manualit kontabël dhe Rregullores Financiare të ISSH, si dhe udhëzimeve të Ministrisë të Financave për mbylljen e llogarive vjetore. Informacioni nga pasqyrat financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2017 rezulton si më poshtë:

A. Mbi formatin nr 1, të pasqyrave financiare (Aktivi I Bilancit Kontabël)

Gjendja e llogarive aktive për vitin 2017, krahasuar edhe me vitin paraardhës (2017-2016), rezulton si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

	Emërtimi i Llogarive të Aktivit	2017	2016	Diferenca
	AKTIVE TE QENDRUESHME	236,661,191	288,164,135	(51,502,944)
Klasa I	Aktive te Qendr. të Pa Trupëzuara	35,565,544	41,376,305	(5,810,761)
203	Projekte Rikonstruksioni/Koncensione, patenta, licenca	58,107,600	58,107,600	-
209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme të pa trupëzuara	(22,542,056)	(16,731,295)	(5,810,761)
Klasa II	Aktive te Qendr. të Trupëzuara	201,095,647	246,787,830	(45,692,183)
212	Ndërtime e Konstruksione	132,088,704	132,088,704	0
215	Mjete transporti	21,089,918	21,089,918	-
218	Inventar ekonomik	334,412,729	345,442,297	(11,029,568)
219	Amortizimi Aktiv.Qendr. të Trupëzuara	(286,495,704)	(256,262,677)	(30,233,027)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

231	Shpenzime proces për rritjen e AQT		4,429,588	(4,429,588)
	AKTIVE QARKULLUESE	47,924,181	52,673,465	(4,749,284)
Klasa I	Gjendja e Inventarit	13,412,901	18,532,697	(5,119,796)
31	Materiale	3,937,701	5,583,257	(1,645,556)
35	Mallra (Librezat)	9,475,200	12,949,440	(3,474,240)
Klasa II	Kërkesa arkëtimi mbi Debitorët	29,262,164	26,586,424	2,675,740
411-418	Kliente e llogari të ngjashme	29,262,164	26,586,424	2,675,740
Klasa III	Llogarite financiare	5,249,116	7,554,344	(2,305,228)
520	Llogari në bankë	5,220,210	7,395,108	(2,174,898)
531	Llogari në arkë	28,906	159,236	(130,330)
	REZULTATI I USHTRIMIT (saldo debitore)	2,924,510	-	-
	TOTALI I AKTIVIT	287,509,882	340,837,600	(393,548,648)

Gjatë vitit 2017 Aktivitetet e Qëndrueshme paraqiten në shumën 236.6 mln lekë, duke zënë rreth 39% të totalit të Aktivitetit, me një rënie prej 51,502,944 lekë krahasuar me një vit më parë. Aktivitetet Qarkulluese paraqiten në shumën 48 mln lekë, duke zënë rreth 7% të totalit të aktiveve, me një rënie prej 4,749,283.9lekë krahasuar me 2016. Për të parë në mënyrë më të detajuar se si kanë ndryshuar zërat e aktiveve, analizojmë tabelën më poshtë:

Në lekë

Aktive	Gjendja në celje të ushtrimit	Shtesa gjatë vitit 2017	Pakësime gjatë vitit 2017	Gjendja në mbyllje të ushtrimit	Ndryshimi
Aktive të trupëzuara	58,107,600.00			58,107,600.00	0
Konc, patenta, lic të ngjas	58,107,600.00	-	-	58,107,600.00	0
Aktive të trupëzuara	503,050,507.45	824,028.00	16,283,184.00	487,591,351.45	-15,459,156
Ndërtim edhe konstruksione	132,088,704.40	-	-	132,088,704.40	0
Mjete transporti	21,089,918.00	-	-	21,089,918.00	0
Inventar ekonomik	345,442,297.05		11,029,568.00	334,412,729.05	-11,029,568
Caktime	4,429,588.00	824,028.00	5,253,616.00	0.00	0
Totali	561,158,107.45	824,028.00	16,283,184.00	545,698,951.45	0

Në lidhje me përbërjen e llogarisë së Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara u konstatua se, llogaria “*Inventarit ekonomik*” zë peshën më të madhe prej 69% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara; pas saj vijon llogaria e “*Ndërtime e Konstruksione*” e cila zë një peshë prej 27% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara, llogaria “*Mjete transporti*” zë peshën prej 4% ndaj totalit të Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara dhe është mbartur e pa ndryshuar nga viti 2016. Po ashtu edhe llogaria “*Caktime*”, e cila ka pësuar shtime dhe pakësime gjatë vitit të barabartë në total me vlerën në celje duke bërë që gjendja në fund të periudhës të jetë zero.

Llogaria “Aktive Të Qëndrueshme” paraqitet për 236,661,191.45 lekë dhe përbëhet nga:

Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara: Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në shumën 35,565,544 lekë, e cila ka dalë si diference midis shumës së përgjithshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në 58,107,600.00 lekë dhe amortizimit të këtyre aktiveve në shumën 22,542,056.00 lekë.

Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara: Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në shumën 201,095,647.45 lekë, e cila ka dalë si diference midis shumës së përgjithshme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe amortizimit të këtyre aktiveve në shumën 286,495,704.00 lekë. Përbërës të këtij posti janë llogaritë e grupit 212,215,218,219:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

-Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” gjatë vitit nuk ka pësuar ndryshime, por është mbartur tepricën në byllje të vitit ushtrimor 2016 prej 132,088,704.40 lekë.

-Llogaria 215 “Mjete Transporti” në vlerën 21,089,918.00lekë dhe po ashtu është mbartur e pa ndryshuar nga viti 2016.

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 345,442,297.05 lekë është pakësuar me 11,029,568 lekë duke aritur në fund vlerën e 334,412,729.05 lekë.

- Amortizimi i aktive të qëndrueshme të trupëzuara rezulton në vlerën 286,495,704 lekë.

Për verifikimin e saktësisë së përlllogaritjeve të amortizimit të llogarisë 212 “Ndërtime dhe Konstruksione”, u mbështetëm mbi Regjistrin e Aktiveve që mban institucioni, ku verifikuam kostot historike përkatëse, dhe nomat e aplikuar të amortizimit për amortizimin e vitit 2017 si vijon:

Në mijë lekë

Nr	Aktivi	Verifikimi	Vl. Fillim	Shtuar	Vl. Fund	Amortizim ne celje	Amortizimi vjetor	Vlera e mbetur	Norma e Aplikuar	Baza
1	Korpusi Kryesoor	Certifikata nr. , date	3,448.16	82,695.01	86,143.16	19,191.90	1,119.86	47,759.35	1.3%	Mbi koston historike
2	Godina 2 Kate		-	34,282.70	34,282.80	13,794.27	445.68	6,694.25	1.3%	Mbi koston historike
3	Kaldaja		593.30	5,825.33	6,418.63	4,156.78	102.70	(1,894.93)	1.6%	Mbi koston historike
4	Garazh + Xhenerik	Inspektim ne vend	-	1,451.47	1,451.47	1,138.93	23.22	(826.40)	1.6%	Mbi koston historike
5	Instalime Jashteme		-	3,792.65	3,792.65	-	0.00	3,792.65	1.6%	Mbi koston historike
	Total		4,041	128,047	132,089	38,282	1,691	55,525		

Për llogaritjen e amortizimit, subjekti i referohet Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2004 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Manualit Financiar të ISSH dhe VKM nr. 401, viti 1989.

Paraqitja e Regjistrit të Aktiveve të patrupëzuara sipas 1 formati ku mungon identifikimi i tyre sipas llojit, vecanërisht në kushtet kur ISSH ka një sërë sistemesh IT të cilat duhet të mirëmbahen, nuk na shërben si evidencë e mjaftueshme (ISSAI 1500) për të dhënë siguri të arsyeshme rreth regjistrimit të saktë të vlerës së këtij Aktivi.

Sa i takon llogarisë 203 “Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme”, nga auditimi u konstatua se, është mbajtur Regjistri i Aktiveve⁵⁰ edhe për këte kategori aktivesh, por ndërsa identifikohen total shtesat ndër vite ndaj vlerës totale të Aktivit, nuk janë të identifikueshme vec e vec aktivet e patrupëzuara (pra nga se përbëhet vlera).

Gjithashtu konstatojmë se norma e amortizimit e aplikuar për 3 vitet e njëpasnjëshme 2015, 2016 dhe 2017 për këtë kategori aktivesh të patrupëzuara është 10%, ndërkohë që Norma e amortizimit për këtë kategori aktivesh është 25% mbi vlerën e mbetur, nëse i referohemi kërkesave të Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Nga sa më sipër nevojitet të formatohet dhe plotësohet me informacion regjistri i Aktiveve të Patrupëzuara në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e

⁵⁰Shiko Ankesin 2



aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Gjithashtu nevojitet të bëhen sistemimet e nevojshme në zërat rekspektiv të Bilancit kontabël (llogaria 203 dhe 213) dhe në Pasqyrën e Të ardhurave dhe Shpenzimeve (llogaria 6025). Kjo gjithashtu do t’i mundësojë Sektorit të Financës njohjen e shpenzimeve për mirëmbajtje/ose përmirësim të këtij aktivi (sa herë të ketë të tilla) mbi vlerësimin nëse vlera shpenzimit në fjalë (nuk)tejkalon 15% e vlerës së mbetur të aktivit përkatës. Sa më sipër merr rëndësi jo vetëm për paraqitjen drejtë të vlerave të llogarive në pasqyrat financiare të njësisë, por gjithashtu minimizon risqet që një aktiv të rezultojë me vlerë të mbetur 0 (zero) në kontabilitet, ndërkohë që për të vijnë të shpenzohen fonde për mirëmbajtje.

Kemi konstatuar se, shpenzimet e mirëmbajtjes së sistemeve IT, të kryera për vitin 2017, në shumën 92,280,000 lekë janë njohur me pa të drejtë, si shpenzim periudhe, në një kohë që në fakt duhen konsideruar si kosto të përmirësimit, që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve, duke qenë se dhe vlera e tyre është më e madhe së 15% e vlerës kontabel të mbetur të aktiveve, kjo në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 1, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Kështu pjesë e procedurave të auditimit ishte kryerja e testeve thelbësore, duke krahasuar koston e mirëmbajtjes, nëse është mbi 15% e vlerës së aktivit, me qëllim vlerësimin nëse kjo e fundit duhej njohur dhe regjistruar si aset, apo si shpenzim periudhe (llog. 602), në përputhje me kërkesat e pikës 3.7 të Udhëzimit nr.1, datë 10.02.2004 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku specifikohet se, konsiderohen si kosto të përmirësimit, të rinovimit dhe të rikonstruksionit, shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlefte e të cilave është më e madhe së 15% e vlerës kontabile të mbetur të aktiveve. Kur këto shpenzime janë më të vogla së 15% e vlefte kontabile të mbetur të aktivit përkatës, ato konsiderohen shpenzime përmirëmbajtjen e aktivit dhe pasqyrohen totalisht si shpenzime biznesi për periudhën korente.

Në rastin e shpenzimeve të sistemeve IT, duke qenë se të dhënat nuk i kemi të detajuara sipas llojit të sistemit IT, bëmë një përlllogaritje mbi Totalin e vlerës së llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” dhe vlerës së Aktiveve të Qendrushme të Patrupsuara, me supozimin se e gjithë vlera përbëhet nga softëare dhe pajisjet IT, dhe konkluduar se edhe pse supozimi tejkalon vlerën potenciale të aktivit në fjalë, shpenzimet e vitit për mirëmbajtje tejkalojnë 15% të vlerës së mbetur të aktivit dhe si të tilla duhet të rrisin vlerën e aktivit, pra të konsiderohen kosto përmirësimi dhe jo mirëmbajtjeje (shpenzime për investime dhe jo shpenzime operative):

Në lekë

Aktivi (lloji)	Vlera e mbetur e aktivit perkates	Shpenzime mirembajtje 2017	Vlera
Të patrupsuara (Softëare, patenta, projekte, etj)	35,565,544	40,500,000	
Të Trupsuara (Inv. Ekonomik)	101,458,971 ⁵¹	49,176,000	
		2,604,000	
Totali	369,978,274	92,280,000	67%

Aktive Qarkulluese paraqiten më vlerën 47,924,180.84 lekë

51

Kosto historike (lekë)	334,412,730
Amortizim I akumuluar	- 206,078,590
amortizim vjetor	- 26,875,169
Vlera e mbetur	101,458,971



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Ky post është i barabartë me shumën e posteve: “Gjendja e Inventarit”, “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët” dhe “Llogari financiare”.

Gjendja e inventarit paraqitet në shumën 13,412,901 lekë, duke pësuar një pakësim prej vitit të kaluar 2016 me 5.119.796 lekë. Në përbërje të kësaj llogarie janë llogaria 31 ”Materiale”, e cila në fund të vitit pasqyrohet me vlerën 3,937,701 lekë, si dhe llogaria 35 ”Mallra” (libreza) me vlerën prej 9,475,200 lekë.

Kërkesa arkëtimi mbi debitorët paraqitet në shumën **29,262,163.57** lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 411-418 “Klient e llogari të ngjashme” kupërfshihen librezat e kontributeve (kartonat) të shpërndara në 12 rajonet. Nga auditimi u konstatua se teprica në celje e kësaj llogarie është mbartur nga teprica në mbyllje e llog 468 për shumën 26,586,423 (llog është debituar). Teprica në celje –sistemim nga llog 468 ”Debitorë të ndryshëm” që përfshin gjithë shumat për tu arkëtuar në llogaritë likuiduese të ISSH nga personat e tretë, që lidhen me një detyrim, pagesë të tepërt, etj. Gjatë vitit 2017, llog 411 është debituar për vlerën totale të librezave të shpërndara në 12 rajone prej 3,632,160 lekë dhe kredituar për shumën e arkëtuar prej 798,500 lekë, duke rezultuar me një gjendje debitore prej 29,262,163 lekë, në 31.12.2017.

Llogaritë financiare paraqiten në shumën 5,249,116.27 lekë dhe përfaqëson llogarinë 520 “Llogari në bankë” për vlerën 5,220,210.27 lekë, vlerë e cila është pakësuar me 2,174,897.57 lekë prej vitit 2016 dhe llogaria 531 “Llogari në arkë” për vlerën 28,906 lekë vlerë e cila është pakësuar nga viti i shkuar me 130,330 lekë.

Llogaria 520 - Llogaritë në bankë përfaqëson totalin e gjendjes së bankave më datë 31.12.2017, si më poshtë vijon:

Tirana Bank	-	997.8 mijë lekë
Banka Kombëtare Tregtare	-	3,636.5 mijë lekë
Credins Bank	-	585.9 mijë lekë

Nga auditimi i kësaj llogarie rezulton se është kryer konfirmim i gjendjes së llogarive më datën 31 dhjetor 2017 midis secilës bankë ISSH, përkatësisht:

Me Akt-konfirmimin, datë 23.01.2018 është kryer konfirmimi i gjendjes së llogarisë me Tirana Bank dhe gjendja rezulton 997.8 mijë lekë

Me Akt-konfirmimin, datë 23.01.2018, është kryer konfirmimi i gjendjes së llogarisë me Credins Bank dhe gjendja rezulton 585,9 mijë lekë.

Me Akt-konfirmimin, datë datë 23.01.2018, është kryer konfirmimi i gjendjes së llogarisë me BKT dhe gjendja rezulton 3,636.5 mijë lekë.

Rezultati i Ushtrimit i krijuar për vitin 2017 rezulton në vlerën 2,924,509 lekë (saldo debitore në llogarinë 85).

B. Mbi auditimin e formatit nr. 2 “Pasivi i Bilancit Kontabël”

Gjendja e llogarive pasive në fund të vitit 2017, gjendja e tyre një vit më parë, dhe diferenca midis dy periudhave (2017-2016), rezultuan si në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Emërtimi i llogarive të pasivit	2017	2016	Diferenca 2017-2016
A	FONDE TË VETA	278,853,383.19	289,286,657.69	-10.433.275.4
10	Fonde të veta	232,019,290.47	280,738,202.47	-48.718.912
101	Fonde bazë	187,363,691.45	234,437,047.45	47,073,356
105	Grante të brendshme kapitale	44,655,599.02	46,301,155.02	-1,645,556
11	Fonde të tjera të veta	0.00	4,429,588.00	-4,429,588.00
115	Caktim nga rezultati i vitit për investime		4,429,588.00	-4,429,588.00



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

12	Rezultati i mbartur	46,834,092.72	4,118,867.22	42,715,225.5
B	DETYRIME	335,656,499.00	8,835,717.00	326,820,782
Klasa 4	Detyrime afatshkurtër	8,656,499.00	8,835,717.00	-179,218
42	Personeli e llogari të lidhura me to	371,254.00	308,260.00	62,994
431	Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa	1,150,771.00	1,516,205.00	-365,434
435	Sigurime shoqërore	3,477,669.00	3,391,748.00	86,191
467	Kreditorë të ndryshëm	3,656,805	3,619,504.00	37,301
C	LLOGARI TË TJERA	327,000,000.00	-	327,000,000.00
Disp 581/2	Xhirime të brendshme midis njësisve organiz.	327,000,000.00		327,000,000.00
85	Rezultati i ushtrimit	460,96	42,715,225.50	-42,714,764.54
X	TOTALI I PASIVIT (A+B)	614,510,343.15	340,837,600.19	300,672,742.96

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë më shumë se një vit më parë për 300,672,742.96 lekë, ose 49% më shumë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë 10 “Fonde të veta”, është pakësuar këtë vit me vlerën -48.718.912lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë 101 “Fonde bazë”, është shtuar këtë vit me vlerën 47,073,356lekë, vlerë e cila i përgjigjet pjesës respektive së aktivitet të bilancit.

Llogaritë 105 “Grante të brendshme kapitale”, është pakësuar këtë vit me vlerën 1,645,556lekë.

Llogaria 12 “Rezultati i Mbartur” paraqitet në Klasën 10, me vlerën 46,834,092 lekë, më 31.12.2017. Nga auditimi i llogarisë analitike konstatoam se:

Llog. 85 - Rezultati i ushtrimit (saldo kreditore) viti 2016: 42,715,225 lekë

Llog. 12 - Rezultati i Mbartur, viti 2016 : 4,118,867 lekë

Llog. 12 – Rezultati i Mbartur, viti 2017: 46,834,092 lekë

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtëra, pakësuar në vlerën 8,656,499 lekë përfaqësojnë:

Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, në vlerën 371,254 lekë, si detyrim për sigurimin vullnetar të punonjësve. Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa”, në shumën 1,150,771 lekë përfaqëson detyrimet e muajit dhjetor për tatim taksat; dhe Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, në shumën 3,477,669 lekë, përfaqëson detyrimet e muajit dhjetor për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore.

Nga auditimi u konstata se këto vlera, edhe pse i takojnë shpenzimeve të konstatuara të dhjetorit, nuk janë njohur si të tilla në Pasqyrën e te Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit ushtrimor 2017.

C. Mbi auditimin e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve sipas formateve të miratuara
Formati 3/1 “Shpenzimet e ushtrimit”, është plotësuar me zërat përkatës të klasës 6, pra me artikujt 600/paga e shtesa, 601/sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, 602/shpenzime operative, 606/transferta për buxhete familjare e individ. Në këtë format janë përfshirë shpenzimet **faktike** nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2017, dhe jo ato të konstatuara sikundër e kërkon nenin 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, të Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ecuria e realizimit mujor kundrejt planit mujor të shpenzimeve administrative të Aparatit rezulton si vijon: Në mijë lekë

Muaj	Plani	Fakti	Realizimi
Janar	21,279	23,974	113%
Shurt	21,390	26,634	125%
Mars	21,658	27,602	127%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Prill	22,145	27,418	124%
Maj	69,792	25,326	36%
Qershor	22,324	27,393	123%
Korrik	22,390	17,941	80%
Gusht	22,479	27,065	120%
Shtator	22,567	36,099	160%
Tetor	22,635	26,479	117%
Nentor	22,700	26,613	117%
Dhjetor	58,377	37,383	64%
	349,736	329,925	

Nga auditimi u konstatua se kontabilizimi i shpenzimeve për llogarinë 602 në Aparatin e ISSH nuk ka ndjekur parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është mbështetur mbi parimin e lëvrimit të parasë, në kundërshtim nenin 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, të Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, ku parashikohet se, metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës. Sa më sipër e konstatuar në vlerat e llogarive 602 dhe 601.

Për njohjen e shpenzimeve, nuk është përdorur parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

Nga auditimi u konstatua se, edhe pse janë njohur si shpenzime periudhe pagat e likuiduara (pasi janë likuiduar Brenda datës 31.12.2016), nuk janë njohur si të tilla shpenzimet për sigurime të dhjetorit. Këtë e

pohojnë vlerat e llogarisë “Personeli dhe llogari të lidhura” dhe “Detyrime ndaj shtetit Debitor”, reflektuar në klasën 4 të Pasivit, “Detyrime Afatshkurtra”.

Nga kryerja e testeve të detajeve mbi transaksionet e llogarisë 602.5 konstatuam se janë regjistruar si shpenzime periudhe, edhe likuidimet e dy faturave të muajit dhjetor 2016, konkretisht:

Në lekë

Data e faturës	Date likuidimi	Furnitori	Vlera
27.12.2016	23.01.2017	Infosoft Systems(miremb rjeti I tekn inf)	3,387,500
19.12.2016	11.01.2017	Infosoft Systems (mirmb servera dhjetor 016)	4,098,000
	Total		7,485,500

Programi “Shpenzimet administrative”, është realizuar në total për shumën 329,925 mijë lekë, kundrejt 349,736 mijë lekë të planit me ndryshime, pra realizuar në masën 94.3 %, ose realizuar më pak për 19,811 mijë lekë. Shpenzimet administrative përdoren nga ISSH për kryerjen veprimtarisë së saj, për pagat e punonjësve, shpenzime operative, etj. Këto shpenzime në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” planifikohen 2% e buxhetit total të ISSH. Realizimi i kësaj kategorie shpenzimesh për dy vite të njëpasnjëshëm, si dhe parashikimi me ndryshimet gjatë vitit 2017 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2016	Fakti 2017	2017			Në %
				Prog. Fillestar	Prog. Ndrysh	Prog.Përf	
	Shpenzime Administrative	390,552	329,925	266,990	82,746	349,736	
1	Paga e shtesa 600	147,103	163,337	146,009	34,610	180,619	50%
2	Kontribut të sigurimeve shoqërore	21,744	24,477	20,900	4,300	25,200	7%
3	Blerje mallra e shërbime	111,450	139,425	97,996	43,090	141,086	42%
4	Transferime korente me jashte	1,910	1,862	2,085	-	2,085	1%
5	Investime	108,345	824	-	746	746	0.2%



Referuar tabelës së mësipërme, vërejmë se shpenzimet për pagat zënë 50% të total shpenzimeve administrative, ndërsa ato për mallra dhe shërbime 42%.

1.Paga e shtesa (600), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 163,337 mijë lekë, kundrejt 180,619 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 90 %. Krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 16.2 mijë lekë, ose 11 % më shumë.

Për periudhën objekt auditimi, në Drejtorinë e përgjithshme të ISSH-së, rezulton se fondi i veçantë është llogaritur dhe përdorur sipas dispozitave ligjore në fuqi, në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar.

2.Kontribute Sigurime shoqërore (601), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 24,477 mijë lekë, kundrejt 25,200 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 97 %. Krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 2.7 mijë lekë, ose 13 % më shumë. Gjatë auditimit të llogarive 600, 601, u shqyrtuan pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dokumentacionet si më poshtë:

12) Rregullorja e Brendshme e ISSH;

13) Rregulloren e Personelit të ISSH, miratuar me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 të Këshillit Administrativ;

14) Vendimet e KA për shtesa dhe ndryshime në numrin e përgjithshëm të punonjësve të ISSH dhe strukturën organizative të ISSH;

15) Vendimet e Drejtorit të Përgjithshëm për shtesa dhe ndryshime në strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH;

16) Dosjet e Personelit;

17) Borderotë e Pagave;

18) Etj.

- Nga auditimi i ushtruar në lidhje me pagat e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rezulton se punonjësit e ISSH nuk janë të pajisur me statusin e nënpunësit civil, por aktiviteti i tyre rregullohet në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe Rregulloren e Personelit të këtij institucioni, miratuar me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008. Gjithashtu, veprimtaria e institucionit bazohet në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Në rregulloren e Personelit të ISSH, miratuar me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 të Këshillit Administrativ, është miratuar organigrama e ISSH, si dhe janë përcaktuar klasat e kategoritë e punës për personelin e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH dhe ato rajonale.

Nga auditimi konstatohet se sipas ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 e Sigurimeve Shoqërore, të ndryshuar, neni 74, pika 1 b/1, detyrat e Këshillit Administrativ përfshijnë edhe përcaktimin e strukturës dhe numrit të punonjësve të ISSH. Nga auditimi rezulton se me VKA nr.5, datë 20.07.2010 është miratuar organigrama e institucionit, dhe me vendimin nr.1570 prot datë 11.03.2014, Drejtoresha e Përgjithshme e ISSH ka miratuar strukturën organizative të institucionit dhe numrin e punonjësve, specifikisht 144 punonjës. Në vijim të saj, janë miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH, shtesa në numrin total të punonjësve të ISSH, konkretisht VKA nr.7, datë 29.04.2015 dhe VKA nr.26, datë 11.12.2015. Neni 25, pika d e ligjit të sipërpërmendur specifikon përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshme ku përcaktohet kompetenca e tij në emërimin dhe rekrutimin e punonjësve. Kështu, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, ka kryer ndryshime në strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, duke shtuar apo pakësuar numrin e punonjësve, sipas nevojave të institucionit në drejtoritë përkatëse.



Nga auditimi u konstatua se për këto ndryshime, nuk është bashkëlidhur në vendimet përkatëse struktura organizative e ndryshuar, në mënyrë që të evidentohet dhe ruhet gjurma e këtyre ndryshimeve. Si rezultat, duke mos u dokumentuar ndryshimet në strukturë, ndeshen problematika për evidentimin e vendeve vakantë pas largimit të punonjësve, si dhe numrit total të punonjësve për cdo drejtori sipas strukturës në fuqi. Gjithashtu, në lidhje me përcaktimin nëse struktura organizative e ISSH është në përputhje me atë në fuqi, KA ka miratuar në Vendimin nr. 3, datë 26.02.2008 së bashku me Rregulloren e Personelit, vetëm organigramën e ISSH, dhe jo strukturën që përcakton numrin e punonjësve sipas cdo drejtorie. Nga auditimi u konstatua gjithashtu, se pas largimit të

Evidentohet nevoja që në rastet e shitesave të personelit në disa drejtori, të meren masa për ndryshimin e strukturës në drejtoritë e tjera, për të mos i pasqyruar ato si vakante në mënyrë fiktive, në kushtet kur plotësimi i tyre do të cojë në rritjen e numrit total të punonjësve të ISSH, në kundërshtim me VKA në fuqi për numrin total të punonjësve.

një punonjësi në Drejtorinë e Burimeve të Informacionit, ky pozicion nuk është paraqitur si vakant në strukturën e vënë në dispozicion nga sektori i Personelit, dhe nuk jemi pajisur me vendim të titullarit nëse ka patur shkurtim të tij në strukturë. Duke qenë se aktualisht në strukturën e ISSH, rezultojnë vakanca në disa drejtori, me plotësimin e tyre, do të rritet edhe numri total i punonjësve të Drejtorisë dhe si rezultat

edhe i totalit të ISSH, ndërkohë që KA, ka paracaktuar numrin maksimal të ISSH.

- Në rregulloren e Personelit të ISSH, është përcaktuar se ndryshimet në klasa, sistem dhe shtesa në pagë janë parashikuar të caktohen nga KA. Pra, cdo punonjësi i akordohet një klasë e cila quhet klasa personale e punonjësi dhe në bazë të punës që ai kryhen, përcaktohet edhe kategoria përkatëse. Politikat e pagës, përfshirë llojet e kompesimit e motivimit për personelin përcaktohen në përputhje me ligjet dhe vendimet e Këshillit të Ministrave. Në Rregulloren e Personelit, klasat e punonjësve janë paracaktuar në bazë të eksperiencës së punës, si dhe nivelit të arsimimit (i mesëm apo i lartë), por pa detajime të tjera për llojin e arsimimit të kërkuar sipas pozicionit. Kategoria e punës së punonjësve është gjithashtu e miratuar në këtë rregullore bazuar në kërkesat profesionale të pozicionit, kushteve të punës dhe përgjegjësi që kërkohet të përmbushen nga personeli përkatës. Në këtë rregullore, në pikën 2 të saj është përmendur se përshkrimi i detyrave për cdo post pune bëhet me rregullore të vecantë, por kjo nuk është kryer nga institucioni. Koeficientët sipas klasave dhe shkallëve të ecurisë në detyrë, janë miratuar nga KA, por për vitin 2017 janë kryer edhe ndryshimet sipas VKA nr. 7, datë 12.04.2017, pas ndryshimeve të qeverisë.
- Nga auditimi u konstatua se ISSH nuk disponon një dokument të miratuar mbi kërkesat e arsimit dhe kualifikimeve të tjera, në varësi të pozicionit të punës. Në rregulloren e personelit të ISSH, miratuar me vendimin nr.3, datë 26.02.2008 është përcaktuar se punonjësve të ISSH i akordohet një klasë sipas kategorisë së punës dhe sipas kësaj klase përcaktohen edhe kërkesat në eksperiencën e punës, por jo sipas fushave të kërkuara të arsimimit.
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore disponon një regjistër të punonjësve të ISSH, në të cilin janë parashikuar edhe fushat e kërkuara në arsim, si dhe eksperiencat e punonjësve, por personeli i kësaj drejtorie nuk kishte dijeni për kuadrin ligjor sipas së cilit janë përcaktuar këto kritere, për shkak të periudhës së hershme në të cilën ky dokument është miratuar.
- Në lidhje me verifikimin e pagave të punonjësve të ISSH, u përzgjedhën disa dosje të personelit të Drejtorisë së Përgjithshme, ku u verifikuan dokumentacionet e bashkëlidhur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

dosjeve si dhe verifikime për klasën dhe kategorinë e cdo punonjësi në bazë të eksperiencës dhe arsimimit.

Në Rregulloren e Personelit të ISSH është përcaktuar si detyrim për klasat drejtuesve (klasa III) eksperiencia minimale 2 vjecare në drejtim, por nga auditimi i dosjeve të punonjësve, u hasën një sërë rastesh të drejtuesve ku ky detyrim nuk rezulton të jetë zbatuar për emërimin e tyre. Gjithashtu, rezulton se dosjet e personelit kanë një sërë mangësish në lidhje me fushat e arsimimit në varësi të pozicioneve, mungesën e letres së motivimit, referencave, vlerësimet e punonjësve, ekstremitete në hartimin e kontratave të punës, autorizime, kërkesën për vend vakant, raportin e vlerësimit të kandidatit, dëshmi penaliteti. Në lidhje me vlerësimet e kandidatëve rezultoi se shumica e tyre janë fiktivë ku të gjithë punonjësit e një drejtorie janë vlerësuar me pikë maksimale duke mos reflektuar vlerësimin e tyre faktik për punën e kryer.

Gjithashtu, u kërkuan nga sektori i personelit të ISSH, dosjet e punonjësve të emëruar, të komanduar dhe të larguar nga ISSH. Nga auditimi i dosjeve të punonjësve të larguar, konstatohet se me urdhrin nr.9381 prot, datë 23.11.2017 është urdhëruar largimi nga puna i zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, vendim për të cilin nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm është njoftuar ky punonjës për rishikimin e marrëdhënies së tij të punës, dhe si pasojë e mungesës së tij në këtë takim, është bërë edhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në rregulloren e Personelit për rastet që punonjëve do u ndërpritet marrëdhënia e punës. Duke konsideruar numrin e madh të rasteve që institucionet shtetërore ndeshen me gjyqe për ish punonjësit e tyre, evidentohet nevoja për të treguar një kujdes më i madh nga institucioni për menaxhimin më të mirë të personelit dhe të procedurave për shkarkimin e tyre nga pozicionet përkatëse, me qëllim shmangien e procedurave gjyqësore në vijim.

Gjithashtu, në lidhje me procedurat e emërimeve, u konstatua se për rekrutimin e punonjësve të rinj në institucion, janë aplikuar gjithmonë procedurat e komandimit për një periudhë 3 mujore, dhe më tej emërimin e tyre të përhershëm në pozicion; ose procedurat për konkurimin e brendshëm nga personeli ekzistues. Në rregulloren e personelit të ISSH është përcaktuar se rekrutimi i punonjësve do të kryhet me konkurim të hapur ose konkurim të brendshëm. Nga auditimi konstatohet se në faqen zyrtare të ISSH nuk është publikuar asnjë informacion për vende vakante të punonjësve, në mënyrë që të aplikohen edhe procedurat e konkurimit të hapur, duke reflektuar kështu një nivel të ulët të transparencës institucionale. Për vitin 2017 janë emëruar 4 punonjës të rinj të komanduar si dhe janë emëruar në pozicionet përkatëse disa punonjës që më parë kanë qenë të komanduar. Në rregulloren e Personelit është përcaktuar se komandimi i përkohshëm në detyrë do të aplikohet vetëm kur për nevojat operacionale kërkohet plotësimi i menjëhershëm i pozicionit të punës, dhe gjatë kohës së komandimit, administrata e sigurimeve shoqërore duhet të zbatojë procedurat për plotësimin përfundimtar të pozicionit, dhe në rastet kur kjo nuk arrihet, do të emërohet punonjësi në pozicion të përhershëm. Nga auditimi konstatohet se sektori i burimeve njerëzore nuk ka kryer publikime të pozicionit të punës, pas komandimeve të personelit në to, dhe komandimi i përkohshëm është kthyer në një procedurë rutinë për emërimin e punonjësve të ISSH, në kundërshtim me rregulloren e personelit të ISSH.

- Nga auditimi në lidhje me shpenzimet për pagat dhe kontributet e punonjësve të Institutit të Sigurimeve shoqërore, u konstatuan si më poshtë: *Në mijë lekë*

Llog.	Shpenzimet për Paga dhe Kontribute	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017			Ndryshimi 2017-2016
				Plan	Fakt	Realizimi	
600	Paga, Shpërblime dhe Shpenzime të tjera	138,122	147,103	180,619	163,337	-17,282	+16,234



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

6001	Paga Personel i Përhershëm	129,322	135,098	168,410	151,846	-16,564	+16,748
6002	Paga Personel i Përkohshëm	0	0	0	0	0	0
6003	Shpërblime Personeli	3,263	4,344	5,209	4,696	-513	+352
6009	Shpërblime të Tjera Personeli	5,537	7,659	7,000	6,795	-205	-864
601	Sigurime Shoqërore e Shëndetsore	20,840	21,744	25,200	24,477	-723	+2,733
6010	Sigurime Shoqërore	18,687	19,497	23,945	22,660	-1,285	+3,163
6011	Sigurime Shëndetsore	2,153	2,246	1,255	1,817	-562	-429
600+601	Total	158,962	168,847	205,819	187,814	-18,005	+18,967

- **Nga kryerja e procedurave analitike** mbi shpenzimet për pagat u konstatua se, realizimi i shpenzimeve për paga dhe kontribute, për vitin 2017 është në total 18,005 mijë lekë më pak se planifikimi i tyre, ku më hollësisht llogaria 600 (paga, shpërblime dhe shpenzime të tjera), është realizuar 17,282 mijë lekë më pak se plani, ndërsa llogaria 601 (sigurime shoqërore e shëndetësore), është realizuar 723 mijë lekë më pak se plani. Për vitin 2017, vërehet një rritje me 18,967 mijë lekë krahasuar me vitin e mëparshëm për totalin e llogarisë të pagave dhe shpërblimeve (600) dhe atë sigurimeve shoqërore e shëndetsore (601). Kjo rritje vjen si pasojë e vendimit të qeverisë për rritjen e nivelit të pagave të punonjësve së administratës, miratuar për ISSH me VKA nr.7, datë 12.04.2017, dhe si rezultat janë rritur edhe shpenzimet për to.
- Në vijim grupi i auditimit kreu teste të detajeve që konsistuan në kontrollin e transaksioneve që lidhen me pagat, të regjistruara në librat kontabël krahasuar me dokumentacionin mbështetës si dhe konfirmimet e shumava me bankat.
- Nga auditimi i llogarisë 600.1 u konstatua se, kjo nënlllogari paraqet shpenzimet e periudhës. Nënlllogaria është debituar për shumën e pagave bruto të personelit të likuiduara gjatë vitit 2017, duke kredituar llogarinë 421 “Personeli” për shpenzimet e Dhjetorit.

Nga auditimi i borderove mbi shpenzimet e pagave të punonjësve të ISSH, u përzgjodhën disa punonjës për të verifikuar nëse paga e tyre është në përputhje me VKA, si dhe nëse është bërë llogaritja e duhur për ndalje për shkak të mungesave, raportit, tatime, sigurime shoqërore, shëndetësore dhe vullnetar. Punonjësit e ISSH përfitojnë shtese në pagë për orë shtesë pune, përkatësisht punonjësit e shërbimit (rojet), sipas ligjit nr.136/2015, neni 90, dhe gjithashtu për rastet e punës në ditët e festave sipas nenti 86, ndryshuar me ligjin nr.9125, datë 29.07.2003. Gjithashtu, përfitojnë shtesë page për vështirësi në punë punonjësit e Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, dhe operatorët, sekretar/protokollisti dhe magazinieri. Në bazë të vendimit të VKA nr.7, datë 12.04.2017 është përcaktuar se punonjësit e ISSH do të përfitojnë një shtesë në pagë prej 1% për cdo vit për vjetërsi në punë, por jo më shumë se 25%. Nga auditimi rezultoi se ISSH gjatë vitit 2017 nuk ka punësuar punonjës të përkohshëm. Fondi i vecantë i institucionit është përdorur për festa të institucionit, shpërblime të punonjësve, shpërblim për dalje në pension dhe kompesim të lejes së zakonshme për punonjësit e larguar, nën përputhje me VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë”, i ndryshuar, pasi pagesat janë kryer përpara se të hynte në fuqi VKM nr. 818, datë 29.12.2017 “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë”, të ndryshuar, Nga auditimi u konstatua se formati i borderosë së pagave të ISSH nuk rezulton të jetë plotësisht në përputhje me udhëzimin nr.4, datë 13.12.2016 “Për formën, elementët dhe plotësimin e borderosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pasi në raportimet mujore të borderove mungon kolona e “Emërtesës së pozicionit sipas strukturës së miratuar”, “Kategoria, klasa, funksioni, titulli”, procedurë kjo e vazhduar përgjatë gjithë vitit 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në lidhje me llogaritjen e përfitimeve për paafësi në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar kjo me raport mjekësor deri në 14 ditë, sipas nenit nr.130, pika 1 përcaktohet se “Kur punëmarrësi nuk mund të punojë për shkak të sëmundjes, punëdhënësi i jep atij jo me pak se 80% e pagës, për një periudhë prej 14 ditësh, të pambuluara nga Sigurimet Shoqërore”. Në kundërshtim me kuadrin ligjor, nga auditimi rezulton se deri në muajin nëntor të vitit 2017, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka vepruar duke aplikuar 70% të mesatares 6 mujore të pagës për punonjësit që kanë më pak se 10 vjet në ISSH dhe 80% të kësaj mesatareje për ata që kanë punuar për më tepër se 10 vite, duke cituar si kuadër ligjor nenin 23, pika 1 dhe neni 25 i ligjit nr.7703, datë 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj i referohet periudhës që do të mbulohet nga sigurimet shoqërore, dhe jo periudhës deri në 14 ditë që do të justifikohet me raport mjekësor dhe si rezultat do të paguhet nga punëmarrësi. Me qëllim sqarimin e plotë të kësaj çështjeje në ISSH, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, ka miratuar një dokument sipas nr.9029 datë 08.11.2017 drejtuar Drejtorinë e Përgjithshme, Rajonale dhe Arkivin Qendror të ISSH, për llogaritjen me 80% të pagës për punonjësit, pavarësisht eksperiencës së tyre në institucion. Pra, si rezultat në muajt nëntor dhe dhjetor është kryer përlllogaritja e saktë e punonjësve që kanë paraqitur raport mjekësor deri në 14 ditë.

Gjithashtu, për llogaritjen e pagës ditore të punonjësve, sipas vendimit nr. 511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave, ditët e punës do të konsiderohen 22 ditë në muaj, e përmendur kjo edhe në udhëzimin nr. 4 datë 13.12.2016 të Ministrisë së Financave “Për Formën, Elementët dhe Plotësimin e Borderosë së Pagave për Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Nga auditimi rezultoi se përgjatë vitit 2017, gjithashtu edhe më parë, paga ditore e punonjësve të ISSH është llogaritur 21.75 ditë, në kundërshtim me VKM e mësipërme.

3.Blerje mallra e shërbime (602), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 139,425 mijë lekë, kundrejt 141,086 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 99 %. Ndërkohë që në krahasimim me vitin e mëparshëm ushtrimor, ky zë është realizuar më shumë për 27,975 mijë lekë, ose rreth 25 % më shumë.

Në mijë lekë

602	Mallra dhe shërbime të tjera	Vlera 2017	Vlera 2016	Ndryshimi	Pesha
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	2,797.46	7,095.39	(4,298)	2%
6021	Materiale dhe shërbime speciale (komisione)	62.13	-	62	0%
6022	Shërbime nga të tretët	12,353.40	11,436.21	917	9%
6023	Shpenzime transporti	414.89	2,297.28	(1,882)	0%
6024	Shpenzime udhëtimi	14,320.75	13,663.06	658	10%
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	102,307	53,940	48,367	73%
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	3,851.14	6,143.82	(2,293)	3%
6029	Shpenzime të tjera operative	3,317.65	16,873.30	(13,556)	2%
	Totali	139,425	111,450	27,975	100%

Nga kryerja e procedurave analitike, rezultoi se, nënlllogaria 602.5 “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në shumën 102,307 mijë lekë, me peshën më të madhe të total llogarisë 602, konkretisht 73%, ka një rritje të konsiderueshme prej 48,367 mijë lekë krahasuar me një vit më parë (ose ndryshe 90% më shumë se viti 2016). Nga auditimi u konstatua se në këtë nënlllogari përfshihen shpenzimet për mirëmbajtjen e rrjeteve, pajisjeve kompjuterike, etj të ngjashme. Shpenzimet për mirëmbajtje I përkasin përkatësisht aktiveve të përmendura në llogarinë 231.

Nënlllogaria	Emertimi	Vlera (mijë lekë)	Pesha specifike
6025300	Mirëmbajtje e zakonshme ndertesash	328	0.3%



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

6025400	Mirembajtje te zak. te rrjetit hidraulik,elektrik,telefonik, ngrohje etj	373	0.4%
6025500	Mirembajtje te zak.kompjuter,vegla,aparate etj	101,196	98.9%
6025600	Mirembajtje e zakonshme e mjeteve te transportit	411	0.4%
6025800	Mirembajtje te zakonshme te paisjeve te zyres	-	0.0%
602.5	Total	102,307	1

Vihet re se, shpenzimet e mirëmbajtjes gjatë vitit 2017 janë shtuar si pasojë e lidhjes së dy kontrave të reja për mirëmbajtjen e sistemeve IT dhe likuidimeve të kryera ndaj operatorit ekonomik “Infosoft System si më poshtë:

a. Kontrata nr.7467/5, datë 02.12.2016, me objekt “Mirëmbajtje dhe suporti i shërbimeve të Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore”, me afat 2 vjet, në shumën 81,300,000 lekë, likuidimi **3,387,500 lekë/muaj**.

b. Kontrata nr.7154/5, datë 31.10.2016, me objekt “Blerje storage dhe migrimi i sistemeve PCAMS&FMS”, me afat 4 vjet, në shumën 24,732,000 lekë, ku është parashikuar likuidimi i shumës 14,316,000 lekë, brenda 4 muajve nga lidhja e kontratës dhe shuma 10,416,000 lekë, do të likujdohet shuma **217,000 lekë/muaj**.

Shpenzimet për mirëmbajtjen rezultojnë në rritje si pasojë e likuidimeve mujore fikse të kryera ndaj operatorit ekonomik “Infosoft System”, për 3 kontrata shërbimi. Njëra nga të cilat ka qenë në vijim, konkretisht kontrata me nr. 2860/7, datë 29.10.2014, me objekt “Marrëveshje Shërbimi për Sistemet Informatike të PCAMS për Llogaritjen dhe Caktimin e Pensioneve, FMS për Menaxhimin Financiar, CMIS për Menaxhimin e Deklarimit Online të Kontributeve, Rrjeti informatik dhe pajisje të caktuara të dhomës së Serverave, Pajisje IT për ISSH dhe komunikimin ISSH –Arkiva”, me afat 4 vjet, në shumën 196,704,000 lekë, dhe likuidim prej 4,098,000 lekë/ muaj.

Nga auditimi konstatohet se punonjësi i IT, i cili konfirmon kryerjen e shërbimit, gjithashtu nënshkruan faturat mujore të paraqitura nga operatori ekonomik, konstaton defektet/mbarëvajtjen e shërbimit, si dhe është njëherazi edhe Kryetar komisionit të vlerësimit të ofertave.

Nga kryerja e testeve të detajeve mbi transaksionet e llogarisë 602.5 konstatuam se janë regjistruar si shpenzime periudhe (të muajit janar), edhe likuidimet e dy faturave të muajit dhjetor 2016, duke cënuar parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, konkretisht: *Në lekë*

Data e faturës	Date likuidimi	Furnitori	Vlera
27.12.2016	23.01.2017	Infosoft Systems(miremb rjeti I tekn inf)	3,387,500
19.12.2016	11.01.2017	Infosoft Systems (mirmb servera dhjetor 016)	4,098,000
	Total		7,485,500

4.Shpenzime organizata ndërkombëtare (605.1), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 1,862 mijë lekë, kundrejt 2,085 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 89 %. Krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar në masën 3 % më pak. Në këtë nënlllogari është përfshirë kuota vjetore e anëtarësimit të ISSH në ISSA - International Social Security Association.

5.Shpenzime për investime (231), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 824 mijë lekë, kundrejt 746 mijë lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 110 %, ose realizuar më tepër për 78 mijë lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë paraqitet me mosrealizim në shumën 107,521 mijë lekë.

DREJTIMI II.2/b:Auditimi i pasqyrave financiare të ISSH



- Gjetja 10:** Eliminimi i llogarive të pagueshme dhe atyre të arkëtueshme mes Aparatit dhe njësisve rajonale, ne pasqyrat e konsoliduara të ISSH
- Situata:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të ISSH u konstatua se, llogaritë e pagueshme dhe ato të arkëtueshme të krijuara mes njësisve shpenzuese dhe Aparatit nuk janë eliminuar gjatë konsolidimit, duke cënuar parimin e vlerësimit⁵² sipas të cilit, elementet futen në llogari dhe përfshihen në pasqyrat financiare, me shumat që përcaktohen, sipas standardeve kontabël⁵³. Shuma prej 29,262,163 lekësh, e reflektuar në llogarinë 468 “Të Drejta të Arkëtueshme” konsiston në vlerën e librezave të kontributeve që Aparati ka shpërndarë në Rajonet e Sigurimeve Shoqërore me qëllim shitjen. Në kuptimin e të drejtave që ISSH ka për këtë aset, dhe në përputhje me bazën ligjore të cituar, vlerësojmë se në pasqyrat e konsoliduara ky zë nuk ka kuptim të reflektohet me kundërparti shumën respektive në llogarinë 401-408 “Klientë e llogari të lidhura me to”, sikundër në fakt është vepruar.
- Kriteri:** Standardi Kombëtar i Kontabilitetit nr. 9; ligji nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 13
- Ndikimi/Efekti:** Reflektimi me pa të drejtë i vlerës prej 29,262,163 lekë si llogari të arkëtueshme
- Shkaku:** ISSH njeh kontabilizon si “detyrime për t’u arkëtuar” detyrimet ndaj vetes, në kushtet e konsolidimit të pasqyrave (po njëjloj për “detyrimet për tu paguar”)
- Rekomandime:** Drejtoria e Financës të marrë masa që përgjatë konsolidimit të pasqyrave financiare të eliminojë llogaritë që mbartim të drejta dhe detyrime brenda grupit.
- Afati për zbatimin e rekomandimit** Brenda datës 28.03.2019
- Gjetja 11:** Mbi respektimin e parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara
- Situata:** Nga auditimi u konstatua se njohja e shpenzimeve të vitit buxhetor në pasqyrat financiare të ISSH, është bërë në momentin e kryerjes së pagesës dhe jo në çastin e ndodhjes së tyre, konstatuar në rastet në vijim:
- Edhe pse janë njohur si shpenzime periudhe pagat e likuiduara, nuk janë njohur si të tilla shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor. Këtë e pohojnë vlerat e llogarisë “Personeli dhe llogari të lidhura” dhe “Detyrime ndaj shtetit Debitor”, reflektuar në klasën 4 të Pasivit/“Detyrime Afatshkurtra”.
 - Gjithashtu nga kryerja e testeve⁵⁴ mbi transaksionet e llogarisë 602.5 “Mallra dhe Shërbime” konstatuam se janë regjistruar si shpenzime periudhe të vitit

⁵² Neni 13, i Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

⁵³ Standardi Kombëtar i Kontabilitetit (SKK) 9

⁵⁴

Data e faturës	Date likuidimi	Furnitori	Vlera
27.12.2016	23.01.2017	Infosoft Systems(miremb rjeti I tekn inf)	3,388
19.12.2016	11.01.2017	Infosoft Systems (mirmb servera dhjetor 016)	4,098



2017, likuidimet e dy faturave të muajit dhjetor 2016, në shumën totale 7,486 mijë lekë⁵⁵.

Kriteri: Nenin 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit” I Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se, metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës.

Ndikimi/Efekti: Mosnjohja e shpenzimeve të periudhës në momentin e konstatimit.

Shkaku: Mosrespektimi i parimeve të menaxhimit të sistemit buxhetore.

Rekomandime: Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa për përgatitjen e një urdhri detyrues, për të gjitha njësitë shpenzuese të ISSH-së, ku të kërkohet menjëherë njohja e shpenzimeve të periudhës, në momentin e konstatimit dhe jo në momentin e lëvrimit të parasë, i shoqëruar me të gjitha hapat e nevojshëm për tu ndjekur nga njësitë shpenzuese. Të ngrihet një grup i dedikuar për të monitoruar dhe mbështetur njësitë, me qëllim marrjen e sigurisë se ky parim po ndiqet në mënyrë që pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, të reflektojnë shpenzimet ushtrimore sipas parimit të kontabilitetit rritës.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Në vazhdim

Gjetja 12:
Situata

Mungesa e gjurmëve të auditit për ndryshimet në strukturën organizative Nga auditimi i organizimit të brendshëm të ISSH, u konstatua se struktura e fundit e miratuar e institucionit është tepër e hershme dhe nuk përputhet plotësisht me atë aktuale. Gjithashtu, pas ndryshimeve të kryera në strukturën organizative nga titullari i institucionit, nuk është ruajtur gjurma e këtyre ndryshimeve për të evidentuar saktësisht vakancat, si dhe shtesat në strukturë jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me reduktim të personelit në strukturat e tjera.

Ndikimi Nga mos pasqyrimi i ndryshimeve, evidentohet se pas largimit të personelit nga pozicioni përkatës, ky vend nuk ka rezultuar si vakant në strukturën organizative, dhe gjithashtu pas shtesave të personelit në një drejtori, ky proces nuk është shoqëruar me pakësimin e numrit të personelit në një drejtori tjetër, për të ruajtur kështu numrin total të punonjësve sipas vendimit të KA. Si rezultat, vakancat e stafit janë fiktive, në kushtet kur shtesat për plotësimin e tyre, tejkalojnë numrin total të personelit.

	Total	7,486
--	--------------	--------------

⁵⁵ Llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, në vlerën 371,254 lekë, paraqitet si detyrim për sigurimin vullnetar të punonjësve; Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa”, në shumën 1,150,771 lekë përfaqëson detyrimet e muajit dhjetor për tatim taksat; dhe Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, në shumën 3,477,669 lekë, përfaqëson detyrimet e muajit dhjetor për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore. Nga auditimi u konstatua se këto vlera, edhe pse i takojnë shpenzimeve të konstatuara të dhjetorit, nuk janë njohur si të tilla në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të vitit ushtrimor 2017.



- Kriteri:** Nenit 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
- Shkaku:** Mos marrja e masave të duhura rregullative nga stafi përgjegjës
- Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në ISSH, të marrin masat e nevojshme për miratimin e strukturës aktuale, si dhe ruajtjen e gjurmëve të sakta në rastet e ndryshimeve sipas urdhrave të titullarit për të evidentuar kështu vakancat në drejtoritë përkatëse.
- Afati për zbatimin e rekomandimit** Menjëherë dhe në vazhdim
- Titulli i çështjes:** **Auditimi i pasqyrave financiare të Aparatit të ISSH**
- Gjetja 13:** Mbi njohjen e shpenzimeve të përmirësimit në Aktivin e Bilancit Kontabël
- Situata:** Nga auditimi i llogarisë 602, kemi konstatuar se, shpenzimet e mirëmbajtjes së sistemeve IT, të kryera për vitin 2017, në shumën 92,280,000 lekë janë njohur me pa të drejtë, si shpenzim operativ (llog. 602), në një kohë kur kjo vlerë duhet të kishte shtuar vlerën e aktivitetit përkatës në Bilancin kontabël të ISSH.
- Nga auditimi i llogarisë 203 “Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme” u konstatua se, për këte kategori aktive sheshtë mbajtur Regjistri i Aktiveve, por ndërsa identifikohen totalisht shtesat ndër vite, ndaj vlerës totale të Aktivitetit, nuk janë të identifikueshme vec e vec aktivet e patrupëzuara (pra nga se përbëhet secili prej tyre). Paraqitja e Regjistrimit të Aktiveve në këtë lloj formati, ku mungon identifikimi i tyre sipas llojit, vecanërisht në kushtet kur ISSH ka disa sisteme IT, të cilat duhet të mirëmbahen, nuk na shërben si evidencë e mjaftueshme për të dhënë siguri të arsyeshme rreth regjistrimit të saktë të vlerës së këtij Aktiviteti.
- Kriteri:** Udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku në pikën 3.7.2 parashkikohet se: “Për të katër kategoritë e aktiveve të përmendura më sipër, për efekte fiskale, konsiderohen kosto të përmirësimit, të rinovimit dhe të rikonstruksionit, shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlera e të cilave është më e madhe së 15% e vlerës kontabel të mbetur të aktiveve. Kur këto shpenzime janë më të vogla së 15% e vlerës kontabel të mbetur të aktivitetit përkatës, ato konsiderohen shpenzime për mirëmbajtjen e aktivitetit dhe pasqyrohen totalisht si shpenzime biznesi për periudhën korrente. Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Ndikimi/Efekti:** Risku që vlera e Aktiveve të Patrupëzuara të mos paraqitet drejtë në Bilanc.
- Shkaku:** Mosnjohja e shpenzimeve të përmirësimit të pajisjeve IT; Mos-identifikimi në Regjistrimin e Aktiveve i softeve IT (sipas llojit) të cilit më pas duhet ti bashkëngjiten edhe cdo shpenzim shtesë që bëhet për përmirësimin e tyre.



Rekomandime: Nga sa më sipër nevojitet që Sektori i Financës në ISSH të formatojë dhe plotësojë me informacion, regjistrin e Aktiveve të Patrupëzuara në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Gjithashtu, nevojitet të bëhen sistemimet kontabël të nevojshme, në zërat rekspektiv të Bilancit kontabël (Ilogaria 203 dhe 213) dhe në Pasqyrën e Të ardhurave dhe Shpenzimeve (Ilogaria 602.5) për shpenzimin e kryer, që përfaqëson kostot e mirëmbajtjes së këtyre aktiveve.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Brenda 30.12.2018

Gjetja 14:

Mos kryerja e procedurave të sakta të rekrutimit në përputhje me Kodin e Punës dhe Rregulloren e Personelit të ISSH

Situata

Nga auditimi mbi procedurat e rekrutimit, u konstatua se për vitin 2017, ISSH nuk ka kryer asnjë publikim të vendeve të lira të punës, në faqen zyrtare të institucionit. Gjithashtu konstatuam se, vetëm në 2 raste është ndjekur procedura për emërimin e punonjësve në përputhje me kërkesat e Rregullores së Personelit të ISSH, ndërsa në 5 raste të tjera, për rekrutimin e tyre është ndjekur procedura e komandimit të përkohshëm, ku 1 prej tyre edhe është emëruar në pozicionin fillimisht të komanduar. Në asnjë prej rasteve të mësipërme, nuk gjetëm evidenca për të mbështetur nevojën e aplikimit të procedurave të komandimit si pasojë e nevojave të menjëhershme, diktuar ng apozicioni i punës, sikundër e kërkon Kodi i Punës dhe Rregullorja e Personelit të ISSH (çështja I, pika 2), e cila parashikon këtë procedurë vetëm në raste emergjente dhe për një periudhë të shkurtër kohore.

Ndikimi:

Mos garantimi i cilësisë më të mirë në rekrutimin e personelit

Kriteri:

Kodi i Punës dhe Rregullorja e Personelit e ISSH.

Shkaku:

Mos aplikimi i procedurave të sakta sipas rregullores nga personeli përgjegjës për rekrutimin dhe përzgjedhjen e punonjësve

Rekomandimi:

Strukturat drejtuese në ISSH, veçanërisht Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të rekrutimit transparente dhe ligjore, duke shmangur raste të rekrutimit të stafit të ri nëpërmjet komandimit të përkohshëm, përveç rasteve emergjente të parashikuara në kodin e Punës.

Afati për zbatimin e rekomandimit

Në vazhdim

Gjetja 15:

Pasaktësi në llogaritjen e zbritjeve të pagës për shkak të mungesave të justifikuara me raport mjekësor dhe në përgatitjen e borderove

Situata

Nga auditimi i pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH u konstatua se në periudhën 01.01.2017-07.11.2017, llogaritja e pagës neto të punonjësve ishte kryer në kundërshtim me nenin 130, pika 1 e Kodit të Punës



i cili citon se: “Kur punëmarrësi nuk mund të punojë për shkak të sëmundjes, punëdhënësi i jep atij jo më pak se 80% e pagës për një periudhë prej 14 ditësh të pambuluara nga sigurimet shoqërore”. Për periudhën e mësipërme, ISSH ka aplikuar zbritjen në masën 70% për punonjësit që kanë më pak se 10 vite eksperiencë punë në ISSH, dhe 80% për ata që kanë mbi 10 vite, duke cituar si bazë ligjore nenin 23, pika 1 dhe nenin 25 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i cili faktikisht i referohet periudhës së paaftësisë për punë pas 14 ditësh, e që mbulohet nga sigurimet shoqërore. Më pas, në muajin nëntor, ky gabim është konstatuar nga ISSH, ku me urdhrin nr. 9029 datë 08.11.2017, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH ka njoftuar drejtoritë e ISSH për kryerjen e saktë të llogaritjes së pagës (pra 80% e pagës për punonjësit, pavarësisht eksperiencës së tyre në institucion). Kjo është një problematikë e evidentuar edhe në subjekte të tjera shtetërore, nga auditimet e KLSH-së, ku është konstatuar zbritja në pagë për shkak të raportit mjekësor, në varësi të eksperiencës së punës, në kundërshtim me nenin 130, pika 1 e Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Ndikimi:

Mos llogaritja e saktë e pagës së personelit në borderotë përkatëse

Kriteri:

Kodi i Punës

Shkaku:

Mos zbatimi i kriterëve ligjore të përcaktuara në Kodin e Punës

Rekomandimi:

Duke marrë në konsideratë problematikën që lidhet me interpretime të ndryshme që institucione të ndryshme buxhetore i bëjnë vlerësimit dhe përlllogaritjes së ditëve me raport mjekësor nën 14 ditë, ku herë mbështeten mbi Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë dhe herë mbi Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në funksion të përmirësimit të punës, rekomandojmë që ISSH të përgatis një dokument njoftues, gjithëpërfshirës ku të bëhen me dije institucionet shtetërore se, për përlllogaritjen e ditëve me raport mjekësor **mbi 14 ditë**, referenca është Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, ndërsa për ditët me raport **nën 14 ditë**, Kodi i Punës, duke qenë se sa më sipër ka lënë hapësirë për interpretime

Afati për

zbatimin e

rekomandimit

Brenda datës 30.08. 2018

Gjetja 16:

Mbi forcimin e gjurmës së auditimin për kontabilizimin e shpenzimeve për pensione, në nivel të konsoliduar

Situata:

Nga auditimi u konstatua se, për shpenzimet e pensioneve, Drejtoria e Financës në ISSH, vlerën e shpenzimeve off-line⁵⁶ e merr të konfirmuar nga Rajonet, duke qenë se dokumentet mbështetëse ndodhen nëpër Rajone, dhe nga sistemi IT këto të dhëna nuk vijnë në kohë reale. Për të rritur nivelin e sigurisë për vlerat e llogarive që lidhen me shpenzimet e pensioneve në nivel

⁵⁶ Shpenzimet që kryhen nga posta, ose bankat, për rajonet ku këto të fundit janë “off-line”



të konsoliduar, përzgjedhëm në mënyrë rastësore një agjenci rajonale (agjencinë e Fierit) dhe konkretisht muajin nëntor, ku në përfundim **nuk** na rezultuan diferenca⁵⁷. Kryerja e verifikimeve të tilla, për të gjitha rajonet kërkon kohë, në kushtet kur ende ka rajone ku pikat postare dhe bankare operojnë off-line, si edhe në kushtet ku në informacionin e gjeneruar nga IT **nuk** përfshihen ato zëra shpenzimesh që lidhen me (a) shpenzimet e varrimit, (b) leje lindjet, dhe (c) karburantin.

Ndikimi/Efekti: Nëse Drejtoria e Financës në ISSH do të mund të bëjë kontroll të tillë, atëherë mund të jap siguri të arsyeshme për shifrën e shpenzimeve, në nivel të konsoliduar.

Shkaku: Mos ardhja e informacionit financiar në kohë reale nga sistemet IT.

Rekomandime: Struktura drejtuese në ISSH të marrin masa për kalimin e cdo pike postare dhe banke duhet të jete online (ende ka rajone që janë offline) si dhe informacioni i përpunuar nga rajonet dhe gjeneruar nga IT të përfshijë edhe: (a) Shpenzimet e varrimit, (b) Leje lindjet, (c) karburantin, etj.

Afati për zbatimin e rekomandimit Në vazhdim

c. Inventarizimi i pasurisë për vitin 2017.

Gjatë auditimit u konstatua se, në përputhje me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 26 e tij, Instituti i Sigurimeve Shoqërore disponon një regjistër në formë kartelash të aktiveve që ka në zotërim ky institucion. Regjistri i aktiveve i vënë në dispozicion i përmbush të gjitha kriteret e udhëzimit të sipërcituar. Bazuar në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve", ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, për mbylljen e rregullt të ushtrimit kontabël dhe llogarive vjetore të vitit 2017, Drejtori i Përgjithshëm ka nxjerrë urdhër inventarizimi nr.9645, date 11.12.2017, në të cilin janë përcaktuar komisionet për kryerjen e inventarëve, detyrat e komisionit, afatet e përfundimit të inventarëve, etj. Për këtë qëllim janë ngritur 3 komisione inventarizimi të përbërë me nga 5 anëtarë:

- komisioni për inventarin ekonomik dhe mjetet kryesore në përdorim të personelit,
- komisioni për mjetet mallrat dhe materialet në magazine,
- komisioni i nxjerrjeve jashtë përdorimit.

Procesverbali për nxjerrje jashtë përdorimi i mbajtur në datën 30.01.2018, nga ku komisioni ka vlerësuar për nxjerrje jashtë përdorimi në zyra të pajisjeve ekonomike, 111 artikuj, me vlerë fillestare 2,277,462 lekë, me konsum të akumuluar 1,599,387 lekë dhe vlerë të mbetur 736,857

⁵⁷ Duke konsideruar se, pikërisht në këtë hallkë të procesit rrezikojmë të kemi "thyerje të kontrollit" nga ana e Drejtorisë së Financës në ISSH, përzgjedhëm 266 çështje, nëpërmjet kryerjes së testeve të detajeve, për shifrën e plotë të shpenzimeve për pensione, kontabilizuar në muajin nëntor, në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, Fier. Nga kryerja e testeve të detajeve mbi popullatën e përzgjedhur na rezultoi se vlera prej 500,679,072 lekë e njohur si shpenzim në kontabilitet rakordon me të dhënat e gjeneruara nga sistemi PCAMS (për pjesën on-line të shpenzimeve), plus pjesa off-line 52,919,856 lekë, e verifikuar me dokumentat justifikues (raportet e postës) dhe stornuar një nga një nga specialisti i pagesave në Rajon.



lekë. Komisioni ka konstatuar materiale jashtë përdorimi në magazinë me një vlerë 1,029,524 lekë, amortizim të akumuluar prej 733,004 lekë dhe vlerë të mbetur 392,379 lekë. Në procesverbal janë shprehur arsyet për nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve, listat e artikujve shoqëruar me vlerën, vitin e hyrjes, amortizimin e akumuluar, vlerën e mbetur dhe personat që i kanë në ngarkim. Afati i përfundimit të inventarëve për mjetet, mallrat dhe materialet në magazinë është caktuar data 25.01.2018 dhe për mjetet dhe pajisjet në përdorim data 30.01.2018. Relacioni mbi rezultatet e inventarizimit është mbajtur në datën 31.12.2017, nga ku rezulton se nuk janë konstatuar diferenca gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen fizike. **Referuar relacionit dhe dokumentacionit të kryerjes së inventarit në magazinë konstatohet se nga inventari nuk janë konstatuar diferenca**, por komisioni i inventarizimit nuk ka vepruar sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", "Përgjegjësitë për inventarizimin" pika 84, ku citohet se "*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material*".

Nga krahasimi me bilancin e ISSH këto vlera nuk paraqesin diferenca.

Sipas sektorit të financës, në përmbledhjen e gjendjes së aktiveve të trupëzuara në një total prej 545,698,952) në mënyrë analitike më poshtë:

-Gjendja e zërit ndërtime në shumën 190,196,304 e ndarë në:

a)Godina në shumën 128,296,050 lekë

b)Instalime të jashtme në shumën 3,792,653 lekë;

c)Projekte e licensa në shumën 58,107,600 lekë.

-Gjendja e zërit Inventar në përdorim, në një total prej 339,500,495 lekë e ndarë në:

a)Automjete në shumën 16,539,760 lekë;

b)Inventar tjetër ekonomik në shumën 322,960,735 lekë.

-Gjendja e zërit Inventar në godine në një total prej 16,002,151 lekë e ndarë në:

a)Automjetë në shumën 4,550,158 lekë;

b)Inventar tjetër ekonomik në shumën 11,451,993lekë.

Në datën 31.12.2017, sipas dokumentit të firmosur nga magazinieri dhe specialistja e buxhetit të brendshëm, gjendja totale e inventarit është 16,002,151lekë, shumë kjo e barabartë me llogarinë e kontabilizuar të inventarit në magazinë. Në përfundim të inventarizimit janë përgatitur listat për çdo llogari dhe për çdo nëpunës që ka në ngarkim mjetet dhe objektet inventariale, si dhe përmbledhësja e të gjitha kartelave të inventarit, të firmosura nga personat përgjegjës dhe antarët e komisionit të inventarizimit. Nga përmbledhja e Inventarit Ekonomik në përdorim nga punonjësit deri në 31.12.2017, të ndarë sipas drejtorive konstatohet se gjendja fizike është e barabartë me atë kontabël në shumën 339,500,495 lekë. Komisioni i ngritur mbi Inventarizimin e materialeve të konsumit në magazinën e ISSH nëpërmjet relacionit datë 31.12.2017, ka deklaruar se nuk janë konstatuar diferenca mes gjendjes fizike dhe kontabël dhe ky inventar përbëhet përkatësisht:

a)Inventari i magazinës përmban 144 artikuj me një vlerë totale prej 13,412,901lekë;

b)Në magazinë ekzistojnë materiale jashtë përdorimit të klasifikuara si më poshtë:

- 30Shtypshkrime të papërdorshme me vlerë 874,421 lekë;

- 17 Artikuj material konsumi të skaduara me vlerë 379,319 lekë.



Konstatohet se ende nuk është marrë vendim nga komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të evidentuara më sipër, duke marrë parasysh gjithashtu se një gjë e tillë është kërkuar edhe në relacionin për inventarizimin e kryer gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017.

Titulli i çështjes:	Auditimi i inventarizimit të pronës
Gjetja 17:	Mos kryerja e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit
Situata	Nga auditimi u konstatua se, me urdhrin e inventarizimit nr. 9645, datë 11.12.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm në ISSH, janë përcaktuar komisionet për kryerjen e inventarëve, detyrat e komisionit, afatet e përfundimit të inventarëve, etj, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 7 “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar; dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Në vijim komisioni ka konstatuar materiale jashtë përdorimi në magazinë me një vlerë 1,029,524 lekë, amortizim të akumuluar prej 733,004 lekë dhe vlerë të mbetur 392,379 lekë. Nga auditimi u konstatua se, ende nuk është marrë ndonjë vendim nga komisioni, për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të evidentuara më sipër, duke konsideruar gjithashtu se sa më sipër është kërkuar edhe në relacionin për inventarizimin e kryer gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017.
Ndikimi:	Për mbylljen e rregullt të ushtrimit kontabël dhe llogarive vjetore
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të ISSH, të ndjekin procedurat ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimi të mallrave të evidentuara nga komisioni i inventarizimit si të papërdorshme nga institucioni prej vitit 2015.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda vitit 2018

d. Rregullshmëria e dokumentave të ditarit të arkës dhe bankës

Shpenzimet administrative përdoren nga ISSH për kryerjen veprimtarisë së saj, për pagat e punonjësve, shpenzime operative, investime, etj. Këto shpenzime në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” planifikohen 2% të buxhetit total të ISSH, janë realizuar në shumën 329,925 mijë lekë, kundrejt 349,736 mijë lekë të planit, pra realizuar në masën 94.3 %. Strukturat drejtuese të ISSH, për vitin 2017 nuk kanë programuar fonde për investime duke mos marrë në analizë investimet e papërfunduara të cilat janë në vazhdim nga viti 2016. Shpenzimet administrative gjatë vitit gjatë vitit janë ndryshuar me 82,746 mijë lekë, ose në masën 31% nga plani fillestar, nga të cilat vetëm zëri “Mallra dhe shërbime” ka ndryshuar në masën 44%, fakt i cili flet për programim të pa studiuar dhe mbështetur në kërkesa dhe nevojat reale të institucionit.



Nga likuidimet e kryera nëpërmjet bankës, u konstatuan, në 5 raste, mangësi në dokumentacionin justifikues për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2012, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" dhe "Dokumentimi i vlerave monetare".

Për periudhën janar 2017 - dhjetor 2017, u audituan veprimet e kryera nëpërmjet bankës, për shpenzimet administrative të Aparatit të ISSH. Nga auditimi me zgjedhje të veprimeve me bankën nga sektori i buxhetit të brendshëm për vitin 2017 rezultoi se:

- Veprimet e kryera me bankën janë kryer me urdhër transferta dhe janë regjistruar në vazhdimësi kronologjikisht në ditarët përkatës.
- Urdhër shpenzimet janë nënshkruar nga personat urdhëruar dhe zbatues, shoqëruar me dokumentacion justifikues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktohet qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues.
- Veprimet ekonomike, janë regjistruar në bazë të dokumenteve autorizuese dhe vërtetuese, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe UMF nr.30, datë 27.12.2012, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", "Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve" dhe "Dokumentimi i vlerave monetare".

Nëpërmjet bankës janë kryer likuidimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, ujë, energji, pagesat ndaj furnitorëve për kontratat e nënshkruara për furnizime dhe shërbime, shpenzime për udhëtime e dieta, etj. U auditua dokumentacioni si vijon: Ditari i regjistrimit të veprimeve të kryera; Dokumentacioni shoqëruar dhe justifikues i likuidimeve të kryera; Dokumentacioni i veprimeve për afatet e likuidimeve. **Në përfundim u konstatua se, janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në:**

- Ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
- Ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare"
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Likuidimet janë kryer në afatet kohore në përputhje me ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

Me Urdhër Transfertën e datës 07.12.2017, nga BKT është likujduar shuma 105,000lekë, "Shoqata SOS" për blerjen e 350 copë kartolina sipas faturës datë 05.12.2017. Prokurimi është kryer referuar urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm nr.9313, datë 21.11.2017. Mungon dokumentacioni shoqëruar si urdhër prokurimi, kërkesat dhe marrja në dorëzim.

Me Urdhër Transfertën e datës 29.12.2017, nga BKT është likujduar shuma 280,800lekë, "Comfort" për shërbimin e sistemit të kondicionimit sipas faturës nr.425, datë 27.12.2017. Prokurimi është kryer referuar kontratës së nënshkruar nga Drejtori Përgjithshëm nr.6762/2, datë 03.10.2017. *Sipas nenit 7 të kontratës "Kërkesat e raportimit"*, kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas një formulari të rënë dakord nga të 2 palët. Bashkëlidhur dokumenteve të bankës mungon dokumenti që vërteton punën e kryer.

Sipas nenit 8 të kontratës "Kushtet e pagesës" përcaktohet se pagesa do të kryhet pas konfirmimit nga personi i autorizuar për ndjekjen e kryerjes së shërbimit si edhe në lidhje me paketat elektronike të njërive, zëvendësimi i tyre do të bëhet në raste të defekteve. Mungon dokumentacioni në lidhje me evidentimin e defekteve/ose jo.



Mungon dokumentacioni shoqërues, vërtetues, pra likujdimi është kryer në kundërshtim me kontratën e nënshkruar nga palët nenet 7 dhe 8, si edhe me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Me Urdhër Transfertën e datës 12.12.2017, nga BKT është likujduar shuma 119,987lekë, “KID ZONE” për blerjen e lodrave sipas faturës nr.7079, datë 12.12.2017.

Mungojnë dokumentet për prokurimin nuk asnjë dokumentacion në lidhje me procedurën e ndjekur për marrjen në dorëzim dhe shpërndarjen, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Me Urdhër Transfertën e datës 29.12.2017, nga BKT është likujduar shuma 25,000lekë, “Endrit Llabut” për argëtimin e fëmijëve me rastin e festave(animator), sipas faturës së thjeshtë tatimore nr.5, datë 27.12.2017. Prokurimi është kryer referuar urdhrin të drejtorit të përgjithshëm nr.9489/1, datë 06.12.2017, nuk ka dokumente tjetër në lidhje me kryerjen e shërbimit.

Me Urdhër Transfertën e datës 21.09.2017, nga BKT është likujduar shuma 28,500 lekë, “SAUBERMACHER” për evadim mbeturinash, sipas faturës nr.285, datë 18.09.2017. Mungojnë dokumentet justifikues bashkëlidhur është vetëm fatura.

Programi “Shpenzimet administrative”, janë realizuar në shumën 329,925 mijë lekë, kundrejt 349,736 mijë lekë të planit, pra realizuar në masën 94.3 %, ose realizuar më pak për 19,811 mijë lekë. Shpenzimet administrative përdoren nga ISSH për kryerjen veprimtarisë së saj, për pagat e punonjësve, shpenzime operative, investime, etj.Këto shpenzime në zbatim të ligjit nr.7703, datë11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” planifikohen 2% të buxhetit total të ISSH. Realizimi i dy viteve parashikimi, ndryshimet gjatë vitit 2017 dhe realizimi i tij, është si në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2016	Fakti 2017	2017			Në %
				Prog. Fillestar	Prog. Ndrysh	Prog.Përf	
	Shpenzime Administrative	390,552	329,925	266,990	82,746	349,736	94.3
1	Paga e shtesa 600	147,103	163,337	146,009	34,610	180,619	90
2	Kontrib. të sigurim shoqërore	21,744	24,477	20,900	4,300	25,200	97
3	Blerje mallra e shërbime	111,450	139,425	97,996	43,090	141,086	99
4	Transferime korente me jashte	1,910	1,862	2,085	-	2,085	89
5	Investime	108,345	824	-	746	746	110

Sipas zërave shpenzimet e këtij programi, janë realizuar si më poshtë:

1.Paga e shtesa (600), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 163,337 mijë lekë, kundrejt 180,619 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 90 %. Krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 16.2 mijë lekë, ose 11 % më shumë.

Për periudhën objekt auditimi, në Drejtorinë e përgjithshme të ISSH-së, rezulton se fondi i veçantë është llogaritur dhe përdorur sipas dispozitave ligjore në fuqi, në zbatim të VKM nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

2.Kontribute Sigurime shoqërore (601), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 24,477 mijë lekë, kundrejt 25,200 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 97 %. Krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 2.7 mijë lekë, ose 13 % më shumë.

3.Blerje mallra e shërbime (602), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 139,425 mijë lekë, kundrejt 141,086 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 99 %. Krahasuar



me vitin e kaluar, ky zë është realizuar më shumë për 28 mijë lekë, ose 25 % më shumë.

Referuar shpenzimeve administrative të kryera për Aparatin e ISSH, konstatohet rritje në zërin “mallra dhe shërbime” në masën 22% krahasuar me vitin 2016, ndërsa vetëm zëri “Shpenzime për mirëmbajtjen” rezulton me rritje në masën 90%. Shpenzimet për mirëmbajtjen rezultojnë në rritje si pasojë e likuidimeve mujore fikse të kryera ndaj operatorit ekonomik “Infosoft System”, për 3 kontratat e shërbimit të nënshkruara si më poshtë:

a. Kontrata nr. 2860/7, datë 29.10.2014, me objekt “*Marrëveshje Shërbimi për Sistemet Informatike të PCAMS për Llogaritjen dhe Caktimin e Pensioneve, FMS për Menaxhimin Financiar, CMIS për Menaxhimin e Deklarimit Online të Kontributeve, Rrjeti informatik dhe pajisje të caktuara të dhomës së Serverave, Pajisje IT për ISSH dhe komunikimin ISSH –Arkiva*”, me afat 4 vjet, në shumën 196,704,000 lekë, likuidimi 4,098,000 lekë/ muaj.

b. Kontrata nr.7467/5, datë 02.12.2016, me objekt “*Mirëmbajtje dhe suporti i shërbimeve të Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore*”, me afat 2 vjet, në shumën 81,300,000 lekë, likuidimi 3,375,000 lekë/muaj.

c. Kontrata nr.7154/5, datë 31.10.2016, me objekt “*Blerje storage dhe migrimi i sistemeve PCAMS&FMS*”, me afat 4 vjet, në shumën 24,732,000 lekë, ku është parashikuar likuidimi i shumës 14,316, 000 lekë, brenda 4 muajve nga lidhja e kontratës dhe shuma 10,416,000 lekë, do të likujdohet shuma 217,000 lekë/muaj.

4.Shpenzime organizata ndërkombëtare (605), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 1,862 mijë lekë, kundrejt 2,085 mijë lekë të planit përfundimtar, pra realizuar në masën 89 %. Krahasuar me vitin e kaluar, ky zë është realizuar në masën 3 % më pak.

5.Shpenzime për investime (231), realizimi i shpenzimeve faktike është në shumën 824 mijë lekë, kundrejt 746 mijë lekë të planit të ndryshuar, pra realizuar në masën 110 %, ose realizuar më tepër për 78 mijë lekë. Duke e krahasuar me vitin e kaluar, ky zë paraqitet me mosrealizim në shumën 107,521 mijë lekë.

Strukturat drejtuese të ISSH, për vitin 2017 nuk kanë programuar fonde për investime duke mos marrë në analizë investimet e papërfunduara të cilat janë në vazhdim nga viti 2016.

Shpenzimet administrative gjatë vitit gjatë vitit janë ndryshuar me 82,746 mijë lekë, ose në masën 31% nga plani fillestar, nga të cilat vetëm zëri “Mallra dhe shërbime” ka ndryshuar në masën 44%, fakt i cili flet për programim të pa studiuar dhe mbështetur në kërkesa dhe nevojat reale të institucionit.

Mbi veprimet e kryera nga arka në lekë dhe në valutë.

Nga auditimi i dokumentacionit të arkës në lekë dhe në valutë për periudhën object auditimi, konstatohet se çdo muaj janë kryer rakordimet e arkës, nëpërmjet procesverbalit të mbajtur mbi gjendjen fizike të arkës në lekë dhe valutë, nga punonjësi i financës me punonjësin e caktuar për lëvizjes së vlerave monetare, sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Për vitin 2017 janë kryer 3 pagesa në valutë për mbulimin e shpenzimeve për shërbimet jashtë vendit, nga ku nuk rezultuan mangësi në dokumentacion/llogaritje të gabuara.

Janë kryer sipas legjislacionit në fuqi shpenzimet për udhëtime e dieta për shërbimet e kryera jashtë vendbanimit, shpenzimet ujë/energji, telefon, etj, ku pagesat janë shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Për 3 rastet e shërbimeve jashtë vendit, titullari i ISSH ka nxjerrë urdhrin për punonjësit që do të kryejnë shërbimin duke përcaktuar qartë kohën e qëndrimit dhe trajtimin financiar të tyre që përfshin dietën ditore, shpenzimet e transportit, shpenzimet e



fjetjes dhe shpenzimet për pagesa të ndryshme sipas VKM nr.870, datë 14.12.2011, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit". Mandatarkëtimet dhe mandate pagesat janë regjistruar në mënyrë kronologjike dhe janë kuadruar çdo 4- mujor.

e.Ligjshmëria e prokurimeve dhe fondeve publike

Në zbatim të pikës nr.B, të programi të auditimit "1345/1, datë 19.01.2108", u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve.
- Dokumentacioni mbi kryerjen e prokurimeve.
- Dokumentacioni shoqërues i likuidimeve të kryera.
- Kontratat e nënshkruara dhe zbatimi i tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:Nga ISSHnuk janë zbatuar plotësisht përcaktimet ligjore të bëra në:

- Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar.
- VKM nr.914, datë 19.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Urdhërin Nr.33, datë 11.07.2013, "Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë", të Ministrisë së Financave.
- VKM nr.710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit"

Prokurimi i fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.

Auditimi është kryer bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 19.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) si edhe në udhëzimet dhe manualët e APP-së.

Për vitin 2017, nga Autoriteti Kontraktor janë programuar dhe realizuar prokurimet si më poshtë:

- Janë programuar 9 procedura prokurimi me vlerë 89,833,340 lekë, nga të cilat është realizuar 1 procedurë prokurimi me vlerë 4,990,000 lekë, ose 5.5% e parashikimit.
- Janë programuar 15 procedura blerje me vlera të vogla, me vlerë 7,249,130 lekë, nga të cilat janë realizuar 18 procedura me vlerë 6,421,209 lekë.

Autoriteti kontraktor nuk ka realizuar 8 procedura prokurimi në shumën 84,833,340 lekë.

Eshtë zhvilluar 1 procedurë prokurimi "kërkesë për propozim" me fond limit 5,000 mijë lekë, dhe është nënshkruar 1 kontratë me vlerë 4,990 mijë lekë me tvsh.

Auditimi është fokusuar në drejtim të:

- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.
- Argumentimi ligjor i procedurave të prokurimit që ka zgjedhur enti prokurues. Realizimi i parimeve themelore të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, barazia e kandidatëve dhe përdorimi ekonomik dhe efektiv i fondeve publike.
- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit.
- Lidhja dhe zbatimi i kontratave, kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve.
- Kërkesat nga degët dhe programimi i nevojave për punë, mallra dhe shërbime.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.
 - Arsyet e mosrealizimit të tenderave dhe a mund të ketë ndodhur që Autoriteti Kontraktor ka shmangur procedurat e tenderimit duke kryer procedura blerje me vlera të vogla.
 - Arsyet mbi domosdoshmërinë e kryerjes së prokurimit dhe si ka ndikuar në vazhdimin e punës ky mosrealizim?
 - Respektimi i afateve nga paraqitja e regjistrat deri në marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve.
 - Komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.
 - Auditim i procedurave të blerjeve me vlera të vogla për të evidentuar mundësinë nëse ka devijime nga programimi ose copëzim fondi për mosrealizim procedure tenderimi.
- Autoriteti Kontraktor ka parashikuar dhe zhvilluar procedurat si mëposhtë:

Në 000lekë

Nr	Objekti i prokurimit	Procedura	Fondi limit	Vlera kontratës	Kontraktor
1	Sigurimi i aseteve të ISSH dhe Drejtorisë së Arkivit Qëndror	Kërkesë për propozim	5,000	4,990	INSIG
2	Blerje shtypshkrime dhe materiale të tjera	“ “	5,500	-	
3	Blerje karburant dhe vaj	“ “	1,666		
4	Blerje bileta avioni	“ “	2,000		
5	Pajisje dhe shpenzime instalimi telekomunikimi	“ “	8,000		
6	Makineri printimi dhe fotokopje	“ “	7,500		
7	Blerje mjete dhe pajisje teknike	“ “	2,167		
8	Blerje orendi zyre	“ “	8,000		
9	Rikonstruksion ndërtese	“ “	50,000		
	Shuma		89,833	4,990	

Konstatohet se nuk janë realizuar prokurimet e parashikuara, nga 9 procedura është realizuar 1 procedurë dhe janë anuluar 2 procedura nga Komisioni i Prokurimit Publik, me objekt “Blerje shtypshkrime” me fond limit 5,500 mijë lekë dhe “Blerje rafte metalike” me fond limit 5,900 mijë lekë, referuar ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë të cilat lidhen me hartimin e kriterëve të kualifikimit nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti kontraktor ka bërë programim të fryrë të nevojave, ka parashikuar dhe nuk ka realizuar prokurimet me objekt: “Blerje karburant dhe vaj” në shumën 1,667 mijë lekë, “Shtypshkrime & Dokumentacion” në shumën 5,092 mijë lekë, “Bileta udhëtimi” në shumën 2,000 mijë lekë, “Pajisje telekomunikimi” në shumën 8,000 mijë lekë, “Printera & fotokopje” në shumën 7,500 mijë lekë, “Pajisje teknike” në shumën 2,167 mijë lekë, “Orendi & pajisje zyresh” në shumën 8,000 mijë lekë dhe “Rikonstruksion i Arkivit” në shumën 50,000 mijë lekë.

Në lidhje me procedurat e prokurimit të parashikuara dhe të pa realizuara konstatohet se parashikimi nuk është kryer bazuar në nevojat reale të institucionit, sepse nuk konstatohen ndërpreje/mangësi në kryerjen e detyrave edhe nga moskryerja e prokurimeve.

Referuar prokurimeve të pa realizuara konstatohet se AK, nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore mbi prokurimin publik, si ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” si edhe Manualin e Prokurimit Publik, ku përcaktohet se Autoriteti Kontraktor programon sipas nevojave vjetore sasinë e mallrave/punëve dhe shërbimeve.

Autoriteti kontraktor nuk ka realizuar procedurat e parashikuara duke u bazuar edhe në VKM nr. 482 datë 05.07.2017 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sigurimi i aseteve të ISSH dhe Drejtorisë së Arkivës Qendrore”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Sigurimi i aseteve të ISSH dhe Arkivës Qendrore”		
Urdhër Prokurimi Nr.9708/1 Dt 13.12.2017	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Termat e Reference Urdhër Nr. 9315, dt.01.12.2017 F.Gj Shefe Kontabilitet E.D Shef IT E.D Spec. Adminst. P.R Spec Finance M.Z Spec Statist. Njësia Prokurimit N.C Inxhinierë B.D Jurist E.P Inxhinier	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 9708/3dt. 26.12.2017 Emër Mbiemër E.N Dr. administrimit L.A Dr.IT K.Xh Jurist
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë/propozim”		
Fondi Limit (pa tvsh) 5,000,000lekë	Oferta fituese 4,990,000 lekë	Diferenca me fondin limit 10,000 Lekë
Data e hapjes së tenderit 26.12.2017 ora 11	Burimi Financimit Buxheti i ISSH	Operatorët Ekonomike Pjesëmarrës në tender 1 “INSIG”
Zbatimi i Kontratës Shërbimit		
Lidhja e kontratës Nr. 17725/Datë 10.01.2018	Vlera e kontratës 4,990,000 lekë	Likuiduar 4,990,000 Lekë UT, BKT nr.507, datë 17.01.2018

Njësia e prokurimit, ka hartuar dokumentet e tenderit bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) si edhe referuar termave të referencës dhe specifikimeve teknike të hartuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Njësia e Prokurimit ka përllogaritur fondin limit, ka hartuar e miratuar kërkesat për kualifikim dhe dokumentet e tenderit.

Sipas procesverbalit të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në datën 26.12.2017, në platformën elektronike në faqen e internetit të APP, ka paraqitur ofertën vetëm operatori ekonomik “INSIG” në shumën 4,990 mijë lekë.

Komisioni ka vlerësuar ofertën e paraqitur dhe shpallur fituese pasi plotëson kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Procedura e ndjekur është kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi mbi prokurimin publik.

Prokurimi i fondeve publike për mallra/shërbime me vlera të vogla.

Për prokurimet me vlera të vogla, titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr.631, datë 23.01.2017, ka ngritur komisionin e blerjeve të vogla i përbërë nga E.P, N.Ç dhe B.D.

-Janë programuar 15 procedura blerje me vlera të vogla, me vlerë 7,249 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 18 procedura me vlerë 6,421 mijë lekë.

Prokurimet me vlera të vogla, janë kryer në platformën elektronike dhe për rastet e mosrealizimit të procedurës elektronike janë kryer procedurat shkresore, nga ku janë shpallur fitues operatorët ekonomikë të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulëta. Nga auditimi i dokumentacionit konstatohen mangësi në drejtim të kriterëve të përcaktuara për pjesëmarrjen e operatorëve



ekonomikë ku në disa raste janë kërkesa të ekzagjeruara të cilat çojnë në përcakimin e fituesit, mungojnë kërkesat nga degët për punë, mallra dhe shërbime por ato janë të hartuara nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm dhe miratuar nga titullari, në kundërshtim me Urdhërin Nr.33, datë 11.07.2013, “Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë”, të Ministrisë së Financave.

Mangësi në ofertat e paraqitura të cilat janë pa data ose në disa raste datojnë 1-3 ditë më parë ose më vonë, se të lind nevoja për kryerjen e prokurimit dhe nuk japin mundësinë për të gjykuar për procedurën e ndjekur, etj mangësi në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë Financave.

Janë kryer prokurime referuar urdhrave të drejtorit për përdorimin e fondit të veçantë për blerjen e lodrave për 74 fëmijë me rastin e vitit të ri, në shumën 119,987 lekë, shuma 25,000 lekë, për argëtimin e fëmijëve me rastin e festave(animator), shuma 23,100 lekë, për blerje lule për 110 gra të ISSH me rastin e 8 Marsit, shuma 240,841 lekë, “Nano Resort” për organizimin e festës së 8 marsit. Në disa raste prokurimet me vlera të vogla janë shoqëruar me mangësi në dokumentacionin e prokurimit dhe atë justifikues.

Me Urdhër Transfertën e datës 12.12.2017, nga BKT është likujduar shuma 119,987lekë, “....” për blerjen e lodrave sipas faturës nr.7079, datë 12.12.2017. Prokurimi është kryer referuar kërkesës nr.9489, datë 09.12.2017 të Drejtorit dhe shefit të sektorit të marrëdhënive me publikun A.B dhe I.Ç, miratuar nga Drejtori Përgjithshëm, ku kërkohet blerja e lodrave për 74 fëmijë me rastin e vitit të ri. Mungon dokumentacioni shoqërues, si urdhër prokurimi, ftesë/ofertë, kritere specifike, etj,

Janë bashkëlidhur 3 oferta, si mëposhtë:

-..... në shumën 119,987 lekë, datë 08.12.2017

-..... në shumën 122,692 lekë me tvsh, datë 06.12.2017

-..... në shumën 131,720 lekë me tvsh, datë nuk ka, 2017. Po kështu ky subjekt është agjenci shërbimesh, e vërtetuar në aktivitetin e tij por edhe në shërbimet hidraulike të kryera në këtë institucion.

Konstatohet se ofertat e paraqitura nuk janë të krahasueshme për t’u vlerësuar sepse 2 ofertat e kanë përcaktuar çmimin me tvsh, ndërsa oferta 1 nuk ka përcaktuar nëse në çmim është përfshirë ose jo tvsh. Mungojnë dokumentet për prokurimin nuk ka asnjë dokumentacion në lidhje me vlerësimin e ofertave, procedurën e ndjekur, marrjen në dorëzim, shpërndarjen,etj.

Ky prokurim është kryer formalisht sepse edhe ofertat datojnë 1-3 ditë më parë se të lind kërkesa dhe miratimi nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me Urdhër Transfertën e datës 16.03.2017, nga BKT është likujduar shuma 205,200 lekë, “Infosoft office” për blerje materiale kancelarie, sipas faturës nr.493, datë 24.02.2017. Prokurimi është kryer referuar urdhrat të prokurimit nr.1400/1, datë 14.02.2017 me fond limit 200,000 lekë, kërkesa nr.1400, datë 14.02.2017 nga E.N dhe miratuar nga drejtori përgjithshëm, nuk ka kërkesa nga degët me Urdhërin Nr.33, datë 11.07.2013, “Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë”, të Ministrisë së Financave.



-Mungon llogaritja e fondit për disa prej artikujve nuk ka detajim të specifikimeve teknike, por kërkohen vetëm si emërtim, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Në ftesën për ofertë është kërkuar afati i lëvrimit të mallit brenda 1 dite, ky kriter është diskriminues sepse operatorët ekonomikë që mund të marrin pjesë në prokurim nuk e kanë kohën e mjaftueshme për lëvrimin e mallit, fakt i cili vërtetohet edhe se nuk janë paraqitur 3 nga operatorët ekonomikë të renditur dhe ka fituar i katërti.

Me Urdhër Transfertën e datës 16.03.2017, nga BKT është likujduar shuma 516,000 lekë, "... " për blerje materiale pastrimi, sipas faturës nr.94, datë 23.02.2017. Prokurimi është kryer referuar urdhrin të prokurimit nr.1273/1, datë 13.02.2017 me fond limit 590,000 lekë, kërkesa nr.1273, datë 10.02.2017 nga E.N dhe miratuar nga drejtori përgjithshëm mungojnë kërkesat nga degët në kundërshtim me Urdhërin Nr.33, datë 11.07.2013, "Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë", të Ministrisë së Financave.

Janë kërkuar specifikime të ekzagjeruara për artikujt e prokuruar si: % e celulozës, % e butësisë së letrës, bardhësia më >86%, përbërja e larësit të duarve me disa përbërës që nuk mund të verifikohen në momentin e magazinimit si edhe nuk ka bashkëlidhur hyrjes ose procedurës fletë analiza, etj, ndërsa për artikuj si shapka/çizme etj, nuk kërkohet asnjë specifikim në lidhje me materialin, ngjyrën, modelin, etj, veprime në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Me Urdhër Transfertën e datës 17.03.2017, nga BKT është likujduar shuma 240,841 lekë, "....." për organizimin e festës së 8 marsit, sipas faturës nr.412, datë 09.03.2017. Prokurimi është kryer referuar urdhrin të prokurimit nr.1855/2, datë 07.03.2017 me fond limit 237,500 lekë, kërkesa nr.1855, datë 07.03.2017 nga E.N dhe miratuar nga drejtori përgjithshëm. Janë kërkuar specifikime të ekzagjeruara të cilat kanë ndikuar në përcaktimin e fituesit, si:-salla 300 metra; -muzike live;-vend parkimi për 70 automjete;-internet WI-FI në ambjentet e brendshme;-shërbimi kërkohet në afërsi të Arkivit Qëndror Lundër jo me larg se 2 km

-autobuz me kondicioner etj, për të ftuarit pa automjete. Lista e pjesëmarrëseve në festë nuk është e nënshkruar e cila konfirmon numrin e tyre. Procedura prokurimi me vlerë të vogël të cilat kanë objekt dreka/darka festive janë në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të cilët synojnë mirëpërdorim të fondeve publike.

Me Urdhër Transfertën e datës 12.09.2017, nga BKT është likujduar shuma 728,400 lekë, "... " për blerje tonera, sipas faturës nr.654, datë 07.08.2017. Prokurimi është kryer referuar urdhrin të prokurimit nr.5016/3, date 03.08.2017 me fond limit 607,000 lekë, kërkesa nr.5016, datë 01.06.2017 nga E.N dhe miratuar nga drejtori përgjithshëm, nuk ka kërkesa nga degët.

Procedura është kryer shkresore bazuar në 3 oferta, si pasojë e mosrealizimit të procedurës në sistemin elektronik e cila është anuluar si pasojë e mosparaqitjes në afatin e përcaktuar në ftesën/ofertë të të 5-të operatorëve ekonomikë.

Ofertat bashkëlidhur -.... në shumën 645,000 lekë, pa datë; -....në shumën 697,500 lekë, pa datë; - Infosoft në shumën 728,400 leke, pa datë, të cilat nuk japin mundësinë për marrjen në kohë dhe zbatimin e procedurave ligjore të prokurimit.

Me Urdhër Transfertën e datës 12.09.2017, nga BKT është likujduar shuma 621,600 lekë, "... " për blerje letër format A4, sipas faturës nr.645, datë 07.08.2017. Prokurimi është kryer referuar urdhrin të prokurimit nr.6670/1, datë 01.08.2017 me fond limit 550,000 lekë.



Autoriteti kontraktor ka zhvilluar 3 procedura prokurimi me vlera të vogla, me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 250 mijë lekë, “Blerje tonera” me fond limit 800 mijë lekë dhe “Blerje letër A4” me fond limit 600 mijë lekë, me fitues të njëjtin operator ekonomik “I..”, në shumën 1,650 mijë. AK, për përdorim me efektivitet të fondeve dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duhet të parashikonte dhe zhvillonte 1 procedurë tenderi “Kërkesë për propozim” duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28/2 “Metodat e llogaritjes së vlerës në kontratat publike”.

Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit ku përcaktohet se Njësia e prokurimit duhet të kryejë minimumi 1 trajnim në vit.

Titulli i çështjes**Gjetja 18:
Situata****Auditimi i shpenzimeve administrative****Programimi i shpenzimeve për prokurime**

Autoriteti Kontraktor nuk ka realizuar prokurimet e parashikuara, nga 9 procedura të parashikuara, është realizuar 1 procedurë dhe janë anuluar 2 procedura nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në lidhje me procedurat e prokurimit të parashikuara dhe të pa realizuara vlerësojmë se parashikimi nuk është kryer bazuar në nevojat reale të institucionit, sepse nuk konstatohen ndërpreje/mangësi në kryerjen e detyrave edhe nga moskryerja këtyre e prokurimeve. AK, nuk ka programuar drejt e sipas nevojave vjetore sasinë e mallrave/punëve dhe shërbimeve, në kundërshtim kjo me kërkesat e parashikuara në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke realizuar kështu prokurimet në masën vetëm 5.5% nga sa ishin planifikuar.

Ndikimi:**Kriteri:**

Risqe që lidhen me realizimin e objektivave të njësisë

Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” si edhe Manualin e Prokurimit Publik

Rekomandimi:

Autoriteti kontraktor, njësia e prokurimit dhe dega e administrimit, të hartojnë nevojat për punë, mallra dhe shërbime, bazuar në nevojat reale, me qëllim arritjen e prioriteteve të caktuara dhe prokurimeve me efektivitet, ekonomikitet dhe efincencë

**Afati për zbatimin
e rekomandimeve**

Në vazhdim

**Gjetja 19:
Situata****Mbi prokurimet me vlera të vogla**

Nga auditimi mbi prokurimet me vlera të vogla në Aparatin e ISSH, u konstatuan mangësi në drejtim të kriterëve të përcaktuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, ku mungojnë kërkesat nga degët për punë, mallra dhe shërbime pasi ato janë të hartuara nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm dhe miratuar nga titullari, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 33, datë 11.07.2013, “Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë”, të Ministrisë së Financave. Strukturat



drejtuese të ISSH, nuk kanë përcaktuar dhe miratuar rregullat e brendshme për gjurmët e auditimit për blerjet me vlera të vogla⁵⁸, me qëllim që të sigurohet dokumentimi i operacioneve të njësisë publike në atë formë, që t’u mundësojë audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse, të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Konkretisht u konstatua se:

-Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit/shërbimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, “Për prokurimet me vlera të vogla” pika 4, si dhe Urdhrin e Ministrisë Financave nr. 57, datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

-Procedurat për blerjet me vlera të vogla, në shumicën e rasteve janë kryer në formë shkresore, nëpërmjet formularit të emergjencës ose si pasojë e anulimit të procedurës në sistemin elektronik.

-Mangësi në ofertat e paraqitura të cilat janë pa data ose në disa raste datojnë 1-3 ditë më parë/ më vonë, se të lind nevoja për kryerjen e prokurimit në kundërshtim me VKM nr.914, date 29.12.2014 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave.

-Autoriteti kontraktor ka zhvilluar 3 procedura prokurimi me vlera të vogla⁵⁹, dhe jo “Kërkesë për propozim”, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28/2 “Metodat e llogaritjes së vlerës në kontratat publike”,

-Njësia e prokurimit nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit Publik;

- Në kushtet kur, cilësia dhe çmimi përcaktohen/diferencohen në specifikimet teknike, konstatojmë mungesa të specifikimeve teknike në disa procedura të kryera për blerjet me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe VKM nr. 914, datë 20.12.2014, neni 27.

-Në 5 raste, pagesat e kryera për prokurime mallra dhe shërbime, kanë mangësi në plotësimin me dokumente justifikues, procesverbale, etj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

Ndikimi:

Kontrolle të dobëta në procesin e prokurimit

Kriteri:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, date 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr. 659, datë 03.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjetet elektronike”, Udhëzimi i APP Nr. 7, datë 20.12.2012 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e

⁵⁸ në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin,

⁵⁹ me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 250 mijë lekë, “Blerje tonera” me fond limit 800 mijë lekë dhe “Blerje letër A4” me fond limit 600 mijë lekë, me fitues të njejtin operator ekonomik “Infosoft”, në shumën 1,650 mijë



prokurimit elektronik për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë” Urdhëri Nr.33, datë 11.07.2013, “Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë”, të Ministrisë së Financave dhe Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit public.

Rekomandimi:

-Nëpunësi Autorizues dhe Titullari i institucionit, në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartojnë dhe miratojnë rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve.

-Autoriteti kontraktor, të marrë masa, që të mos kalohet asnjë blerje apo shërbim me procedurë të vogël, pa u kaluar nëpërmjet platformës elektronike, në respektim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

-Njësia e Prokurimit, të marrë të gjitha masat, që specifikimet teknike, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kritere të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik, me qëllim arritjen e mallrave dhe shërbimeve me cilësinë e kërkuar.

-Autoriteti kontraktor, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, me qëllim përmirësimin e punës së Njesisë së Prokurimit për hartimin e nevojave, kërkesave, hartimin e specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit të nevojshëm për kryerjen e blerjeve me vlera të vogla, etj.

Afati për zbatimin e rekomandimit: Në vazhdim

Mbi zbatimin e kontratave

Referuar shpenzimeve administrative të kryera për Aparatin e ISSH, konstatohet rritje në zërin “mallra dhe shërbime” në masën 22% krahasuar me vitin 2016, ndërsa vetëm zëri “Shpenzime për mirëmbajtjen” rezulton me rritje në masën 90%. Shpenzimet për mirëmbajtjen rezultojnë në rritje si pasojë e likujdimeve mujore fikse të kryera ndaj operatorit ekonomik “Infosoft System”, për 3 kontratat e shërbimit të nënshkruara si më poshtë:

a. Kontrata nr.2860/7, datë 29.10.2014, me objekt “Marrëveshje Shërbimi për Sistemet Informatike të PCAMS për Llogaritjen dhe Caktimin e Pensioneve, FMS për Menaxhimin Financiar, CMIS për Menaxhimin e Deklarimit Online të Kontributeve, Rrjeti informatik dhe pajisje të caktuara të dhomës së Serverave, Pajisje IT për ISSH dhe komunikimin ISSH –Arkiva”, me afat 4 vjet, në shumën 196,704,000 lekë, likujdimi 4,098,000 lekë/muaj.

b. Kontrata nr.7467/5, datë 02.12.2016, me objekt “Mirëmbajtje dhe suporti i shërbimeve të Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore”, me afat 2 vjet, në shumën 81,300,000 lekë, likujdimi 3,375,000 lekë/muaj.

c. Kontrata nr.7154/5, datë 31.10.2016, me objekt “Blerje storage dhe migrimi i sistemeve PCAMS&FMS”, me afat 4 vjet, në shumën 24,732,000 lekë, ku është parashikuar likujdimi i shumës 14,316,000 lekë, brenda 4 muajve nga lidhja e kontratës dhe shuma 10,416,000 lekë, do të likujdohet shuma 217,000 lekë/muaj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Kontratat e shërbimit, nuk janë hartuar në përputhje me aneksin 2, të Udhëzimit nr. 2, datë 02.09.2013 “Për standardizimin e hartimit të termave të referencës për projektet TIK në Administratën Publike” Kap III pika 10 Aneksi 2. Referuar Udhëzimit të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar, MNSH-ja duhet të ishte si aneks më vete bashkëlidhur kontratës. Sipas Aneksit 1 të këtij udhëzimi duhet të ishin përcaktuar elementë të rëndësishëm për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes, si drejtuesi i projektit, personi i kontaktit, përkufizimet e termave teknikë, përshkrimi i shërbimeve, të drejtat dhe detyrimet e institucionit dhe të ofruesit të shërbimit, menaxhimi i shërbimeve, disponueshmëria e shërbimit, kufizimet e mundshme, mirëmbajtja e sistemit/ve, penalitetet e mundshme, dokumentacioni mbështetës, ndërprerja e MNSH-së, dhe të tjerë elementë të rëndësishëm që përcaktohen në këtë aneks.

Nga auditimi konstatohet se punonjësi i cili konfirmon kryerjen e shërbimit, nënshkruan faturat mujore të paraqitura nga operatori ekonomik, konstaton defektet/mbarëvajtjen e shërbimit është njëherazi edhe kryetar komisionit të vlerësimit të ofertave. Kontrata përmban zërat:

Nr	Emërtimi	Sasia	Çmimi pa tvsh	Çmimi me tvsh	Afati lëvrim
1	Blerje San Storage HPE 3PAR Store Serv 8000	1	6,410,000	7,692,000	4 muaj nga lidhja e kontratës
2	Migrimi i sistemeve (PCAMS, FMS, Infrastrukturore)	1	5,200,000	6,240,000	4 muaj nga lidhja e kontratës
3	Mirëmbajtja 4 vjeçare	4	2,170,000	10,416,000	4 vjet nga lidhja e kontratës
4	Trajnim on Job	1	320,000	384,000	4 muaj nga lidhja e kontratës
Shuma				24,732,000	

Si shihet edhe nga tabela, konstatohet se zëri “Mirëmbajtje 4 vjeçare” ka peshën më të madhe në vlerën totale të kontratës, ose 2,724 mijë lekë më të lartë se vlera e mallit, referuar kësaj vlere AK, do t’i jepej mundësia për blerjen dhe instalimin e një pajisjeje tjetër të re. Në dokumentet e tenderit është përcaktuar garancia për pajisjen 1 vit, ndërsa mirëmbajtja 4 vjet, zëri i mirëmbajtjes nga AK, është parashikuar në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, pika 2/a/b ku citohet se: në rastet e zhvillimit të sistemeve të reja të informacionit kohëzgjatja e marrëveshjes duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 vjet, ndërsa institucionet që kanë sisteme ekzistuese mirëmbajtja nuk duhet të jetë më e shkurtër se 2 vjet.

Pra, sa më lart konstatohet se vlera për mirëmbajtjen e kontraktuar në shumën 10,416,000 lekë, nga autoriteti Kontraktor nuk duhet të jetë 4 vjet por jo më e shkurtër se 2 vjet. Kontrata është nënshkruar në 31.10.2016 dhe mirëmbajtja për 4 vjet nga nënshkrimi i kontratës pra, kontrata përfundon më 31.10.2020 dhe shuma 5,208,000 lekë, është kontraktuar në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013. *Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në: Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar; VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”; Urdhërin Nr.33, datë 11.07.2013, “Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë”, të Ministrisë së Financave; VKM nr.710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe*



Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”; dhe Manualin e Prokurimit Publik.

IV. Zbatimi i detyrave të lëna në auditimin e mëparshëm

Nga auditimi i dokumentacionit në dispozicion, rezulton se në ISSH, nga 17 rekomandime të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, 5 rekomandime janë zbatuar, 7 rekomandime janë në proces, 4 rekomandime nuk janë zbatuar dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Me shkresën e KLSH nr.190/8, datë 13.07.2017 është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet. ISSH ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet,

personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. ISSH ka kthyer përgjigje KLSH me shkresën nr.723/15, datë 08.08.2017, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i aktivitetit ekonomiko-financiar për vitin 2016”.

Rekomandimi 1

(1.1) ISSH të kërkojë nga Ministria e Financave që të jetë pjesë aktive në procesin e programimit dhe projektimit të të ardhurave, të cilat në çdo kohë duhet të programohen bazuar në analizë të detajuar të shpenzimeve të pritshme të skemës, kjo do të sigurojë edhe një bashkëpunim në kohë reale dhe në mënyrë operative me strukturat që brenda DPT sigurojnë informacionin mbi kontributet e sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

(1.2) Të kërkohej në rrugë institucionale (përmes një marrëveshje mirëkuptimi midis dy institucioneve) të trajtohen problematikat e mbledhjes së kontributeve përmes takimeve periodike mujore kjo duke i shërbyer këmbimit të informacionit por edhe trajtimit me profesionalizëm dhe me të njëjtin standard të kontribuesve të kësaj skeme.

Në zbatim të Rekomandimit 1

(1.1) Në zbatim të këtij rekomandimi ISSH ka vazhduar bashkëpunimin me DPT dhe konkretisht në kuadrin e hartimit të Programimit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020 i janë kërkuar DPT treguesit e realizimit të pritshëm të numrit të kontribuesve dhe të të ardhurave për vitin 2017, treguesit e programuar për vitin 2018 si dhe për vitet 2019-2020. Shkresa e ISSH, nr.637/1, datë 26.07.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020”, drejtuar DPT dhe për dijeni MMSR.

Në përgjigje të shkresës nr.637/1, datë 26.07.2017, DPT me shkresën nr.17692/1, datë 03.8.2017 “Kthim përgjigje”, drejtuar ISSH dhe për dijeni MMSR, ka dërguar vetëm të dhënat e realizimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2017 duke u shprehur njëkohësisht se të dhënat e programimit buxhetor afatmesëm përgatiten nga Ministria e Financave.

Nga MMSR nuk ka patur asnjë reagim lidhur me shkresat që i drejtohen për dijeni, ndërsa Ministria e Financave vazhdon detajimin e treguesit të të ardhurave kontributive, vetëm në mijë lekë, pa treguesit e tjerë bazë, si numri i kontribuesve dhe paga mesatare, mbi të cilën duhet bërë programimi i të ardhurave nga kontributet, për fondin e sigurimeve shoqërore dhe përfondin e sigurimeve shëndetësore.

(1.2) ISSH dhe DPT, kundrejt këtij rekomandimi të KLSH, kanë rënë dakort për bashkëpunimin institucional dhe kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017, me qëllim ripërcaktimin e detyrave dhe komunikimeve midis DPT-së dhe ISSH-së.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces

**Rekomandimi 2**

ISSH përmes MMSR dhe MF të kërkojë ndërhyrje për të rregulluar përmes një baze ligjore, procedurat dhe rregullat e transferimit on-line elektronik të listëpagesave mujore të subjekteve fizik dhe juridik (*private dhe publike*) në kohë reale, si dhe pagesave të realizuara nga ato. Të bëhet rakordimi i të dhënave të kontabilitetit me bazën e të dhënave për llogaritjen e treguesve të skemës në mënyrë që të sigurohet konsistenca në treguesit vjetor të paraqitur. ***Brenda vitit 2017***

Në zbatim të Rekomandimit 2

Për të rregulluar përmes një baze ligjore, procedurat dhe rregullat e transferimit on-line elektronik të listëpagesave mujore të subjekteve fizikë dhe juridikë (*private dhe publike*) në kohë reale, si dhe pagesave të realizuara nga ato, është parashikuar dhe rënë dakort sipas konceptimit të bërë në Kreun IV “Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve” dhe në Kreun V “Detyrime të Institutit të Sigurimeve Shoqërore” të *Marrëveshjesë Bashkëpunimit nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017.*

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Rekomandimi 3

(3.1) ISSH të kërkojë bashkëpunimin e MMSR, MBZHRAU, MF dhe ekspertëve më me zë të fushës së sigurimeve të fshatit, në mënyrë që të kordinohen dhe harmonizohen treguesit e kësaj skeme me masat e ndërmarra në kuadër të strategjisë së zhvillimit bujqësor, me qëllim arritjen e pjesëmarrjes në skemën e sigurimit shoqëror të gjithë të vetëpunësuarve që kryejnë aktivitet ekonomik në sistemin e bujqësisë.

(3.2) Të merren masa edhe për ngritjen profesionale të personave që ndjekin skemën e mbledhjes së të ardhurave të këtij sektori, shoqëruar me vendosjen e treguesve të matshëm të performancës së punonjësve me numrin e kontribuesve të skemës.

(3.3) Të ketë një programim më të kujdesshëm të të ardhurave të sigurimit vullnetar duke reflektuar trendin rënës të kësaj skeme, verifikuar në këtë vit dhe karakteristikat e çdo rajoni.

Menjëherë dhe në vijimësi

Në zbatim të Rekomandimit 3

Në zbatim të këtij rekomandimi, ISSH ka përfunduar në grup pune materialin konstruktiv “Rikonceptimi i skemës në zonat rurale” në kuadër të strategjisë së zhvillimit bujqësor, me qëllim arritjen e pjesëmarrjes në skemën e sigurimit shoqëror të të gjithë të vetëpunësuarve që kryejnë aktivitet ekonomik në sistemin e bujqësisë.

Rikonceptimi i skemës në zonat rurale është një material paraprak dhe konstruktiv për vijimësinë e studimit më të thelluar dhe më të bashkërenduar me aktorë të tjerë që veprojnë në fshat, me instanca të tjera qëndroresi MBZHR dhe MF si dhe me ekspertë në fushën e sigurimeve të fshatit.

(3.1) Në zbatim të këtij nënrekomandimi që ISSH të kërkojë bashkëpunimin e MMSR, MBZHRAU, MF fillimisht grupi i punës ka bashkëpunuar për disponimin e të dhënave që kanë lidhje me tregues të zonave rurale që disponojnë këto dikastere. Kështu në materialin konstruktiv “Rikonceptimi i skemës në zonat rurale” lidhur me të dhënat e zonave rurale më pak të avantazuara është komunikuar me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe konkretisht shkresa e ISSH nr.9710, datë 12.12.2017 “Kërkohen të dhëna analitike për zonat më pak të avantazuara të vendit” dhe përgjigjia e MBZHR me shkresën nr.9110/1, datë 29.12.2017 “Mbi dërgimin e të dhënave të kërkuara”. Me këtë praktikë kjo ministri ka dërguar edhe udhëzimin e përbashkët të MBUMK dhe MF nr.3, datë 10.2.2001 “Mbi përcaktimin e zonave më pak të



avantazhuara malore".Referuar udhëzimit të përbashkët të dy dikastereve është strukturuar materiali "Rikonceptimi i skemës në zonat rurale".

Po kështu për bashkëpunimin me aktorë të tjerë që veprojnë në fshati janë kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të dhëna për numrin e fermerëve të pajisur me NIPT si dhe lista e fermerëve të pajisur me NIPT dhe të ndarë sipas Drejtorive Rajonale Tatimore.DPT me shkresën nr.28155/1, datë 18.12.2017 "Kthim përgjigje"ka vënë në dispozicion këtë listë me CD dhe aktualisht nga ISSH po identifikohendhe evidentohenfermerët që janë pajisur me NIPT dhe nuk janë të siguruarnë skemën e sigurimeve shoqërore.

(3.2)Lidhur me vendosjen e treguesve të matshëm të performancës së punonjësve me numrin e kontribuesve të skemës, ky problem është trajtuar me prioritet dhe në vazhdimësi nga Këshilli Administrativ i ISSH dhe për këtë qëllim Këshilli Administrativ ka miratuar dy vendime:

a.Vendim i Këshillit Administrativ nr. 7, datë 20.01.2007 në pikën 1, të tij ka të miratuar: "Inspektorët e kontributeve të personave të vetëpunësuar në bujqësi të shpërblehen çdo muaj me pagë mujore minimale dhe me një shtesë, që llogaritet në përqindje mbi të ardhurat e realizuara në territorin që mbulon".

Ky vendim është zbatuar me korrektësi nga të gjithë Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe gjatë kontrollit, marrë shkas nga rekomandimi i KLSH, kanë rezultuar përlllogaritje të plota dhe të sakta shpërblimi për çdo inspektor të të vetë punësuarve në bujqësi.

b.Vendim i Këshillit Administrativ nr. 9, datë 20.10.2014 në të cilin është miratuar shtesa e pikës 1/1, në vendimin e mësipërm: "Inspektorët e kontributeve të personave të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga zonat e përcaktuara sipas ndarjes së kuotës vjetore të derdhjes së kontributeve, për çdo kontribues të futur për herë të parë në skemën e sigurimit shoqëror, përveç shpërblimit sipas pikës "1" do të marrin një bonus prej 3.4% të shumës së kontributeve të paguara, që i përkasin vitit korrent".

Duke marrë shkas nga rekomandimi i KLSH, ISSH ka verifikuar zbatimin e këtij vendimi dhe ka rezultuar se 5 Drejtori Rajonale e zbatonin këtë vendim dhe 7 Drejtori Rajonale nuk e zbatonin vendimin për dhënien e bonusit prej 3.4% për inspektorët e të vetëpunësuarve në bujqësi. Në këto kushte, ISSH për zbatimin e këtij vendimi nga të gjithë Drejtoritë Rajonale, ka dërguar shkresën nr.9397, datë 24.11.2017 "Për zbatimin e Vendimit të Këshillit Administrativ nr.7, datë 13.04.2017, të ndryshuar".

(3.3)Referuar treguesve në rënie të skemës vullnetare për vitin 2016, krahasuar me një vit më parë 2015, nga ISSH është bërë një programim istudiuar mirë për vitin 2017.Fokusi është drejtuar tek rajonet me më shumë prurje dhe me më shumë kapacitete për planifikimin e të ardhurave për çdo DRSSH.Të ardhurat e kësaj skeme për vitin 2017, janë realizuar në masën 103%.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Rekomandimi 4

ISSH të kërkojë përmes Ministrisë së Financave, bashkëpunimin me DPT në hartimin e një plani masash konkrete jo vetëm për të monitoruar dhe mbajtur nën kontroll borxhin në drejtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore por për të siguruar përmes një procedure të menduar mire pagesën e këtij borxhi, referuar detyrimit të papaguar kjo jo vetëm për shkak të mungesës së të ardhurave që krijon për skemën e sigurimeve por impaktin e lartë në jetën e qytetarëve të cilët humbasin pjesën e pensionit për shkak të detyrimeve të papaguara.Masat shtrënguese të mbledhjes së borxhit për kontributin e sigurimeve shoqërore nuk duhet të jenë të njëjta si për detyrimet e tjera tatimore për shkak të risqeve fiskale dhe sociale që shoqërojnë këto detyrime të paguara.

*Menjëherë***Në zbatim të Rekomandimit 4**

Gjatë vitit 2017 subjektet debitoare në organet tatimore kanë qenë nën influencën e zbatimit të ligjit nr.33/2017 "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore". Me këtë ligj ka falje së kushtëzuar së gjobave dhe të kamatëvonesave për subjektet debitoare që likuidojnë detyrimet kontributive, të prapambetura të sigurimeve shoqërore, deri në fund të vitit 2017. Evidencat e subjekteve debitoare të fundit të vitit 2017, pas sistemimit të veprimeve nga organet tatimore, krahasuar me evidencën e debitorëve të fundit të vitit 2016 do të ndikojnë pozitivisht, në uljen e numrit të subjekteve debitoare dhe të detyrimeve të tyre të prapambetura. Megjithatë, në zbatim të këtij rekomandimi, referuar detyrimit të papaguar kjo jo vetëm për shkak të mungesës së të ardhurave që krijon për skemën e sigurimeve, por edhe për impaktin e lartë në jetën e qytetarëve të cilët humbasin pjesën e pensionit, për shkak të detyrimeve të papaguara, ISSH i është drejtuar Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë z.Arben Ahmetaj me shkresën nr.7635, datë 18.09.2017 "Informacion për numrin e subjekteve debitorë dhe për detyrimet e tyre të prapambetura të tyre, në organet tatimore, deri më 15.08.2017". Në zbatim të këtij rekomandimi DPT, ka dërguar nëpërmjet emailit/mujor, në ISSH listën e subjekteve debitoare dhe nga ISSH është dërguar lista e subjekteve debitoare pranë çdo DRSSH të cilat kanë bërë grupimet e subjekteve debitoare në kategori: buxhetore, jobuxhetore, ndërmarrje shtetërore, biznes i madh. Biznes i vogël.

*Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.***Rekomandimi 5**

ISSH të kërkojë ndërhyrjen e Ministrisë së Financave dhe nëse është e nevojshme edhe Kryeministrin për të finalizuar administrimin e dokumentacionit të listëpagesave të periudhës deri në vitin 2012, dokumentacion që krijon pengesa të mëdha për përfituesit fundor të skemës së sigurimeve, qytetarët që vuajnë papërgjegjshmërinë e administratës tatimore në manaxhimin e këtij problem.

*Menjëherë***Në zbatim të Rekomandimit 5**

ISSH dhe DPT në pikën 2, të kreut IV, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.5.2017, me qëllim administrimin e listëpagesave të periudhave deri në vitin 2012, kanë rënë dakort që DPT, ndër të tjera të dërgojë zyrtarisht, në format letër: "Listëpagesat e padërguara në ISSH nga administrata tatimore, të periudhave nga tetori 2003 deri më 31.12.2011". Kundrejt kësaj marrëveshje dhe bashkëpunimit ndërmjet Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorive Rajonale tatimore është bërë e mundur që gjatë vitit 2017 të dërgohen nga Drejtoritë Rajonale Tatimore në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore gjithsej 60,732 listëpagesa të munguara të formatit letër, nga të cilat: 469 janë listëpagesa të subjekteve publikë; 20,375 janë listëpagesa të firmave private dhe 39,888 janë listëpagesa të të vetëpunësuarve.

ISSH në kuadër të mungesave të listëpagesave ka informuar edhe për mungesat e listëpagesave të formatit elektronik dhe jo vetëm kaq por edhe për mangësitë e konstatuara në këto listëpagesa me shkresën nr.7753, datë 21.09.2017 "Mbi disa probleme për dërgimin e listëpagesave, të formatit elektronik dhe për lëshimin e vërtetimeve, të kontributeve të paguara, për individët", drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni z.Arben Ahmetaj, Ministër i Financave dhe



Ekonomisë. Aktualisht ISSH është në një procedurë bashkëpunimi me DPT ku po bëhet e mundur zgjidhja e problemit të mungesës së listëpagesave të formatit letër të subjekteve biznesi i vogël me një të vetëpunësuar, numri i të cilave arrin deri në 50% të listëpagesave të munguara gjithsej.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Rekomandimi 6

Nga strukturat drejtuese të ISSH, për të minimizuar deficitin financiar të degës së pensioneve të fshatit, e veçanërisht shpenzimet për skemën e barrë lindjeve, duhet të bëhen studime të mirëfillta e të veçanta, duke evidentuar masat që do garantojnë mbajtjen në nivele të kontrollueshme të deficitit të kësaj Dega, pa harruar projeksionet lidhur me Degën e Pensioneve të Qytetit, sensibiliteti i së cilës mbetet i lartë.

Në vijimësi

Në zbatim të Rekomandimit 6

Në materialin konstruktiv “Rikonceptimi i skemës në zonat rurale” kundrejt varianteve të rritjes së ardhurave kontributive, nga sigurimi i të vetëpunësuarve në bujqësi, është parashikuar që në vitin 2020 të futen në skemën e fshatit 120,000 fermerë dhe kundrejt pagesave kontributive të rritura, drejt barazimit të kuotave të vetëpunësuarve rural me të vetëpunësuarit urban, llogariten të realizohen të ardhurat në rreth 8 miliardë lekë, gjë që përmirëson ndjeshëm dhe balancon deficitin financiar, të degës së pensioneve të fshatit. Kundrejt një analize të veçantë pune së bashku me materialin konstruktiv “Rikonceptimi i skemës në zonat rurale” do t’i paraqiten Këshillit Administrativ të ISSH propozimet konkrete dhe masat tekniko-organizative, përfshi edhe masat shtërnguese, për rritjen e të ardhurave dhe të numrit të kontribuesve në skemën e fshatit. Nga ISSH është dërguar memo e datës 07.03.2018, Ministrisë të Financave në të cilën analizohet subvencionin i lartë nga Buxheti i Shtetit për bujqit, si edhe ndryshimet e propozuara për këtë skemë si edhe ndryshimet ligjore që duhen bërë në disa nene të ligjit nr.7703/1993. Ky rekomandim është në proces dhe ende nuk është marrë vendimi i KA.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Rekomandimi 7

Performanca e Drejtorive Rajonale në lidhje me shërbimin ndaj qytetarëve, duhet të bëhet objekt analize në Këshillin Administrativ të ISSH, ku të përcaktohen edhe masat konkrete si për eliminimin e rasteve të caktimit të pensioneve jashtë afateve, ashtu edhe masat administrative për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sidomos në rajonet: Berat, Kukës, Durrës dhe Tiranë.

Menjëherë

Në zbatim të Rekomandimit 7

Për zbatimin e këtij rekomandimi, ISSH ka kryer analiza të vazhdueshme dhe inspektime në lidhje me shërbimin ndaj qytetarëve, për shkaqet e vonesave, etj, duke propozuar masa konkrete për eliminimin e rasteve të pensioneve jashtë afatit ligjor. Analiza e fundit për këtë qëllim është zhvilluar në datën 07.02.2018.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi 8

Nga Strukturat Drejtuese e Menaxhuese të ISSH, si dhe nga Ministria e Financës, të meren masa për iniciimin e ndryshimeve të nevojshme në VKM nr.8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 këh në muaj” e njëjtë si për pensionistët e fshatit dhe të qytetit, duke saktësuar të gjitha rastet, për të



mos lënë vend për keq interpretim, mungesë objektivizmi e standarte të dyfishta në trajtimin e shtresave të pensionistëve.

Menjëherë

Në zbatim të Rekomandimit 8

Ky rekomandim ka gjetur zbatim nëpërmjet VKM nr.495, datë 29.06.2016 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300kë/muaj”. Sa i takon familjeve të pensionistëve në fshat, ky vendim është zbatuar për vitin 2017, nga ku numri i familjeve përfituese është rreth 13000 familje.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi 9

Nga Strukturat Drejtuese e Menaxhuese të ISSH dhe Ministrisë së Financës, të bëhet analiza dhe rregullimi i të gjitha rasteve përjashtimore nga ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, brenda kufirit maksimal të përcaktuar në VKM nr.730, datë 02.09.2015 “Për një ndryshim të VKM nr.429, datë12.02.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore”, në mënyrë që të eliminohen standardet e dyfishta që për të drejta të barabarta përfitimi të mos jetë i njëjtë.

Brenda vitit 2017

Në zbatim të Rekomandimit 9

ISSH, ka ngritur vazhdimisht këtë problem, por nuk ka gjetur zbatim rregullimi i pensioneve të vjetra të cilat janë përfituar me VKM.Për vitin 2017, nuk janë lidhur pensione për raste përjashtimore nga ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

Rekomandimi 10

Nga Strukturat Drejtuese e Menaxhuese të ISSH dhe Ministrisë së Financës, të bëhet analizimi dhe evidentimi i të gjitha rasteve të invalidëve të krijuar nga viti 2008 e në vazhdim, në mënyrë që edhe këta invalidë të përfitojnë furnizimet me karburant dhe mjetet lëvizëse nga këto shpenzime që u takojnë me ligj.

Menjëherë

Në zbatim të Rekomandimit 10

ISSH, nëpërmjet takimeve dhe korrespondencave shkresore me Ministrinë e Punës dhe Ministrinë e Financave, është kërkuar kalimi i kësaj kategorie për tu trajtuar pranë Shërbimit Social Shtetëror , por ende nuk ka gjetur zgjidhje.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

Rekomandimi 11

Për të shmangur parregullsitë e korigjimet në përmbledhësen e pasqyrave financiare të ISSH, në udhëzimin e MF, të përcaktohet një datë e realizueshme për ISSH të mbylljes së transaksioneve vitit ushtrimor. Dorëzimi i përmbledhëses së pasqyrave financiare, të realizohet pas rakordimit përfundimtar për të ardhurat me Drejtorinë e Tatimeve dhe Ministrinë e Financës, duke eliminuar kështu korigjimin e të ardhurave pas dorëzimit të pasqyrave përmbledhëse financiare. Nga strukturat menaxhuese të ISSH, FDSKSH dhe MF, të bëhet sistemimi i llogarisë 44 “Institucione të tjera publike” në shumën 275.5 milion lekë, duke respektuar nga MF, të ardhurat që i takojnë institucioneve ISSH dhe ISKSH.

Brenda vitit 2017

Në zbatim të Rekomandimit 11

Për këtë rekomandim nga strukturat drejtuese të ISSH është kryer një korespondencë e vazhdueshme me Ministrinë e Financave, por ende nuk ka gjetur zgjidhje dhe **nuk** janë marrë



masa për sistemimin e llogarisë 44 “Institucione të tjera publike” në shumën 275.5 milion lekë, duke respektuar nga MF, të ardhurat që i takojnë institucioneve ISSH dhe ISKSH.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

Rekomandimi 12

Drejtoria Juridike dhe Sekretaria e KA të ngrejë një grup pune të përbashkët për të bërë të mundur përmbledhjen e të gjitha rregulloreve në fuqi në një rregullore të vetme me qëllim që të bëhet më efektiv zbatimi i tyre dhe referenca të jetë konform përcaktimeve në Statutin e ISSH dhe ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Në vijimësi

Në zbatim të Rekomandimit 12

Drejtoria Juridike dhe Sekretaria e Këshillit të Administrimit, referuar këtij rekomandimi kanë përcaktuar në planin e masave grupin e punës i cili ka hartuar rregulloren e re, me qëllim përmbledhjen e rregulloreve të veçanta të degëve në 1 rregullore të vetme, duke përcaktuar funksionimin dhe detyrat e çdo dege dhe punonjësi, konform përcaktimeve në Statut dhe ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Grupi i punës është ngritur me urdhrin nr.9166, datë 13.11.2017. Rregullorja ka përfunduar dhe është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr. 2115, date 15.03.2018⁶⁰.

Ky rekomandim konsiderohet në proces.

Rekomandimi 13

ISSH të rishikojë periodikisht kontratat tip të punës për përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi dhe nëse vlerësohet e arsyeshme të dërgojë për miratim në KA ndryshimet përkatëse në to. ISSH të rishikojë dosjet e personelit për të siguruar që informacioni i administruar në to është i plotë dhe dokumenton të gjithë procesin nga rekrutimi, vlerësimi, ndryshimet në vendin e punës e deri në shkëputjen e këtyre marrëdhënieve nga punëmarrësi. Gjithashtu ISSH duhet të vlerësojë nevojën për ndryshime në rregulloret dhe procedurat përkatëse për të garantuar që procesi i menaxhimit dhe vlerësimit të burimeve njerëzore të mbështesë dhe nxisë përmbushjen e objektivave prioritare të ISSH.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i pa zbatuar.

Rekomandimi 14

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të marrë masa të menjëhershme për të ndryshuar fokusin e auditimit të brendshëm nga ajo e inspektimit në auditimin e mirëfilltë ku objektivi kryesor të jetë dhënia e garancisë së arsyeshme menaxhmentit të ISSH mbi funksionimin e sistemeve dhe mekanizmave të menaxhimit dhe kontrollit. Të rriten përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve profesionale për të ndërmarrë në të ardhmen misionet auditimi mbështetur në vlerësimin e riskut dhe materialitetit me bazë regjistrin institucional të vlerësimit dhe menaxhimit të riskut në ISSH.

Në vazhdimësi

Në zbatim të Rekomandimit 14

Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm dhe Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve pranë ISSH, pas një vlerësimi të punës dhe drejtimeve kryesore për realizimin nga secila drejtori, kanë marrë në shqyrtim eliminimin e dublimit të proceseve të punës. Për këtë qëllim nëpërmjet shkresës nr. 7376 prot., datë 07.09.2017 është kryer një ndryshim brenda

⁶⁰ Rekomandimi konsiderohet në proces për sa kohë që ende nuk na është vënë në dispozicion një kopje e Rregullores së re, nga ku grupi I auditimit të KLSH të verifikojë reflektimin e ndryshimeve të propozuara nga KLSH.



strukturës organizative, e konkretisht në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm është hequr sektori i auditimit të përfitimeve afatgjata dhe personeli në këtë drejtori është reduktuar me 3 punonjës të cilët ishin pjesë e këtij sektori, të cilët kaluan në strukturën e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve pranë ISSH. Me këtë ndryshim stukturor Drejtoria e Auditit të Brendshëm që nga muaji shtator 2017 përbëhet nga sektori i auditimit financiar dhe sektori i raporteve e menaxhimit të riskut. Gjithashtu është bërë një rishikimin e programeve të auditimit duke marrë në konsideratë jo vetëm ndryshimet stukturore brenda drejtorisë por në bazë të përcaktimeve të kap IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me Urdhërin e Ministrisë të Financave nr.100, datë 25.10.2016, angazhimet e auditimeve janë fokusuar në auditimin dhe vlerësimin e proceseve dhe funksioneve që realizohen në sistemin e sigurimeve shoqërore.

Vlerësimi dhe menaxhimi i Riskut

Për kryerjen e menaxhimit të riskut, DAB ka kryer një rivlerësim duke marrë në konsideratë proceset dhe funksionet që realizohen në sistemin e sigurimeve shoqërore. Vlerësimi i riskut është kryer duke u bazuar në efektin e tij dhe shkallës së probabilitetit të ndodhjes së ngjarjes. Në bazë të rezultateve të arritura nga ky rivlerësim janë ndërtuar në vazhdimësi programet e auditimeve duke i dhënë rëndësi proceseve dhe funksioneve me risk të lartë.

Për të kryer një vlerësim më të plotë të riskut për vitin 2018, DAB ka kërkuar nga DRSSH-të dhe DSSH-të të kryejnë vlerësimin e riskut individual në bazë të proceseve dhe funksioneve që kryhen në secilën prej tyre.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Rekomandimi 15

Drejtori i Përgjithshëm i ISSH të marrë masa që ISSH të ndërtojë dhe zbatojë një strategji të menaxhimit të burimeve njerëzore duke e mbështetur dhe me financimet përkatëse për realizimin me sukses të saj. Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore duhet të ndërtojë çdo vit planin për trajnimin dhe edukimin e vazhdueshëm të personelit dhe të raportojë periodikisht në lidhje me zbatimin e tij. ISSH duhet të kryejë një vlerësim të ngarkesës në punë për çdo pozicion pune dhe të përgatisë një raport me propozime përkatëse për rialokim të burimeve njerëzore me qëllim ruajtjen e një klime motivuese për personelin si dhe tërheqjen dhe mbajtjen e një stafi të mirëkualifikuar.

Në vazhdimësi

Në zbatim të Rekomandimit 15

Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka hartuar dhe miratuar planin e trajnimeve nr.1401, datë 14.02.2017 “Planifikimi i trajnimeve për vitin 2017”, në të cilin janë përcaktuar temat kryesore sipas fushave si: 7 tema trajnimi për drejtorinë e përfitimeve, 7 tema trajnimi për drejtorinë e kontributeve, 4 tema trajnimi për drejtorinë e finances, 4 tema trajnimi për drejtorinë juridike, 4 tema trajnimi për administrim të përgjithshëm, 3 tema trajnimi për drejtorinë e arkivës dhe nga 1 temë për drejtorinë e auditit dhe të certifikimit. Pra, në planin e trajnimeve janë parashikuar të zhvillohen 31 trajnime. Referuar informacionit nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Sektori i trajnimeve, konstatohet se plani i trajnimeve është realizuar rreth 40%, duke u fokusuar jo vetëm në temat e parashikuara por edhe në trajnime të tjera të nevojshme nga ndryshimet në legjislacion. Strukturat drejtuese ende nuk kanë hartuar strategjinë e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 16

ISSH të dërgojë një urdhëresë të gjitha KMCAP rajonale ku të bashkëlidhë listën e mjekëve që janë emëruar në KMCAP epror me qëllim që KMCAP rajonal të njoftojë pacientët që nuk



pranohen konsulta më të specializuara për konfirmim të diagnozave të ndryshme për efekt të vlerësimit të paaftësisë nga mjek specialistë që janë njëkohësisht anëtar të KMCAP epror sipas listës, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit orientimin e drejt dhe të saktë të pacientëve për konsultat e mundshme në mjek të specializuar.

ISSH të marrë masa për të siguruar të dhënat dokumentare njësoj si për çdo punonjës të ISSH për mjekët që janë emëruar nga KM në KMCAP epror dhe shpërblehen për punën e tyre nga ISSH dhe ti administrojë ato tek Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të ISSH.

ISSH të marrë masa për të vënë në lëvizje dikasteret përkatëse të ngarkuara me përgjegjësinë e përzgjedhjes, propozimit dhe miratimit në KM të mjekëve zëvendësues të anëtarëve të komisioneve respektive të KMCAP epror me qëllim plotësimin e kërkesave ligjore dhe rritjen e efektivitetit të komisioneve të KMCAP epror, mos pengimin e vendimmarrjes e tyre në raste të mungesave për arsye të ndryshme dhe ofrimin në kohën e duhur të shërbimit ndaj pacientëve

Në vazhdimësi

Në zbatim të Rekomandimit 16

ISSH, ka dërguar listat e mjekëve si edhe ka njoftuar drejtoritë e rretheve për mjekët e emëruar në KMCAP. Në lidhje me përcaktimin e diagnozave nga mjekë të tjerë, ISSH ka konstatuar problematika në kempet e tjera në disa rrethe, si pasojë e mungesës së mjekëve specialist të diagnozave të ndryshme (sa i takon fletëve të drejtimit të mjekëve për diagnozat). Në kempin qëndror është zgjidhur problematika e zëvendësimit të anëtarëve të komisioneve të mjekëve.

Ky rekomandim konsiderohet i pranuar dhe në proces.

Rekomandimi 17

Instituti i Sigurimeve Shoqërore të marrë masa për të forcuar sistemet e kontrollit të brendshëm në institucion në mënyrë që të eliminohen praktikat e gabuara, duke theksuar se pavarësisht përhapjes së vogël vëmendja e drejtuesve në zbatimin e rregullshmërisë financiare duhet të jetë e madhe. Të eliminohen rastet e deviacioneve nga baza rregullative në pagesën e shpenzimeve për dieta dhe udhëtime.

Në zbatim të Rekomandimit 17

Strukturat drejtuese kanë marrë masa për forcimin e sistemeve të kontrollit, nga auditimi i kryer për vitin 2017, në shpenzimet e kryera për udhëtime dhe dieta nuk u konstatuan mangësi.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

Titulli i çështjes: Auditimi i zbatimit të rekomandimeve

Gjetja 20	Mbi zbatimin e rekomandimeve
Situata	KLSH në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e punës në ISSH ka rekomanduar 17 masa organizative. Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, rezultoi se nga ISSH janë pranuar 17 rekomandime të lëna nga KLSH, nga të cilat 4 rekomandime janë zbatuar, 8 rekomandime janë në proces, 4 rekomandime nuk janë zbatuar dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht.
Kriteri	Shkresa e KLSH nr.190/8, datë 13.07.2017, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet.
Ndikimi/Efekti	Përmirësimi i punës në ISSH



Niveli i Prioritetit	I Lartë
Rekomandimi	Strukturat drejtuese të ISSH, të marrin masa të përcaktojnë personat përgjegjës dhe analizojnë nivelin e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces dhe atyre ende të pa zbatuara, me qëllim përmirësimin e punës, brenda vitit 2018.
Afati për zbatimin e rekomandimit	Brenda vitit 2018

V. TË NDRYSHME GJATË AUDITIMIT

1.Mbi certifikimine dosjeve të pensioneve

Administrimi i fondeve të sigurimeve shoqërore, përfitimeve, procedurat të caktimit dhe kryerja e pagesave të pensioneve në 12 DRSSH sipa prefekturave dhe në dy degë rajonale që janë Saranda dhe Tropoja, janë objekt i çertifikimit nga njësia e Inspektimit të Përfitimit të Pensioneve.

Njësia e Inspektimit të Përfitimeve funksionon si strukturë e veçantë në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm. Njësia e Inspektimit të Përfitimeve ka filluar veprimtarinë e saj në bazë të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 146, datë 01.12.2010 si dhe u konsolidua me miratimin nga Këshilli Administrativ të Rregullores nr. 1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr. 1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, të ndryshuar, Rregullores nr. 25/1, datë 04.03.2011 “Për një Shtesë në rregulloren nr. 25/1, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar, dhe Rregullores nr. 3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr. 3, datë 15.08.1996 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare”.

Në zbatim të rregulloreve të sipërpërmendura, ky sektor kontrollon dosjet e pensioneve dhe çertifikon përfitimet (*pensione pleqërie, invaliditeti, familjar dhe pensionet sociale*), si dhe përfitimet suplimentare të caktuara në zbatim të ligjeve për skemat suplimentare dhe trajtimeve të veçanta që janë caktuar saktë, dhe për shkeljet në moszbatim të dispozitave ligjore, mban aktkonstatimin dhe procesverbalin përkatës për secilin rast. Gjithashtu inspektorët, paralelisht me kontrollin fizik të dosjes kryejnë dhe kontrollin në sistemin elektronik të llogaritjes dhe pagesës së pensioneve (PCAMS) për saktësinë e të dhënave dhe rakordimin e masave të pensionit në sistem, me dosjen fizike, ku dhe reflektohen dosjet e çertifikuara, si dhe dosjet e konstatuara me problematikat përkatëse.

Veprimtaria e Sektorit të Inspektimeve Afatgjata, nuk konsiston thjesht në inspektim, por në kontroll **dhe çertifikim të çdo pensioni**, që caktohet në sistemin e Sigurimeve Shoqërore mbi bazën e Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu ky sektor kontrollon përfitimet e caktuara në zbatim të ligjeve për Skemat e Sigurimeve Shoqërore Suplementare dhe të Trajtimeve të Veçanta, të financuara nga Buxheti i Shtetit. Ky sektor kontrollon dosjet e pensioneve dhe çertifikon përfitimet, që janë caktuar saktë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi, dhe për përfitimet, në të cilat gjen moszbatim të dispozitave ligjore dhe shkelje apo gabime, mban aktkonstatimin dhe procesverbalin përkatës për secilën dosje. Njësia e Inspektimit të Përfitimeve për vitin 2017 e cila ka në organikë të saj 18 persona



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

funksionon me dy sektorë, që janë: Sektori i Përfitimeve Aftgjatë (me 14 inspektorë) dhe Sektori i Suplimentarit (me 2 inspektorë). Kjo njësi ka audituar sipas programit të auditimit nr. ekstra datë 02.01.2017 në 11 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me periudhë kontrolli viti 2013 deri më 31.12.2016, duke përfshirë dosje të reja 33,510, dosje të pensione suplimentare 7,018, **në total 40,528** dosje, referuar programit vjetor të kontrollit të vitit 2017, rezulton se nuk janë përfshirë DRSSH Elbasan dhe Fier , Gjirokastrë, Berat, Fier, Dibër dhe Shkodër .

Referuar të dhënave të Njësi e Inspektimit të Pensioneve (kontrolli në Sektori i Përfitimeve Afatgjatë), gjatë vitit 2017) rezultoi se ka përfunduar inspektimin në DRSSH Durrës, DRSSHTiranë (për vitet 2013-2015), në DRSSH Vlorë (për vitet 2013-2015), DSSH Sarandë , DRSSHKukës dhe DSSHTropojë për periudhën 2015-2016). Nuk janë kontrolluar përfitimet suplimentare dhe përfitimet nga trajtimet e veçtë në DRSSH Durrës dhe Vlorë .

Çertifikimi si proces kontrolli është i rëndësishëm dhe kryerja e këtij procesi për cdo vit, ka të bëjë direkt në përdorimin me efektivitet të fondeve të pensioneve , në zbatim të kërkesave të ligjit nr. ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 (suplementi shtetëror), ligji nr.10142, datë 15.05.2009, ligji nr.10 139, date 15.05.2009, ligji nr.8607, datë 27.04.2000, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Më hollësisht sipas dosjeve të kontrollit gjetjet e konstatuara paraqiten si më poshtë vijon:

Inspektimi i përfitimeve afatgjata nga skema e detyrueshme. (Përfitimet e caktuara me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar).

Problematika në lidhje me çertifikimin e pensioneve:

a- Gjatë vitit 2017 janë kontrolluar **40,305** dosje, dhe janë çertifikuar **36,692** dosje, të pa çertifikuar rezultojnë 3,613 dosje.

b- Rezultojnë 357 dosje me detyrime debitore 15,194,854 lekë.

c- Rezultojnë 729 dosje me detyrime kreditore 23,874,042 lekë.

Në total dëmi ekonomik i rezultuar është 39,068,896 lekë, detyrime të papaguara gjatë vitit 2017, që rëndojnë buxhetin e vitit 2017 të ISSH për pensionet.

d- Rezultojnë dosje të pakontrolluara nga viti 2014 deri më 31.12.2017 gjithsej 96,321 doje të lidhura sipas ligjit nr.7703,datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Lista nr.1

Në lekë

Evidenca e dëmit të rezultuar gjatë kontrolleve për vitin 2017 në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar							
	DREJTORITË RAJONALE / DEGËT - ISSH						TOTALI
	Durrës	Tiranë	Vlore	Sarandë	Kukës	Tropojë	
	PERIUDHA E KONTROLLUAR						
	01.01.2013 31.12.2015	01.01.2013 31.12.2014	01.01.2013 31.12.2015	01.01.2013 31.12.2015	01.01.2015 01.12.2016	01.01.2015 31.12.2016	
Dosje për kontroll	10948	17201	7143	3809	955	249	40,305
Dosje të certifikuara	10225	15276	6792	3543	672	184	36,692
Dosje të pacertifikuara	723	1925	351	266	283	65	3,613
% e dosjeve të pacertifikuara	7.1%	11.2%	5.2%	7.5%	29.7%	26%	8.96%
Pezullime	6	13	1	0	5	1	26



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Rishqyrtime	214	537	196	161			1108
Detyra për rishqyrtime	152	587	13	8	125	30	915
% e dosjeve të lidhura gabim	3.4%	6.6%	3.1%	4.4%	13.6%	12.5%	5%
Detyra për plotësim e verifikim	255	691	107	47	122	26	1248
Dosje me probleme mjekesore	96	97	28	50	31	9	311
Dosje me probleme të tjera			6				6
Dosje të rezultuara debitore	118	105	47	87			357
Vlera e dëmit	5,819,122	3,970,112	2,133,385	3,272,235			15,194,854
Dosje të rezultuara kreditore	100	426	132	71			729
Vlera e demit	3,089,446	9,709,169	6,752,456	4,322,971			23,874,042
Totali i demit							
Dosje gjithsej	218	531	179	158			1,086
Vlera	8,908,568	13,679,281	8,885,841	7,595,206			39,068,896

Inspektimi i përfitimeve afatgjata nga skema e detyrueshme. (Përfitimet e caktuara me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.)

Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata gjatë vitit 2017 ka përfunduar programin e kontrollit dhe si rezultat çertifikimin i pensioneve në 6 DRSSH si më poshtë :

- DRSSH Durrës,(për periudhën 01.01.2013-31.12.2015), është e pa mbuluar viti 2016 e në vazhdim. Dosje të kontrolluara janë 10,948, të çertifikuara 10,255 dhe të rezultuara me detyrime debitore 118 dhe shuma e dëmit e konstatuar është 5,819,122 lekë. Dosje me detyrime kreditore rezultojnë 100 me vlerë dëmi 3,089,446 lekë.

-DRSSH Tiranë (për periudhën vitet 2013-2014), është e pa mbuluar viti 2015, 2016 e në vazhdim. Dosje të kontrolluara janë 17,201, të çertifikuara 15,276 dhe dosje me detyrime debitore 105 dhe shuma e dëmit e konstatuar është 3,970,112 lekë dhe 426 dosje kreditore me vlerë dëmi 9,709,169 lekë.

- DRSSH Vlorë, (për periudhën 01.01.2013-31.12.2015), është e pa mbuluar viti 2016 e në vazhdim. Rezultojnë se janë kontrolluar 7,143 dosje , janë çertifikuar 6,792 dosje. Rezultojnë dosje debitore 47 dhe shuma e dëmit të konstatuara është 2,133,385 leke dhe 132 dosje kreditore me vlerë dëmi 8,885,841 lekë.

-DSSH Sarandë, (për periudhën 01.01.2013-31.12.2015), është e pa mbuluar viti 2016 e në vazhdim. Janë kontrolluar 3,809 dosje nga të cilat janë çertifikuar 3,543 rezultojnë 87 dosje me detyrime debitore në shumën prej 3,272,235 lekë dhe me detyrime kreditore 71 dosje në vlerë dëmi 4,322,971 lekë.

- DRSSH Kukës,(për periudhën 01.01.2015-31.12.2016), është e pa mbuluar viti 2016 e në vazhdim.

- DSSH Tropojë, (për periudhën 01.01.2015-31.12.2016), është e pa mbuluar viti 2016 e në vazhdim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

Ndërkohë auditimi i përfitimeve të caktuara për periudhën 01.01.2014 - 31.12.2015 në DRSSH Berat, DRSSH Dibër dhe DRSSH Gjirokastër, nuk ka asnjë informacion për përfundimin e auditimit të këtyre DRSSH. I cili ka filluar datë 7.11.2017 dhe përfundon për dy rajonet e para datës 31.01.2018 dhe për DRSSH Gjirokastër datë 16.02.2018.

Gjithashtu nga auditimi i dosjeve të kontrolluara nga njësia e inspektimit të Përfitimit u konstatua se rezultojnë më datën 01.01.2018 gjithsej 96,321 dosje të lidhura për pensione në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar për 12 DRSSH për vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe të pa kontrolluara nga Njësia e Inspektimit të Pensioneve. Të analizuar sipas llojit të pensioneve për 12 DRSSH paraqiten si më poshtë vijon:

Lista nr.2

		Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar						P. soci al	p. social	p. social	P. social	Shuma
											1.1.2018	
N r	DRSSH	Periudha kontrollit	2014	2015	2016	2017	Tot.	2015	2016	2017	Tot.	
1	Fier	01.01.2016 31.12.2017	0	0	4225	3841	8066	0	92	48	140	8206
2	Vlore	01.01.2016 31.12.2017			3752	3267	7019		28	18	46	7065
3	Durres	01.01.2016 31.12.2017	0	0	3311	3190	6501	0	104	73	177	6678
4	Tirana	03.01.2015 31.12.2017		9620	9686	8632	27938	144	252	220	616	28554
5	Berat	01.01.2016 31.12.2017			1916	1661	3577		32	12	44	3621
6	Gjirokast er	01.01.2016 31.12.2017			1641	1465	3106		12	5	17	3123
7	Diber	01.01.2016 31.12.2017			1181	1182	2363		51	30	81	2444
8	Shkoder	01.07.2014 31.12.2014 +2015+2016 +2017	1322	2739	2775	2521	9357	101	33	29	163	9520
9	Korca	01.01.2015 31.12.2015 +2016+2017	0	3517	3547	3547	10611	170	87	27	284	10895
10	Kukes	01.01.2017	0			591	591			12	12	603
11	Lezhe	01.01.2015 31.12.2015 +2016+2017	0	1641	1632	1471	4744	159	51	22	232	4976
12	Elbasan	01.01.2015- 31.12.2015 +2016+2017	0	3971	3059	3079	10109	409	86	32	527	10636
	Totali		1,322	21,488	36,725	34,447	93,982	983	828	528	2,339	96,321

B. Sektori i Inspektimit të Përfitimeve nga skemat suplementare e trajtimet e veçanta.

Në ISSH, nga auditimi i zbatimit të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 (suplementi shtetëror), ligji nr.10142, datë 15.05.2009, ligji nr.10 139, datë 15.05.2009, ligji nr.8607, datë 27.04.2000, etj akte nënligjore për suplementin, rezultoi:

Konstatim:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "Institutin e Sigurimeve Shoqërore"

a-Gjatë vitit 2017 janë kontrolluar 5 DRSSH dhe që i përkasin **5,513** dosje, nga të cilët janë çertifikuar **4,917** dosje, të pa çertifikuar rezultojnë 596 dosje.
 b-Janë konstatuar 101 dosje me detyrime debitore në vlerë dëmi të konstatuar 11,904,229 lekë dhe 62 dosje me detyrime kreditore me vlerë dëmi 1,631,917 lekë.
 c- Rezultojnë dosje nga viti 2014 deri më 31.12.2017 të pa kontrolluara nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve për Pensione që përfitojnë nga skema e suplementit nga zbatimi i ligjeve të cituara më lart gjithsej 5,661 dosje.

Pasqyra e dëmit nga përfitimet suplementare për vitin 2017 sipas Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore sipas periudha të kontrollit paraqitet si më poshtë vijon:

Lista nr.3

Në lekë

	DREJTORITË RAJONALE - ISSH					Totali
	BERAT	GJIROKASTER	SHKODER	KORÇE	TIRANE	
	PERIUDHA E KONTROLLUAR					
	01.01.2014 31.12.2016	01.01.2014 31.12.2016	01.07.2014 31.12.2016	01.01.2014 31.12.2016	01.01.2015 31.12.2016	
Dosje për kontroll	226	473	377	859	3,578	5,513
Dosje të certifikuara	213	376	357	803	3,168	4,917
Dosje të pa certifikuara	13	97	20	56	410	596
% e dosjeve të pacertifikuara	5.7%	20%	4.5%	6%	14%	12.6%
Pezullime	0	2	3	4	12	21
Rishqyrtime	10	16	10	19	126	181
Detyra për plotësim e verifikim	13	95	17	52	394	571
% e dosjeve të lidhura gabim	10%	23.9%	7.9%	8.7%	11.3%	10.3%
Dosje të rezultuara debitore	8	6	6	13	68	101
Vlera e dëmit	639,918	1,457,191	458,524	1,628,160	7,720,436	11,904,229
Dosje te rezultuara kreditore	2	10	4	6	40	62
Vlera	4,721	555,429	120,136	211,501	740,130	1,631,917
Dosje në total	10	16	10	19	108	163
Totali i Dëmit	644,639	2,012,620	578,660	1,839,661	8,460,566	13,536,146

Sektori i Inspektimit të Përfitimeve nga skemat suplementare e trajtimet e veçanta ka përfunduar programin e plotë të kontrollit në

- **DRSSH Berat**, për periudhën 01.01.2014-31.12.2016, e pa mbuluar viti 2017 e në vazhdim. Dosje të kontrolluara 226 nga të cilat janë çertifikuar 213 dosje. Rezultojnë dosje debitore 8 me vlerë dëmi 639,918 lekë dhe 2 dosje kreditore me vlerë dëmi 4,721 lekë.

- **DRSSH Gjirokastër**, për periudhën 01.01.2014-31.12.2016, pa mbuluar viti 2017 e në vazhdim. Rezultojnë 376 dosje të certifikuara nga 473 dosje të kontrolluara. Dosje me detyrime debitore rezultojnë 6 në vlerë dëmi 1,457,191 lekë dhe 10 dosje me detyrime kreditore me vlerë dëmi 555,429 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

- **DRSSH Shkodër**, për periudhën 01.07.2014-31.12.2016, e pa mbuluar viti 2017 e në vazhdim. Gjithsej janë kontrolluar 377 dosje dhe janë çertifikuar 357 dosje. Rezultojnë 6 dosje debitore me vlerë dëmi 458,524 lekë dhe 4 dosje me detyrime kreditore në vlerë 120,136 lekë.

- **DRSSH Korçë** për periudhën 01.01.2014-31.12.2016, pa mbuluar viti 2017 e në vazhdim. Janë kontrolluar 859 dosje nga të cilat janë çertifikuar 803 dosje. Rezultojnë 13 dosje debitore në vlerë 1,628,160 lekë dhe 6 dosje me detyrime kreditore me dëm në vlerë 211,501 lekë.

- **DRSSH Tiranë**, për periudhën 01.01.2015-31.12.2016, e pa mbuluar viti 2017 e në vazhdim. Janë kontrolluar 3,578 dosje nga të cilat janë çertifikuar 3,168 dosje. Rezultojnë 68 dosje debitore me vlerë dëmi 7,720,436 lekë dhe 40 dosje me detyrime kreditore në vlerë 740,130 lekë.

Rezultoni nga auditimi se aktualisht gjënden gjithsej nga viti 2014, 2015, 2016, 2017 për 12 DRSSH 5,661 dosje që rezultojnë të lidhura për pension suplimentar por që janë pa kontrolluar nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, në zbatim të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 (suplementi shtetëror), ligji nr.10142, datë 15.05.2009, ligji nr.10 139, datë 15.05.2009, ligji nr.8607, datë 27.04.2000 më hollësisht paraqiten si më poshtë vijon: *Lista nr.4*

Nr	DRSSH	Periudha kontrollit	2014	2015	2016	2017	Tot.
1	Fier	01.01.2016 31.12.2017	0	0	156	210	366
2	Vlore	01.01.2016 31.12.2017	0	0	228	257	485
3	Durres	01.01.2016 31.12.2017	0	0	200	236	436
4	Tirana	01.01.2017 31.12.2017	0			1809	1809
5	Berat	01.01.2017 31.12.2017	0			84	84
6	Gjirokaster	01.01.2017 31.12.2017	0			90	90
7	Diber	01.01.2014 31.12.2014 +2015+2016	16	548	130	131	825
8	Shkoder	01.07.2017 31.12.2017	0			121	121
9	Korca	01.01.2017 31.12.2017	0			245	245
10	Kukes	01.01.2015 01.01.2017	0	319	75	57	451
11	Lezhe	01.01.2015 31.12.2017	0	224	134	103	461
12	Elbasan	01.01.2016 31.12.2017	0		132	156	288
	Totali		16	1,091	1,055	3,499	5,661

Titulli i çështjes:

Të Ndryshme (Mbi certifikimin e pensioneve)

Gjetja 21

Certifikimi i pensioneve

Situata

- Janë konstatuar për vitin 2017, referuar programit të kontrollit vjetor me nr.ekstra , datë 08.01.2017, pensione të pa çertifikuar në 5 DRSSH për vitet 2016 e në vazhdim duke kaluar dhe afatet kohore të kontrollit të pensioneve, referuar nenit 62 të ligjit nr.7,703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, ky afat është 3 vjecar dhe është përcaktuar si afat parashkrimi për pensionet e



njoftura dhe të paguara dhe brenda këtij afati duhet kryer kontrolli, verifikimi dhe çertifikimi i pensioneve referuar listës nr. 1 dhe nr.2, nr.3, nr.4 gjithsej 96, 321 dosje sipas ligjit nr.7 703, datë 11.05.1993, i ndryshuar dhe 5,661 dosje sipas ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 e të tjerë akte ligjore për suplementin .

- Janë konstatuar dëme ekonomike nga Njësi e Inspektimit të Përfitimeve për vitin 2017 në shumën prej 39,068,896 lekë, për periudhën nga viti 2013 deri më 2015 nga lidhja e pensioneve në zbatim të ligjit nr.7,703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ”, dhe në shumën prej 13,536,146 lekë nga lidhja e pensioneve në zbatim të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 (suplementi shtetëror), ligjit nr.10142, datë 15.05.2009, ligjit nr.10 139, datë 15.05.2009, ligjit nr.8607, datë 27.04.2000, detyrime të cilat institucioni duhet ti paguajë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. E konkretisht, detyrimet kreditore rezultojnë të shlyera brenda vitit dhe detyrimet debitore të cilat janë kontabilizuar dhe pagesat kthyhen çdo muaj në DRSSH referuar verifikimit të kryer në sistem nga nga auditimi i disa dosjeve me detyrime debitore dhe kreditore e konkretisht në DRSSH Tiranë , dosjet me nr. 218939, me nr.217737, me nr.222054 dhe në DRSSH Vlorë dosjet me nr. 134988, 137753, 139965 dhe nr. 140618.

Kriteri

Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rregulloria nr. 1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr. 1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, të ndryshuar, Rregulloria nr. 25/1, datë 04.03.2011 “Për një Shtesë në rregulloren nr. 25/1, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar, dhe Rregullores nr. 3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr. 3, datë 15.08.1996 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare”.

Ligji nr.8097, datë 21.03.1996 (suplementi shtetëror), ligji nr.10142, datë 15.05.2009, ligji nr.10 139, datë 15.05.2009, ligji nr.8607, datë 27.04.2000, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndikimi/Efekti

Çertifikimi si proces kontrolli është i rëndësishëm dhe kryerja e këtij procesi për cdo vit, ka të bëjë direkt në përdorimin me efektivitet të fondeve të pensioneve, dhe identifikimin e në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara nga mos zbatimi me korektësi i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Niveli i Prioritetit

I Lartë



Rekomandimi	<p>Institucioni të marrë masa që të përfundojë kontrollin për 3,613 dosje të identifikuar në 5 DRSSH (DRSSH Vlorë, Tiranë, Kukës, Durrës), në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar ; dhe për 596 dosje të identifikuar të pensioneve për suplementin nga viti 2014 deri më fund të vitit 2016 në 5 DRSSH (Berat, Gjirokastrë, Korçë, Tiranë dhe Shkodër).</p> <p>Institucioni të marrë masa që të përfundojë kontrollin dhe certifikimin e dosjeve të pensionit për 96,321 dosje nga viti 2014 e në vazhdim për 12 DRSSH ku janë konstatuar këto dosje. Institucioni të përfundojë kontrollin nga viti 2014, 2015, 2016, 2017 për 5,661 dosje në 12 DRSSH, që rezultojnë të lidhura për pension suplementar, por që vijnë të jenë të pa kontrolluara nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve.</p> <p>Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontrolleve dhe certifikimi i pensioneve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhet brenda vitit të lidhjes së tyre, me qëllim identifikimin e në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara nga mos zbatimi me korrektësi i akteve ligjore të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, në mënyrë që fondet për pensione të përdoren me efektivitet në përputhje me kërkesat e nenit 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar</p>
Afati për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vazhdim
Titulli i çështjes: Gjetja 22: Situata	<p>Të ndryshme (Mbi certifikimin e pensioneve)</p> <p>Administrimi i të dhënave të sistemit informatik të sigurimeve shoqërore.</p> <p>Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2017 nuk janë lënë gjurmë në sistemin e të dhënave të sigurimeve shoqërore për të gjitha dosjet e certifikuar nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve. E konkretisht rezultojnë pa komente për DRSSH Durrës gjithsej 3,759 dosje nga 10,948 dosje të kontrolluara; për DRSSH Tiranë gjithsej 3,759 dosje nga 17,201 dosje të kontrolluara; për DRSSH Vlorë 2,353 dosje për 7,143 dosje të kontrolluara; për DRSSH Sarandë 506 dosje nga 3,809 dosje të kontrolluara; për DRSSH Kukës 478 dosje nga 955 dosje të kontrolluara; dhe për DRSSH Tropojë 76 dosje nga 249 dosje të kontrolluara.</p> <p>Gjithashtu është konstatuar që nga Njësia e Inspektimit të Pensioneve nuk është përcaktuar një “fjalor i unifikuar”, në mënyrë që komentet të jenë të unifikuar dhe sipas një formati gjithpërfshirës.</p>
Kriteri:	Ligji nr.7,703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, ligji nr. ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 (suplementi shtetëror), ligji nr.10142, datë 15.05.2009, ligji nr.10 139, date 15.05.2009, ligji nr.8607, datë 27.04.2000.
Ndikimi/Efekti:	Për të lënë gjurmë të kontrolli dhe certifikimit të pensioneve në sistemin e të dhënave ndër vite me qëllim monitorimin e këtij procesi të rëndësishëm dhe përdorimit me efektivitet të fondeve për pensione të çdo lloji në 12 DRSSH.
Rekomandimi:	Për të lënë gjurmë të kontrolli dhe certifikimit të pensioneve në



sistemin e të dhënave ndër vite me qëllim monitorimin e këtij procesi të rëndësishëm dhe përdorimit me efektivitet të fondeve për pensione të çdo lloji në 12 DRSSH, nga strukturat drejtuese të ISSH të merren masa që sistemi i hedhjes së të dhënave të pensioneve, të hartojë module ku të reflektohen gjatë hedhjes së të dhënave nga Njësia e Inspektimit të Pensioneve shënimet për çdo dosje të kontrolluar dhe të certifikuar, me qëllim lënien e gjurmëve të kontrollit të dosjeve të pensioneve.

Në funksion të sa më sipër, Njësia e Inspektimit të Pensioneve nevojitet të krijojë një “Fjalor të unifikuar”, në mënyrë që komentet në sistem, në përfundim të kontrollit të përfitimeve të pensioneve të jenë të unifikuara dhe sipas një formati gjithëpërfshirës informacioni.

Afati i zbatimit të rekomandimit:

Në vazhdim

Titulli i çështjes:

Te ndryshme (Mbi respektimin e afateve të lidhjes dhe dokumentimi të pensioneve për vitin 2017)

**Gjetja 23:
Situata**

Problematika që ndikojnë në afatin e lidhjes së pensioneve.

- Nga auditimi u konstatuan problematika në lidhje me mosrespektimin e afateve të lidhjes së pensioneve për vitin 2017, në referencë të pikës 3 të nenit 85 të ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, si më poshtë vijon:

Për vitin 2017, nga 34,458 dosje pensioni të lidhura për 12 DRSSH-të, nga evidencat e Drejtorisë së Përfitimeve rezultoi se: 88,1% e tyre ose 32,132 pensione, janë lidhur brenda afatit maksimal ligjor (45 ditë) dhe koha mesatare e përcaktimit të tyre rezultoi 20,9 ditë; ndërsa rezultuan me tejkalim të afatit ligjor 8% e pensioneve ose 2,326 pensione, koha mesatare e përcaktimit të të cilave rezultoi rreth 88 ditë. Raste konkrete për vitin 2017, cilësojmë DRSSH Berat, Tiranë dhe Elbasan me 150 pensione të lidhura jashtë afatit ligjor me 2 deri në 5 muaj, dhe DRSSH Fier, Lezhë dhe Dibër me 280 pensione lidhur nga data 3 deri në 5 muaj.

-Faktorë që kanë ndikuar në mos-lidhjen në afat të pensioneve, janë edhe mungesat e dokumentacionit përkatës për periudhën e sigurimit dhe si pasojë njohja e vjetërsisë, ku gjithashtu ka ndikuar edhe mosdërgimi në Degën e Arkivës të ISSH/ Tiranë, i dokumentave të para vitit 1994, siç janë regjistrat me të dhënat e punësimit dhe listëpagesat e punonjësve nga institucione qendrore dhe lokale. Në vijim na rezultoi se ende nuk janë dërguar në ISSH, regjistrat e vjetërsisë në punë të Institucioneve Qendrore dhe Ministrive që vijojejnë të jenë në aktivitet, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 464, datë 22.07.1998 “Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin,

**Kriteri:**

ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”⁶¹.

Ligji 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloria nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin , administrimin dhe pagesën e pensioneve” dhe VKM nr.464, datë 22.07.1998 “ Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.

Ndikimi/Efekti:

Vonesat e lidhjes së pensioneve , si pasojë e keqmenaxhimit të burimeve një burimeve njëzore si dhe mungesat në dokumentacionit për caktimin e masës së pensioneve në ISSH reflektojnë në performancën e institucionit gjatë kryerjes së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Rekomandimi:

Strukturat drejtuese në ISSH, me qëllim uljen e numrit të ditëve për përlogaritjen e pensioneve si dhe rritjen e saktësisë së tyre, të marrin masa për të shtuar trajnimet për punonjësit që merren me përlogaritjen dhe caktimin e pensioneve.

Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa për identifikimin dhe publikimin e listës së institucioneve që ende nuk kanë dërguar në ISSH regjistrat e vjetërsisë në punë dhe listëpagesat e institucioneve qendrore dhe ministrive, me qëllim përfundimin me sukses të procesit të dixhitalizimit dhe të skanimit të rregjistrave të vjetërsisë në punë dhe të listëpagesave.

VI. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT***Opinion mbi pasqyrat financiare***

Ne nuk shprehim opinion mbi pasqyrat financiare të ISSH. Për shkak të rëndësisë së çështjes së përshkruar në seksionin mbi bazën e refuzimit të opinionit të raportit tonë, ne nuk siguroam evidenca auditimi përkatëse, të mjaftueshme për të marrë një bazë për dhënien e opinionit të auditimit mbi këto pasqyra financiare.

Baza për Opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-

⁶¹ Sot aktualisht në ISSH janë dixhitalizuar të dhëna për vjetërsinë në punë nga viti 1949-1993. Rregjistri i vjetërsisë në punë për vitet 1949-1993 është në proces dixhitalizimi dhe skanimi gjë që do të ndikojë në përshpejtimin e verifikimit të dokumentacionit për përfitime të pensioneve. Janë skanuar dhe dixhitalizuar aktualisht në Arkivin Qendror 22,942 rregjistra të Ndërmarrjeve dhe Institucioneve në shkallë vendi. Në zbatim të VKM nr.464, datë 22.07.1998 “ Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, nuk janë dërguar në ISSH, rregjistrat e vjetërsisë në punë të Institucioneve Qendrore dhe Ministrive që janë në aktivitet aktualisht.



Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Ne vume re se, në ISSH sistemi financiar që integron informacionin në kohë reale nga të gjitha njësitë e varësisë (Oracle) ende nuk është i qenderzuar.

Drejtoria e Financës në ISSH kryen rakordimet për vlerat totale të zërave, duke qenë se kontabilizimet në llogaritë respective kryhen nëpër rajone, ku edhe mbahen dokumentat justifikues. Të dhënat mbi shpenzimet për përfitime që gjenerohen nga sistemet specifike IT (PCAMS dhe CIMS), në fakt nuk shërbejnë si evidencë e mjaftueshme për informacionin kontabël, për shumatat e xhiruara “offline”. Ne testuam 1 agjenci edhe për diferencat offline, nga ku **nuk** na rezultuan diferenca me kontabilitetin. Por ne e kishim të pamundur të verifikonim ose konfirmonim me mjete alternative vlerat “offline” për të gjitha njësitë shpenzuese.

Opinion mbi përputhshmërinë me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi

Ne gjithashtu audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së ISSH me rregullat financiare dhe rregulloret për implementimin e rregullave financiare të ISSH, përfshirë rregullat mbi prokurimet, mbi limitet buxhetore, si dhe rregulla, rregullore, marrëveshje që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të ISSH.

Në opinionin tonë, veprimet në procesin e raportimit financiar, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor kontabël, të aplikueshëm dhe përkatës, si dhe me parimet dhe rregullat, **përvec** kontabilizimit dhe raportimit mbështetur mbi parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (ose kontabilitetit rritës).

Transaksionet e kryera gjatë ekzekutimit të buxhetit të ISSH kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi, përfshirë rregullat e prokurimeve dhe ato buxhetore.

Baza për Opinionin mbi Përputhshmërinë

Në pasqyrat financiare (Balanci dhe pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) transaksionet e ISSH, duhet të reflektohen mbështetur mbi parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Nga auditimi u konstatua se, kontabilizimi i tyre, nuk mbështetet mbi parimin e kontabilitetit rritës, por mbi atë të lëvrimit të parasë, duke rezultuar në transaksione të paregjistruara në periudhën e duhur kontabël. Edhe pse efekti sasior i këtij konstatimi është vlerësuar vetëm pjesërisht nga ana jonë⁶², mos aplikimi i parimit të kontabilitetit rritës përbën një cënim të bazës ligjore në fuqi sa i takon aplikimit të parimit kontabël të zbatueshëm.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-

⁶² Si pasojë e kufizimit të objektit të auditimit



Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar të auditimit

Përgjegjësitë e Drejtimit të ISSH

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*Nëpunësi autorizues*), Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*Nëpunës autorizues i dytë zëvendësues*), Drejtori i Drejtorisë së Financës (*Nëpunësi zbatues*), si dhe Drejtori i Sektorit të Financës (*Nëpunësi zbatues i dytë, zëvendësues*), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Drejtimi i ISSH^{së} është përgjegjës për përputhshmërinë e veprimtarisë së ISSH^{së} me rregullat financiare në fuqi si dhe me rregulloret për implementimin e tyre, përfshirë rregullat mbi prokurimet, mbi limitet buxhetore, si dhe rregullore e marrëveshje që ndikojnë në përdorimin e fondeve /burimeve të ISSH^{së}.

1. Konstatim⁶³: Deficiti i financiar i degës së pensioneve të fshatit, ka rezultuar 11,371.1 milion lekë, nga 11,593.2 milion lekë një vit më parë, pra 222 milion lekë më pak, ose 1.92% më pak se një vit më parë. Edhe pse në vlerë nominale, skema e pensioneve në fshat dhe rezultati financiar i kësaj dege, duket disi i përmirësuar⁶⁴, vëmë re që skema e fshatit vijon të subvencionohet nga shteti në masën 41% (tregues ky i cili nuk është përmirësuar në krahasim me vitin 2016) ose në masën rreth 1,443 milion lekë, vlerë kjo e cila duke iu shtuar deficitit direkt, e çon vlerën e financimit nga buxheti I shtetit në masën 12,814 milion lekë. Ndërsa skema e qytetit kontribuon në totalin e të ardhurave të skemës së pensioneve në masën 95%, e përthith 85% të shpenzimeve, ky raport paraqitet në kah të kundërt për skemën e fshatit, ku kjo e fundit rezulton të kontribuojë në të ardhurat e mbledhura vetëm 5%, ndërkohë që përthith shpenzime rreth 15% të total shpenzimeve të skemës së pensioneve. Skema e fshatit, edhe pse me një kontribut relativisht të ulët në të ardhura (prej 5%), vërehet të zërë një peshë relativisht të konsiderueshme të total deficitit prej 41%. Kjo pasi periudha e sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, për efekt pensioni, njihet e njëjtë si për të vetëpunësuarit në qytet, pavarësisht se tarifa e kontributit vjetor të tyre është mesatarisht rreth 57% më e ulët se e qytetit, dhe diferenca për kontributet e tyre mbulohet nga buxheti i shtetit. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 70-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

⁶³ Rekomandojmë rishikimin e skemës mbi bazën e studimeve të mirëfillta, me qëllim respektimin e parimit kontributiv të saj, por duke qenë se, mbështetur në standardet ndërkombëtare të auditimit të SAI-eve, KLSH nuk auditon politikën, nuk mund të rekomandojmë masa konkrete.

⁶⁴ Përmirësimi ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve nga 53,168 që ishin në vitin 2016, në 58,528 në vitin 2017, duke dhënë një impakt të vlerësuar prej 203,6 milion lekë në kontributet e vitit korent.



2. Konstatim⁶⁵: Në vitin 2017, rritja e pensioneve sipas indeksit të çmimeve është implementuar që në muajin mars 2017. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 2013-2017, Këshilli i Ministrave ka miratuar datën e indeksimit të pensioneve, në mbështetje të kërkesave të nenit 61, të ligjit për sigurimet shoqërore, të cilat për çdo vit, duke filluar nga vitit 2013, kanë hyrë në fuqi më datë 01.08. Përfundimtar ka bërë **indeksimi për vitin 2017**, i cili mbështetur në VKM nr. 130, datë 22.02.2017 “Për indeksimin e pensioneve”, **është bërë në muajin Mars 2017⁶⁶**.

Në vitin 2017, si pasojë e indeksimit 4 muaj më herët, impakti i vlerësuar në rritjen e shpenzimeve ka qenë 1,120 milion lekë më shumë se në vitin 2016. Në rritjen e shpenzimeve për pensione përveç shtesës së periudhës 4 mujore, ndikoi edhe rritja e vetë normës së indeksimit të çmimeve në mars 2017. Konkretisht për vitin 2016 indeksi rezultoi 1.6 %, ndërsa në vitin 2017, ky indeks ishte 3%, duke sjellë një impakt prej rreth 780 milionë lekë shpenzime më shumë. Pra në total, efektet e vlerësuara si shtese nga indeksimi i pensioneve, rezultuan rreth 1,900 milionë lekë më shumë. Por ndërsa pensionet u rriten me efekte nga muaji mars, pagat u rriten me efekt nga muaji maj, kontributet e të cilave u derdhën në muajin qershor. Pra për një periudhë rreth 3 mujore, u rritën shpenzimet e skemës si pasojë e indeksimit, pa u shoqëruar me rritje të të ardhurave si pasojë e kontributeve të shtuara nga indeksimi i pagave (efekt i vlerësuar rreth 300 milionë leke/muaj të ardhura më pak, ose në total 900 milionë leke/3muaj).

Sa më sipër, janë tre faktorët, të cilët nëse do të zhvilloheshin në të dy vitet, 2016 dhe 2017, në kushte të njëjta, do të kishin impakt pozitiv në uljen e deficitit nominal. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 70-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i programimit të buxhetit të ISSH për vitin 2017, i cili realizohet në 15 njësitë e sistemit, u konstatua se procesi i programimit buxhetor ka hasur vështirësi e problematika në vlerësimin dhe përlllogaritjen e tij, duke mos zbatuar në të gjitha fazat e programimit të buxhetit, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.4, datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019”, që lidhen me sa vijon:

a. Programi i **të ardhurave** (kontributeve të sigurimeve shoqërore) të subjekteve që mblidhen nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe për rrjedhojë ISSH ka marrë tregues të gatshëm për to. Si rezultat në programimin fillestar të ardhurave të vitit 2017, në shumën 67,566 mijë lekë, kishte rezerva e kjo u konstatua me faktin që, megjithëse me aktin normativ nr.3/2017, programi i të ardhurave u shtua me 1,600 milion lekë, përsëri të ardhurat e programuara u tejkaluan me mbi 1,572 milion lekë, kundrejt planit me ndryshime dhe 3,168 milion lekë, ose mbi 5,2% më shumë me planin fillestar

⁶⁵ E arsyeshme nga pikëpamja metodologjike është që, në momentin e rritjes së pensioneve, duhet të behet edhe indeksimi i pages minimale. Nën këtë këndvështrim gjithashtu merr rëndësi, qëndrueshmëria në implementimin e politikave, sa i takon indeksimit të pensioneve, në mënyrë që të shmangen diferencat në kohë nga viti në vit.

⁶⁶

Viti	VKM	Hyn ne fuqi
2013	583, date 17.07.2013	01.08.2013
2014	456, datë 09.07.2014	01.08.2014
2015	651, datë 22.07.2015	01.08.2015
2016	549, datë 27.07.2016	01.08.2016
2017	130, datë 22.02.2017	01.03.2017



b. Gjatë programimit të **shpenzimeve**, ISSH ka mbajtur në konsideratë për llogaritjen e përfitimeve rreth 603,000 pensionistë të të gjitha llojeve dhe kategorive, ka llogaritur e administruar kompensimet për mbi 40,000 persona të varur ekonomikisht nga pensionisti, sidomos familjarë të invalidëve, ka administruar pagesat për rreth 4,200 veteranë dhe invalidë të luftës dhe rreth 525 invalidë të punës etj. Gjithashtu ISSH vazhdon të administrojë skemën e pensioneve të posaçme, skemën e pensioneve suplementare të punonjësve që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të tjerë të shtetit, skemën e sigurimeve suplementare të policisë dhe ushtarakëve të tjerë, skemën e përfitimeve të veçanta për minatorët, si dhe skemën e përfitimeve të veçanta për familjet e dëshmorëve me rreth 34,500 përfitues. Janë hasur vështirësi e problematika në programin e këtyre përfitimeve si:

-Gjatë programimit të Fazës së parë të PBA 2017-2019 të shpenzimeve ky institucion, nuk ka angazhuar strukturat e varësisë së tij, por vetëm strukturën qendrore, e cila parashikon dhe programon në kohë afat-mesme vetëm shpenzimet e ISSH.

-Mungesa e një baze të plotë të dhënash ka sjellë vështirësi edhe në programimin e shpenzimeve për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë, e për pasojë edhe baza e vlerësuar për efekt të përlllogaritjes së pensionit, kalkulohet rast pas rasti.

-Mbi bazë parashikimesh përlllogaritjet edhe numri i invalidëve, pensioneve familjare etj, si dhe e pensioneve të parakohshme e suplementare, e numri i tyre varet nga reformat që parashikojnë institucione të tjera si ushtria, policia, administrata publike etj.

-Për numrin e pensioneve të reja pleqërisë, për të cilët ka informacion të plotë nga regjistri i shtetasve, përsëri ka problematika planifikimi, që lidhen me paraqitjen e kërkesave për përfitimet, sepse rreth 40% e popullsisë shqiptare të regjistruar, ndodhet jashtë shtetit. *S Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 19-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të MFE/Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makro Ekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në bashkëpunim me strukturat drejtuese të ISSH, të marrin masa që:

a. Të riorganizojnë dhe mundësojnë **programimin e të ardhurave** të mbledhura nga DPT dhe programimin e shpenzimeve në të gjitha fazat edhe nga strukturat e ISSH, duke shtuar bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për shkëmbimin e të dhënave për subjektet kontribuese, të cilat mundësojnë krijimin e të ardhurave dhe për subjektet problematike, të cilat pengojnë krijimin e tyre, në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhura të mos vijnë të gatshme në ISSH, por të programohen mbas një analize të drejtë e pa rezerva nga të dyja strukturat.

b. Strukturat drejtuese të ISSH, të mundësojnë **programimin e shpenzimeve** nga të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit, duke patur parasysh zgjidhjen e problematikave në shpejtimin e plotësimit të bazës së të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë.

Brenda vitit 2018

2. Nga auditimi i programimit të buxhetit të të ardhura që mblidhen nga strukturat e ISSH (**kontribute të vetpunësuarve në bujqësi-fermerit**) që për vitin 2017 janë programuar në vlerë 2,382 milion lekë, janë ndryshuar me aktin normativ nr.3, në vlerë 2,112 milion lekë, ose më pak se programimi fillestar për 270 milion lekë dhe janë realizuar në masën 2,127 milion lekë, u konstatua se ka vështirësi në përlllogaritjen e tyre, nisur nga fakti që koncepti fermer, lidhet me tokën që kanë në përdorim si të vetpunësuar në bujqësi, referuar përcaktimit në ligjin nr. 7501, datë



19.07.1991 të ndarjes së tokës, por për shkak të ndryshimeve demografike, ky koncept për përcaktimin e “fermerit, ose të vetpunësuarit në bujqësi” ka ndryshuar. Në këto kushte është e vështirë që përcaktimin e qartë të termit “fermer, ose i vetpunësuar në bujqësi” ta zgjidhin vetëm strukturat e ISSH”, në mënyrë që parashikimi i shpenzimeve për përfitime dhe kontributet e derdhura nga fermerët, të jenë të shoqëruara me ndryshimet ligjore për këtë proces. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 19-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Me qëllim rritjen dhe saktësimin e programimit të të ardhurave nga kontributet në **sektorin e bujqësisë**, strukturat drejtuese të ISSH dhe njëkohësisht përgjegjëse për kontributet në ISSH (bujkut), në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MBZHR të bëjnë të mundur përcaktimin e qartë termin “fermer, apo i vetpunësuar në bujqësi”, duke shoqëruar këtë r-përcaktim me ndryshimet ligjore përkatëse.

Brenda vitit 2018

3. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të **buxhetit të Aparatit** rezultoi se:

-Planifikimi fillestar i shpenzimeve për investime për vitin 2017, ishte zero, kur kishte kontrata e investimit në vazhdim;

-Realizimi i buxhetit administrativ të Aparatit gjatë vitit 2017, është 31% më shumë se një vit më parë, e kjo kryesisht në shpenzimet operative. Nga analiza e shpenzimeve operative (artikulli 602) dhe ndryshimi që pësojnë ato nga viti në vit, rezultoi se planifikimi i tyre megjithëse ishte bërë i detajuar, kishte ndryshime të mëdha në zëra të ndryshëm gjatë krahasimit të tyre me realizimin e vitit të kaluar dhe ndryshime të theksuara gjatë fazave të programimit të tyre. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 19-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Të programohen në mënyrë të detajuar shpenzimet administrative të Aparatit të ISSH, si për kostot operative, ashtu edhe për ato e investimeve, në mënyrë që ndryshimet në zërat analitikë të tyre, të justifikojnë dhe dokumentojnë domosdoshmërinë e ndryshimit nga viti në vit dhe gjatë vitit buxhetor. *Sa më sipër përshkruar në mënyrë të detajuar në faqet 34-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Brenda vitit 2018

4. Gjetja nga auditimi: Të ardhurat nga kontributet dhe të ardhura të tjera të realizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) për vitin 2017, zënë rreth 96.2% të totalit të kontributeve të hyra në ISSH, në vlerë 70,543 milion lekë, për të cilat evidentohen problematika si vijon:

a- Konstatohet se ka mungesa në numrin e listë pagesave vjetore që duhet të dërgojë DPT-ja në ISSH dhe veçanërisht këto të identifikuar për vitin 2014, ku mungojnë një sasi e konsiderueshme e tyre dhe kryesisht për muajt tetor dhe nëntor të këtij viti. Megjithëse është vënë në dijeni zyrtarisht DPT-ja dhe po merren masat që ky informacion të kalojë në ISSH, teknikisht kjo çështje vijon të jetë në proces, duke krijuar problematika në përdorimin online të kësaj baze, sa i takon caktimit të pensioneve të personave që kanë mungesa të dhënash. Konkretisht, në fund të vitit 2017 rezultojnë gjithsej 1.810.880 listë pagesa të munguara dhe nga këto: 1.703.858, ose rreth 94% janë listëpagesa të munguara të të vetpunësuarve (biznes i vogël); 101.226, ose rreth 6% janë listëpagesa të munguara të biznesit të madh (firma private); 5.796 janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë).



Gjithashtu konstatohen parregullsi e problematika, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 464, datë 22.07.1998 "Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë ISSH", që lidhen me procesin e dixhitalizimit dhe të skanimit të regjistrave të vjetërsisë në punë dhe të listëpagesave". Gjithashtu problematika konstatohen edhe në zbatimin e marrëveshjes midis DPT dhe ISSH, lidhur me procedurat dhe rregullat për dërgimin, apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributeve sipas subjekteve dhe individëve, komunikimin midis palëve mbi informacionin statistikor, si dhe çështjeve që dalin pas inspektimit nga ISSH të të dhënave mbi kontributet të procesuara në llogaritë individuale.

b- Ka mungesë informacioni për ato raste kur subjektet gjenden me detyrime të papaguara, ose të paguara pjesërisht, e cila ka sjellë mos-arkëtimin e të ardhurave nga kontributet, si pasojë e rritjes së numri të subjekteve debitoare dhe vlerës respektive të pambledhur nga këto subjekte.

-Konkretisht, në vitin 2017 kanë rezultuar **63,531 subjekte debitoare**, në vlerë **9.1 miliardë lekë**, të evidentuara në DPT, të cilët prodhojnë një problem të madh social dhe financiar. Për këtë vit, po dhe në vazhdimësi ISSH u ka bërë prezent organeve eprore, numrin e lartë dhe detyrimet e prapambetura për kontribute të papaguara, të subjekteve debitorë në organet tatimore. Këta debitorë të krijuar në DPT, për kontributet e sigurimeve shoqërore, të deklaruar dhe të pa derdhura në ISSH, ose kontribute të deklaruar më shumë se sa janë derdhur për llogari të ISSH, e të pa shoqëruara me listë pagesat përkatëse, janë të evidentuar në kontabilitetin e DPT. Debitorët për kontributet, janë evidentuar dhe ndiqen edhe nga drejtoria e kontributeve në ISSH, në zbatim të pikës 5.19, të kreut 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 09.12.2014 dhe të nën/pikës "iv", shkronja "a", të kreut II, të "Marrëveshjes së Bashkëpunimit" nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr. 11422, datë 19.5.2017, ndërmjet DPT-së dhe ISSH-së, por nuk ka një plan veprimi midis dy institucioneve, për të mundësuar mbledhjen në kohë të detyrimeve të prapambetura për kontributet dhe mbajtjen nën kontroll të nivelit të borxhit subjektet kontributuese të skemës së kontributeve.

-Gjithashtu në subjektet e biznesit të madh, subjektet fason, si dhe në disa subjekte që zhvillojnë veprimtari profesionale në media etj., ka rezerva dhe informalitet të konstatuar nga të dy institucionet (ISSH dhe DPT) për vlerën e kontributeve të derdhura. Konkretisht mbështetur në problematikat sa i takon listëpagesave që DPT i sjell ISSH.

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 34-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/DPT, të hartojnë dhe monitorojnë një plan-veprimi për të mundësuar zgjidhjen e problematikave të mbartura. Ky plan veprimi, duhet të përmbajë objektiva specifike, të matshme, të arritshme, përkatëse, dhe të mbështetura mbi afate konkrete për realizimin e tyre (objektiva SMART), që lidhen me:

a. Zgjidhjen e problematikave sa i takon mungesës së listëpagesave vjetore që DPT-ja duhet të dërgojë në ISSH dhe veçanërisht listëpagesat e muajve tetor dhe nëntor 2014, për të shmangur problematika në përdorimin on-line të kësaj baze, për caktimin e pensioneve të atyre personave me listëpagesa të munguara dhe zgjidhjen me prioritet të listë pagesave të munguara të formatit letër të periudhës 2006-2012.

b. Plotësimin e informacionit të munguar për ato raste kur subjektet gjenden me detyrime të papaguara (debitore), ose të paguara pjesërisht, për të eliminuar mungesën e periudhave të sigurimit nëpërmjet analizës së debitorëve për periudhat e mëparshme, si dhe duke bërë rast pas



rasti rregullimin dhe plotësimin e tyre. Në veçanti plani i veprimit të përcaktojë kohën e evidentimit të e subjekteve të biznesit të madh, subjektet fason, dhe subjektet që zhvillojnë veprimtari profesionale në media etj., të cilat nuk paguajnë në rregullisht, apo nuk derdhen fare kontribute të sigurimeve shoqërore për të punësuarit e tyre për minimizimin e evazionit fiskal në derdhjen e kontributeve.

Brenda vitit 2018

5. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi kontabilizimin e të ardhurave të mbledhura nga DPT u konstatua se nuk janë parashikuar llogari të ardhurash sipas degëve të parashikuara nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi. Si pasojë, për vitin 2017, Drejtoria e Financës në ISSH, kontributet nga DPT, **në vlerën 70,734 milion lekë**, të derdhura nga personat juridike e fizikë, subjektet publikë dhe private, dhe sistemimet e mëvonshme të këtyre kontributeve, nuk i ka regjistruar në kontabilitet me numër llogarie të specifikuar për çdo lloj kontributi, por i ka regjistruar vetëm në një llogari - 512100 "Të ardhura të hyra nga llogaria e unifikuar e thesari-TSA"-, llogari e cila nuk **jep sigurinë analitike** të krijimit të këtyre të ardhurave dhe verifikimin e dyfishtë të një veprimi kontabël, pra të dhënat statistikore të ardhura nga Drejtoria e Kontributeve të këtij institucioni, të mara nga DPT, të jenë të barabarta me shumën e regjistruara në kontabilitet dhe të mara nga Ministria e Financës/Drejtoria e Thesarit për të gjitha kategoritë e kontributeve të ndara sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Sa më sipër në kundërshtim me nenin 10, pika 3 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku parashikohet se: "Paraqitjet e grupuara për të dhëna dhe elementë që ndikojnë në vendimmarrjet ekonomike të përdoruesve paraqiten veçmas në pasqyrat financiare. Paraqitjet e grupuara lejohen vetëm për elemente me natyrë të ngjashme, shumën e të cilave nuk janë materiale". *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 33-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH/Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të MFE/DPTH, të riorganizojnë dhe mundësojnë regjistrimin e kontributeve të të ardhurave të sigurimeve shoqërore të derdhura në DPT dhe të transferuara në ISSH me nën-llogari përkatëse analitike, të specifikuara për çdo lloj kontributi dhe çdo lloj dege, konform legjislacionit në fuqi.

Brenda vitit 2018

6. Gjetja nga auditimi: Vlera totale e transfertave nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit dhe skemave (nga Ministria e Financave, MFE) rezultoi në shumën 48,705 milion lekë. Këto transfertat janë pasqyruar nga MFE në Llogarinë e Unifikuar të Thesarit, dhe regjistrohen si e ardhur në sistemin Oracle, nga Drejtoria e Financës në ISSH. Nga auditimi u konstatua se, emërtimet e llogarive që përdor MFE ndryshojnë nga emërtimet e llogarive që përdor ISSH. Mospërputhjet mes nomenklaturës së llogarive midis dy institucioneve të sipërpërmendura, ka shkaktuar mospërputhje mes klasave të transfertave që tregojnë edhe qëllimin e përdorimit të tyre, si dhe mospërputhje mes vlerave respektive të tyre (edhe pse vlera totale e transferuar nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit dhe skemave është e njëjtë - 48,705 milion lekë). Sa më sipër vështirësojnë gjurmimin e transferimit dhe përdorimit të të ardhurave sipas destinacionit të parashikuar/kërkuar. Sa më sipër është komponent i rëndësishëm i procedurave që lidhen me "kontrollin pas faktit" të cilat, në referencë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, duhet të ushtrohen pas përfundimit të transaksionit dhe verifikojnë nëse fondet publike arkëtohen e shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve



të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, si dhe për arritjen e rezultateve të pritshme nga përdorimi i fondeve publike. Gjithashtu neni 22, pika 5 e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit parashikon se, kontrollet pas faktit nuk kryhen nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit.

Në përfundim, edhe pse nuk identifikua gabime gjatë auditimit sa i takon vlerës totale të transfertës prej 48,705 milion lekë nga buxheti i shtetit për ISSH, mospërputhja e emërtimeve dhe vlerave, të llogarive, mes dy sistemeve mbart risqe potencialë që këto fonde të mos përdoren për qëllimin e parashikuar si rezultat i gabimeve ose veprimeve të qëllimshme. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 34-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

6.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH/Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të iniciojnë krijimin e një nomenklature të përbashkët llogarish e nën-llogarish, mes ISSH dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për transfertat nga buxheti i shtetit, si për mbulimin e deficitit, ashtu edhe për mbulimin e skemave të pensioneve, me qëllim forcimin e kontrolleve për minimizimin e risqeve që lidhen me ndryshimin e destinacionit të të ardhurave. Nga ana e Ministrisë së Financave, çdo fundmuaji të përpilohet një tabelë përmbledhëse ku të identifikohen llogaritë respektive sipas kësaj nomenklature të përbashkët, dhe shumat respektive të transferuara nga buxheti i shtetit sipas destinacionit të kërkuar nga ISSH. Ky dokument të shërbejë si akt-rakordim mes dy institucioneve dhe të firmoset nga të dy palët e përfshira në proces. Është detyrë e menaxhimit të ISSH, të përcaktojë në procedurat e ushtrimit të kontrolleve pas faktit, personat përgjegjës që marrin pjesë në këtë proces.

Brenda datës 30.09.2018

7. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se njohja e shpenzimeve të vitit buxhetor në pasqyrat financiare të ISSH, është bërë në momentin e kryerjes së pagesës dhe jo në çastin e ndodhjes së tyre, në kundërshtim me nenin 61 “Standardet dhe procedurat e kontabilitetit”, të Ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016, ku parashikohet se, metoda e njohjes së shpenzimeve dhe të ardhurave, për qëllim të këtij ligji, ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës. Sa më sipër konstatuar në sa vijon:

-Edhe pse janë njohur si shpenzime periudhe pagat e likuiduara, nuk janë njohur si të tilla shpenzimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor. Këtë e pohojnë vlerat e llogarisë “Personeli dhe llogari të lidhura” dhe “Detyrime ndaj shtetit Debitor”, reflektuar në klasën 4 të Pasivit/“Detyrime Afatshkurtra”.

-Gjithashtu nga kryerja e testeve mbi transaksionet e llogarisë 602.5 “Mallra dhe Shërbime” konstatuam se janë regjistruar si shpenzime periudhe të vitit 2017, likuidimet e dy faturave të muajit dhjetor 2016, në shumën totale 7,486 mijë lekë. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 125-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

7.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa për përgatitjen e një urdhri detyrues, për të gjitha njësitë shpenzuese të ISSH-së, ku të kërkohet menjëherë njohja e shpenzimeve të periudhës, në momentin e konstatimit dhe jo në momentin e lëvrimit të parasë, i shoqëruar me të gjitha hapat e nevojshëm për tu ndjekur nga njësitë shpenzuese. Të ngrihet një grup i dedikuar për të monitoruar dhe mbështetur njësitë, me qëllim marrjen e sigurisë se ky parim po ndiqet në mënyrë që pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2018, të reflektojnë shpenzimet ushtrimore sipas parimit të kontabilitetit rritës.

**Brenda datës 30.09.2018**

8. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të ISSH u konstatua se, llogaritë e pagueshme dhe ato të arkëtueshme të krijuara mes njësisve shpenzuese dhe Aparatit nuk janë eliminuar gjatë konsolidimit, duke cënuar parimin e vlerësimit⁶⁷ sipas të cilit, elementet futen në llogari dhe përfshihen në pasqyrat financiare, me shumën që përcaktohen, sipas standardeve kontabël⁶⁸. Shuma prej 29,262,163 lekësh, e reflektuar në llogarinë 468 "Të Drejta të Arkëtueshme" konsiston në vlerën e librezave të kontributeve që Aparati ka shpërndarë në Rajonet e Sigurimeve Shoqërore me qëllim shitjen. Në kuptimin e të drejtave që ISSH ka për këtë aset, dhe në përputhje me bazën ligjore të cituar, vlerësojmë se në pasqyrat e konsoliduara ky zë nuk ka kuptim të reflektohet me kundërparti shumën respektive në llogarinë 401-408 "Klientë e llogari të lidhura me to", sikundër në fakt është vepruar. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 115-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa që përgjatë konsolidimit të pasqyrave financiare të eliminojë llogaritë që mbartin të drejta dhe detyrime brenda grupit.

Brenda datës 28.03.2019

9. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 602, kemi konstatuar se, shpenzimet e mirëmbajtjes së sistemeve IT, të kryera për vitin 2017, në shumën 92,280,000 lekë janë njohur me pa të drejtë, si shpenzim periudhe (llog. 602.5), në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 1, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi te ardhurat", në një kohë që në fakt duhen konsideruar si kosto të përmirësimit, që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve, duke qenë se dhe vlera e tyre është më e madhe së 15% e vlerës kontabël të mbetur të aktiveve. Duke konsideruar sa më sipër, kjo vlerë duhet të kishte shtuar vlerën e aktivitetit përkatës në Bilancin kontabël të ISSH.

Nga auditimi i llogarisë 203 "Koncesione, patenta, licenca e të ngjashme" u konstatua se, për këtë kategori aktiveve është mbajtur Regjistri i Aktiveve, por ndërsa identifikohen total shtesat ndër vite, ndaj vlerës totale të Aktivitetit, nuk janë të identifikueshme veç e veç aktivitetet e patrupëzuara (pra nga se përbëhet secili prej tyre). Paraqitja e Regjistrimit të Aktiveve në këtë lloj formati, ku mungon identifikimi i tyre sipas llojit, veçanërisht në kushtet kur ISSH ka disa sisteme IT, të cilat duhet të mirëmbahen, nuk na shërben si evidencë e mjaftueshme për të dhënë siguri të arsyeshme rreth regjistrimit të saktë të vlerës së këtij Aktiviteti. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 125-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

9.1 Rekomandimi: Nga sa më sipër nevojitet që Sektori i Financës në ISSH të formatojë dhe plotësojë me informacion, regjistrin e Aktiveve të Patrupëzuara në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Gjithashtu, nevojitet të bëhen sistemimet kontabël të nevojshme, në zërat respektiv të Bilancit kontabël (llogaria 203 dhe 213) dhe në Pasqyrën e Të ardhurave dhe Shpenzimeve (llogaria 602.5) për shpenzimin e kryer, që përfaqëson kostot e mirëmbajtjes së këtyre aktiveve.

Brenda 30.12.2018

⁶⁷ Neni 13, i Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

⁶⁸ Standardi Kombëtar i Kontabilitetit (SKK) 9



10. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Këshillit Administrativ (KA) u konstatua sa më poshtë vijon:

- Në kushtet ku Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë u bashkuan në një ministri të vetme⁶⁹, u konstatua se, në mbledhjet e KA të ISSH, realizuar pas datës 13.10.2017 ky këshill ka funksionuar me 11 anëtarë, nga 12 të përcaktuar në nenin 72 të ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në mbledhjen e KA-së, të datës 20.10.2017 për të rregulluar pikërisht numrin e anëtarëve, u miratua caktimi i dy anëtarëve, përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konkretisht Ministri në rolin e Kryetarit të KA, dhe zëvendësministri në rolin e një anëtari.

- Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Administrativ, është kryer pa votim të fshehtë, në kundërshtim me nenin 73, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i cili përcakton se: “Kryetari zgjidhet nga KA-ja me votim të fshehtë”.

- Në mbledhjet e KA-së së vitit 2017 nuk gjendet i trajtuar miratimi i raportit vjetor, *bilancit vjetor, buxhetit vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore*. Në mbledhjen e datës 20.12.2017 është miratuar rezultati financiar i vitit 2016. Në Rregulloren financiare, paragrafi “Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D “Raportimi”/nënçështja 3, specifikon se, raporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet. Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2017 nuk është zbatuar në ISSH kjo çështje. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 86-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

10.1 Rekomandimi: Për sa më sipër të vlerësohet dhe gjykohet mundësia që, për të shmangur praninë e dy përfaqësuesve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të konsiderohet në përbërjen e KA-së, një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duke qenë se Instituti i Sigurimeve Shoqërore operon me skemat e fermerëve. Sa më sipër të reflektohet në nenin 72, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Të merren masa që në rastet e ardhshme, zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Administrativ të kryhen me votim të fshehtë.

Këshillit Administrativ, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, duhet të miratojë pasqyrat financiare dhe rezultatin financiar të ISSH-së brenda afateve ligjore të përcaktuara në Rregulloren Financiare të institucionit. Projektvendimi duhet të shoqërohet me relacionin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe me pasqyrat financiare të nënshkruara nga hartuesi i llogarive vjetore dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike.

Në vazhdim

11. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm (DAB) u konstatua se për vitin 2017 kjo drejtori ka realizuar 23 misione auditimi nga 21 misione të parashikuara, nga të cilat 5 auditime financiare, 14 përputhshmërie, dhe 4 tematike. Në përfundim rezultoi sa më poshtë vijon:

- DAB, në asnjë rast nuk ka hartuar, projektraportin e auditimit pas përfundimit të auditimit në terren, duke hartuar direkt raportin e auditimit, në kundërshtim me kërkesat që dikton Standardi

⁶⁹ Pas restrukturimit të ministrive sipas VKM, datë 13.10.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr.90/2012.



2410 “Kriteret për komunikim” si dhe me kapitullin 4/ pika 4.6 e Manualit të Auditimit të Brendshëm;

- Gjatë auditimit nuk na u vendos në dispozicion korrespondenca e drejtuesit të DAB me Bordin dhe Drejtorin e Përgjithshëm, sa i takon raportimit periodik të DAB-së të menaxhimi i lartë dhe bordi, mbi qëllimin dhe njohjen me rezultatet e aktivitetit të Auditit të Brendshëm (AB), në raport me planin e tij, sikundër specifikohet në pikën 3.1 “Plani strategjik i auditimit”, të Manuali i AB-së, si dhe në Standardin 2060. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 96-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

11.1 Rekomandimi:

- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të marr masa që në çdo auditim të respektojë formatet standarde të kërkuara si pjesë e dokumenteve zyrtare të procesit të auditimit, duke mos eliminuar në asnjë rast, fazën e hartimit të projekt raportit, në mënyrë që t’i jepet mundësia subjektit të audituar që të reagojë brenda afateve të përcaktuara, në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura në projekt raport.

- Drejtuesi i DAB-së të marr masa që në raportimet periodike tek menaxhimi i lartë dhe bordi, ndër të tjera të përfshijë ekspozime ndaj rrezikut material dhe çështje të kontrollit, duke përfshirë rreziqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes së organizatës dhe çështje të tjera të nevojshme ose të kërkuara nga menaxhimi i lartë dhe bordi. Ky dokument t’i paraqitet edhe komitetit të auditimit për mendim (aty ku ekziston) dhe t’i dërgohet për miratim titullarit të njësisë publike si dhe Strukturës Përgjegjëse për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm. Nisur nga fakti se Bordi është i pranishëm në këtë institucion, të merren masa për të praktikuar korrespondencën e raportimit me Bordin dhe Drejtorin e Përgjithshëm zyrtarisht, duke lënë gjurmë edhe për to.

Vazhdimisht

12. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u konstatua se, nuk është vepruar plotësisht në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 07.08.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe me ato të Manualit Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për sa vijon:

-në raportin e kontrollit të brendshëm të ISSH dhe pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2017, mungonte deklarata e cilësisë së titullarit si dhe u identifikuan mangësi dhe pasaktësi në përgatitjen e Pyetësorit të Vetëvlerësimit;

-nuk ishte kryer një delegim i dokumentuar mbi përgjegjësinë lidhur me përzgjedhjen e koordinatorit të riskut dhe të MFK në ISSH;

-ISSH nuk dispononte rregulloren për delegimin e detyrave, konfliktin e interesit, gabimeve, etj; ISSH nuk kishte përgatitur planin strategjik dhe vjetor lidhur me veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme;

-nuk ishin dokumentuar mbledhjet e Grupit të Menaxhimit Strategjik;

-ISSH nuk kishte miratuar gjurmët e auditimit;

-paraqiten mangësi lidhur me dokumentimin e raportimit dhe shpërndarjes së informacionit nëpërmjet strukturave. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 109-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

12.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH të marrin masat e nevojshme për përzgjedhjen e koordinatorit të riskut dhe të MFK në ISSH, forcimin e gjurmëve të auditimit nëpërmjet dokumentimit të mbledhjeve të GM-së, si dhe përgatitjen e rregulloreve për forcimin e sistemeve



të kontrollit të brendshëm, duke reflektuar kërkesat që burojnë nga ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollit.

Brenda vitit 2018

13. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore u konstatua se ISSH ka funksionuar mbi bazën e rregullore së brendshme, e cila në fakt rezultoi të jetë projekt rregullore, e pa miratuar nga KA për më shumë se 10 vite radhazi, që paraqet mangësi në përmbajtjen e saj dhe nuk i përshtatet plotësisht strukturës aktuale të institucionit. Për më tepër që kjo projekt rregullore nuk ka reflektuar ndryshimet e ndodhura në strukturë dhe as detyrat e personelit përkatës.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se, struktura e fundit e miratuar e institucionit nuk përputhet plotësisht me atë aktuale. Pas ndryshimeve të kryera në strukturën organizative nga titullari i institucionit, nuk është ruajtur gjurma e këtyre ndryshimeve për të evidentuar saktësisht vakancat. Shtesat në strukturë jo në të gjitha rastet janë shoqëruar me reduktim të personelit në strukturat e tjera. Nga mos pasqyrimi i ndryshimeve, evidentohet se, pas largimit të personelit nga pozicioni përkatës, ky vend nuk ka rezultuar si vakant në strukturën organizative, dhe gjithashtu pas shtesave të personelit në një drejtori, ky proces nuk është shoqëruar me pakësimin e numrit të personelit në një drejtori tjetër, për të ruajtur kështu numrin total të punonjësve sipas vendimit të KA. Si rezultat, vakancat e stafit kanë qenë fiktive, në kushtet kur shtesat për plotësimin e tyre, tejkalojnë numrin total të personelit. Sa më sipër në kundërshtim me kërkesat që burojnë nga neni 20 i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 82-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

13.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Institutit të Sigurimeve të marrin masa për: -ngritjen e grupeve të punës sipas drejtorive për rishikimin e rregulloreve përkatëse, përshtatjen e tyre me strukturën organizative të ISSH dhe përputhjen e tyre me Rregulloren e brendshme të institucionit.

Brenda vitit 2018

14. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e rekrutimit, u konstatua se për vitin 2017, ISSH nuk ka kryer asnjë publikim të vendeve të lira të punës, në faqen zyrtare të institucionit. Gjithashtu konstatuam se, vetëm në 2 raste është ndjekur procedura për emërimin e punonjësve në përputhje me kërkesat e Rregullore së Personelit të ISSH, ndërsa në 5 raste të tjera, për rekrutimin e tyre është ndjekur procedura e komandimit të përkohshëm, ku 1 prej tyre edhe është emëruar në pozicionin fillimisht të komanduar. Në asnjë prej rasteve të mësipërme, nuk gjetëm evidenca për të mbështetur nevojën e aplikimit të procedurave të komandimit si pasojë e nevojave të menjëhershme, diktuar ng apozicioni i punës, sikundër e kërkon Kodi i Punës dhe Rregullorja e Personelit të ISSH (çështja I, pika 2), e cila parashikon këtë procedurë vetëm në raste emergjente dhe për një periudhë të shkurtër kohore. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 136-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

14.1 Rekomandimi:

Strukturat drejtuese në ISSH, veçanërisht Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e procedurave të rekrutimit transparente dhe ligjore, duke shmangur raste të rekrutimit të stafit të ri nëpërmjet komandimit të përkohshëm, përveç rasteve emergjente të parashikuara në kodin e Punës.



Në vazhdim

15. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për shpenzimet e pensioneve, Drejtoria e Financës në ISSH, vlerën e shpenzimeve off-line⁷⁰ e merr të konfirmuar nga Rajonet, duke qenë se dokumentet mbështetëse ndodhen nëpër Rajone, dhe nga sistemi IT këto të dhëna nuk vijnë në kohë reale. Për të rritur nivelin e sigurisë për vlerat e llogarive që lidhen me shpenzimet e pensioneve në nivel të konsoliduar, përzgjedhëm në mënyrë rastësore një agjenci rajonale (agjencinë e Fierit) dhe konkretisht muajin nëntor, ku në përfundim **nuk** na rezultuan diferenca⁷¹. Kryerja e verifikimeve të tilla, për të gjitha rajonet kërkon kohë, në kushtet kur ende ka rajone ku pikat postare dhe bankare operojnë off-line, si edhe në kushtet ku në informacionin e gjeneruar nga IT **nuk** përfshihen ato zëra shpenzimesh që lidhen me (a) shpenzimet e varrimit, (b) leje lindjet, dhe (c) karburantin, për të cilat nevojitet forcimi i gjurmës së auditimit sa i takon rrjedhës së dokumentuar të transaksioneve financiare, në përputhje edhe me kërkesat e ligjit nr. Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 205-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

15.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa për të mundësuar kalimin online të të gjitha pikave postare dhe bankare (konstatohet se, ende ka rajone që janë offline); si dhe të mundësojnë që informacioni i plotësuar nga rajonet dhe përpunuar më pas nga IT, sa i takon shpenzimeve të pensioneve, të përfshije ndër të tjera edhe: (a) shpenzimet e varrimit, (b) leje lindjet, (c) karburantin.

Brenda vitit 2019

16. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, kontributet e të vetë-punësuarve në bujqësi për vitin 2017, referuar bilancit përmbledhës⁷² janë realizuar në vlerën 2,126.67 milion lekë dhe se Drejtoria e Financës ndjek dhe kontabilizon në pasqyrat financiare vetëm vlerën e likuiduar nga fermerët, duke lënë jashtë kontabilitetit të dhënat mbi debitorët e krijuar si pasojë e gabimeve, ndjekja e të cilëve vijon të bëhet vetëm nga Dega e Kontributeve të institucionit. Moskontabilizimi i debitorëve për diferencat e papaguara shtrembëron vlerën e regjistruar të debitorëve në kontabilitet. Nga 500 çështje të zgjedhura nga grupi i auditimit për testim në DRSSH/Tiranë, në rastin konkret 500 kontribues për vitin 2017, në 104 prej tyre rezultuan diferenca (mes detyrimit për t'u paguar me vlerën e paguar faktikisht), në shumën totale prej 286,014 lekë, pra me një diferencë debitore mesatare rreth 2,750 lekë/kontribues. Diferenca e konstatuar nga auditimi, edhe pse nën pragun e materialitetit të vlerësuar nga grupi i auditimit, merr rëndësi sa i takon rregullimit të procesit në tërësi, që lidhet me ndjekjen e debitorëve (gjurmimin e zërit respektiv) dhe minimizimin e riskut që ky fenomen paraqet nëse shtrihet në të gjitha njësitë shpenzuese. Sa më sipër e diktuar nga kërkesat që burojnë Manuali Kontabël i ISSH, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 758/2, datë 04.03.2004, ku përcaktohet se: "në klasën 4 evidentohen edhe detyrimet për kontribute dhe kamatëvonesa të papaguara brenda vitit ushtrimor. Llogaritja e

⁷⁰ Shpenzimet që kryhen nga posta, ose bankat, për rajonet ku këto të fundit janë "off"line"

⁷¹ Duke konsideruar se, pikërisht në këtë hallkë të procesit rrezikojmë të kemi "thyerje të kontrollit" nga ana e Drejtorisë së Financës në ISSH, përzgjedhëm 266 çështje⁷¹, nëpërmjet kryerjes së testeve të detajeve, për shifrën e plotë të shpenzimeve për pensione, kontabilizuar në muajin nëntor, në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, Fier. Nga kryerja e testeve të detajeve mbi popullatën e përzgjedhur na rezultoi se vlera prej 500,679,072 lekë e njohur si shpenzim në kontabilitet rakordon me të dhënat e gjeneruara nga sistemi PCAMS (për pjesën on-line të shpenzimeve), plus pjesa off-line 52,919,856 lekë, e verifikuar me dokumentat justifikues (raportet e postës⁷¹) dhe stormuar një nga një nga specialisti i pagesave në Rajon.

⁷² Llogaritë kontabël 753 kontribute & 711 kamatëvonesa



detyrimit për kontribute dhe kamatëvonesa të papaguara realizohet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe në akte të tjera nënligjore". Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 44-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

16.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH/Drejtoria e Financës, të hartojnë dhe miratojnë një udhëzim/urdhër për tu zbatuar nga të gjitha njësitë shpenzuese, mbi njohjen dhe regjistrimin e këtij lloji detyrimi⁷³ në pasqyrat financiare, në mënyrë që ndjekja dhe likuidimi i diferencave të jetë pjesë e ndjekjes dhe monitorimit edhe nga strukturat që mbulojnë aktivitetin financiar të institucionit (drejtoria dhe degët e financës në rajone).

Brenda datës 30.09.2018

17. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, me urdhrin e inventarizimit nr. 9645, datë 11.12.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm në ISSH, janë përcaktuar komisionet për kryerjen e inventarëve, detyrat e komisionit, afatet e përfundimit të inventarëve, etj, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve"; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar; dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Në vijim komisioni ka konstatuar materiale jashtë përdorimi në magazinë me një vlerë 1,029,524 lekë, amortizim të akumuluar prej 733,004 lekë dhe vlerë të mbetur 392,379 lekë. Nga auditimi u konstatua se, ende nuk është marrë ndonjë vendim nga komisioni, për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të evidentuara më sipër, duke konsideruar gjithashtu se sa më sipër është kërkuar edhe në relacionin për inventarizimin e kryer gjatë vitit 2015, 2016 dhe 2017. Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 147-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

17.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH, të evidentojnë përgjegjësinë për situatën e deritanishme, si dhe të ndjekin procedurat ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimi të mallrave të evidentuara nga komisioni i inventarizimit si të papërdorshme nga institucioni prej vitit 2015.

Brenda vitit 2018

18. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi mbi prokurimet me vlera të vogla në Aparatin e ISSH, u konstatua se janë parashikuar 15 procedura blerje me vlera të vogla, me vlerë 7,249 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 18 procedura me vlerë 6,421 mijë lekë, nga ku kemi konstatuar mangësi në drejtim të kriterëve të përcaktuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, ku mungojnë kërkesat nga degët për punë, mallra dhe shërbime pasi ato janë të hartuara nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm dhe miratuar nga titullari, në kundërshtim me Urdhrin Nr. 33, datë 11.07.2013, "Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë", të Ministrisë së Financave. Strukturat drejtuese të ISSH, nuk kanë përcaktuar dhe miratuar rregullat e brendshme për gjurmët e auditimit për blerjet me vlera të vogla⁷⁴, me qëllim që të sigurohet dokumentimi i operacioneve të njësisë publike në atë formë, që t'u mundësojë audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse, të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Konkretisht u konstatua se:

-Mungojnë kërkesat nga degët për nevojën e kryerjes së prokurimit/shërbimit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015, "Për prokurimet me vlera të vogla" pika 4, si dhe Urdhrin e

⁷³ Vlera e debitorëve të krijuar si pasojë e gabimeve në llogaritje të dala nga sistemi

⁷⁴ në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin,



Ministrisë Financave nr. 57, datë 12.06.2014, Gjurma Standarde e Auditimit, ku përcaktohen hapat që ndiqen në prokurimin me vlerë të vogël.

-Procedurat për blerjet me vlera të vogla, në shumicën e rasteve janë kryer në formë shkresore, nëpërmjet formularit të emergjencës ose si pasojë e anulimit të procedurës në sistemin elektronik.

-Mangësi në ofertat e paraqitura të cilat janë pa data ose në disa raste datojnë 1-3 ditë më parë/ më vonë, se të lind nevoja për kryerjen e prokurimit në kundërshtim me VKM nr. 914, date 29.12.2014 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik” të Ministrisë së Financave.

-Autoriteti kontraktor ka zhvilluar 3 procedura prokurimi me vlera të vogla⁷⁵, dhe jo “Kërkesë për propozim”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 28/2 “Metodat e llogaritjes së vlerës në kontratat publike”,

-Njësia e prokurimit nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit Publik;

- Në kushtet kur, cilësia dhe çmimi përcaktohen/diferencohen në specifikimet teknike, konstatojmë mungesa të specifikimeve teknike në disa procedura të kryera për blerjet me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” dhe VKM nr. 914, datë 20.12.2014, neni 27.

-Në 5 raste, pagesat e kryera për prokurime mallra dhe shërbime, kanë mangësi në plotësimin me dokumente justifikues, procesverbale, etj, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, “Dokumentimi i lëvizjes së tyre”. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 149-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

18.1 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Titullari i institucionit, të hartojnë dhe miratojnë rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve.

-Autoriteti kontraktor, të marrë masa, që të mos kalohet asnjë blerje apo shërbim me procedurë të vogël jashtë platformës elektronike, në respektim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi.

-Njësia e Prokurimit, të marrë të gjitha masat, që specifikimet teknike, të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kriteret të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik, me qëllim arritjen e mallrave dhe shërbimeve me cilësinë e kërkuar.

-Autoriteti kontraktor, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, në Agjencinë e Prokurimit Publik, me qëllim përmirësimin e punës së Njesisë së Prokurimit.

Në vazhdim

19. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i prokurimeve në Aparatin e ISSH u konstatua se, Autoriteti Kontraktor (AK) nuk ka realizuar prokurimet e parashikuara, pasi nga 9 procedura të parashikuara me vlerë 89,833 mijë lekë, është realizuar 1 procedurë vlerë 4,990 mijë lekë (ose 5.5% e parashikimit), ndërsa janë anuluar 2 procedura nga Komisioni i Prokurimit Publik, me objekt “Blerje shtypshkrime” me fond limit 5,500 mijë lekë dhe “Blerje rafte metalike” me fond limit 5,900 mijë lekë,.

⁷⁵ me objekt “Blerje kancelari” me fond limit 250 mijë lekë, “Blerje tonera” me fond limit 800 mijë lekë dhe “Blerje letër A4” me fond limit 600 mijë lekë, me fitues të njëjtin operator ekonomik “Infosoft”, në shumën 1,650 mijë



Në lidhje me procedurat e prokurimit të parashikuara dhe të pa realizuara vlerësojmë se parashikimi nuk është kryer bazuar në nevojat reale të institucionit, sepse nuk konstatohen ndërprerje/mangësi në kryerjen e detyrave edhe nga moskryerja këtyre e prokurimeve. AK, nuk ka programuar drejt e sipas nevojave vjetore sasinë e mallrave/punëve dhe shërbimeve, në kundërshtim kjo me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duke realizuar kështu prokurimet në masën vetëm 5.5% nga sa ishin planifikuar. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 149-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

19.1 Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të evidentojë përgjegjësitë dhe në bashkëpunim me njësinë e prokurimit dhe degën e administrimit, të hartojnë nevojat për punë, mallra dhe shërbime, bazuar në nevojat reale, me qëllim arritjen e prioriteteve të caktuara dhe prokurimeve me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë. Në asnjë rast të mos realizohen procedura prokurimi nëse ISSH nuk disponon sasinë e fondeve të nevojshme për të kryer këto procedura.

Në vazhdim

20. Gjetja nga auditimi: Mbi auditimin e procesit të certifikimit të pensioneve u konstatua sa vijon:

- Referuar programit të kontrollit vjetor me nr. ekstra , datë 08.01.2017, u konstatuan pensione të pa certifikuar në 5 DRSSH për vitet 2016 e në vazhdim duke kaluar afatet kohore të parashikuara të kontrollit të pensioneve. Referuar nenit 62 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar ", ky afat është 3 vjet dhe përcaktohet si afat parashkrimi për pensionet e njohura dhe të paguara. Pikërisht brenda këtij afati duhet kryer kontrolli për gjithsej 96,321 dosje, të trajtuara sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, dhe për 5,661 dosje të trajtuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 dhe akteve të tjera nënligjore që burojnë prej këtij ligji. .

- Gjithashtu përgjatë vitit 2017, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve në ISSH u konstatua dëm ekonomik në shumën prej 39,068,896 lekë, i shkaktuar në periudhën që përfshin vitin 2013 deri më 2015, nga lidhja e pensioneve në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", dhe në shumën prej 13,536,146 lekë nga lidhja e pensioneve në zbatim të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 (suplementi shtetëror), ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, ligjit nr. 10139, datë 15.05.2009, ligjit nr. 8607, datë 27.04.2000, detyrime të cilat institucioni duhet t'i paguajë, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë". E konkretisht, detyrimet kreditore rezultojnë të shlyera brenda vitit dhe detyrimet debitorë janë kontabilizuar dhe pagesat kryhen çdo muaj në DRSSH⁷⁶. Certifikimi si proces kontrolli është i rëndësishëm dhe kryerja e këtij procesi për çdo vit, ka të bëjë direkt në përdorimin me efektivitet të fondeve të pensioneve, dhe identifikimin e në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara nga mos zbatimi me korrektësi i akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 171-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

20.1 Rekomandimi: Institucioni të marrë masa që të përfundojë kontrollin për 3,613 dosje të identifikuar në 5 DRSSH (DRSSH Vlorë, Tiranë, Kukës, Durrës), në zbatim të ligjit nr. 7703,

⁷⁶ Referuar verifikimit të kryer në sistem nga auditimi i disa dosjeve me detyrime debitorë dhe kreditore e konkretisht në DRSSH Tiranë, dosjet me nr. 218939, me nr.217737, me nr.222054 dhe në DRSSH Vlorë dosjet me nr. 134988, 137753, 139965 dhe nr. 140618.



datë 11.05.1993, i ndryshuar ; dhe për 596 dosje të identifikuara të pensioneve për suplementin nga viti 2014 deri më fund të vitit 2016 në 5 DRSSH (Berat, Gjirokastër, Korçë, Tiranë dhe Shkodër). Institucioni të marrë masa që të përfundojë kontrollin dhe certifikimin e dosjeve të pensionit për 96,321 dosje nga viti 2014 e në vazhdim për 12 DRSSH ku janë konstatuar këto dosje. Institucioni të përfundojë kontrollin nga viti 2014, 2015, 2016, 2017 për 5,661 dosje në 12 DRSSH, që rezultojnë të lidhura për pension suplementar, por që vijnë të jenë të pa kontrolluara nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve.

20.2 Rekomandimi: Institucioni të marrë masa që planifikimi i kontrolleve dhe certifikimi i pensioneve nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve të kryhet brenda vitit të lidhjes së tyre, me qëllim identifikimin e në kohë të mangësive dhe dëmeve të shkaktuara nga mos zbatimi me korrektësi i akteve ligjore të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, në mënyrë që fondet për pensione të përdoren me efektivitet në përputhje me kërkesat e nenit 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vazhdim

21. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2017 **nuk** janë lënë gjurmë në sistemin e të dhënave të sigurimeve shoqërore për të gjitha dosjet e certifikuara nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve. E konkretisht rezultojnë pa komente për DRSSH Durrës gjithsej 3,759 dosje nga 10,948 dosje të kontrolluara; për DRSSH Tiranë gjithsej 3,759 dosje nga 17,201 dosje të kontrolluara; për DRSSH Vlorë 2,353 dosje për 7,143 dosje të kontrolluara; për DRSSH Sarandë 506 dosje nga 3,809 dosje të kontrolluara; për DRSSH Kukës 478 dosje nga 955 dosje të kontrolluara; dhe për DRSSH Tropojë 76 dosje nga 249 dosje të kontrolluara.

Gjithashtu është konstatuar që nga Njësia e Inspektimit të Pensioneve nuk është përcaktuar një “fjalor i unifikuar”, në mënyrë që komentet të jenë të unifikuara dhe sipas një formati gjithëpërfshirës. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 171-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

21.1 Rekomandimi: Për të lënë gjurmë të kontrollit dhe certifikimit të pensioneve në sistemin e të dhënave ndër vite me qëllim monitorimin e këtij procesi të rëndësishëm dhe përdorimit me efektivitet të fondeve për pensione të çdo lloji në 12 DRSSH, nga strukturat drejtuese të ISSH të merren masa që sistemi i hedhjes së të dhënave të pensioneve, të hartojë module ku të reflektohen gjatë hedhjes së të dhënave nga Njësia e Inspektimit të Pensioneve shënimet për çdo dosje të kontrolluar dhe të certifikuar, me qëllim lënien e gjurmëve të kontrollit të dosjeve të pensioneve.

Në funksion të sa më sipër, Njësia e Inspektimit të Pensioneve nevojitet të krijojë një “Fjalor të unifikuar”, në mënyrë që komentet në sistem, në përfundim të kontrollit të përfitimeve të pensioneve të jenë të unifikuara dhe sipas një formati gjithëpërfshirës informacioni.

Në vazhdim

22. Gjetja nga auditimi: - Nga auditimi u konstatuan problematika në lidhje me mosrespektimin e afateve të lidhjes së pensioneve për vitin 2017, në referencë të pikës 3 të nenit 85 të ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, si më poshtë vijon:

Për vitin 2017, nga 34,458 dosje pensioni të lidhura për 12 DRSSH-të, nga evidencat e Drejtorisë së Përfitimeve rezultoi se: 88,1% e tyre ose 32,132 pensione, janë lidhur brenda afatit maksimal



ligjor (45 ditë) dhe koha mesatare e përcaktimit të tyre rezultoi 20,9 ditë; ndërsa rezultuan me tejkalim të afatit ligjor 8% e pensioneve ose 2,326 pensione, koha mesatare e përcaktimit të të cilave rezultoi rreth 88 ditë. Raste konkrete për vitin 2017, cilësojmë DRSSH Berat, Tiranë dhe Elbasan me 150 pensione të lidhura jashtë afatit ligjor me 2 deri në 5 muaj, dhe DRSSH Fier, Lezhë dhe Dibër me 280 pensione lidhur nga data 3 deri në 5 muaj.

-Faktorë që kanë ndikuar në mos-lidhjen në afat të pensioneve, janë edhe mungesat e dokumentacionit përkatës për periudhën e sigurimit dhe si pasojë njohja e vjetërsisë, ku gjithashtu ka ndikuar edhe mos-dërgimi në Degën e Arkivës të ISSH/ Tiranë, i dokumenteve të para vitit 1994, siç janë regjistrat me të dhënat e punësimit dhe listëpagesat e punonjësve nga institucione qendrore dhe lokale. Në vijim na rezultoi se ende nuk janë dërguar në ISSH, regjistrat e vjetërsisë në punë të Institucioneve Qendrore dhe Ministrive që vijnë në aktivitet, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 464, datë 22.07.1998 “Për krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore”. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 171-180 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

22.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në ISSH, me qëllim uljen e numrit të ditëve për përlogaritjen e pensioneve si dhe rritjen e saktësisë së tyre, të marrin masa për të shtuar trajnimet për punonjësit që merren me përlogaritjen dhe caktimin e pensioneve.

Strukturat drejtuese në ISSH të marrin masa për identifikimin dhe publikimin e listës së institucioneve që ende nuk kanë dërguar në ISSH regjistrat e vjetërsisë në punë dhe listëpagesat e institucioneve qendrore dhe ministrive, me qëllim përfundimin me sukses të procesit të dixhitalizimit dhe të skanimit të regjistrave të vjetërsisë në punë dhe të listëpagesave.

Menjëherë dhe në vazhdim

23. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, gjatë vitit 2017 janë kryer pagesa për shpenzime qiraje për zyra dhe për nevoja magazinimi, sipas kontratave respektive vjetore, në shumën prej 10,001 mijë lekë për 8 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me një sipërfaqe totale 2.490 m². Këto ambiente me qira, të marra për nevoja pune vijnë prej vitit 2009 (rastit i DRSSH Berat) dhe vitit 2012 e në vazhdim (rastet e DRSSH Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Kukës, Shkodër, Vlorë, e Sarandë). Nga auditimi u konstatua se, mungesa e kryerjes së një analize mbi eficientësinë e fondeve të përdorura për këtë qëllim, që në fazën e planifikimit të shpenzimeve, mbart risqe që lidhen me mospërdorimin e fondeve me efektivitet. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqen 70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

23.1 Rekomandimi: Nga strukturat përgjegjëse në ISSH të merren masa që të shikohet mundësia e përdorimit të ambienteve të tjera që janë pronë shtetërore e pushtetit vendor; ose gjatë planifikimit të shpenzimeve të kryhen analiza të mirëfillta kosto-efektiviteti, duke u vlerësuar mundësia për parashikimin e fondeve të investimit për blerje ambiente zyrash për nevojat e institucionit, nëse pas analizës kostot e qiramarrjes do të rezultojnë më të mëdha se ato të blerjes së ambienteve, për periudhat e parashikuara kohore.

Në vazhdim

24. Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH u konstatua se në periudhën 01.01.2017-07.11.2017, llogaritja e pagës neto të punonjësve ishte kryer në kundërshtim me nenin 130, pika 1 e Kodit të Punës i cili citon se: “Kur punëmarrësi nuk mund të punojë për shkak të sëmundjes, punëdhënësi i jep atij jo më pak se 80% e pagës për



një periudhë prej 14 ditësh të pambuluara nga sigurimet shoqërore". Për periudhën e mësipërme, ISSH ka aplikuar zbritjen në masën 70% për punonjësit që kanë më pak se 10 vite eksperiencë punë në ISSH, dhe 80% për ata që kanë mbi 10 vite, duke cituar si bazë ligjore nenin 23, pika 1 dhe nenin 25 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i cili faktikisht i referohet periudhës së paaftësisë për punë pas 14 ditësh, e që mbulohet nga sigurimet shoqërore. Më pas, në muajin nëntor, ky gabim është konstatuar nga ISSH, ku me urdhrin nr. 9029 datë 08.11.2017, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH ka njoftuar drejtoritë e ISSH për kryerjen e saktë të llogaritjes së pagës (pra 80% e pagës për punonjësit, pavarësisht eksperiencës së tyre në institucion). Kjo është një problematikë e evidentuar edhe në subjekte të tjera shtetërore, nga auditimet e KLSH-së, ku është konstatuar zbritja në pagë për shkak të raportit mjekësor, në varësi të eksperiencës së punës, në kundërshtim me nenin 130, pika 1 e Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 139-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

24.1 Rekomandimi: Duke marrë në konsideratë problematikën që lidhet me interpretime të ndryshme që institucione të ndryshme buxhetore i bëjnë vlerësimit dhe përlllogaritjes së ditëve me raport mjekësor nën 14 ditë, ku herë mbështeten mbi Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë dhe herë mbi Ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në funksion të përmirësimit të punës, rekomandojmë që ISSH të përgatis një dokument njoftues, gjithëpërfshirës ku të bëhen me dije institucionet shtetërore se, për përlllogaritjen e ditëve me raport mjekësor **mbi 14 ditë**, referenca është Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, ndërsa për ditët me raport **nën 14 ditë**, Kodi i Punës, duke qenë se sa më sipër ka lënë hapësirë për interpretime.

Brenda datës 30.08. 2018

25. Gjetja nga auditimi : KLSH në auditimin e mëparshëm për përmirësimin e punës në ISSH ka rekomanduar 17 masa organizative. Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, rezultoi se nga ISSH janë pranuar 17 rekomandime të lëna nga KLSH, nga të cilat 4 rekomandime janë zbatuar, 8 rekomandime janë në proces, 4 rekomandime nuk janë zbatuar dhe 1 rekomandim është zbatuar pjesërisht. *Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet 162-171 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

25.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH, me qëllim përmirësimin e punës të marrin masa të përcaktojnë personat përgjegjës dhe të analizojnë nivelin e zbatimit të rekomandimeve, me qëllim zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces, si edhe të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht dhe të pa zbatuara, konkretisht:

- Drejtori i Përgjithshëm i ISSH të marrë masa që ISSH të ndërtojë dhe zbatojë një strategji të menaxhimit të burimeve njerëzore duke e mbështetur dhe me financimet përkatëse për realizmin me sukses të saj (*statusi i rekomandimit "i pranuar dhe i zbatuar pjesërisht"*);

- Nga Strukturat Drejtuese e Menaxhuese të ISSH dhe Ministrisë së Financës, të bëhet analiza dhe rregullimi i të gjitha rasteve përjashtimore nga ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, brenda kufirit maksimal të përcaktuar në VKM nr.730, datë 02.09.2015 "Për një ndryshim të VKM nr.429, datë12.02.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurat e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore", në mënyrë që të eliminohen standardet e dyfishta që për të



drejta të barabarta përfitimi të mos jetë i njëjtë (*statusi i rekomandimit “i pranuar dhe i pazbatuar”*);

- Nga Strukturat Drejtuese e Menaxhuese të ISSH dhe Ministrisë së Financës, të bëhet analizimi dhe evidentimi i të gjitha rasteve të invalidëve të krijuar nga viti 2008 e në vazhdim, në mënyrë që edhe këta invalidë të përfitojnë furnizimet me karburant dhe mjetet lëvizëse nga këto shpenzime që u takojnë me ligj (*statusi i rekomandimit “i pranuar dhe i pazbatuar”*);

- Për të shmangur parregullsitë e korigjimet në përmbledhësen e pasqyrave financiare të ISSH, në udhëzimin e MF, të përcaktohet një datë e realizueshme për ISSH të mbylljes së transaksioneve vitit ushtrimor. Dorëzimi i përmbledhëses së pasqyrave financiare, të realizohet pas rakordimit përfundimtar për të ardhurat me Drejtorinë e Tatimeve dhe Ministrinë e Financës, duke eliminuar kështu korigjimin e të ardhurave pas dorëzimit të pasqyrave përmbledhëse financiare. Nga strukturat menaxhuese të ISSH, FDSKSH dhe MF, të bëhet sistemimi i llogarisë 44 “Institucione të tjera publike” në shumën 275.5 milion lekë, duke respektuar nga MF, të ardhurat që i takojnë institucioneve ISSH dhe ISKSH (*statusi i rekomandimit “i pranuar dhe i pazbatuar”*);

- ISSH të rishikojë periodikisht kontratat tip të punës për përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi dhe nëse vlerësohet e arsyeshme të dërgojë për miratim në KA ndryshimet përkatëse në to. ISSH të rishikojë dosjet e personelit për të siguruar që informacioni i administruar në to është i plotë dhe dokumenton të gjithë procesin nga rekrutimi, vlerësimi, ndryshimet në vendin e punës e deri në shkëputjen e këtyre marrëdhënieve nga punëmarrësi. Gjithashtu ISSH duhet të vlerësojë nevojën për ndryshime në rregulloret dhe procedurat përkatëse për të garantuar që procesi i menaxhimit dhe vlerësimit të burimeve njerëzore të mbështesë dhe nxisë përmbushjen e objektivave prioritare të ISSH (*statusi i rekomandimit “i pranuar dhe i pazbatuar”*);

Brenda vitit 2018

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”i ndryshuar, nenet 37, 141, 153 pikat 1 dhe 2, Rregulloren e Personelit, pika V. 1, 2, 3, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, analizimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimin nr. 65, datë 28.06.2018 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe ngritjen e Komisionit të Disiplinës për fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, nëpunësve përgjegjës.

VII. ANEKSE

Bashkelidhur këtij projektraporti, janë:

1. ANEKSI 1 – Tabela Fiskale 2017
2. ANEKSI 2 – Regjistri i Aktiveve të Patrupezuara, Aparati
3. ANEKSI 3 - Pasivi i Bilancit Kontabël
4. ANEKSI 4 - Për përzgjedhjen e çështjeve për shqyrtim – Pasqyrat e Konsoliduara
5. ANEKSI 5 - Rezultatet e testeve të kryera mbi shpenzimet për përfitime online dhe kontabilizimin e tyre (DRSSH/Fier), përfshirë edhe proceset



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”

6. ANEKSI 6 – Mbi certifikimin e pensioneve
7. **Te lidhura me link (mbi testet ne DRSSH,Fier):** Raporti i pagesave të kryera për pikën paguese [3. Pasqyra e konsoliduar\Per Bilancin 2017\Bilanci 2017\BANKAT OFFLINE.pdf](#) ; Praktika (dosja fizike) për pagesat sipas qendrave paguese [3. Pasqyra e konsoliduar\Per Bilancin 2017\Bilanci 2017\praktika e nje qender paguese poste-sigurime.pdf](#); përplasja e shifrave për verifikimet e pagesave off-line dhe on-line [3. Pasqyra e konsoliduar\Per Bilancin 2017\Bilanci 2017\Teste Agjencia Fier.xlsx](#)

VIII. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

Pjesë përbërëse e këtij Raporti Auditimi është dhe dokumentacioni i mbajtur dhe i dorëzuar nëprotokollin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore si më poshtë:

1. Aktverifikimi nr.1, datë 19.03.2018
2. Aktverifikimi nr.2, datë 19.03.2018
3. Aktkonstatimi nr.1, datë 15.03.2018
4. Aktkonstatimi nr.2, datë 19.03.2018
5. Aktkonstatimi nr.3, datë 19.03.2018
6. Aktkonstatimi nr.4, datë 19.03.2018
7. Aktkonstatimi nr.5, datë 19.03.2018
8. Aktkonstatimi nr.6, datë 19.03.2018
9. Aktkonstatimi nr.7, datë 19.03.2018
10. Aktkonstatimi nr.8, datë 28.03.2018
11. Aktkonstatimi nr.9, datë 04.04.2018
12. Aktkonstatimi nr.10, datë 15.04.2018
13. Aktkonstatimi nr.11, datë 15.04.2018
14. Aktkonstatimi nr. 12, datë 15.04.2018

Përsa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTRILLI I LARTË I SHTETIT